

32
C 11

LOG NARODA



hjen 1974.

Wieder zu stoppen. Sogar die 21:00
die Rehabilitation des berichtigten
minister's Bankovs' in Teil der
strategische Man will damit die
Umschreibung im Kosovo in der
Vorgangsbildung rechtfertigen.
SPIEGEL: Kürzlich war eine Delega-
tion des Europaparlaments im Kosovo.
sion haben auch mit ihnen gesprochen.
Die serbische Presse hat den Abgeord-
neten deshalb vorgeworfen, sie hätten
nur Kontakt zu Separatisten gesucht.
RLGOV: Das Gegenteil ist richtig.

Ko su potpisnici

Ç'NUK QENKA SHQIPT ARIZIM!

Ç' THONE DHE Ç' KERKOJNE KOSOVARET

...stav i
ustavom zašti-
...ustavom polo-
...osnovama načela
Nalaznut najbratovljenijim
...prilicnostima socijalističene re-



32
C 11
~

Ç'THONË DHE Ç'KËRKOJNË KOSOVARËT

(Përmbledhje studimesh, artikujsh,
intervistash dhe komentesh)



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Redaktorë HARILLAQ KEKEZI
REXHEP HIDA

Piktor ARDIAN KARAKASHI

Libri që po paraqitim, përfshin një numër intervistash, bisedash e shkrimesh të ndryshme të disa prej intelektualëve më përfaqësues shqiptarë të Kosovës, të botuara kohët e fundit në shtypin jugosllav e të huaj.

Fjala e tyre shpreh ato beteja krenare, të dhimbshme e tragjike, që ata kanë bërë e po bëjnë për mbrojtjen e të drejtave kombëtare e demokratike të popullit të tyre të shumëvujtur, atë guxim të lartë intelektual për denoncimin e padrejtësisë e të diskriminimit nacional, atë ndjenjë të thellë përgjegjësie për fatet e njeriut të thjeshtë.

Shkrimet, që përmban kjo përmbledhje, megjithëse të censuruara e të vetëcensuruara, e pasqyrojnë drejt dramën kosovare.

Ne nuk duam të flasim në emër të intelektualëve kosovarë. Ata dinë ta mbrojnë vetë kauzën e popullit të tyre, dinjitetin e personalitetin e tyre si njerëz e si intelektualë. Ata i përkasin një populli, që nuk kërkon mëshirë e lëmoshë. I përkasin një formimi kulturor historik, që i bën të jenë të papërkulur përpara dhunës, shtypjes e arbitraritetit. U përkasin atyre njerëzve, që në kohët e sotme luftojnë për aspiratat më të larta e më të ndritura të popujve, siç janë liria, barazia, demokracia e të drejtat e vërteta njerëzore.


Duke paraqitur këtë libër, do të donim vetëm të theksonim se fjalët e tyre janë të sinqerta, mendimet e tyre janë të qarta, zemra e tyre është e hapur. Prandaj jemi të bindur se kushdo, që do t'i lexojë këto shkrime, nuk do të mbetet indiferent ndaj zërit të intelektualëve shqiptarë të Kosovës, që mbrojnë një të vërtetë — atë që

nuk mund të ketë bukë pa liri, se shtypja nacionale është një nga të këqijat, me të cilën njerëzimi përparimtar nuk është pajtuar kurrë.

Aleks Buda, kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH; **Alfred Uçi**, kryetar i Komitetit të Kulturës dhe Arteve; **Androkli Kostallari**, drejtor i Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë; **Arben Puto**, përgjegjës i Sektorit Shkencor të Degës së Drejtësisë në Universitetin e Tiranës «Enver Hoxha»; **Çesk Zadeja**, kompozitor; **Dalan Shaplo**, shef i Sektorit të Folklorit Gojor në Institutin e Kulturës Popullore; **Dritëro Agolli**, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë; **Dhimitër Shuteriqi**, kryetar i Komitetit Shqiptar për Mirëkuptimin dhe Bashkëpunimin Ballkanik; **Ismail Kadare**, shkrimtar, nënkryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë; **Luan Omari**, jurist, sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave të RPSSH; **Sofokli Lazri**, drejtor i Institutit të Studimit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare; **Stefanaq Pollo**, drejtor i Institutit të Historisë; **Zija Xholi**, përgjegjës i Katedrës së Historisë së Filozofisë në Universitetin e Tiranës «Enver Hoxha».

I

NDRYSHIMET NË KUSHTETUTËN E RS TË SERBISË DHE PASOJAT PËR STATUSIN JURIDIK TË KOSOVËS



A P E L

**I PUNËTORËVE SHKENCORË DHE KULTU-
RORË PËR MBROJTJEN INSTITUCIONALE
DHE AFIRMIMIN E POZITËS KUSHTETUESE
TË KOSOVËS MBI BAZËN E PARIMEVE
THEMELORE TË KUSHTETUTËS SË RSFJ-së,
DREJTUAR KUVENDIT TË RS TË SERBISË
DHE OPINIONIT TË JUGOSLLAVISË**

Me vetëdije të plotë se përmbajtja dhe vlera e pozitës kushtetuese të Kosovës përfaqëson në thelb përmbajtjen dhe vlerën kushtetuese të popullsisë së Kosovës dhe, si e tillë, vlerën e posaçme reale dhe emocionale të popullsisë shqiptare të Kosovës;

me vetëdije të plotë se Kosova nuk është dhe as që mund të jetë pronë politike njënacionale e cilitdo nacionaliteti të saj dhe e çfarëdo nacionaliteti jashtë saj, e aq më tepër as Kosovë mesjetare, as Kosovë paramesjetare, as Kosovë e raportit të forcave të luftërave ballkanike dhe as Kosovë e raportit të forcave gjatë Luftës së Dytë Botërore, por Kosovë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e Revolucionit Socialist, pra, jo Jug i Serbisë ose Serbi e Vjetër, sipas koncepteve nacionalhegjemoniste reaksionare të Nikolla Pashiçit dhe të ithtarëve të tij

e politik të të gjitha kombeve e kombësive në Jugosllavinë e re, e në këtë kuadër edhe të klasës punëtore dhe të inteligjencies shqiptare në Jugosllavi. Së këndejmi, vlerësimet e shpeshta kalkulative dhe pragmatike politike mbi gjoja mosinformimin dhe dezinformimin e popullit shqiptar në Kosovë për përmbajtjen dhe kahun e ndryshimeve kushtetuese janë nënçmuese jo vetëm për një popull, por edhe për rrjedhat emancipuese të gjer-tanishme në Jugosllavi. Janë po ashtu fare kalkulative dhe të pavërteta pohimet e shpeshta pragmatike politike se populli shqiptar në Jugosllavi është kundër ndryshimeve kushtetuese në tërësi. Dihet fare mirë se kërkesa masive për mosprekjen e parimeve themelore kushtetuese dhe të Kushtetutës së vitit 1974 ka kuptim metaforik politik për mosprekje të pozitës kushtetuese të KSA të Kosovës, si kërkesë tejet e drejtë dhe plotësisht legjitime.

Pyesim çdo njeri dhe çdo popull me vullnet të mirë: si është e mundur dhe çfarë drejtësie do të ishte kjo, nëse shqiptarëve në Jugosllavi do t'u ngushtohej ajo shkallë e vetëqeverisjes politike, e cila viteve të shtatëdhjeta, me vullnet të përbashkët politik, u konsistua pikërisht nëpërmjet pozitës së tashme të KSA të Kosovës si bashkësi e nacionaliteteve të barabarta të saj. Besojmë se nuk kemi nevojë që edhe me këtë rast të citojmë fjalët afirmative të Titos dhe të Kardelit për pozitën e tashme kushtetuese të Kosovës. Le ta zgjojmë zërin e arsyes duke pyetur: mos vallë kushtetutëdhënësi i viteve të shtatëdhjeta dhe personalitetet politike më të shquara të asaj kohe nuk dinin se ç'është «thelbi i autonomitetit», shikuar në raportet reale ndërnacionale dhe të kolektiviteteve nacionale?

Ngushtimi eventual i pozitës kushtetuese të Kosovës do të shkaktonte te shqiptarët ndjenjën objektive se po i merret jo diçka që u është dhuruar, por ajo që u takon burimisht.

Për shkak se është në shpërputhje me kahun themelor të rrjedhave emancipuese në shoqëri, ngushtimi i pozitës kushtetuese të Kosovës ka karakter kundërhistorik, si dhe për shkak se ngushtimi i pozitës kushtetuese të Kosovës (si autonomi e ndërtuar mbi bazën na-

cionale) nënkupton forcimin e shtetësisë së një populli mbi tjetrin, një ngushtim i tillë s'mund të ketë objektivisht përmbajtje humaniste.

E gjithë kjo do të thotë se qëndrimi dhe apeli ynë nënkuptojnë vetërespektin dhe respektin e sinqertë të ndërsjellë të kombeve dhe të kombësive.

Së këndejmi apelin tonë, drejtuar Kuvendit të RS të Serbisë dhe opinionit të Jugosllavisë, e konsiderojmë të drejtë, legjitim dhe të arsyeshëm.

Duke ftuar opinionin e Jugosllavisë që të përkrahë apelin tonë, themi se ne si përkrahje në rend të parë çmojmë mirëkuptimin. Kuvendit të KSA të Kosovës, ndërkaq, i takon obligimi dhe roli vendimtar për mbrojtjen institucionale të pozitës kushtetuese të Kosovës, në kuptim të mosdhënies së pëlqimit për cilindo amendament, me të cilin do të reduktoheshin në çfarëdo mase të drejtat dhe detyrat e KSA të Kosovës, përkatësisht kualiteti dhe shkalla e pavarësisë së tyre.

Prishtinë, 21 shkurt 1989

Punëtorët shkencorë
dhe kulturorë të Kosovës
(Pason lista e të nënshkruarve)

APELI iu dërgua:

Kuvendit të RS të
Serbisë, mjeteve të informimit publik në Jugosllavi

Iu dërgua po ashtu:

Kryesisë së RSFJ-së,
Kryesisë së KQ të LKJ-së,
Kryesive të republikave
dhe të krahinave,
Kryesisë së Konferencës,
Krahinore të LSPP të Kosovës.

Nënshkruesit e Apelit të punëtorëve shkencorë dhe kulturorë për mbrojtjen institucionale dhe afirmimin e

pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të kushtetutës së RSFJ-së drejtuar Kuvendit të RS të Serbisë dhe opinionit të Jugosllavisë:

- | | |
|---------------------|------------------------|
| 1. Agim Çavdërbasha | 35. Behxhet Krasniqi |
| 2. Abdyl Kadolli | 36. Beqir Shkreli |
| 3. Abdyl Rama | 37. Besim Bokshi |
| 4. Abdyllatif Fusha | 38. Binak Kastrati |
| 5. Abdyl Krasniqi | 39. Binak Kelmendi |
| 6. Abdulla Vokrri | 40. Bujar Bukoshi |
| 7. Adem Limani | 41. Burbuqe Pustina |
| 8. Adem Rrusta | 42. Burim Hatipi |
| 9. Agim Deva | 43. Dalip Limani |
| 10. Agim Vinca | 44. Dervish Rozhaja |
| 11. Agni Dika | 45. Emine Gashi |
| 12. Agron Dobroshi | 46. Emine Halimi |
| 13. Agron Kërliu | 47. Engjëll Berisha |
| 14. Agron Krasniqi | 48. Enver Maloku |
| 15. Agron Pustina | 49. Enver Mehmeti |
| 16. Agush Beqiri | 50. Eqrem Basha |
| 17. Ahmet Kelmendi | 51. Elvin Ahmeti |
| 18. Ajri Begu | 52. Ejup Pllana |
| 19. Ali Aliu* | 53. Esat Dujaka |
| 20. Ali Aliu** | 54. Esat Mekuli |
| 21. Ali Olloni | 55. Eshref Biçaku |
| 22. Ali Podrimja | 56. Eshref Osmani |
| 23. Ali Zatriqi | 57. Evliana Bajçinovci |
| 24. Atdhe Gashi | 58. Fadil Bujari |
| 25. Anton Çetta | 59. Faik Hima |
| 26. Arsim Morina | 60. Fatmir Dalladaku |
| 27. Asene Agai | 61. Faton Agani |
| 28. Avni Brovina | 62. Faton Hoxha |
| 29. Avni Spahiu | 63. Fazlli Zyferi |
| 30. Bajram Krasniqi | 64. Fehmi Agani |
| 31. Bajram Kabashi | 65. Fehmi Bojaxhiu |
| 32. Basri Ibrahim | 66. Fehmi Rexhepi |
| 33. Bedri Bakalli | 67. Fëllanza Gjinolli |
| 34. Behar Zogiani | 68. Flamure Selimi |

*) Ali Aliu, kritik letrar, doktor i shkencave filologjike.

***) Ali Aliu, gazetar.

- | | |
|-----------------------|-------------------------|
| 69. Flora Brovina | 110. Mehmet Gërguri |
| 70. Gani Mulliqi | 111. Mehmet Maxhuni |
| 71. Gani Hoxha | 112. Mehmet Kraja |
| 72. Gazmend Kaçaniku | 113. Mehmet Surdulli |
| 73. Gazmend Shaqiri | 114. Mensur Pozhegu |
| 74. Gazmend Zajmi | 115. Muharrem Bajrami |
| 75. Gani Bobi | 116. Muharrem Bulliqi |
| 76. Halit Ahmetaj | 117. Muharrem Kutllovci |
| 77. Halit Hoxha | 118. Muharrem Jakupi |
| 78. Halit Ymeri | 119. Muharrem Gashi |
| 79. Hajrulla Gorani | 120. Muharrem Saliu |
| 80. Hajredin Ukelli | 121. Muhamed Blakaj |
| 81. Hakif Bajrami | 122. Muslim Mulliqi |
| 82. Hamide Latifi | 123. Muslim Abdyli |
| 83. Hasan Ahmeti | 124. Mustafë Lecaj |
| 84. Hasim Saliu | 125. Murat Blaku |
| 85. Hivzi Islami | 126. Nagip Rexhepi |
| 86. Hasni Arifi | 127. Nazim Qehaja |
| 87. Hysni Hoxha | 128. Nehat Islami |
| 88. Hyri Daka | 129. Nexhat Krasniqi |
| 89. Ibrahim Kadriu | 130. Nexhmi Hyseni |
| 90. Ibrahim Rexhepi | 131. Nuri Bashota |
| 91. Ibrahim Rugova | 132. Nusret Ramadani |
| 92. Idriz Ajeti | 133. Orhan Kurtati |
| 93. Irfan Pashoja | 134. Osman Imami |
| 94. Ismet Shaqiri | 135. Osman Zeka |
| 95. Isuf Berisha | 136. Qamile Morina |
| 96. Jusuf Bajraktari | 137. Qazim Hyseni |
| 97. Jusuf Buxhovi | 138. Ramadan Bislimi |
| 98. Latif Islami | 139. Ramadan Musliu |
| 99. Liman Matoshi | 140. Ramadan Jashari |
| 100. Liman Rushiti | 141. Ramë Myftari |
| 101. Lirim Shaqiri | 142. Ramiz Abdyli |
| 102. Lulëzim Agai | 143. Ramiz Kelmendi |
| 103. Lumturie Gashi | 144. Ramush Rama |
| 104. Lutfi Dervishi | 145. Ramush Tahiri |
| 105. Mark Krasniqi | 146. Raif Aliu |
| 106. Mazllum Belegu | 147. Rauf Dhomi |
| 107. Mazllum Hasimja | 148. Remzije Belegu |
| 108. Mehmet Emërllahu | 149. Rexhep Ismaili |
| 109. Mehmet Gjata | 150. Rexhep Qosja |

151. Rexhep Hoxha
152. Rexhep Shala
153. Riza Binishi
154. Ruke Beqiraj
155. Rrustem Berisha
156. Rrustem Rugova
157. Sabri Hamiti
158. Salem Lepaja
159. Sadri Bajraktari
160. Sadri Fetiu
161. Sami Beqiri
162. Sami Myzolli
163. Sami Piraj
164. Sali Ahmeti
165. Sali Krasniqi
166. Sahit Maliqi
167. Sehadete Mekuli
168. Sejdulla Hoxha
169. Selim Krasniqi
170. Simë Dobreci
171. Skënder Zogaj
172. Sylejman Aliu
173. Sylë Osmanaj
174. Shaban Geci
175. Shaban Hasi
176. Shefqet Berisha
177. Shefqet Meha
178. Shefqet Lulaj
179. Shefqet Riza
180. Shkëlzen Maliqi
181. Shkëlzen Raça
182. Shpëtim Robaj

183. Shyqëri Galica
184. Talat Gjinolli
185. Talat Pallaska
186. Tafil Morina
187. Tahir Neziri
188. Tefta Ahmeti
189. Teuta Ejupi
190. Ymer Aliu
191. Ymer Bajra
192. Ymer Elezi
193. Ymer Koçinaj
194. Ymer Jaka
195. Vehap Shita
196. Veli Blakçori
197. Vesta Nura
198. Xhavit Bicaj
199. Xhavit Kuçi
200. Xheladin Shala
201. Xheladin Reçica
202. Xhemail Bajraktari
203. Xhemail Mustafa
204. Xhemail Rexhepi
205. Xhemil Bytyçi
206. Xhevat Hasani
207. Zana Bukoshi
208. Zenun Çelaj
209. Zehir Hamiti
210. Zejnel Kabashi
211. Zejnel Kelmendi
212. Zejnulla Rrahmani
213. Zekeria Cana
214. Zekë Gecaj
215. Zeqirja Ballata

«Shto trazhe albanski intelektualci», «Borba», Beograd,
23.2.1989

«Ko su potpisnici», «Borba»,
Beograd, 25.2.1989

Rrustem Rugova

AUTONOMIA E KRAHINAVE NË THUMB

Duke kërkuar që të suprimohen të gjitha normat kushtetuese, me të cilat përcaktohen të drejtat autonome të krahinave në fushën e MPP¹*, të VSH², të punëve të brendshme, të jashtme, përfaqësimi i tyre në organet e Federatës dhe në zbatimin e drejtpërdrejtë të politikës së caktuar në Federatë, disa individë, qarqe e madje edhe disa punëtorë shoqërorë, kulturorë e shkencorë, në fakt kërkojnë rrënimin e Jugosllavisë së re socialiste, federative, të kombeve dhe të kombësive të barabarta.

Kohët e fundit gjithnjë e më zëshëm nëpër gazeta, publikime të ndryshme kulturore dhe shkencore dhe paraqitje të tjera publike po ngjallet dhe po përhapet teza e vjetër për «fajin» e krahinave autonome, përkatësisht të kombësive, për gjendjen në Jugosllavi, për krizën në marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavi, e posaçërisht në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Kroaci. Në thumb

1) Mbrojtja e Përgjithshme Popullore.

2) Vetëmbrojtja shoqërore.

*) Të gjitha shënimet dhe shpjegimet në fund të faqes pa referencë janë të redaksisë.

të kritikave të tilla veçanërisht janë zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974, posaçërisht ato, me të cilat caktohen dhe rregullohen të drejtat, liritë e punonjësve dhe të qytetarëve të kombeve dhe të kombësive të barabarta të vendit tonë. Përhapet teza se asgjë nuk është aq e shenjtë sa të jetë e pandryshueshme, se kriza nuk mund të kapërcehet pa ndryshime radikale edhe në sistemin e normave juridike, se Serbia tash nuk e ka të rregulluar statusin e shtetit dhe se ajo, më në fund, duhet të jetë si republikat e tjera, se duhet zgjidhur dhe rregulluar statusi i Kosovës në Serbi dhe në Jugosllavi etj.

Vërtet as Kushtetuta e vitit 1974 nuk është e shenjtë dhe e pandryshueshme, por, ashtu siç e përcaktuan komunistët e vendit edhe në Kongresin e fundit partiak, të trembëdhjetin, ashtu siç u propozua edhe nga Kryesia e RSFJ me iniciativën për t'ia filluar punës rreth ndryshimit të Kushtetutës së RSFJ, parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974 mbesin të pandryshueshme, pra, tash për tash janë «të shenjta», dhe po të preken ato, në fakt preket diçka që është më se e shenjtë për kombet dhe kombësitë e vendit tonë.

Kundër çfarëdo majorizimi

Krahinat autonome lindën gjatë revolucionit socialist, si bashkësi shoqërore-politike vetëqeverisëse, ku drejt-përdrejt dhe më së miri realizohet politika e LK-ve, e përcaktuar edhe në programin e komunistëve për barazinë e plotë të kombeve dhe të kombësive. Pikërisht fjala e parë e parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974 është se Jugosllavia socialiste federative, e krijuar me luftën e përbashkët të kombeve dhe të kombësive, mbështetet në sistemin e saj socialist vetëqeverisës dhe se «punonjësit dhe qytetarët dhe kombet e kombësitë i realizojnë të drejtat e tyre sovraane në republikat socialiste dhe në krahinat socialiste autonome». Në alinenë e tretë, të pestë dhe të shtatë të kreut të parë të Kushtetutës së RSFJ, për dallim nga Kushtetuta

e vitit 1963, kudo ku përmenden kombet, përmenden edhe kombësitë. Parimi i barazisë së kombeve dhe të kombësive të RSFJ është përcaktuar edhe me nenin 245: «Në Jugosllavinë socialiste federative kombet dhe kombësitë janë të barabarta». Dhe parimi i këtillë i barazisë kombëtare në RSFJ shprehet në tërësinë e marrëdhënieve shoqëro-ekonomike dhe shoqëro-politike. Parimi i barazisë shprehet edhe në vendosjen në Federatë dhe në të gjitha organet e saj, Kryesia e RSFJ përbëhet nga tetë anëtarë, nga secila republikë dhe krahinë nga një; Këshillin Ekzekutiv Federativ e përbëjnë kryetari i Këshillit dhe anëtarët e tij që zgjidhen në bazë të parimit të barazisë së kombeve dhe të kombësive, e në Dhomën e Republikave dhe të Krahinave të Kuvendit të RSFJ zgjidhen nga 12 delegatë të secilës republikë dhe nga tetë delegatë të të dy krahinave autonome, ndërkaq në Dhomën Federative zgjidhen nga 30, përkatësisht 20 delegatë nga organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse, si dhe bashkësitë e organizatat shoqërore politike të republikave dhe të krahinave autonome. Një strukturë e këtillë dhe përbërja e organeve federative, krahas metodës dhe mënyrës së vendosjes, e cila bazohet në barazinë e plotë të kombeve dhe të kombësive të RSFJ, përkatësisht të delegacioneve të republikave dhe të krahinave dhe të anëtarëve të forumeve të Federatës, pengojnë, së paku në pikëpamje të rregullimit normativ, çfarëdo majorizimi në bashkësinë tonë shumënacionale.

Kërkesa të rrezikshme

Vazhdimësia e parimit të barazisë së kombeve dhe të kombësive të RSFJ vazhdon, pas këtij neni, edhe në nenin 246 të Kushtetutës së RSFJ, ku, ndër të tjera, përcaktohet se në Jugosllavi janë të barabarta gjuhët e kombeve dhe të kombësive dhe shkrimet e këtyre gjuhëve. Në Jugosllavi janë në përdorim zyrtar gjuhët e kombeve dhe gjuhët e kombësive në përdorim zyrtar janë në pajtim me Kushtetutën e RSFJ dhe me ligjin federativ. Ky qëndrim, që është bërë halë në sy pikë-



risht të atyre forcave, të cilat përdorimin e gjuhës së kombësisë, posaçërisht mendohet në përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe dhe të asaj hungareze në Jugosllavi, e konsiderojnë së bashku me pozitën kushtetuese të KSA-ve si shkaktar dhe nxitës të nacionalizmit shqiptar, hungarez, të revanshizmit dhe nacionalizmit serb, që shtyllë ka orientimin centralist të zgjidhjes së çështjes kombëtare në Jugosllavi.

Kërkesat, propozimet dhe mendimet për suprimimin e të drejtave të tjera të kombësive të kundërta me parimet e Kushtetutës së RSFJ logjikisht janë të kundërta edhe me parimet e Kushtetutës së RS të Serbisë dhe të KSA-ve. Sepse, është e kuptueshme, parimet e as normat e Kushtetutës së RSS e të KSA-ve nuk mund të jenë të kundërta me ato të Kushtetutës së RSFJ. Kushtetuta e Serbisë madje në kaptinën e vet të shtatë me titull «Realizimi i barazisë së kombeve dhe të kombësive», në nenet 145, 146, 147 dhe 148 dhe më thellë, në mënyrë më të plotë dhe më të drejtpërdrejtë përpunon parimin e barazisë së plotë të kombeve dhe të kombësive, siç e bën këtë edhe Kushtetuta e KSA të Kosovës dhe ajo e KSA të Vojvodinës.

Po ashtu, në kundërshtim pikërisht me propozimin e Kryesisë së RSFJ për të filluar ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ është kërkesa për ndryshime radikale kushtetuese, sepse radikalizmi nënkupton edhe ndryshimin e parimeve themelore. Madje, në kundërshtim me këtë propozim janë edhe disa propozime dhe kërkesa për ndryshimin e disa neneve dhe pjesëve të tyre në Kushtetutën e RSFJ dhe posaçërisht në Kushtetutën e RSS e të KSA-ve, sepse ndryshimi i këtyre neneve dhe pjesëve të tyre do të thoshte kërkesë për ndryshimin e parimeve themelore. Pra, ndryshimi i këtyre neneve do të ishte në kundërshtim me parimet themelore kushtetuese. Fjala vjen, po të ndryshohej diçka në nenet e kushtetutës së KSA të Kosovës që kanë të bëjnë me barazinë e gjuhëve dhe të shkrimeve të kombeve dhe të kombësive në Kosovë, atëherë kjo do të ishte në kundërshtim me parimin kushtetues të barazisë së këtyre gjuhëve, pra të barazisë së kombeve dhe të kombësive. Ose, po të ndryshohej çkadoqoftë në nenet me të cilat më tut-

je zbërthehet parimi i barazisë së kombeve dhe të kombësive që jetojnë në Kosovë (siç ka kërkesa, p.sh. për avancimin e kombit në krahasim me kombësinë, qoftë kur është fjala për përdorimin e përparësinë e gjuhës, qoftë në fushat e tjera të realizimit të identitetit kombëtar, të të drejtave dhe të obligimeve të pjesëtarëve të kombeve dhe të kombësive), atëherë kështu do të shkelej në mënyrë flagrante parimi i barazisë së kombeve dhe të kombësive, gjë që, sigurisht, do të jetë tërësisht e papranueshme dhe, në fakt, kështu vetëm do të nxiteshin konflikte të tjera ndërnacionale në Jugosllavinë e sotme, ku edhe ashtu janë ngjallur forca të ndryshme antisocialiste, antikomuniste dhe në radhë të parë, anti-vetëqeverisëse, tendenca, të cilave duhet t'iu kundërvihemi edhe më ashpër se deri më tash.

*«Rilindja», Prishtinë,
19.4.1989*

Ali Alaj

Komenti i TVP-së¹

KËRKESA E ARTIKULIME ABSURDE

Tashmë nuk ka dilema, ndryshimet e Kushtetutës së Republikës së Serbisë kanë marrë krahë të paparë të politizimit. Nëse këtë e vlerësojmë në bazë të disa kërkesave publike, atëherë nuk është pa arsytim mendimi se situata rreth reformës kushtetuese, pa fajin dhe përgjegjësinë e krahinave, po vjen e po dramatizohet, dhe po i kalon caqet parimore të dialogut konstruktiv dhe demokratik. Ilustrim më i theksuar i kësaj atmosfere është tubimi i fundit në Bashkësinë Lokale të Obiliqit.

Edhe pse ideologët e kësaj fushate e mohojnë këtë, arsyetimet e tyre i demanton kërkesa e parmbrëmshme në Obiliq, e cila është thënë më parë në Akademinë e Shkençave dhe të Arteve të Serbisë dhe disa herë në foltoren e Kuvendit të Serbisë, se krahinat nuk mund të jenë element konstituiv i Federatës, e nëse do të jenë, atëherë të tilla mund të jenë vetëm nëpërmjet Republikës së Serbisë. Edhe pas këtij konstatimi absurd, këto forca deklarohen se nuk qenkan për ndryshime të themeleve parimore të Kushtetutës së vitit 1974.

Shtrohet pyetja se a mund të bisedohet me këso

1) Televizionit të Prishtinës.

pikënisjeje për reformën kushtetuese. Pa dyshim se jo, ngaqë kur veprohet me majorizim, atëherë barazia është larg, ose është vetëm farsë. Kërkesat reviduese ndoshta nuk do të ishin aq tragjike, sikur të ngelnin jashtë suazave zyrtare. Nga ana tjetër, brengos fakti se si në Bashkësinë Lokale të Obiliqit Milenko Markoviqi, anëtar i kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, theksoi se «këto vlerësime, sikur këto që i thatë ju këtu, i ka edhe udhëheqja e Serbisë.» Nëse është kështu, shtrohet pyetja se për çfarë procesesh është kjo udhëheqje republikane. (Të përkujtojmë se në Obiliq u bënë thirrje për vëllavrasje dhe për suprimim të autonomisë).

Në këso rrethanash edhe në këso atmosfere nuk mund të bëhen ndryshime kushtetuese, nuk mund të ndryshohet asnjë kushtetutë në Jugosllavi, pra, as kjo e Serbisë.

Në Revolucion dhe në luftë kanë fituar të drejtën e pacenueshme që vetë të vendosin për fatin e tyre dhe të barabartë të vendosin për fatin e përbashkët. Alternativat e tjera ose mund të jenë tendenca për krijimin e shteteve të mëdha nacionale ose të një Jugosllavie të tretë. Vazhdimi i tendencave të tilla mund të jetë fatal për të sotmen dhe për ardhmërinë e vendit. Prandaj, forcat që marrin rrugë të këtillë, duhet të masin veten dhe t'i masin me urti veprimet e këtilla. Është shpeshtuar, në këto suaza, kërkesa për ngushtimin e autonomisë, kinse si rrugë për stabilizimin e gjendjes në Kosovë. Nëse i përmbahemi një paralelizmi, atëherë sipas këtyre strukturave, cila duhet të jetë rruga për kapërcimin e krizës ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi? Mos rastësisht do të ishte kjo rruga e ndryshimit të rregullimit të saj federativ apo e unitarizmit dhe centralizmit të saj?

Gjithnjë e më të zëshme janë edhe artikulet e një orkestre euforike në sulmet e papara kundër udhëheqjes në Kosovë dhe jo vetëm të saj. Qëllimi final i këtyre synimeve është diskualifikimi i kësaj udhëheqjeje dhe mundësisht përjashtimi i saj nga debati kushtetues. Sepse nëse një udhëheqje politike vetëqeverisëse dhe shumënacionale, siç është kjo në Kosovë, shpallet e paaftë dhe jokonstruktive, atëherë nuk jemi larg kërkesës për aplikimin

e mjeteve jovetëqeverisë në reformën kushtetuese. Kjo kërkesë nuk mund të shihet ndryshe, pos në dritën e insistimeve të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, sepse, si thuhet në koment, aty ku nuk ka vetëqeverisje, gjërat, pra edhe këto kushtetuese, vendosen ndryshe, gjithsesi në mënyrë jodemokratike dhe jashtë konsensusit të definuar në Jugosllavi si instrument i barazisë së kombeve dhe të kombësive e të republikave dhe të krahinave.

Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në Mbledhjen e vet të 11-të ka konstatuar se për ndryshimet kushtetuese në Serbi duhet biseduar me përgjegjësi, kurse uniteti politik dhe kapërcimi i diferencave duhet të arrihet me aktivitete të përbashkëta të organeve më të larta shtetërore dhe politike të Jugosllavisë, të republikave dhe të krahinave, para së gjithash midis udhëheqësve të LK të Serbisë dhe të Kosovës dhe të Vojvodinës, të cilat duhet të veprojnë drejt forcimit të kohezionit dhe të unitetit në Jugosllavi.

Ky përcaktim i Komitetit Qendror do të thotë se ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë është çështje e tërë Jugosllavisë, e të gjitha kombeve dhe kombësive. Sipas ecurive të deritanishme organet republikane nuk veprojnë në bazë të këtyre qëndrimeve të LKJ. Prandaj udhëheqja politike e shtetërore e vendit duhet të ndërprejë këtë rrjedhë të pavolitshme dhe të papranueshme, sepse këto udhëheqje e kanë këtë mandat.

*«Rilindja», Prishtinë,
3.7.1988*

Ibrahim Rugova

SERBËT VIJNË PËRSËRI SI HAKMARRËS

— Intervistë për revistën «Der Shpigel» —

Ibrahim Rugova, 44 vjeç, profesor i letërsisë në Universitetin e Prishtinës, është Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Krahinës Autonome të Kosovës, që i përket Serbisë.

REDAKTORI: Këtë javë serbët përkujtojnë me pompozitet 600-vjetorin e betejës së Fushë-Kosovës, në të cilën perandoria mesjetare serbe u mund nën sulmin e turqve: priten mbi një milion patriotë serbë. E ndiejnë shqiptarët si provokim këtë festë?

RUGOVA: Natyrisht, është provokim. Është thjesht një festë shoviniste serbe. Unë do ta pranoja marshimin, në qoftë se do të kishim të bënim me një vlerësim kulturor të kësaj beteje të rëndësishme për tërë Jugosllavinë.

REDAKTORI: Po ka qenë populli serb ai që luftoi atëherë kundër turqve?

RUGOVA: Ekzistojnë prova të mjaftueshme historikisht që në betejë morën pjesë gjithashtu hungarezë, kroatë, boshnjakë dhe, natyrisht, shqiptarë.

REDAKTORI: Por shqiptarët vetëm në anën e turqve...

RUGOVA: Jo, në anën e princit serb Lazar. Në fund

të fundit shqiptarët në vitin 1389 ishin ende të krishterë dhe luftonin gjithashtu islam. Besimin mysliman ne e kemi marrë nën pushtimin turk. Miti shovinist i Fushës së Mëllenjave¹ lindi në shekullin e 19-të, pas krijimit të shtetit serb.

REDAKTORI: A keni frikë se tani mund të ketë përsëri përleshje të përgjakshme midis serbëve dhe shqiptarëve?

RUGOVA: Mjafton të mendoni: një milion serbë të nxitur, të cilët do të sistemohen në hotele, pensione, bile edhe në banesa private në të gjithë Kosovën. Do të pihen dhe do të mburren. Një fjalë e gabuar mund të shërbejë si shkëndijë në fuçinë e barutit.

REDAKTORI: Shqiptarët kanë qëlluar mbi serbët. A përgatiten ata për një luftë civile?

RUGOVA: Njerëzit nuk shikojnë më rrugëdalje tjetër. Gjatë protestave gjithmonë kështu ndodh: në qoftë se mbeten pa asnjë jehonë, atëherë duhet thirrur me zë më të lartë.

REDAKTORI: Po kush duhet t'ju përgjigjet? Presidencën shtetërore jugosllave, qeveria serbe?

RUGOVA: Përshtypja ime është se në Jugosllavi ka forca, të cilat dëshirojnë pikërisht aksione terroriste në Kosovë. Në qoftë se te ne ka të shtëna, atëherë kjo shërben si justifikim për të rritur represionet. Dhe në qoftë se rezistenca e shqiptarëve kundër hegjemonisë serbe në vendet e huaja mund të denoncohet si terrorizëm, atëherë mund të mendohet që simpatia ndërkombëtare për çështjen tonë do të humbasë shpejt. Ju mund ta mendoni se kush bën spekulime të tilla.

REDAKTORI: Ka mundësi që serbët dhe udhëheqësi i tyre Milosheviçi shpresojnë të kenë dobi nga një ashpërsim i konfliktit. Por presidencën e shtetit dhe qeveria federative nuk mund të kenë ndonjë interes për një luftë civile.

RUGOVA: Ndoshta. Atëherë ka arritur kulmin koha për të ndërhyrë dhe për të ndaluar arbitraritetin serb. Pjesë e strategjisë së presionit është madje rehabilitimi i famëkeqit, ministrit të brendshëm Rankoviç. Me këtë duan

1) Fushë — Kosovës.

të justifikojnë shtypjen e përgjakshme në Kosovë në të kaluarën.

REDAKTORI: Para pak kohësh në Kosovë ishte një delegacion i Parlamentit Evropian për t'u njohur me gjendjen. Delegatët biseduan edhe me ju. Për këtë shtypi serb akuzoi deputetët, se kishin kërkuar kontakte vetëm me armiqtë e serbëve.

RUGOVA: E kundërta është e vërtetë. Delegacionit iu ndalua çdo kontakt me njerëzit në rrugë, prandaj ata e ndërprejnë para kohe vizitën. Parlamentarët evropianë morën vetëm qëndrimet zyrtare: të mira për serbët dhe të këqija për shqiptarët.

REDAKTORI: Në pranverë serbët arritën me forcë të bëjnë një ndryshim të kushtetutës, e cila u lejon atyre më shumë të drejta në Kosovë. Ju dhe miqtë tuaj kishit kërkuar një votim të popullit për të. Çfarë rezultate do të kishte dhënë, sipas mendimit tuaj, një referendum i tillë?

RUGOVA: Për ndryshim do të kishin votuar e shumta 10-15 për qind e zgjedhësve. Populli është në anën tjetër.

REDAKTORI: Çfarë ka ndodhur me 10 anëtarët shqiptarë të Kuvendit që votuan kundër kufizimit të autonomisë së Kosovës?

RUGOVA: Kryetari i Kuvendit, natyrisht një serb, ka kërkuar që këta devijatorë të hiqen nga postet e tyre. Së shpejti ata do t'i humbasin mandatet e tyre.

REDAKTORI: Çfarë ka ndryshuar në Kosovë që nga hyrja në fuqi e kushtetutës së re?

RUGOVA: Në bazë të kushtetutës janë vënë nën pushtetin qendror serb 5 fusha — policia, planifikimi ekonomik, drejtësia, mbrojtja territoriale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Por edhe të gjitha fushat e tjera, nën parullën «uniteti i republikës», dominohen nga serbët.

REDAKTORI: Çfarë efekti ka kjo?

RUGOVA: Numri i klasave të shkollës së mesme në gjuhën shqipe reduktohet në mënyrë drastike. Vetëm këtë vit 11 mijë nxënës shqiptarë do të jenë të detyruar të ndërpresin arsimimin e tyre me përfundimin e shkollës fillore sipas motos: shqiptarët injorantë janë më pak të rrezikshëm.

REDAKTORI: Sipas njoftimeve të shtypit kroat, janë

«izoluar» mbi 200 shqiptarë kosovarë. Ç'do të thotë kjo konkretisht?

RUGOVA: Qysh prej 3 muajsh ata mbahen pa proces gjyqësor, pa të drejtë për një mbrojtje dhe pa leje vizite nga të afërmit e tyre. Të paktën 245 shqiptarë janë në arrest izolimi: në shumicën e tyre intelektualë, por edhe drejtorë fabrikash dhe specialistë. Disa janë keqtrajtuar rëndë në burg. Qëllimi i serbëve është të izolojnë udhëheqës të mundshëm të rezistencës shqiptare. Kur më 1966 Rankoviçi humbi përkrahjen e Titos dhe u hoqën pasuesit serbë të Rankoviçit, ata kërcënuan se një ditë do të ktheheshin përsëri si hakmarrës. Tani kjo ndodhi.

REDAKTORI: Gazetat serbe pretendojnë se Kosova synon më shumë autonomi për t'u bashkuar me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

RUGOVA: Kjo është një përrallë e vjetër propagandistike. Shumica e shqiptarëve të Kosovës e kanë pranuar plotësisht qenien e tyre në Federatën Jugosllave. Por duhet thënë se në qoftë se do të vazhdojë shtypja, atëherë populli do të kërkojë një rrugëdalje.

REDAKTORI: Dhe nga do të drejtohej?

RUGOVA: Ose në drejtim të Shqipërisë, ose në një drejtim tjetër. Gjatë kohës së Rankoviçit, qindra mijëra shqiptarë u arratisën në Turqi. Që nga viti 1981, 250 mijë shqiptarë janë larguar nga atdheu i tyre dhe jetojnë si emigrantë në Perëndim ose në republika të tjera të Jugosllavisë.

REDAKTORI: Edhe 40 mijë serbë janë larguar gjithashtu gjatë kësaj kohe nga Kosova; thuhet se janë dëbuar nga shqiptarët.

RUGOVA: Kjo është gënjeshtër. Natyrisht, ka pasur grindje midis fqinjëve, por kjo ndodh edhe midis shqiptarëve. Në të vërtetë serbët nuk mund ta durojnë që të kenë edhe shqiptarë në pozita drejtuese. Ata dëshirojnë të ndalojnë kohën. Pas vitit 1966 ne, shqiptarët, kemi pasur mundësinë të arsimohemi në shkolla dhe universitete (sot 90 për qind e popullsisë di të lexojë dhe të shkruajë) dhe kërkojmë të drejta të barabarta.

REDAKTORI: A lejon ende kontradikta midis serbëve dhe shqiptarëve një zgjidhje paqësore?

RUGOVA: Në qoftë se Serbia do të përpiqet përsëri të

shtypë identitetin tonë kombëtar, atëherë do të ketë një kryengritje. Unë vetëm mund t'i paralajmëroj serbët: edhe ata janë një popull i vogël. Në të kaluarën sa herë që një popull i vogël është përpjekur të luajë rolin e një fuqie në Ballkan, kjo ka përfunduar me tragjedinë e vet.

«Die Serben kommen als Rächer wieder», «Der Spiegel», Nr. 26, 1989.

Rrustem Rugova

SHKELJE E MARRËVESHJEVE

Propozimi i amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serbisë, në pjesët e saj, që kanë të bëjnë me pozitën e krahinave autonome, që janë në përbërje të RS të Serbisë dhe elemente konstitutive të Federatës, shmanget shumë nga marrëveshjet paraprake për t'u hyrë ndryshimeve kushtetuese dhe kështu cenon edhe parimet kushtetuese mbi autonominë në sistemin tonë kushtetues.

Pardje në mbledhjen e Komisionit Kushtetues të Kuvendit të RS të Serbisë u miratua propozimi i Amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së RSS, me një votë kundër, të përfaqësuesit të Kosovës. E vërteta është se Kosova, përkatësisht Komisioni Kushtetues i Kuvendit të KSA të Kosovës, ka shumë vërejtje parimore dhe konkrete në tekstin e propozuar tash për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serbisë. Vërejtjet parimore janë se me këtë dokument (pra, fjala është për tekstin e propozuar të amendamenteve të kushtetutës së RSS), posaçërisht në pjesën e tij që ka të bëjë me funksionet unike të republikës, të organeve shtetërore dhe të administra-

tës së Republikës, të organeve ekzekutive të Kuvendit të RS të Serbisë, të Kryesisë së RS të Serbisë, të gjyqeve të republikës dhe të vetë procedurës për ndryshimin e kushtetutës së Republikës, janë shkelur dhe injoruar propozimet e marrëveshjet paraprake të Kryesisë së RSFJ-së për të filluar procedurën për ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ-së, propozimi i kryesisë së Republikës Socialiste të Serbisë për të filluar procedurën e ndryshimit të kushtetutës së kësaj republike. Vendimi i Kuvendit të RS të Serbisë për të filluar procedurën e ndryshimit të Kushtetutës së RSS, e madje duke u bazuar në debatet kushtetuese vetëm në Serbi e Vojvodinë, e, duke injoruar debatin kushtetues në Kosovë, hartuesit e këtij propozimi kanë shkelur edhe qëndrimin e pikës së pestë të konkluzioneve të Mbledhjes së 17-të të KQ të LKJ, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet e Kushtetutës së RS të Serbisë. Madje, propozimet më të reja shkelin edhe mbi vetë projektamendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serbisë, sepse në shumë segmente e çështje kyç, të cilat kanë të bëjnë edhe me krahinat autonome, largohen nga marrëveshjet e arritura, nga parimet dhe anojnë nga zgjidhjet radikale, pra nga maksimumi.

Injorohet çdo propozim nga Kosova

Në këtë mënyrë injorohet qëndrimi nga pika e pestë e konkluzioneve të Mbledhjes së 17-të të KQ të LKJ, me të cilat qartazi precizohet se «Projekti i Amendamenteve për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serbisë është në pajtim me qëndrimet e Kongresit të 13-të të LKJ... se ato paraqesin një bazë të mirë ideopolitike për arritjen e zgjidhjeve... , se zgjidhjet duhet të jenë rezultat i debatit publik dhe i punës së përbashkët...» Siç dihet, me punë të përbashkët u arrit pëlqimi për vëllimin dhe kohën e ndryshimeve kushtetuese në RS të Serbisë, nëpërmjet komisioneve kushtetuese, pra të Serbisë, të Vojvodinës dhe Kosovës dhe këtë vendim e miratoi Kryesia e RS të Serbisë, në bazë të të cilit u hartuan projekt-

amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së RSS, të cilat dolën në diskutim publik. Esenca e debatit publik në Serbi, siç thonë edhe dokumentet e prezantuara në mbledhjen e fundit të komisionit kushtetues të Kuvendit të RSS, ishte që, më në fund, RS e Serbisë të barazohet me republikat e tjera të vendit tonë, që të nxirret një kushtetutë republikane, që organet shtetërore dhe organet e tjera të administratës republikane të shtrijnë dhe të kenë të gjitha kompetencat si organe republikane mbi ato krahinore (madje edhe në rolin e mbikqyrjes e të inspeksionit), që gjyqet republikane të kenë «fjalën e fundit» në vendosjen e lëndëve ku është shkëlur ligji republikan, që kryesia e RS të Serbisë t'i ketë kompetencat e veta të duhura, kur është fjala për mbrojtjen e përgjithshme popullore, vetëmbrojtjen shoqërore, organizimin e mbrojtjes territoriale, mobilizimin, rezervat ushtarake, komandimin e madje edhe urdhrin për angazhimin e organeve kompetente, të organeve shtetërore për të mbrojtur kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe shpartallimin e forcave armiqësore në cilëndo pjesë të territorit të RS të Serbisë. Këto kërkesa nga debati publik në Serbi, përkatësisht edhe nga mitingjet e protestës së serbëve e malazezëve, që vitin e kaluar u organizuan në Kosovë, Serbi, Vojvodinë e Mal të Zi, të thuash se plotësisht gjejnë vend në amendamentin 32, që ka të bëjë me funksionet unike të republikës, por edhe në amendamentet e tjera që kanë të bëjnë me kompetencat e kryesisë së RS të Serbisë, të gjykatave kushtetuese të RS të Serbisë dhe të gjyqit suprem të republikës. Madje, amendamenti i ri, 47, që ka të bëjë me propozimin që tani e tutje kushtetuta e RS të Serbisë të ndryshohet pavarësisht nga krahinat autonome, pra vetëm me 2/3 e votave të delegatëve të kuvendit të kësaj republike, është rezultat vetëm i propozimit të një grupi delegatësh të Kuvendit të RS të Serbisë dhe i debatit publik vetëm në Serbi, themi kushtimisht, jashtë debatit publik në Kosovë.

Me sa jemi të informuar, grupet punuese profesionale, të formuara edhe në kuadër të komisionit kushtetues të RS të Serbisë ditëve të fundit të dhjetorit të vitit të kaluar, bënë përpjekje që të afrohen qëndrimet

dhe të gjenden zgjidhje në pajtim me pikën e pestë të konkluzioneve të KQ të LKJ, por, një dokument i komisionit kushtetues të KSA të Kosovës, që mbante titullin «Qëndrime dhe mendime», u hodh poshtë dhe totalisht u injorua nga ana e komisionit kushtetues të Serbisë me vërejtjen se «...kërkohen sqarime e argumente plotësuese...» dhe kështu në fakt çështja dukshëm është politizuar dhe ashpërsuar edhe më shumë për të arritur në situatën sa të krijohen ndasi edhe në baza kombëtare. Nuk e kuptojmë e as nuk e kemi të njohur arsyen e mungesës së katër anëtarëve të komisionit për çështje kushtetuese nga Kosova në mbledhjen e fundit të komisionit kushtetues të Kuvendit të RS të Serbisë. Kujtojmë se çfarëdo që të jetë arsyeja e mungesës së tyre nga kjo mbledhje kaq e rëndësishme, kjo mungesë në opinion ka krijuar e po krijon shumë dilema e paqartësi.

Në kushtet e ndasive ndërnacionale në Kosovë e të veprimt të nacionalizmit e separatizmit shqiptar, por edhe të nacionalizmit serb e malazez, të hegjemonizmit nacional dhe të «lojës» së burokracive nacionale me interesat jetikë të RSFJ, të klasës së saj punëtore, pra të qëllimeve klasore të LKJ-së, ashpërsimi i mëtejshëm i raporteve gjatë këtij harmonizimi kushtetues është dhe një argument dhe adut më shumë në duart e atyre forcave që janë jo vetëm për destabilizimin e gjendjes në Kosovë, por edhe për destabilizimin e mëtejshëm të gjendjes në tërë Jugosllavinë socialiste e vetëqeverisëse të Titos.

Kushtetuta nuk mund të ndryshohet me procedurë jokushtetuese

Nisur prej debatit publik të organizuar në Serbi, prej propozimeve që dolën nga tubimet e protestës së serbëve dhe të malazezëve, prej disa paragjykimeve, e madje do të thoshim edhe prej disa appetiteve, që janë të kundërta me qenien e sistemit tonë kushtetues, të shoqërisë sonë socialiste vetëqeverisëse, të kombeve e kombësive të barabarta, me frytet e revolucionit tonë socialist, me

amendamentin e ri, 47, propozohet që kushtetuta e RS të Serbisë të ndryshohet në kuvendin e kësaj republike me dy të tretat e votave të delegatëve, pasi të jetë «marrë» mendimi i kuvendeve të krahinave, të BVI-ve¹, komunave dhe të organeve e të subjekteve të tjera të republikës. Pra, mendimi i Kuvendeve të krahinave nuk është i obligueshëm, siç është fuqia e deritanishme kushtetuese e dhënies së pëlqimit të këtyre kuvendeve dhe kështu, juridikisht kuvendet krahinore, sa u përket çështjeve të ndryshimit të kushtetutës republikane, por jo vetëm të kësaj (edhe për ligjet republikane kuvendet krahinore parashikohen vetëm të japin mendim) janë vetëm në funksion të dhënies së mendimit.

Kushtetuta e RSFJ, e RSS dhe e KSA-ve ndërkaq thotë ndryshe, KQ i LKJ të Jugosllavisë në mbledhjen e vet të 17-të decidivisht thotë se edhe kushtetuta e RSS duhet të ndryshohet vetëm me procedurë kushtetuese. Po qe se është kështu, atëherë hapet çështja e realizimit konsekuent të qëndrimeve të forumeve më të larta partiake dhe shtetërore edhe në aspektin e rolit të forumeve kompetente për propozime që afrojnë dallimet e jo që ato t'i largojnë edhe më shumë, që të krijojmë situata konfuze dhe të ashpërsojmë më shumë dallimet.

«Rilindja», Prishtinë,
8.1.1989.

1) BVI-ve, Bashkësive Vetadministruese të Interesuara.

LARJA E HESAPEVE NË KOSOVË

Intervista e Gani Jasharit dhënë revistës «Danas», Nr. 375 duhet të ketë shkaktuar një pakënaqësi të madhe te çdo njeri që e përjeton thellë dramën kosovare dhe te secili që është i interesuar të mësojë të vërtetën e plotë rreth kësaj drame. Kryetari i sapozgjedhur i Komitetit të LK të Prishtinës, Gani Jashari, i servir opinionit publik të interesuar vlerësime dhe zgjidhje të shpejta për ngjarjet në Kosovë, të pavërteta dhe shpifje dhe paralajmëron për një larje hesapësh të pamëshirshme me intelektualët shqiptarë. Që ky është fakt, do të përpiqem ta provoj me anën e analizës së përgjigjeve të tij për pyetjet e bëra nga bashkëpunëtori i «Danas»-it.

1. — Kryetari i LK të Prishtinës akuzon kombësinë shqiptare se ka disa vjet që po manipulohet nga lëvizja nacionaliste separatiste. Por ai nuk thotë se nga cila datë fillon kjo dukuri. Mund t'u referohej thënieve të Llazar Mojsovit në Kuvendin Federativ, i cili rrënjët e «nacionalizmit dhe të separatizmit shqiptar» i gjen që në kohën e Lidhjes së Prizrenit më 1878, madje edhe më parë, ndërsa rrënjët e «kundërrevolucionit» i kërkon në vitin 1941.

2. — Në rrethanat e tanishme të komplikuarra dhe të rënda në Kosovë është bërë modë që të dënohet ashpër sintagma e ish-udhëheqjes politike kosovare «të ruaj-

më kuadrot gjatë rregullimit të gjendjes». Përkrrahësve të dorës së hekurt policore të Bismarkut iu shtuan edhe autorët e peticionit të akademikëve të kombësisë serbe në Universitetin e Prishtinës. Përsa i përket diferencimit politik është fakt se ky proces nuk ka filluar më 1984-1986, por menjëherë pas demonstratave të studentëve më 1981 dhe zbatohet vetëm kundër popullsisë shqiptare. Do t'i lutesha Jasharit të vërtetonte të kundërtën.

3. — Një analizë e thellë e gjithanshme dhe themelore e ngjarjeve të nëntorit, të shkurtit dhe të marsit në Kosovë, që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, do të vërtetonte më së miri se sa qëndron akuza se klasa punëtore në Kosovë ka qenë e manipuluar. Mos vallë shkopë magjik i vuri në lëvizje punëtorët, fshatarët, qytetarët, të rinjtë dhe fëmijët? Asnjë forcë nuk i detyroi ata të merrnin rrugën drejt Prishtinës, jo me trena e autobusë të porositur posaçërisht, por me këmbë, me rroba pune dhe në një ditë me shi. Ky nuk ishte shpërthim i nacionalizmit dhe i urrejtjes dhe as marshim kryqtarësh mesjetarë me thirrje për linçim dhe larje hesapësh, por ishte një manifestim popullor për të mbështetur udhëheqjen kosovare të zgjedhur në mënyrë të ligjshme. Erdhi nëntori i vitit 1988 dhe askush nuk u kujtua për qetësimin e shpirtit dhe normalizimin e gjendjes së përgjithshme në Kosovë. Fyerja që iu bë minatorëve, pjesës më të shëndoshë të klasës punëtore, duke i cilësuar si të manipuluar, nacionalistë dhe separatistë, fushata e shtypit të verdhë kundër trashëgimisë kombëtare të shqiptarëve, shpifjet kundër personaliteteve më të shquara të kombit shqiptar, kërkesat për t'u ndryshuar emrin shkollave në gjuhën shqipe, si dhe deklaratat e papeshuara të shefit të diplomacisë jugosllave në shtypin francez se gjoja shqiptarët janë të ardhur në Kosovë gjatë shekullit të kaluar, të gjitha këto nuk mund të kontribuonin për qetësimin e gjendjes së përgjithshme. Përkundrazi, ato ishin një eksploziv shpërthyes në këtë situatë. Minatorët nuk vendosën të mos dilnin nga galeritë dhe të bënin grevë urie për të ngrënë banane. Demonstratat e marsit duhen konsideruar si të lidhura dhe të kushtëzuara drejtpërdrejt me votimin për ndryshimin e kushtetutës në Kuvendin e Kosovës në kushtet e shpa-

lljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Vallë ky vendim i Kryesisë së RSFJ ishte një veprim i urtë nga pikëpamja shtetërore? Këtë do ta lëmë ta vërtetojë koha, gjyqi i historisë.

4. — Për vite me radhë kemi dëgjuar të njëjtin refren: përse hesht inteligjencia shqiptare. Përgjigjja e vërtetë për këtë është: ajo nuk ka heshtur, por asaj ia kanë mbyllur gojën. Inteligjencia shqiptare mundi të fliste lirisht me rastin e debateve publike lidhur me ndryshimet e kushtetutës. Dhe këtë e bëri nëpërmjet Apelit të punonjësve të shkencës dhe të kulturës, të cilin Gani Jashari e konsideroi pamflet politik dhe nënshkruesit e tij i cilësoi pseudointelektualë. Qëndrimi i Jasharit në këtë drejtim ka të bëjë me edukatën dhe higjienën e tij morale. Meqë ra rasti, mund të thuhet se nga këta «pseudointelektualë» ai mësoi në shkollë dhe, po të mos ishin ata, ai do të vazhdonte të mbante mbiemrin Jashareviç, ashtu sikurse të afërmit e tij gjetkë dhe bashkatdhetarët e tij në mjedise të tjera të Jugosllavisë...

5. — Për ç'arsye Apeli i intelektualëve kosovarë pas-ka shkaktuar dëme kolosale politike? Apeli u paraqit në mënyrë plotësisht legale dhe iu drejtua forumeve legale partiake dhe shtetërore dhe kjo u bë në kuadrin e diskutimeve rreth ndryshimeve të kushtetutës. Ç'është e vërteta, Apeli ka dy defekte të mëdha: e para, se numri i nënshkruesve të tij është shumë i paktë, atë mund ta kishin nënshkruar me mijëra vetë. E dyta, është shkruar me një ton shumë të moderuar, të butë, lutës dhe, do të thosha, edhe në mënyrë inferiore. Pavarësisht nga kjo Apeli i intelektualëve shqiptarë, ndryshe nga shumë peticione të njohura dhe pamflete reaksionare, me anën e të cilave jo vetëm që kërkohet heqja e autonomisë së krahinave, por sulmohet drejtpërdrejt edhe Kushtetuta e RSFJ-së, u shpall për fat të keq akt armiqësor dhe iu nënshtrua sulmeve më të ashpra.

Vetvetiu imponohet pyetja: vallë opinioni publik jugosllav që përpiqet kaq shumë për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, për të drejtat qytetare dhe shprehjen lirisht të mendimeve mund të mbetet indiferent dhe vëzhgues pasiv ndaj një dukurie të tillë të padëgjuar: që nënshkruesit e Apelit të persekutohen, t'u bëhet thirrje

për pendim, për të hequr dorë «vullnetarisht» nga postet drejtuese dhe të çohen në milici për t'u marrë në pyetje? Një nderimi të tillë i jam nënshtruar edhe unë si bashkautor dhe përhapës i këtij Apeli.

Nënshkrimi i Apelit ishte çështje e vullnetit të mirë të çdo qytetari që mendon me kokën e vet. Nuk është e vërtetë se nënshkrimi i këtij Apeli, sipas Gani Jasharit, u është imponuar disa intelektualëve. Unë personalisht e çova Apelin për nënshkrim në fakultetin e mjekësisë. Në qoftë se, ndërkohë, ndonjë nënshkrues i tij është «penduar» si rezultat i presioneve që i janë bërë dhe netëve pa gjumë që ka qenë i detyruar të kalojë, kjo është çështje e ndërgjegjes së tij morale, por, megjithatë, nuk jam i sigurt se me «pendime» të tilla do të mund të ruajë tani dhe në të ardhmen vendin e shefit që mund të ketë...

6. — Nuk qëndrojnë aspak deklaratat e Gani Jasharit se diferencimi në Kosovë po bëhet mbi baza klasore dhe jo nacionale. Jemi dëshmitarë të faktit se diferencime klasore në Kosovë nuk ka dhe nuk do të ketë. Grupi i profesorëve serbë e malazezë me në krye rektorin e Universitetit Balosheviç në fillim të këtij viti shkollor u bëri thirrje nxënësve dhe studentëve të kombësisë së tyre për një bojkotim të përgjithshëm të mësimëve. Që atëherë kanë kaluar shumë kohë dhe nuk kam dëgjuar që ndonjëri prej tyre të jetë vënë përpara përgjegjësisë. Iniciatorëve dhe formuluesve, si dhe nënshkruesve të peticioneve dhe pamfleteve të ndryshme nacionaliste dhe reaksionare të serbo-malazezëve nuk u është prekur asnjë fije floku. Si mund të hidhet poshtë atëherë fakti se nacionalizmi serb nuk mbrohet nga shteti? Psh. autorët e memorandumit të Akademisë së Shkencave të Serbisë vazhdojnë të jenë anëtarë të LKJ. Zyrtarisht dëgjojmë se kemi një polici me pajisje nga më modernet dhe me efektivitet, por autorët e krimit të përbindshëm (nxjerrjes së syrit të Burimit të vogël) deri më sot nuk janë zbuluar, ndërsa vrasja në mes të ditës në Kragujevac e një nëne shqiptare bashkë me fëmijën e saj është konsideruar si një vepër kriminale e kryer nga ndonjë maniak.

7. — Dy fjalë për ndryshimet në kushtetutë: Gani Jashari i shikon diskutimet dhe miratimin e amenda-

menteve të kësaj kushtetute në Kuvendin e Kosovës dhe të Serbisë nëpërmjet syzeve të marra hua. Për këtë arsye ai edhe frikën e kombësisë shqiptare nga ndryshimet në Kushtetutë e shikon si rezultat të mosinformimit të duhur apo të dezinformimit. Si argument ai ka thënë se «ç'mund të dijë për ndryshimet në kushtetutë një bujk apo një punëtor». Pra, sipas tij, fjala është për një kategori anal-fabetësh, injorantësh dhe debilësh. Por bujku dhe punëtori shqiptar ë di shumë mirë se çfarë fiton dhe çfarë humbet nga ndryshimet në kushtetutë. Në fund të fundit këtë ia kanë shpjeguar edhe politikanët dhe gazetarët serbë duke folur vazhdimisht për kërkesat e tyre maksimale dhe minimale në këtë drejtim.

8. — Në Beograd jetojnë dhe punojnë mijëra shqiptarë. Por nuk është e vërtetë se atje ka shkolla fillore në gjuhën shqipe, siç thotë Jashari.

9. — Është shumë e arsyeshme që Jashari të shprehet kundër shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova. Por a nuk do të ishte me vend që të thoshte dy-tri fjalë edhe për numrin kolosal të të rinjve të papunë të kombësisë së tij, të cilët shkojnë për kafshatën e gojës nëpër rajonet e tjera të Jugosllavisë dhe në Evropë, ku bëjnë punët më të rënda fizike, megjithëse janë të kualifikuar për punë të tjera? Ç'mund të thuhet për shpërnguljen e mijëra e mijëra shqiptarëve pa shpresë që të rikthehen në vatrën e tyre...?

10. — Çdo popull ka pasur dhe do të ketë liderë. Por kombësia shqiptare është ngopur nga liderë të tillë që janë politikanë të këqinj, karrieristë të sëmurë, burokratë, hipokritë, të gatshëm që të thonë gjithmonë amin, bajraktarë me cilësi morale të dyshimta, njerëz të kolltukut që presin me padurim rastin për t'i vënë bërrylin tjetrit në mënyrë që t'i zënë vendin. Kombësia shqiptare është ngopur me përfaqësuesit e vet të vetëzgjedhur ose të vetëmëruar në forumet krahinore të republikës dhe të federatës, të cilët ka vite që nuk thonë asnjë fjalë për problemet kryesore të vendit ose të bazës së tyre dhe thjesht dremisin në këto forume. Pas studimeve shumëvjeçare të historisë më të re kam arritur në konkluzionin se kombësia shqiptare te ne kurrë nuk ka pasur fat me esnafin e vet politik. Përjashtimet e vogla nuk mund ta

zbusin zhgënjimin. Është tragjike kur krerët e lënë me gisht në gojë popullin e vet...

11. — Jashari thotë me zë të ulët: «Cilido që dyshohet, duhet të vihet përpara përgjegjesisë nga organet e LK dhe të shtetit». Kjo është gjueti mesjetare kundër shtrigave në një shtet juridik të prapambetur. S'ka gjë. Kombësia shqiptare do ta kalojë edhe këtë furtunë.

Të përfundoj.

A mundet vallë udhëheqësi partiak i Prishtinës të kontribuojë për stabilizimin e gjendjes në Kosovë me anën e verbalizimit «revolucionar» të marrë hua në stilin: stop, duhet vepruar kështu, nuk lejohet ashtu! A mund t'i besohet vallë atij detyra e krijimit të frontit të përbashkët të shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve në kushtet e një klime politike mbytëse, të komplotit të hesh-tjes, të nënshtrimit pa kushte dhe të larjes së hesapeve në mënyrën më brutale me inteligjencien dhe çdo qytetar tjetër të kombësisë shqiptare që mendon ndryshe nga Jashari? Në qoftë se ata që e vënë në kolltukun që ka, synojnë të arrijnë qëllime të kundërta, atëherë kjo do të ishte me të vërtetë shumë tragjike.

«Obračunî na Kosovu», «Danas»,
Zagreb, 30.5.1989

Shkelzen Maliqi

GJITHÇKA MUND TË PARASHIKOHEJ

— *Intervistë për revistën «Danas»*

— Si i përjetoni dhe i komentoni ngjarjet dramatike të ditëve të fundit në Kosovë?

— Nuk do të thosha se mund të flitet për situatë dramatike vetëm gjatë ditëve të fundit. Kjo situatë vazhdon prej disa muajsh, ndërsa ngjarjet e ditëve të fundit ishin vetëm kulmi i asaj që ishte akumuluar gjatë kësaj kohe. Pra, nuk duhet të habitemi nga ajo që po ndodh, megjithëse duhet ta pranojmë se më ka habitur ashpërsia dhe eksploziviteti i ngjarjeve.

— A mund të parashikoheshin dhe të shmangeshin ngjarjet e fundit?

— Bëj pjesë midis atyre që para 2-3 vjetësh paralajmëruan për rrezikun e shkallëzimit të pakontrolluar të rrethanave në Kosovë, sidomos ngjarjet e muajve të fundit e rritën probabilitetin e këtyre parashikimeve. Kam parasysh edhe politikën e re serbe, që arriti pikën kulminante gjatë ndryshimeve në kushtetutën e Serbisë. Tani që ka mbaruar puna me kushtetutën, vihet re qartë manipulimi me karakterin e ndryshimeve dhe vëllimin e parashikuar të këtyre ndryshimeve. Udhëheqja serbe duket qartë se qysh në fillim nuk kishte ndër mend të respektonte marrëveshjen e arritur dhe në fund e shkeli

atë. Ju e dini se faza përfundimtare e ndryshimeve në kushtetutë u parapri nga mbledhje e njoftime të jashtëzakonshme dhe, në fund, për kushtetutën u votua gjatë kohës së masave të jashtëzakonshme, të arrestimit të një pjese të udhëheqësve kosovarë, të presioneve mbi delegatët e krahinës për të dhënë miratimin e tyre, etj. Vetë kjo rrjedhë ngjarjesh krijoi te shqiptarët ndjenjën e frikës se do t'u hiqej autonomia. Duhet thënë se kjo frikë u përforcua me faktin se udhëheqja e re e Serbisë nuk u distanca hapur ndaj persekutimit të shqiptarëve në kohën e Rankoviçit, përkundrazi, nëpërmjet shtypit u krijua përshtypja se dëshirohet të rehabilitohet koha e Rankoviçit. Po të kihet parasysh se, sidomos që nga vjeshta, janë radikalizuar edhe tezat zyrtare në Serbi për gjoja genocidin dhe terrorin kundër popullsisë serbe e malazeze në Kosovë, atëherë është e kuptueshme se për ç'arsye shqiptarët filluan të veprojnë, se pas zgjerimit të kompetencave shtetërore të Serbisë vjen edhe marrja e masave përkatëse, dhe dihet se çfarë masash merren kundër genocidit dhe terrorit. Përgjigjja që dha udhëheqja serbe nuk ishte bindëse. Ajo tha, për shembull, se askush nuk do t'u heqë shqiptarëve të drejtën për gjuhën amtare, sikur një gjë e tillë të ishte e kontestueshme, ndërsa këtu ishte fjala për të drejtat e përgjithshme politike të shqiptarëve, për të cilat udhëheqja serbe nuk dha garanci. Një gjë e tillë do të linte patjetër pasoja.

— Të gjitha këto nuk justifikojnë përdorimin e armëve si mjet i fundit për mbrojtjen e «çështjes shqiptare». Përkundrazi, në këtë mënyrë çështjet e hapura të autonomisë së Kosovës shtyhen dhe tani më tepër se kurrë ndonjëherë shtrohet çështja nëse ekzistojnë në përgjithësi shanse për t'i dhënë fund së shpejti krizës kosovare.

— Jam dakord, por ata që kanë rrëmbyer armët, nuk presin të dëgjojnë se ç'do të themi unë dhe ju për këtë çështje. Ata ia arritën qëllimit: ekstremistët shqiptarë (ashtu si dhe ekstremistët në palën tjetër) ka vite që e ëndërronin një situatë të tillë. Tani zhvillohet një fushatë masash politike për ndarjen e popullsisë shqiptare nga grupet nacionaliste dhe irredentiste, por në rrethanat, në të cilat fola, ndodh e kundërta. Në një pjesë të kësaj popullsie edhe përdorimi i dhunës kuptohet si

e vetmja metodë që i ka mbetur për mbrojtjen e interesave jetike të shqiptarëve në Jugosllavi. Mund të them se është krijuar një situatë, në të cilën ekstremistët shqiptarë kanë një ndikim më të madh se kurrë ndonjëherë tjetër.

— A mund të quhen demonstruesit huliganë, nacionalistë etj, sikurse veprohet tani nga një pjesë e mjeteve të informacionit?

— Këto janë përgjithësime të padrejta. Gjithashtu nuk duhen bërë përgjithësime të tjera që errësojnë të vërtetën. Në Kosovë u bënë përpjekje për të mbrojtur rendin kushtetues, prandaj edhe populli iu përgjigj thirrjeve për demonstrata në mënyrë masive.

— Ju jeni një nga nënshkruesit e Apelit të 215 intelektualëve të kombësisë shqiptare drejtuar opinionit publik jugosllav dhe Kuvendit të Serbisë. Flitet se udhëheqja e re kosovare ka vendosur të «neutralizojë» nënshkruesit, se një grup prej tyre janë arrestuar dhe se edhe të tjerët do të pësojnë sanksione të ndryshme.

— Së pari, duhet thënë se Apeli drejtohej kundër atyre deformimeve në ndryshimin e kushtetutës, të cilat sollën dramalizimin e tanishëm të situatës në Kosovë. Tani kërkohet të vërtetohet sikur ne paskemi dashur të bënim të pamundur ndryshimet kushtetuese, gjë që nuk është e vërtetë. Ne kërkuam vetëm që këto ndryshime të bëheshin në kushte normale dhe një gjë e tillë nuk drejtohej as kundër ndryshimeve në kushtetutë, as kundër Serbisë, sikurse thuhet tani atje, megjithëse edhe unë vetë kam vërejtje për disa formulime të këtij Apeli. Për sa u përket sanksioneve kundër nënshkruesve të këtij Apeli, kam dëgjuar, sikurse edhe ju, se një grup nënshkruesish, sigurisht ata që i quajnë si më të «rrezikshëm», u «izoluan» menjëherë dhe se masa do të ndërmerren edhe kundër të tjerëve, gjë që do të thotë se edhe unë personalisht duhet të pres ndonjë sanksion. Tani për tani janë nën goditje profesorët e universitetit. Me sa di unë, është fjala për rreth 65 profesorë të tillë që janë arrestuar dhe, sikurse thuhet, janë dërguar në burgje diku jashtë krahinës. Sikurse thashë, edhe unë vetë jam, me sa duket, në listën e të dyshimtëve, duke gjykuar në bazë të sulmeve gjithnjë e më të shpeshta të ditëve të fundit kundër meje, sidomos

në gazetën «Jedinstvo» të Prishtinës. Është fjala për një fushatë frikësimesh e denoncimesh që po zhvillohet tani në shtypin e Serbisë. Nuk ka ndonjë koment tjetër veçse të them se kjo është një metodë e sprovuar mashtrimesh, me anën e së cilës kërkohet të largohet vëmendja nga problemet e vërteta, ndërsa këto probleme, sikurse e shohim të gjithë, janë kolosale.

*«Sve se moglo predvidjeti»,
«Danas», Zagreb, 4.4.1989*

Jusuf Ferizi

LETËR E HAPUR DREJTUAR ALEKSANDËR PERLJAS

I nderuar Perlja!

Lexova me vëmendje njoftimin lidhur me bisedimet që patët si ministër për marrëdhëniet me botën e jashtme të Serbisë me funksionarin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Francis Amara. Them «me vëmendje», sepse ju njoh nga viti 1973 në mbledhjen e 4-t të nivelit të lartë të vendeve të paangazhuara në Algjeri, dhe jemi parë edhe në Paris, kur ishit drejtor i Qendrës Kulturore të Jugosllavisë, ndërsa më vonë korrespondent i gazetës «Politika».

Dhe e përsëris — «me vëmendje», sepse keni punuar për shumë vjet në një vend, i cili ka një traditë 200-vjeçare të shtetit juridik. Kjo «me vëmendje» ka të bëjë me deklaratën tuaj se numri i të izoluarve (kategori që nuk e njeh sistemi juridik) prej 200 vetash është pakësuar në 40 veta (sikur të kishte rëndësi numri dhe jo institucioni që e tmerron botën e civilizuar).

Edhe një surprizë tjetër e madhe nga biseda juaj me Amarën: Ju u përpoqët ta bindnit atë se me ndryshimet e reja kushtetuese në Serbi u ndalua procesi i shkëputjes së Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia. Ç'fyerje e rëndë është kjo për kombësinë shqiptare, e cila afirmimin e saj, barazinë dhe lirinë kombëtare për herë të parë në histo-

rinë e saj në Kosovë e përjetoi në Jugosllavinë titiste të AVNOJ-it¹, të kombeve dhe kombësive të barabarta!

Ajo që më tronditi në mënyrë të veçantë është «këshilla» që i dhatë funksionarit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, madje edhe OKB-së, se shqiptarët në Jugosllavi nuk trajtohen më si kombësi, por si pakicë nacionale.

Më në fund, po ju pyes sinqerisht, shoku Perlja, që të më thoni se si ta interpretoj këtë deklaratën tuaj në krahasim me deklaratën e fundit të sekretarit tonë Federativ për Punët e Jashtme në Konferencën e Parisit për të drejtat e njeriut. Budimir Lonçari me këtë rast e informoi këtë konferencë se Jugosllavia është i vetmi vend në botë ku pakicat nacionale quhen kombësi.

Jusuf Ferizi — gazetar

TV. Prishtinë

«Borba», «Otvoreno pisma

Aleksandrn Prlji», Beograd,

3.7.1989

1) Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë

Ali Aliu - Milazim Krasniqi

KOMISARI I NDËRLIDHJES

Gjatë bisedës me revistën «Danas» (Nr. 383) sekretari i Kryesisë së Komitetit të LK të Kosovës, Tomisllav Sekuliç, shprehu në mënyrë të qartë pikëpamjet e tij në lidhje me Kosovën. Kursi i tij radikal në kuadrin e një strategjie globale është i njohur prej vitesh dhe si i tillë është theksuar në procesin e deshqiptarizimit të Kosovës, për të cilën ai ka qenë mbrojtur nga Fushë-Kosova. Nuk ka dyshim se ai është përsëri me më shumë pushtet dhe zbatuesi kryesor i zhvillimeve aktuale në Kosovë. Që në fillim të intervistës së tij ai konstaton se shqiptarët janë në rrugë të gabuar dhe se që tani duhet të ndryshojnë kursin. Duhet thënë se «Komisari i ndërlidhjes» merrte tani përsipër një detyrë të vështirë, kur beson se në mënyrë mekanike shqiptarëve duhet t'u caktohet kursi, në të cilin duhet të ecin, sikur ata të ishin një masë amorfe. Për një «ndryshim të tillë të kursit» të tyre Sekuliçi ka një recetë të gatshme: «Në qoftë se sot 80 mijë shqiptarë jetojnë në Beograd në mënyrë krejt normale. . . , përse një jetë e tillë e përbashkët do të ishte e pamundur në Kosovë?» Sikurse dihet, shqiptarët jetojnë «plotësisht normalisht» jo vetëm në Beograd, por edhe në shumë qytete të tjera të Serbisë (ata janë më se 200 mijë veta) dhe nënkuptohet se janë të kënaqur me pozitën e tyre «të barabartë», përveç punëve të rënda dhe banimit në bo-

drumet dhe barrakat në periferi të qyteteve, ata nuk kanë asnjë lloj jete arsimore dhe kulturore dhe asnjë veprimtari në jetën publike, ekonomike dhe politike. Për këtë arsye dyert për asimilimin e tyre janë gjithmonë të hapura.

Megjithëkëtë, është e nevojshme të sqarohet pak çështja e «ndryshimit të kursit», për të cilin angazhohet Sekuliçi. Le të kujtojmë se në grumbullimet e nëntorit të kaluar të kombësisë shqiptare ishte i pranishëm kursi i Jugosllavisë së Titos, për të cilën dëshmojnë të dhëna dhe dokumente të gjalla. Për çfarë kursi flet tani Sekuliçi dhe përse angazhohet ai? Mos vallë mendon për kursin e detitoizimit të Jugosllavisë, i cili është aktualizuar dhe mbështetet me zë të lartë në disa qendra të caktuara? Pasi vizioni i Sekuliçit për «jetën e lumtur të përbashkët» të shqiptarëve përfshin edhe kërkesat për një Jugosllavi tjetër, është e nevojshme të bëhet pyetja se për çfarë kursi e ka fjalën komisarari i ndërlidhjes. Ai nuk pranon të shprehet për memorandumimin, i cili e konsideron Kosovën në kursin e detitoizimit, sepse edhe ai vetë i përmbahet kësaj platforme. Për këtë arsye ai mbështet dhe i shpall të rregullta kërkesat e disa qarqeve serbe në Prishtinë për shkatërrimin e një federate të tillë të Jugosllavisë siç e krijoi AVNOJ dhe Titoja. Për këtë arsye duket e pakuptueshme orvatja e T. S. që një kurs i tillë të mbështetet dhe të identifikohet me kursin e LKJ-së: «Nuk kemi alternativë tjetër përveç asaj që ofron LKJ dhe këtu s'është orientimi për jetë të përbashkët». Për ç'arsye nuk do të mund të shërbente LKJ si një urë që vërteton dekretet dhe urdhëresat, kur një praktikë e tillë tashmë është ligjëruar pas «bashkimit» politik e shtetëror të Serbisë!

Receta e ofruar nga T. S. për «jetën plotësisht normale të përbashkët» të shqiptarëve, në të vërtetë, po zhvillohet me një ritëm të caktuar. Përgatitjet për këtë kanë filluar para disa vjetësh, ndërsa si poligone për të provuar metodat e Çubrilloviçit¹ ishin disa mjedise jashtë

1) Anëtar i Akademisë serbe të shkencave, ish-ministër në qeverinë e RSFJ, autor i Memorandumit të vitit 1937 drejtuar qeverisë mbretërore të Jugosllavisë, «Shpërngulja e shqiptarëve».

Kosovës. Le të kujtojmë vetëm disa nga masat që janë marrë kundër shqiptarëve në Maqedoni: heqja e arsimit të mesëm në gjuhën shqipe, kufizimi i së drejtës për përdorimin e kësaj gjuhe në jetën publike, shkatërrimi i mureve dhe shtëpive, masat policore represive, kufizimi i natalitetit me masa administrative, etj. Reagimet tona të dikurshme për gjithçka po ndodh me shqiptarët në Maqedoni nuk ishin iluzione, sepse masa të tilla po zbatohen tani pjesërisht edhe në Kosovë. Sikurse dihet, po bëhen gati 10 vjet që kur i është shpallur një luftë e vërtetë çdo institucioni arsimor dhe kulturor që studion traditat shpirtërore të shqiptarëve, kundër tyre janë lëshuar anatema ose është bërë i dyshimtë çdo shqiptar i arsimuar. Kjo fushatë arriti të krijojë një platformë të përshtatshme për një nxitje të re të «deshqiptarizimit» të Kosovës. Në një atmosferë të tillë çdo ditë pushohen ose pezullohen nga detyrat e tyre qindra drejtorë, përgjegjës, inxhinierë, juristë, ekonomistë dhe punonjës në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe ekonomike në krahinë, dhe në vend të tyre vihen, në pjesën më të madhe të rasteve, kuadro nga radhët serbe. Struktura e kuadrit drejtues në ekonomi, në organet shtetërore, në institucionet e arsimit dhe të kulturës, në gjykatat etj., po ndryshohet në mënyrë radikale në dëm të shqiptarëve. Që tani mund të thuhet se popullsia serbe prej 10 për qind në Kosovë përbën shumicën e funksionarëve në Krahinë. (Po përmendim vetëm një shembull: kryesia e Komitetit të LK të Prishtinës ka krijuar 15 grupe pune për zbatimin e diferencimit ideopolitik të shqiptarëve në nivelin e komunës dhe vetëm tri nga këto grupe kanë përgjegjës nga kombësia shqiptare). Që të mos e rëndonim këtë shkrim me një varg shembujsh dhe numrash, po përmendim vetëm dy shembuj të tjerë: drejtori i përgjithshëm i kombinatit të Trepçes u zëvendësua nga një serb. Përpara disa ditësh organet e komunës së porsakrijuar të Obiliqit propozuan shkarkimin e drejtorit të Elektroekonomisë së Kosovës, që është shqiptar, dhe propozuan vetëm një kandidat, Petar Kostičin. Këto dy kombinatë përbëjnë bazën e ekonomisë së Kosovës. Këto ditë është hedhur ideja për bashkimin e elektroekonomisë së Kosovës me atë të Serbisë, gjë që, pa dyshim, ka lidhje me «kursin» e ri.

Duke iu përgjigjur pyetjes së bashkëbiseduesit të tij lidhur me praninë e nacionalizmit serb në Kosovë, Sekuliçi nuk kishte mundësi të mos pranonte veprimtarinë e tij. Por, kur shtrohet çështja se për ç'arsye nuk dënohen në mënyrë të barabartë kërkesat nacionaliste të serbëve, përkatësisht, se për ç'arsye dënohen në një mënyrë kaq brutale kërkesat e shqiptarëve që bëhen në frymën e kushtetutës, Sekuliçi e kishte përgjigjen të gatshme: «Këtu e kemi fjalën për kundërrevolucionin shqiptar, i cili ka strategjinë dhe qëllimet e tij. Këtu rreziku është më i madh.» Domethënë, këtu është fjala për një kundërrevolucion «të përjetshëm», gjë që nënkupton edhe mundësinë e masave represive «të përjetshme», mundësinë e procesit «të përjetshëm» për deshqiptarizimin, diferencimin, dyshimet dhe mosbesimin ndaj shqiptarëve. Sipas këtij «kursi» do të thoshim: Në qoftë se shqiptari guxon të ketë urinë e mendimit, të themi, lidhur me amendamentet në kushtetutë ose vetë kushtetutën dhe gjatë debateve për kushtetutën ekziston mundësia potenciale që ai ta shprehë këtë mendim, atëherë do të shpallet menjëherë nacionalist ose kundërrevolucionar. Në qoftë se guxon të mos jetë dakord me vendimin që gjysmës së rinisë shqiptare t'i hiqet e drejta e arsimit, atëherë ai është kundërrevolucionar etj. Nuk po flasim për faktin që dialogu i lirë në frymën e demokratizimit të shoqërisë për shqiptarët është plotësisht i pamundur. Sipas Sekuliçit, nacionalizmi serb mund të justifikohet sepse sot midis serbëve dhe malazezëve në Kosovë ka njëfarë nervozizmi, mosdurimi dhe pakënaqësie lidhur me ato që ndodhin dhe u duket sikur po bëhet pak për zgjidhjen e problemeve të tyre. «1.700 masa ideopolitike» (megjithëse ato, sikurse pohon vetë Sekuliçi, ndërkohë mund të jenë shtuar), kapin vetëm 2 për qind të popullsisë. Një anëtar tjetër i Komitetit të LK të Prishtinës (Gogiç) shkon më tutje. Ai pyet: çfarë janë 100 ose 120 përjashtime nga LK në një kolektiv që ka një mijë ose dy mijë të punësuar? Kjo do të thotë se është fjala për një motiv bazë: të pakësohet me çdo kusht prania e shqiptarëve në të gjitha fushat e jetës, gjë që përputhet plotësisht me strategjinë globale të modelit të Çubrilloviçit.

I pyetur lidhur me të dhënat e botuara për sa u për-

ket të izoluarve dhe torturave të policisë kundër tyre, Sekuliçi tha se nuk i kishte lexuar personalisht këto raporte dhe se nuk ka «dëgjuar informacione të tilla», porse beson dhe e di se «gjëra të tilla nuk kanë ndodhur». Ta lëmë mënjanë faktin se komisari i ndërlidhjes ka pasur dhe ka mundësi që të ketë në duart e tij deklarata me shkrim për këto gjëra edhe nga vetë të izoluarit, por edhe nga organet kompetente. Por, kur një udhëheqës partie i shpall të gjitha këto të dhëna si dezinformacione, atëherë kjo do të thotë se ai përpiqet të provojë se shqiptarët dezinformojnë, se ky është qëndrim i ndonjë shtabi të organizuar kundërrevolucionar. Për këtë arsye ai hesht lidhur me torturat fizike të policisë kundër qindra intelektualëve dhe deputetëve shqiptarë të izoluar. Për ta heshtin edhe zyrtarisht, heshtin edhe gazetatat në Kosovë dhe në Serbi, hesht edhe inteligjencia serbe. Dhe si të mos heshtin kur një pjesë e tyre kanë nxitur dhe frymëzuar marrjen e masave të tilla! Ato gjëra që kërkonin nëpër mitingje fushë-kosovasit, i realizuan njerëzit me uniforma blu në burgjet e Serbisë. Tucoviçi i madh kishte të drejtë kur fajtorë të vërtetë shpalli gazetarët për shkak të terrorit të ushtrisë serbe kundër popullsisë shqiptare në kohën e tij. Ç'dinë, për shembull, ushtarët në sheshin Tien An Men të Pekinit? Kur shkojnë atje, ata janë plotësisht të bindur se do të ndeshin armikun e rrezikshëm të vendit të tyre.

Më në fund, kur është fjala për terrorin policor kundër shqiptarëve të izoluar, duket se kjo është një traditë e gjatë dhe e hidhur. Le të kujtojmë vetëm aksionin e grumbullimit të armëve në dimrin e viteve 1955-1956, kur në këtë aksion u torturuan më se 30 mijë njerëz. Nuk mund të themi se nuk njihet kjo përvojë «e pasur» e torturave fizike mbi shqiptarët, që është zbatuar jo shumë kohë më parë në këto hapësira!

Kur përpunohet mendimi se çfarë kërkon Serbia nga Kosova, se synimet e saj në këto marrëdhënie janë plotësisht të ndershme, atëhere mund të bënim pyetjen: Ç'kërkon Kosova nga Republika e Serbisë dhe nga vendi, si dhe a do të vazhdojë ajo të konsiderohet ndonjëherë subjekt në këto marrëdhënie?

Çështja e ndihmës financiare për Kosovën paraqitet


në mënyrë të njëanshme dhe jo vetëm nga Sekuliçi: sa jepen për Kosovën. Mirë, por mund të bëhet edhe pyetja: sa merren nga Kosova? A mund t'i thuhet më në fund opinionit publik e vërteta lidhur me pozitën e Trepçes dhe sot? Teza për kontrollimin e investimeve, e cila shtrohet dendur, e imponon pyetjen e lartpërmendur. Nuk mund të mashtrohemi se asnjë e vërtetë nuk mund të jetë më e dëmshme sesa e panjohura.

Më në fund, po e përfundojmë këtë shkrim me atë që e përfundoi bashkëbiseduesja e shkëlqyer bisedën me Tomisllav Sekuliçin, me buzëqeshjen e saj të hidhur, megjithëse të përmbajtur, duke pasur parasysh aktualitetin.

*«Komesar za vezu», «Danas»,
Zagreb, 11.7.1989.*

II

KRIZA E KOSOVËS DHE GJENDJA E JASHTËZAKONSHME



Muhamedin Kullashi

**KRIZA KOSOVARE DHE KRIZA
E JUGOSLLAVISË**

Ka shumë kohë që Kosova po shërben si problemi kryesor i Jugosllavisë, si qendra e krizës jugosllave. Disa Kosovën e shikojnë si gjenerator të të gjitha fatkeqësive të Jugosllavisë, ndërsa disa të tjerë vetëm si shprehje të përqendruar të krizës së përgjithshme (politike, ekonomike, ndërnacionale) jugosllave. Disa mendojnë se kriza kosovare zbulon themelet e krizës së Jugosllavisë, kurse disa të tjerë se ajo i mbulon duke vënë në rendin e ditës probleme të tilla, të cilat të largojnë nga problemet kryesore të sistemit. Ndërsa disa përcaktimin zyrtar të detyrave për zgjidhjen e problemeve të Kosovës do t'i shikojnë të drejta dhe të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve të Serbisë dhe Jugosllavisë, të tjerët do të paraqesin mendimin se «Kosova nuk ka shërbyer si katalizator për rishikimin parimor të themeleve, mbi të cilat është konstituar bashkësia jonë politike, por si shkak i mirëpritur që të shmangen diskutimet e tilla».

Me këtë rast do t'i referohem një interpretimi të krizës kosovare, të propaganduar gjerësisht në organet e propagandës, të pranishëm te shumë intelektualë dhe politikanë. Ai paraqitet në shumë variante, i tendosur ose elastik, i matur ose radikal, i sipërfaqshëm ose teorikisht

i mbështetur në mënyrë solide, por unë do të përpiqem të dalloj elementet e përbashkëta themelore. Do të paraqes disa vërejtje duke pasur për qëllim të tregoj se në ç'masë ky interpretim dhe kjo praktikë politike, e cila mbështetet në të, bëjnë të mundur ndriçimin e krizës kosovare dhe zgjidhjen e saj dhe në cilën masë i bëjnë të pamundura.

Termtat kryesorë, me të cilët operon ky interpretim gjatë analizës së krizës kosovare, janë: «shqiptarizimi», «kundërrevolucioni» dhe «genocidi». Rrënjët e krizës së tanishme kosovare disa i shikojnë në ndryshimet që u bënë në Plenumin e 4-t të Brionit, disa edhe më parë, në kohën kur u formulua politika e PKJ-së ndaj çështjes nacionale. Prirjen kryesore të periudhës pas Brionit në Kosovë Dobrica Qosiçi do ta formulojë shkurtimisht si «shqiptarizim total të hapësirës shtetërore dhe kombëtare serbe dhe jugosllave për krijimin sistematik dhe evolutiv të Shqipërisë së Madhe». «Shqiptarizimi» është përcaktuar si pushtim, nga ana e një pakice kombëtare shqiptare, të territorit serb dhe jugosllav.

Vështirë se mund të mohohet se pas Plenumit të Brionit në Kosovë janë bërë ndryshime të mëdha: vendoset administrata dygjuhësore, rritet përqindja e shqiptarëve të vendosur në punë, hiqet embargoja për mësimin e letërsisë dhe historisë shqiptare, krijohen institucione të shumta kulturore dhe shkencore, para së gjithash universiteti me mësimdhënie në gjuhën serbe dhe shqipe, zhvillohet veprimtaria botuese edhe në gjuhën shqipe (libra, revista, gazeta), përveç radios, programi i TV transmetohet edhe në gjuhën shqipe, ndërsa me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 delegatët e Kosovës depërtojnë në të gjitha forumet, organet dhe institucionet e mundshme, në të gjitha nivelet.

Gjithë periudhën pas Brionit në Kosovë një politolog i njohur do ta vlerësojë si «përgatitje të kundërrevolucionit . . . , të cilin e ka financuar klasa punëtore e Jugosllavisë». Kështu, nocioni kundërrevolucion shërben për saktësimin e kuptimit të nocionit shqiptarizim. Një autor tjetër «shqiptarizimin» do ta përcaktonte si një nga «metodat më të rrezikshme separatisto-kundërrevolucionare». Për një filozof tonin të rëndësishëm kjo periudhë

është shënuar «me realizimin e një programi ofensiv kom-
bëtar», i cili ka si qëllim krijimin e Shqipërisë së Madhe.
Që të mos ketë keqkuptime rreth karakterit të këtij pro-
grami, filozofi ynë shton se bartësit e këtij programi janë
ballistët si forca kryesore politike në Kosovë dhe jo grupet
e vogla marksiste-leniniste. Në realizimin e këtij progra-
mi «populli shqiptar në Kosovë ka gëzuar përkrahjen e
fuqive shumë më të mëdha nga Serbia dhe populli serb»:
Turqisë, Austro-Hungarisë, Kominternit, ushtrive gjer-
mane dhe italiane, ndërsa sot edhe përkrahjen e oligar-
kive të shumicës së njësive tona federative. Prandaj, para-
lajmëron filozofi, «ai është kundërshtar më i fortë në këtë
luftë dhe ky është një fakt, që nuk duhet harruar ku-
rrë».(!)

Shumë intelektualë do të konstatojnë se për realizi-
min e këtyre qëllimeve shqiptarët kanë përdorur të gjitha
mjetet, kurse një nga më të fuqishmit dhe më efikasat
ka qenë lindshmëria. Lindshmëria, si një aspekt thelbë-
sor për shqiptarizimin e Kosovës, vlerësohet nga disa
shoqata (Shoqata e pedagogëve të universitetit dhe e
punonjësve të tjerë shkencorë të RS të Serbisë dhe Sho-
qata shkencore e Serbisë) si «formë e paramenduar dja-
llëzore e luftës speciale». Një nga dështimet e politikës
nacionale në Jugosllavi një filozof tjetër e shikon në
faktin se nuk ka pasur njerëz «që do të guxonin t'i para-
lajmëronin shqiptarët se me lindshmërinë e tyre do të
arrijnë pak dhe vetëm do të shkaktojnë konflikte të rënda
me kombet e tjera në qoftë se me vendosmëri nuk do të
pakësojnë përqindjen e lindshmërisë». Mendoj se një
kuptimi të tillë të problemit të lindshmërisë te shqiptarët
mund t'i bëhet vërejtja, të cilën Bllahu, duke cituar
Marksin, i bën teorisë maltuziane: atë e karakterizon
«mendimi thellësisht i ulët», në të dy kuptimet, në atë
shkencor dhe moral.

Në shumë shkrime për Kosovën marrëdhëniet shqip-
taro-serbe sot dhe në të kaluarën janë paraqitur me
skemën që pretendon të shprehë thelbin e këtyre mar-
rëdhënieve: vazhdimësi e dhunës së shumëfishtë, në
të cilën të parët rregullisht paraqiten si agresorë, ndërsa
të dytët si viktima. Në bazë të «ekspansionit të vet bio-
logjik», të «brutalitetit dhe paturpësisë biologjiko-shtaza-

rake» shqiptarët bëjnë genocid ndaj serbëve dhe malazezëve, duke i dëbuar ata nga vatrat e tyre. Sipas disave, ky proces fillon menjëherë pas Brionit, sipas të tjerëve, qysh para Luftës, ndërsa, sipas të tretëve, të paktën tre shekuj më parë. Në kuadrin e kësaj skeme rregullisht paraqiten edhe përcaktimet antropologjike dhe etnopsikologjike të të dy palëve: të parët për nga natyra e tyre janë etnocentrikë, të egër e gjysmë të egër, agresivë, grabitës, (këtu manipulohet edhe me disa deklarata të Marksit), të mbyllur ndaj përparimit, të paaftë për bashkëjetesë, shërbëtorë të të gjithë pushtuesve. Të dytët janë liridashës, fisnikë, johakmarrës, kultivojnë idenë e vëllazërimit deri në vetëmohim.

Ky model i interpretimit të gjendjes dhe marrëdhënieve, në radhë të parë të marrëdhënieve shqiptaro-serbe, është deduktiv dhe apriori: shembujt e ndryshëm të historisë seleksionohen dhe paraqiten në atë mënyrë, që duhet të vërtetojnë skemën themelore. Në fakt, nga historia e popujve ballkanikë, plot me konflikte, nuk është vështirë të konstatosh — dhe ato janë të vazhdueshme në historiografitë nacionale — tablo të tilla të reduktuara, thënë në mënyrën më të butë. Në to ngjarjet, rrethanat e caktuara, veprimtaritë e personaliteteve, të grupeve apo institucioneve thjeshtohen, shtrembërohen dhe ndonjëherë edhe falsifikohen. Skemat aprioristike, në të cilat futen marrëdhëniet e ndërlikuara shqiptaro-serbe gjatë historisë, tregojnë jo vetëm njëanshmëri, por edhe një pa-dije që s'mund të kihet zili, të paktën, për njërën nga këto dy palë, për shqiptarët. Këto skema nuk do të mund t'i sqaronin kurrsesi ngjarjet, për të cilat dëshmojnë D. Tucoviçi, D. Vasiçi: ose të ashtuquajturat «deformime të UDB-së», ose shpërnguljen masive me dhunë të shqiptarëve për në Turqi etj. Dobësitë e lartpërmendura e bëjnë atë të paaftë për të sqaruar edhe ngjarjet pas Brionit në Kosovë, aspektet e shumëfishta të realitetit kosovar: ç'ka qenë në këto ngjarje nacionaliste dhe ç'ka qenë përpjekje për realizimin e disa të drejtave rudimentare qytetare dhe kombëtare, për të sqaruar tronditjet sociale dhe nacionale, funksionimin dhe veprimtarinë e burokracisë pluronacionale kosovare, transformimet që bëhen nga zhvillimi i shpejtë ekonomik, përpjekjet që sy-

nonin daljen nga prapambetja dhe ato që kanë tërhequr drejt vetizolimit, tronditjet dhe reflektimet në ndërgjegjen e të rinjve brenda këtij procesi më shumë spontan, për të sqaruar në mënyrë të argumentuar format e manifestimit të nacionalizmit shqiptar, duke përcaktuar kuptimin e nocionit nacionalizëm, pikat, në të cilat përpjekjet e shqiptarëve për emancipimin kombëtar kalojnë në synimet për epërsi etj. Në vend të kësaj, marrëdhëniet shqiptaro-serbe reduktohen në dhunën e shumëfishtë të më të fortëve ndaj më të dobtëve dhe në armiqësinë e vazhdueshme, kurse shqiptarizimi përshkruhet si proces shkaktërrimtar për pushtimin dhe përdhosjen e territorit serb dhe jugosllav.

Skema të tilla, të ngarkuara me paragjykime të rënda, janë të habitshme për autorë të tillë, të cilët me veprimtarinë shumëvjeçare janë treguar si mendimtarë, kritikë përparimtarë, humanistë dhe demokratë. Megjithatë, në qëndrimin ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të shumë intelektualë kanë munguar fryma kritike, humanizmi dhe shpirti demokratik.

Teknologjia e fabrikimit të tablosë për Kosovën — me kontribut të përbashkët të organeve të propagandës, intelektualëve dhe qendrave të fuqisë politike — nuk është ndonjë novacion i madh; ajo mbështetet në dy forma klasike propagandistike: a) në ndërtimin e një tabloje për gjendjen e përgjithshme, për marrëdhëniet thelbësore në bazë të «të vërtetave të vogla», gjysmë të vërtetave dhe të pavërtetave, b) në përsëritjen këmbëngulëse të vlerësimeve globale («genocid», «terror») të mbështetura në shembujt e kriminalitetit. Me këtë nuk dua të them se kjo tablo nuk ka aspak lidhje me realitetin kosovar, se nacionalizmi shqiptar dhe ekskluziviteti nacional janë thjesht shpifje, por të tregoj anën problematike të ndërtimit të kësaj tabloje për gjendjen globale dhe marrëdhëniet zotëruese.

Në këtë tablo të gjitha format e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve midis shqiptarëve dhe serbëve detyrimisht marrin karakter ndërnacional, të gjitha pasojat e funksionimit të keq të organeve shtetërore dhe administrative, të gjitha pasojat e arbitraritetit të paturpshëm të burokracisë shumëkombëshe në të gjitha nivelet, ku

ana shumëkombëshe është veçori e shprehur në qendrat më të rëndësishme drejtuese, shkrihen në një prirje të vetme: të armiqësisë së shqiptarëve ndaj serbëve për t'i dëbuar ata nga Kosova. Pothuajse çdo shpërngulje e serbëve dhe e malazezëve shpjegohet me të vetmin shkak — me dhunën e shumëfishtë të shqiptarëve. Nga teza fillestare, sipas së cilës ka pasur raste të shpërnguljeve nën presion, u arrit në tezën, sipas së cilës të gjitha shpërnguljet janë shkaktuar nën presion. Transformimi i kësaj teze nuk mbështetet në asnjë analizë serioze. Çdo përpjekje për një qëndrim «realist» ndaj këtij problemi, çdo përpjekje për të analizuar shkaqet, sidomos çdo lloj krahasimi me lëvizjet e tjera migruese në vend, si dhe vënia në dukje e shpërnguljes së shqiptarëve, demaskohen si përpjekje për të fshehur «fashizmin genocid shqiptar». Po kështu cilësohen edhe të gjitha konstatimet, që flasin për ekzistencën e marrëdhënieve të mira ndërnacionale në ndonjë kolektiv, bashkësi lokale apo fshat.

Çdo formë mosmarrëveshjeje dhe konflikti midis pjesëtarëve të kombësive të ndryshme në Kosovë ka paraqishtë një domethënie të rezervuar, që më parë ndihet edhe fajtori. Në një konsultë të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Brezovicë, para tre vjetësh, zëvendësprokurori publik i Republikës, duke konstatuar këtë prirje, paralajmëroi: «Do të ishte e rrezikshme në qoftë se çdo konflikt midis pjesëtarëve të kombësive të ndryshme do të trajtohej me motive nacionaliste». Paralajmërimet e tilla nuk mund të dëgjohen më. Hidhen poshtë të gjitha të dhënat e plota për format e ndryshme të konflikteve në Kosovë, përpjekjet për t'i analizuar ato, krahasimet me dukuri të njëjta në pjesët e tjera të vendit. Disa gazetarë kanë paralajmëruar për domosdoshmërinë e analizave të thella për sqarimin e gjendjes në Kosovë.

Të gjitha të dhënat e deritanishme zyrtare për kriminalitetin tregojnë se Kosova për disa forma deliktësh është nën mesataren e vendit, ndërsa për disa të tjera në nivelin mesatar të vendit. Përqindja më e madhe e konflikteve ndodh midis pjesëtarëve të të njëjtit komb dhe një numër shumë më i vogël u përket pjesëtarëve të kombeve të ndryshme. Nuk do të dëshiroja të flisja për manipulimet që bëhen në këtë drejtim, sidomos për

manipulimet lidhur me përdhunimet. Do të përmend vetëm një shembull të këtij manipulimi: gjatë vitit 1988 në Kosovë ka pasur vetëm një përdhunim (dhe dy orvajtje për përdhunim), ku autori është shqiptar, ndërsa viktima — pjesëtare e kombësisë serbe. Do të ishte interesant sikur dikush të përpiqej të analizonte çdo gjë që është shkruar dhe është thënë për këtë temë në mjetet e informacionit publik, në forume, mbledhje etj. duke e paraqitur punën sikur gjëra të tilla ndodhin çdo ditë.

Problemi i padrejtësive ndaj serbëve dhe malazezëve në Kosovë shpeshherë paraqitet turbull, pa përpjekje që ai të shpjegohet qartë. Në kushtet e mosfunksionimit të shtetit juridik, kur vepron arbitrariteti burokratik, padrejtësitë nga organet shtetërore dhe organe të tjera gjatë realizimit të të drejtave shoqërore, ekonomike dhe kombëtare nuk janë një dukuri e rrallë. Por, problemi errësohet në atë moment, kur flitet vetëm për mohimin e të drejtave të serbëve dhe malazezëve, kur në mënyrë të kuptueshme thuhet se shqiptarët kanë më shumë të drejta dhe liri.

Një analizë e kujdesshme dhe e thellë e këtij problemi në Kosovë do të tregonte gjithë kufizimin dhe njëanshmërinë e tablosë që ofrohet. Këtu do të paraqes vetëm disa të dhëna, të cilat do të ishin kontribut i dobishëm për analizën e problemit të mohimit të të drejtave në Kosovë. Disa sociologë mendojnë se papunësia është kategoria që diskriminon më shumë popullsinë. Rreth 65 000 familje shumanëtarëshe në Kosovë nuk kanë asnjë anëtar në marrëdhënie pune në sektorin shoqëror. Struktura nacionale e të zënëve me punë, në 1 000 banorë në Kosovë të punësuar janë 109 shqiptarë, 228 serbë dhe 258 malazezë, pra, punësimi i shqiptarëve është dy herë më i vogël. Shpërndarja e funksioneve drejtuese i përgjigjet edhe më pak strukturës nacionale të popullsisë. Struktura e kuadrit në Universitetin e Prishtinës më 1980-1981 ishte: 66,12 për qind pedagogë të kombësisë shqiptare, 33,88 për qind të kombësisë serbe dhe malazeze, ndërsa më 1987-1988 — 59,3 për qind e pedagogëve janë të kombësisë shqiptare, ndërsa 40,7 për qind të kombësive serbe dhe malazeze.

Disa intelektualë kanë protestuar kundër arrestimeve e

dhe dënimeve të shqiptarëve lidhur me kërkesën «Kosova-
-Republikë», duke menduar se në themel bëhet fjalë për
«delikt verbal», për veprimtari politike pa dhunë: shkru-
arja e pamfleteve, parullave etj. Në qoftë se është kështu,
dhe në qoftë se merret parasysh fakti se për këtë veprim-
tari janë dënuar me afate të shkurtra ose të gjata disa
mijëra shqiptarë pas vitit 1981 (ndërsa nga 1968 deri në
vitin 1981 rreth 400), atëherë problemi i mbrojtjes juri-
dike dhe i të drejtave qytetare në Kosovë bëhet pak i
ndërlikuar.

Nga viti 1981 në Kosovë janë larguar nga shkollat
e mesme dhe fillore 370 arsimtarë të kombësisë shqiptare,
14 pedagogë nga universiteti, disa qindra nxënës kanë
humbur të drejtën e shkollimit nga 1 deri në 5 vjet si të
papërshtatshëm nga pikëpamja moralo-politike. Rreth
1000 nxënësve nuk u është dhënë e drejta për të studiuar,
megjithë dhënien me sukses të provimeve pranuese, mbi
bazën e karakteristikave që u dërgojnë komunat fakulte-
teve. Me qenë se kjo karakteristikë është sekrete, nxë-
nësi nuk ka mundësi të mbrohet nga vërejtjet që janë
paraqitur aty kundër tij. (Rasti në Podujevë: disa nxë-
nësve u është mohuar e drejta e shkollimit për arsye
se «prindërit e tyre janë përpjekur të blejnë shtëpi ose
prona të serbëve dhe malazezëve».) Gjithashtu është akti-
vizuar zakoni juridik mesjetar i izolimit ose i damkosjes
së familjeve, anëtarë të së cilave u kanë shkaktuar ndonjë
dëm fqinjëve të tyre serbë dhe malazezë. Ka munguar
mbrojtja juridike edhe për disa qindra familje, pjesëtarët
e të cilave jetojnë në izolim për shkak të deliktit të gjak-
marrjes. Gjithashtu theksohet se ka mjaft dallime në
kriteret e politikës së dënimeve në vartësi nga përkatësia
nacionale: psh. me një vit burg është dënuar personi ma-
dhor i kombësisë serbe për përdhunimin e një vajze të
mitur të kombësisë shqiptare, ndërsa në të njëjtën kohë
me 10 vjet burg dënohet i mituri i kombësisë shqiptare
për përpjekje përdhunimi ndaj vajzës së mitur të kom-
bësisë serbe; për përpjekje përdhunimi personi i kombë-
sisë serbe ndaj një personi të kombësisë shqiptare dënohet
me 60 ditë burg, rasti në Liplan; për vrasjen e serbit,
shqiptari është dënuar me vdekje; ndërsa për tri raste
vrasjeje shqiptarësh nga serbë «opinion i publik nuk është

informuar për gjykimin e tyre» (siç ka deklaruar një funksionar kosovar). Mendoj se edhe këto të dhëna mund të tregojnë se parulla «kërkojmë të njëjtat të drejta si dhe shqiptarët» nuk qëndron. Pasojat e një politike të tillë gjyqësore, e cila drejtohet nga kritere arbitrare dhe me arbitraritetin e krerëve politikë, mund të merren me mend.

Në paraqitjen dhe vlerësimin e gjendjes në Kosovë një nga termat më të përdorur është termi «armik» dhe «veprimtari armiqësor». Nga historia politike dihet se ky term përdoret kundër çdo kundërshtari ose rivali politik ose thjesht kundër viktimës së zgjedhur. «Ai që është zgjedhur si armik tashmë edhe shikohet si armik». (Hork Hejmer — Adorno në «Dialektika e iluminizmit»). Duke u zbatuar edhe në kushtet paqësore kjo terminologji e kohës së luftës shpreh përpjekjen, që ndaj atyre që kanë botëkuptim tjetër politik ose të kundërt, të zbatohen po ato masa që përdoren ndaj armiqve të jashtëm. Kur është fjala për shqiptarët e Kosovës, dhe jo vetëm të Kosovës, por edhe të krahinave të tjera të Jugosllavisë, ata herë pas here paraqiten në rol të dyfishtë: edhe si armiq të brendshëm, edhe si armiq të jashtëm. Perceptimi i shqiptarëve si armiq të jashtëm dhe të brendshëm është i pranishëm në shkrimet, ku flitet për depërtimin e shqiptarëve në territoret serbe ose jugosllave, ku flitet për pushtimin e territoreve dhe të institucioneve. Kur shqiptari blen pronën e serbit, kjo, sipas një ekonomisti tonë të shquar, është «shitje e territorit kombëtar». Por, në realitetin kosovar me këtë nocion mund të cilësohet pothuajse çdo gjest, akt dhe sidomos mosmarrëveshje ose grindje midis pjesëtarëve të kombësive të ndryshme. (Rasti në fshatin Dobreve: fëmija shqiptar godet me gur një fëmijë serb. Ky rast është cilësuar si nacionalist dhe armiqësor. U burgosën dy anëtarë madhorë po të asaj familjeje dhe më vonë është filluar procedura penale dhe kundër fëmijës së mitur. Me këtë akt djaloshi është shndërruar në armik, me këtë akt ai jo vetëm që ka manifestuar natyrën e tij nacionaliste, por edhe natyrën e familjes dhe të shkollës që e ka edukuar). Quhet e «natyrshme» që në gjendjen e Kosovës çdo akt i tillë të marrë një klasifikim të tillë. E ashtuquajtura «atmosferë» e

konflikteve të tilla u jep detyrimisht kuptim armiqësor. A kemi të bëjmë këtu me mbrojtjen juridike të qytetarëve apo me mohimin e drejtësisë dhe të ligjshmërisë? Arbitrariteti, me të cilin përdoret nocioni armik, i bën shumë të pasigurta themelet e të drejtave qytetare dhe të njeriut. Nuk janë aq të rralla rastet që ky nocion përdoret jo vetëm për individin, grupin, për disa institucione, por edhe për të gjithë kombësinë shqiptare. Disa do ta paraqesin këtë si të padyshimtë, disa të tjerë do ta supozojnë këtë duke lënë të nënkuptohet mundësia e ekzistencës së disa shqiptarëve të ndershëm ose «me orientim jugosllav». Në rastet më të shpeshta kjo supozohet qartë kur veprimtaria armiqësore kundërrevolucionare e shqiptarëve në Kosovë paraqitet si e përgjithshme, kudo e pranishme, si forcë e plotfuqishme që përshkon të gjitha sferat e jetës.

Nocionet «shqiptarizim», «kundërrevolucion», «genocid», «armik» nuk reduktohen vetëm në faktin që pengojnë analizën kritike të gjendjes kosovare në tërësi dhe sidomos shfaqjet e nacionalizmit shqiptar. Për nga rëndësia e përhapjes dhe e përdorimit arbitrar të tyre ato ngjallin me sukses pasigurinë, frikën dhe urrejtjen të të gjitha kombësitë. Përcaktimi i gjendjes që mbështetet në këto nocione nuk është një përcaktim i thjeshtë, i përkrahur nga institucionet e fuqishme, ai është pjesë e procesit të krijimit të një atmosfere të caktuar politike dhe jetësore, të marrëdhënieve të caktuara që i karakterizojnë mosbesimi, frika dhe urrejtja. Brenda një kuadri të tillë politik likuidohen të gjitha përpjekjet për zhvillim në çdo sferë të jetës shoqërore.

Këto nocione radikale sugjerojnë si një zgjidhje të vetme të mundshme, të zvarritur për një kohë shumë të gjatë, «si një zgjidhje përfundimtare» të problemit kosovar: represionin me armë, administratën ushtarake, dëbimin nga Kosova të 300-400 mijë të ashtuquajturve «emigrantë».

Ndryshe nga ky orientim, i cili të çon në rrugë pa krye, mendoj që rrugëdalje nga kriza kosovare paraqesin ato orientime që këmbëngulin për «vendosjen e regjimit të drejtësisë» (Zoran Gjingjiç), në «mjete paqësore e jo në mjete lufte» (Bebojsha Popov), ose «vetëm në bazë të një programi të plotë pozitiv të luftës për zhvillimin e

socializmit humanist, demokratik dhe vetadministrues» (Gajo Petroviç).

Duke lënë mënjanë çështjen nëse kriza kosovare mund të zgjidhet më parë, paralelisht ose vetëm pas ndryshimeve të domosdoshme në shtet si tërësi, pajtohem me ato mendime që vënë në dukje domosdoshmërinë e ndryshimeve radikale, të cilat i kërkon kriza që është radikale (Zharko Puhovski). Duke konsideruar se burimi themelor i krizës së Kosovës, të Serbisë dhe të Jugosllavisë qëndron në zotërimin absolut të sferës politike mbi të gjitha sferat e jetës shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pajtohem me ato mendime, të cilat vënë në dukje domosdoshmërinë e kufizimit dhe të kontrollit të pushtetit politik, krijimin e premisave për një funksionim efikas të shtetit juridik, për sigurimin e veprimtarisë së pavarur të gjykatave, për pluralizmin politik dhe kulturor, për autonominë e shoqërisë dhe të individit ndaj shtetit, për krijimin e kushteve që individi të mos reduktohet në prodhim të sferës politike, në një armë në duart e oligarkive nacionale, por për krijimin e hapësirës për një pjesëmarrje të tij serioze bashkërisht me individët e tjerë të lirë.

«Kosovska kriza i kriza Jugosllavije», referat i mbajtur në tubimin shkencor në Lubjanë me temë «Kosova — Serbia — Jugosllavia». Marrë nga «Zbornik: Kosovo-Serbija-Jugosllavia», Lubjane, Maj 1989, f. 17-24.

Rexhep Qosja

**LETËR E HAPUR SHKRIMTARËVE
SERBË, PJESEMARRËS NË TAKIMIN
«MBI KOSOVËN DHE PËR
KOSOVËN»**

Pasi në librat ku keni shkruar dhe në takimet ku keni folur për shqiptarët e për Kosovën e keni lënë mënjane respektimin e së vërtetës, pra, edhe të ndjenjës humanitare, po ju drejtohem me një letër të hapur, duke shpresuar se për-mendimet e shprehura në të do të mendoni sadopak. Sigurisht, unë nuk i di të gjitha ato që janë thënë në takimin «Mbi Kosovën dhe për Kosovën», por edhe ato që kam mundur të lexoj në disa gazeta, siç janë «Rilindja» dhe «Jedinstvo» të Prishtinës, të cilat kanë informuar opinionin publik për këtë veprimtari, janë të mjaftueshme për të kuptuar përmbajtjen e metafizikës suaj kosovare dhe për të nxjerrë se cilat janë mesazhet e saj. Është e vërtetë se nuk është hera e parë që në «Francuska 7» mbliidhet sinodhi i shenjtë i Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë kushtuar shqiptarëve dhe Kosovës, por ndoshta është herë e parë që në të marrin pjesë jo vetëm disa nga shkrimtarët më të rëndësishëm bashkëkohorë të Serbisë, të njohur në të gjithë vendin e jashtë tij, por

edhe disa shkrimtarë e historianë letërsie, të cilët deri dje, si anëtarë të organeve më të larta politike të LK të Serbisë, kanë folur nga tribuna e saj për marrëdhëniet ndërnacionale nga pikëpamja e dialektikës marksiste e jo të metafizikës së shenjtë. Në fakt, ju jeni shkrimtarë të lumtur, pasi në çdo drejtim jeni shkrimtarë të lirë. Ju mund të grumbulloheni kur të doni dhe jo vetëm në «Francuska 7». Në takimet tuaja mund të ftoni edhe priftërinj, që kanë ose nuk kanë interes për letërsinë, të bëni diskutime, pa asnjë lloj censure e sidomos pa asnjë lloj autocensure, për çfarëdolloj shoqate letrare ose teme të mirëfilltë politike, e më fort për shqiptarët dhe për Kosovën. Ju mund të udhëtoni edhe nëpër botë, në Evropë, në SHBA, në Australi e në kontinente të tjera dhe të flisni për çdo gjë në «Francuska 7». Ju jeni të lumtur, pasi jeni me të vërtetë të çliruar nga «besnikëria» burokratike ndaj vetvetes. Ndërsa ju mund të mblidheni e të flisni edhe për tema politike, të botoni mite të vjetra e të sajoni mite të reja për Kosovën, të lavdëroni ose të kritikoni sipas dëshirës, unë në ato mbledhje të rralla të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dëgjoj të diskutohet kryesisht për konkurse letrare, për çmime letrare e joletrare dhe për honorare, ndërsa për metafizikën tuaj ne mund t'i shprehim deri-diku më lirisht mendimet tona vetëm në disa gazeta ose revista jashtë Kosovës.

Përçarje të tmerrshme

Me veprat tuaja, gjë që më duket plotësisht e natyrshe, për krijuesit letrarë, ju ngrini lart flamurin e lirive demokratike dhe të së vërtetës. Këtë flamur e keni ngritur lart tani, gjatë diskutimeve në takimin «Mbi Kosovën dhe për Kosovën». Megjithatë, fakti që ju drejtohem publikisht është shprehje e së drejtës së pamohueshme intelektuale dhe morale, për të cilën ju flisni kaq shumë, por duke hapur një hendek të madh e të tmerrshëm midis lirisë, demokracisë e së vërtetës, që i lejon vetes, dhe lirisë, demokracisë e së vërtetës që u lejon shqiptarëve dhe ngandonjëherë, disa midis jush, edhe kombeve të tje-

ra në Jugosllavi. Për ç'liri, demokraci e të vërtetë në përgjithësi mund të flisni ju? Për lirinë, demokracinë e të vërtetën që janë të pandashme, pasi u takojnë të gjithëve, apo vetëm për lirinë, demokracinë e të vërtetën që ju takojnë vetëm juve? Apo nuk e vini re se si kërcënohet liria e shqiptarëve me ato që ju predikoni sot jo vetëm në këtë takim, por edhe me konturet e sajua për Kosovën e nesërme?

Qysh prej disa vjetësh ju, dhe jo vetëm disa gazetarë, po i bëni shqiptarët një fantazmë, nga e cila kërcënohet tërë Jugosllavia, e sidomos Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Me fjalët tuaja për shqiptarët e për Kosovën ju jeni bërë një forcë e vërtetë ndihmëse për ato qarqe burokratike, që krizën e vet politike, shoqërore e morale përpiqen ta frenojnë me dënimin e atyre që cilësohen si të vetmit fajtorë për gjithçka — të shqiptarëve. Për më tepër, takimi juaj është bërë një institucion publik, ku nëpërmjet një fushate presioni indoktrinohet opinioni shoqëror me një predispozicion të paparë antishqiptar, qëllimet e të cilat janë mjaft të qarta dhe mjaft konkrete.

A e lexoni shtypin e përditshëm dhe periodik? A keni lexuar gjatë këtyre viteve në këtë shtyp, në gjuhën serbokroate, se ç'është shkruar për shqiptarët në të kaluarën dhe në të tashmen? Sigurisht që po. A e keni lexuar ç'shkruhet për shqiptarët në këtë fushatë të fundit diskredituese të «Politika», «Politika ekspres», «Novosti», «Borba», «Duga», «NIN», «Intervju», «Svet» dhe në gazetatat e në periodikët e tjerë? Sigurisht që po.

Shqiptarët dhe kinezët

Për shembull, a e keni parë «Borbën» e datës 8 maj të këtij viti? Në qoftë se e keni parë, atje janë botuar pesë shkrime, në të cilat flitet për shqiptarët: në shkrimin e parë njoftohet për mbledhjen e ardhshme të KQ të LKJ-së për Kosovën; në shkrimin e dytë kritikohet mënyra si informoi TV e Prishtinës për grumbullimin e serbëve e të malazezëve në Fushë-Kosovë më 24 prill 1987; në të tretin, në kuadrin e njoftimeve për festimin e 100-

-vjetorit të Akademisë së Shkencave e të Arteve të Serbisë, botohen fjalët e kryetarit të saj për gjoja dhunën e organizuar ndaj popullsisë serbe e malazeze në Kosovë dhe për shkëljen e të drejtave të tyre më elementare; në shkrimin e katërt flitej për shqiptarët në Maqedoni, për njëfarë gatishmërie të tyre misterioze që të blejnë nga maqedonët tokë me çmime, siç thuhet, të larta; gjithashtu përmendet dhe lindshmëria e lartë e palejuar etj. Në shkrimin e pestë shprehet shqetësimi lidhur me faktin se shqiptarëve nga Tetova, Gostivari, Prishtina, Gjakova dhe Prizreni u është dhënë mundësia të ndërtojnë për vetë në Ulqin hotele e restorante.

A e keni lexuar «Politikën» e datës 20 maj po të këtij viti? Sigurisht që po. Një nga 6 shkrimet e saj për shqiptarët është edhe ai që flet për manastirin e Roskovecit afër Preshevës, domethënë jashtë Kosovës, për varret e për objektet e tjera të tij, për të cilat thuhet se turqit i kanë ruajtur, por shqiptarët sot jo. A e keni parë «Politikën» e datës 28 maj po të këtij viti? Në qoftë se e keni parë, mund ta keni vënë re se në këtë numër shkrimet për shqiptarët vetëm brenda një jave janë dyfishuar, duke arritur në 12. Dhe kështu, sipas rrethanave, do të jetë derisa të thirret plenumi i KQ të LKJ-së në fund të qershorit si dhe më pas, me një ndërprerje të shkurtër ose të gjatë, deri në shpalljen e ndryshimeve kushtetuese. Kudo, në të gjitha anët, shqiptarët! Sikur ata janë më të shumtë se kinezët dhe sikur përbëjnë një racë të veçantë njerëzore, nga e cila vetëm të këqija mund të priten. Si intelektualë, që e keni për detyrë të mendoni, është e dyshimtë nëse keni menduar, qoftë edhe një orë, a ka ndonjëfarë logjike në të gjithë këtë? Në qoftë se shqiptarët, të cilët janë pakicë në këtë shtet, kërcënojnë të tjerët në Kosovë, sepse përbëjnë shumicën në këtë krahinë, si është e mundur të bëjnë të njëjtën gjë edhe në jug të Serbisë, në Maqedoni e në Mal të Zi, ku përbëjnë pakicën? Mos vallë pikërisht shqiptarët, një popull i vogël, janë aq të gjithëfuqishëm, saqë pozitën e tyre si pakicë në një shtet, — ku përbëjnë vetëm një të 12-tën e tij, — ta kthejnë në mënyrë magjike në pozitë të shumicës dhe pushtetin e kufizuar të pakicës ta kthejnë në mënyrë magjike në një pushtet të pakufizuar të shumicës!

Por ndoshta juve, shkrimtarëve, ju lejohet që mundësi të tilla, të cilat nuk janë të çuditshme vetëm për fantastikën letrare magjike të Artur Klarkut, t'i përshkruani me aq këmbëngulje në takimet tuaja për shqiptarët! A i keni dëgjuar mirë dhe a i keni lexuar më pas ato që u thanë për shqiptarët në Fushë-Kosovë më 24 prill 1987? Sigurisht që po. A e keni dëgjuar apo e keni lexuar në një variant të shkurtuar në «Borba» të datës 23-24 maj 1987 atë që thanë disa shkrimtarë, profesorë e gazetarë të kombësive serbe e malazeze me rastin e vizitës kolektive në Beograd më 21 maj? Sigurisht që po.

A e keni dëgjuar mirë se çfarë kanë thënë për shqiptarët disa nga kolegët tuaj në takimin «Mbi Kosovën dhe për Kosovën»? Sigurisht që e keni dëgjuar. Dhe të gjitha këto nuk ju duken as të tepruara dhe as fort të palejueshme, përkundrazi, ju kërkoni që takimi të vazhdojë deri në fund të qershorit. Ndoshta deri në ndryshimet kushtetuese.

Duke lexuar e duke dëgjuar të gjitha këto, a nuk ju krijohet përshtypja se është organizuar një diskutim i posaçëm politik për shqiptarët dhe për Kosovën, në krahasim me të cilin do të dukeshin të zbehta, madje naive, diskutimet që kanë bërë për shqiptarët politikanët, historianët dhe etnografët borgjezë serbomëdhenj gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar e në dekadat e para të shekullit XX. Sa fjalë të reja fyese janë përdorur për ta e sa situata të tjera komprometuese janë sajuar kundër shqiptarëve! Lenini u revoltua shumë në kohën e vet që shovinistët rusomëdhenj i quanin polakët me përbuzje poliaçiçe, tartarët — knjazë, ukrainasit — karagjozë, ndërsa gjeorgjianët dhe popujt e tjerë të Kaukazit — çellovjekë. Ai e dinte se prapa fjalëve përbuzëse fshihej diçka shumë më e keqe dhe më fyese — sjellja prej pushtuesi e kombit të madh ndaj kombit të vogël, shtypja e kombit të vogël nga kombi i madh.

Në disa libra ose në takimin e fundit «Mbi Kosovën dhe për Kosovën», si dhe në disa gazeta e organe periodike, disa prej jush e disa gazetarë, në shpikjen e fjalëve përbuzëse dhe në krijimin e situatave komprometuese për shqiptarët tregohen shumë më pjellorë sesa shovinistët rusë në sajimin e fjalëve fyese për pjesëtarët e pa-

kipave kombëtare të lartpërmendura në Rusinë cariste. Në disa gazeta e organe periodike ndodh që emrat e shqiptarëve të zëvendësohen me shprehjen «njerëz me kësulë të bardhë», në disa shfaqje teatrore shqiptarët paraqiten si mizorë, hajdutë, spiunë, debilë; në «Letopisimatice srpske» të muajve mars-prill 1987 shkruhet se në disa salla televizive të hoteleve, ku ka edhe shkrimtarë, shqiptarët i quajnë fundërrina; në një nga takimet tuaja të mëparshme një shkrimtar kërkoi që shqiptarët të dëbohen matanë kufirit; në takimin e fundit, njëri prej këtyre shkrimtarëve i quajti kaçakë të pagdhendur; një poet e përkthyes i njohur recitoi vjershën e vet simbolike «Barbarët», ndërsa një kritik lexoi pjesë nga përmbledhja me vjersha «Persekutimi», ku shprehet një qëndrim i tillë gjoja i serbëve e i malazezëve, por që në fakt është i vetë autorit, ndaj shqiptarëve:

*Edhe në ethet e vdekjes,
derisa zemra të punojë,
do të kërkojmë
aë edhe në atë botë
këta njerëz
të mos jenë fqinjët tanë.*

Kurrë nuk do të arrija t'i lejoja vetes bindjen se fjalë të tilla fyese, këngë, drama, ose, novela e romane me fjalë të tilla fyese dhe një qëndrim të tillë ndaj një populli të bëhen tregues të një kënaqësie shpirtërore. Por nuk mund të rri pa ju pyetur: a nuk ju kujtojnë fjalë e mendime të tilla persekutimet publike para 50 vjetësh në një mjedis më të qytetëruar sesa vendet tona ballkanike? A nuk kemi të bëjmë këtu me një vërshim konceptesh që mund të quhen raciste? A është e mundur që të ketë edhe sot e kësaj dite shkrimtarë e kritikë që pranojnë të lënë në trashëgiminë e së ardhmes shkrime artistike ose shken-core me prirje raciste ndaj një populli. me të cilin jetojnë së bashku prej shekujsh dhe kanë ndarë me të të mirën e të keqen, ose ndaj ndonjë populli tjetër, cilido qoftë ai?

Shpërthime raciste

Megjithatë, poshtërimet e fyerje të tilla nuk janë gjëja më e keqe dhe më e rëndë që shkruhen e dëgjohen sot për shqiptarët edhe nëpër libra e në mjediset e shkrimtarëve. Shqiptarët që njihen për dinjitetin e tyre, goditen edhe më rëndë nga metodat, në të cilat bazohet një diskurs i tillë për ta në shtyp, në organet periodike, ndonjëherë në radio e në televizion, e sidomos në takimet letrare e të veteranëve: shantazhe, denoncime para opinionit publik, cinizëm, thirrje për të dhënë shpjegime pa fund, poshtërimet publike etj. Disa individë, të cilët mbas 30 ose 40 vjetëve pune të pandërprerë letrare e shkencore kanë arritur në pension, nuk lihen t'i kalojnë të qetë vitet e fundit të jetës, disa, të cilëve pleqëria u ka sjellë me vete edhe sëmundje, qofshin ata edhe profesorë të deridjeshëm të universiteteve, nuk lihen të vdesin të qetë, disave, të cilët gjithë jetën janë sjellë ashtu siç kërkohet prej tyre, u kërkohet që të japin llogari edhe për ato që supozohet se kanë menduar apo ndier para 44 vjetëve.

Kërkohet që disa ngjarje të rëndësishme historike të jenë jo ashtu siç kanë qenë në kohën e tyre, por ashtu siç do të donte dikush të ishin sot. Kështu, përballë së pamundurës vihen jo vetëm njerëzit, por edhe historia. Lartjen e hesapeve në mënyrë të tillë brutale me njerëzit e me historinë e tregon në mënyrë të qartë diskreditimi publik i jetës familjare të disa individëve, të kësaj gjëje të shenjtë dhe të paprekshme në jetën shqiptare.

A e kuptoni se me diskreditime të tilla publike fyeni dinjitetin dhe sovranitetin e personalitetit? Duket sheshit se si zbatohet në disa raste praktika e njohur: së pari, përlyerja morale, pastaj asgjësimi politik. Një rregulli të tillë në diskursin për shqiptarët e për Kosovën i përmbahen edhe disa midis jush, megjithëse kundër një rregulli të tillë keni shkruar shumë faqe dhe keni shqiptuar shumë fjalë. Në këtë mënyrë takimet tuaja për shqiptarët dhe për Kosovën gjatë këtyre viteve të fudit janë shndërruar në një gjyq, ku në fakt populli shqiptar në Jugosllavi gjykohet para tërë opinionit publik. A keni men-

duar ndonjëherë se misionë të tilla prej predikuesi të lirisë, të demokracisë e të së vërtetës po i zëvendësoni me rolin e një prokurori publik kundër një populli?

Uzurpim i së vërtetës

Po kujt i shërbeu ky diskursi juaj? Vetëm që të mund të shprehni shqetësimin tuaj për shkak të marrëdhënieve të prishura ndërnacionale në Kosovë, të cilat i përjetojmë më me dhembje pikërisht ne që jetojmë e që duhet të jetojmë në Kosovë? Sigurisht, jo vetëm për këtë. Këto diskutimet tuaja të programuara, ashpërsia dhe paturpësia e të cilave varen kaq shpesh nga efekti i dëshiruar, kanë qëllimet e synimet e veta. Në të vërtetë, me këtë ju përpiqeni të bëni të pamundur shprehjen e çdo mendimi tjetër për Kosovën dhe t'i jepni kështu vetes privilegjin e një gjykuesi të vetëm të së vërtetës, për më tepër të së vërtetës së përhershme. Pasi e vërteta bie ndesh me synimet tuaja, ju doni që me një diskurs të tillë, e në fakt me modelin e njohur të zëvendësimit të tezave, ta mbytni paraprakisht.

A nuk janë një shembull i mirë për këtë orvatjet e diskualifikimeve politike edhe të atyre individëve, mendimi i shprehur publikisht i të cilëve ndryshon shumë pak nga mendimet që shprehni ju në takimet e në shkrimet tuaja? Në këtë mënyrë, ju e keni vënë veten në një pozitë të palavdërueshme për intelektualët, roli i të cilëve është jo të mbytin, por të mbrojnë të vërtetën, edhe atëherë kur ajo nuk u shkon për shtat. Duket sikur ju nuk keni asnjë detyrim as ndaj vetë së vërtetës, as ndaj kulturës, së cilës i përkisni e ku kanë dhënë veprat e tyre edhe personalitete të mëdha krijuese, siç ka qënë Dositëj, Obradoviçi, Vuk Karaxhiçi, Svetozar Markoviçi dhe Jovan Skerliçi.

Megjithëse tashmë jemi në prag të shekullit XXI, të vërtetën për shqiptarët e për Kosovën ju e shikoni nga pikëpamja e patriarkaës së Pejës dhe kështu nuk pranoi të mendoni as për të vërtetën e tjetrit. Kësisoj, uzurpimin e së vërtetës ju do të donit ta futnit në kokën e të

gjithëve, në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Qëndrimi juaj ndaj së vërtetës shumë herë të provuar lidhur me Gjorgje Martinoviçin¹ e sëmurë është një shembull i qartë i një uzurpimi të tillë të së vërtetës. Ju nuk pranoni as shpjegimet që dhanë me këtë rast organet zyrtare të Kosovës, as shpjegimet që dhanë mjekët e juristët, ju nuk pranoni, madje as shpjegimet e dhëna nga organet zyrtare të Federatës!

Po kujt i besoni ju? Çfarë pranoni ju, shkrimtarët? A nuk do të thotë qëndrimi juaj ndaj kësaj çështjeje se të gjithë ata që u përpoqën për sqarimin e saj janë të pandërgjegjshëm, ndërsa vetëm ju jeni të ndërgjegjshëm? Sigurisht, që do të thoshnit jo! Atëherë çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ju, meqë jeni të gatshëm të uzurponi të vërtetën, jeni të gatshëm të uzurponi edhe lirinë e dikujt. Për vete kërkoni gjithçka, ndërsa të tjerëve nuk u lejoni asgjë. Ky është despotizëm, ka thënë një shkrimtar i shekullit XIX. Por ai ka qenë në Francë!

Fytyrën e vërtetë të uzurpimit të së vërtetës e tregon zakonisht vetë stili i fryrë. Vetëm në bazë të fjalëve fyese, të quajtura nga disa prej jush si situata komprometuese, natyrisht letrare, ku disa të tjerë vënë edhe gjëra të pavërteta, për të cilat disa të tretë shpifin, nuk mund të kuptohen plotësisht synimet përfundimtare të këtij diskursi letraro-politik për shqiptarët. Vetëm kur dëgjon e lexon disa mendime e propozime, kur dëgjon se çfarë thuhet për Universitetin e Kosovës, për disa intelektualë e personalitete politike në pension, për gjuhën letrare shqipe, për programet e përbashkëta të arsimit fillores e të mesëm, për studimet albanologjike, deri kohët e fundit edhe për bibliotekën popullore të universitetit, për flamurin kombëtar, për të gjitha këto institucione kaq të rëndësishme për një kulturë kombëtare dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar të një populli, vetëm kur, madje edhe në një gazetë letrare, lexon propozimin për ve-

1) Gjorgje Martinoviç, një i sëmurë patolgjik. Në maj 1985 deklaroi para hetuesisë në Gjilan se ishte sulmuar dhe plagosur nga disa shqiptarë të panjohur. Gjykatat dhe komisionet e mjekëve ligjorë në Kosovë, Serbi dhe Federatë vërtetuan se ai ishte plagosur vetë.

ndosjen e taksave për çdo fëmijë shqiptar, të lindur pas fëmijës së katërt, kur shikon se si e mendojnë disa barazinë në zënien me punë ose në përdorimin e gjuhës dhe të shkrimit, vetëm atëherë bëhet e qartë se për ç'të vërtetë flitet më shpesh në këto takime mbi Kosovën dhe për Kosovën. Vetëm atëherë bëhet plotësisht e qartë se fjalët tuaja të përsëritura në kuadrin e një vale presioni ndaj gjoja kërcënimit të të drejtave, të lirisë e të barazisë së serbëve e të malazezëve në Kosovë, të cilat dramatizohen kaq shumë duke përdorur fjalë dhe shprehje me ngjyra negative politike, siç janë persekutim, tirani, terrorizëm, fashizëm, Kosovë etnikisht e pastër etj., përbëjnë një formë të veçantë të dhunës intelektuale, se qëllimi përfundimtar është një barazi e tillë, të cilën shqiptarët e kanë njohur mirë qysh para Luftës: barazi me druvarët, me hamenjtë e qymyrit e me fshatarët, të cilët rriheshin prej xhandarëve edhe kur thonin, edhe kur nuk thonin «mirëmëngjes, zotni».

Ideologji antishqiptare

Por pavarësisht nga të gjitha këto, qëndrimi juaj ndaj shqiptarëve dhe Kosovës nuk i zhduk shpresat tona. Besoj se në këtë ideologji antishqiptare ju do të jeni gjithnjë të izoluar. Një ideologji të tillë nuk e përkrahin forcat përparimtare të Serbisë. Disa prej jush ankohen se shumë intelektualë të vendit tregohen indiferentë ndaj thirrjeve për një vlerësim të tillë të shqiptarëve e të Kosovës dhe nuk e pranojnë predispozicionin militant ndaj shqiptarëve. E përse ta pranojnë? Ata që kanë sy të shohin e kokë të mendojnë vetë, nuk mund të kapen pas anakronizmit tuaj për Kosovën. Qëndrimi juaj ndaj shqiptarëve është gur prove ndaj së vërtetës, si dhe ndaj barazisë në përgjithësi. Tash shihet qartë se, kur flisni për shqiptarët, sidomos në takimet e përbashkëta me veteranët, fjalët demokracia, liria dhe e vërteta i shqiptoni shpesh vetëm nëpër dhëmbë, duke u hequr çdo lloj përmbajtjeje dinjitoze. Megjithatë, po të gjykojmë në bazë të asaj se për çfarë u duartrokkit për një kohë të gjatë në takimin e fundit «Mbi

Kosovën dhe për Kosovën», ju në fakt jo vetëm për shqiptarët, por edhe për disa kombe të tjera mohuat të vërtetën, barazinë e lirinë, masën e të cilave e përcaktoni vetëm ju dhe këtë masë e shpjegoi në këtë takim mjaft qartë dramaturgu e kritikë Branislav Mihajloviç Mihis!

Megjithëse shumë prej jush kërkojnë shpesh frymëzim në histori, më shpesh në historinë e mesjetës dhe në jetën e shenjtoreve, nuk mund të thuhet që historinë e respektoni si mësuese të sprovuar të jetës. Në fjalimet për shqiptarët sot dhe në përfytyrimet për Kosovën e së nesërmes ju përsëritni gabimet, për të cilat kjo mësuese e jetës e ka kritikuar disa herë deri tani borgjezinë serbe. Cila është arsyeja që sot pranoni të bëni diçka, për të cilën historia do t'ju kritikojë nesër? Edhe në qoftë në natyrën e burokracisë, nuk është në natyrën e shkrimtarëve e të krijuesve të tjerë që të ngrihen kundër rrjedhës së historisë. Ata e kanë kuptuar shpesh rrjedhën e saj, e cila deri më sot e ka pasuruar planetin tonë me popuj kaq të vegjël, por të mëdhenj. Duke dëgjuar atë që thanë disa prej jush në takimin «Mbi Kosovën dhe për Kosovën», a nuk ju duket se një gjë e tillë tingëllon kundër së ardhmes?

Nxitje publike

Duke e përfunduar letrën, dëshiroj të them edhe këtë. Besoj se çdo admirues i singertë i veprave tuaja letrare do të ankohej që në këtë takim keni harruar një gjë, të cilën shkrimtarët nuk duhet ta harrojnë kurrë: ju keni harruar se besnikëria ndaj popullit të vet nuk i jep të drejtë askujt, e aq më pak shkrimtarëve, të fyejnë e të nënvlerësojnë cilindo popull qoftë dhe t'i shndërronjë takimet e tyre e për më tepër fjalën e shkruar në nxitje publike kundër tij. Shkrimtarët asnjëherë dhe askund nuk duhet të fyejnë e të nënvlerësojnë popujt e tjerë, pasi kështu futin grindjen, duke rënduar mbi ta dhe mbi kujtesën e historisë. Pavarësisht nga madhësia ose nga fatkeqësitë që kanë përjetuar gjatë historisë së tyre, të gjithë popujt kanë të njëjtën vlerë e të

njëjtin dinjitet. Shkrimtarët duhet që jo vetëm ta kultivojnë te vetja e tyre ndjenjën e respektit ndaj çdo populli, por edhe të përpiqen që këtë ndjenjë ta ushqejnë edhe te populli i tyre. Por popujt duhet t'i respektojmë me të vërtetë, në radhë të parë, nëpërmjet gatishmërisë për t'u njohur barazinë e tyre të plotë, e jo vetëm barazinë, deri në njëfarë shkalle, nëpërmjet respektimit dhe jo imponimit të vullnetit politik.

Dyshoj në patriotizmin e atij shkrimtari, zemra e të cilit ka vend vetëm për popullin e tij. Si rregull, një zemër e tillë shumë e vogël kryesisht është zemër pseudo-politikani e burokrati, e cila herë pas herë do të jetë e ngushtë edhe për popullin e vet. Dashuria ndaj popullit tënd është e pandarë nga respekti ndaj të gjithë popujve, pra, nga dashuria ndaj njerëzimit.

«Otvoreno pismo srpskim piscima, učesnicima susreta «O Kosovu i za Kosovo»»

«Borba», «Srećni, slobodni, metafizičari», 10.6.1987;

«Borba», Javni tužioc i jednog naroda», 11.6.1987;

«Borba», «Protiv hoda istorije», 12.6.1987.

Fehmi Agani

VËSHTRIM KRITIK LIDHUR ME DISKURSION POLITIK PËR KOSOVËN DHE SHQIPTARËT

Protestat e nëntorit të shqiptarëve në Kosovë, të zhvilluara për pesë ditë e pesë netë rresht e që, ndoshta, janë manifestimi më masiv politik deri tani, në historinë e shqiptarëve të këtyre viseve në përgjithësi janë me të vërtetë emocionuese në mënyrë të shumanshme dhe të shumëfishtë.

Së pari, të bën përshtypje masiviteti, këmbëngulja dhe vendosmëria e manifestuesve, vetorganizimi i tyre. Me të vërtetë të bën përshtypje fakti që veprojnë njëherësh disa qindra mijëra veta, thuhet nga të gjitha vendet, shtresat e moshat, që manifestohet njëkohësisht, në Prishtinë dhe në dhjetë qendra të tjera të krahinës, që pjesëmarrësit të nisen që në orët e para të mëngjesit e të përshkojnë në këmbë 50-100 kilometra në kohë të keqe, për të arritur në Prishtinë në orët e vona të mesnatës!

Po kështu, të bën përshtypje edhe fakti që manifestuesit të lodhur e të rraskapitur, të cilëve as që mund t'u shkonte mendja për sanduiçe ose për ndonjë pije tonike, aq më pak për dieta ose për ndonjë lloj kompen-

simi tjetër, do të mund të mblidhnin forcat për të shprehur protestën dhe pakënaqësinë e tyre, për të shprehur kërkesat e tyre me parulla të pakta, por kaq qartë dhe me zë aq të lartë, saqë do t'ia kalonin çfarëdo lloji plebishiti ose referendumi, do të viheshin në lëvizje qindra grupe dhe kolona njerëzish e të mos kishte as edhe një incident që të meritonte vëmendje!

Shërbimet përkatëse, të cilat tani po diferencohen përsëri, u habitën se si mund të ndodhte diçka e tillë e t'i shpëtonte mbikëqyrjes së kudondodhur dhe gjithçkapërgjuese e vëzhguese. Kush mund të jetë ai organizator magjik nga radhët e atyre personave të pandjekur? Pjesa denoncuese e shtypit kishte dëgjuar një thirrje telefonike dhe kishte vënë re një makinë të dyshimtë në një vend të dyshimtë!

Strukturat drejtuese politike të vendit, të cilave u duhet shprehur mirënjohja se nuk iu nënshtruan tundiimit të efikasitetit të rremë, megjithatë, sikur janë në konfuzionin më të madh: si t'i vlerësojmë këto ngjarje ose, më mirë të thuash, si t'i balancojmë vlerësimet dhe të gjejmë kompromisin e nevojshëm?

Udhëheqja e Serbisë u tregua më e shpejtë. Supozoj se Milosheviçi nuk e kishte hequr nga teksti i fjaliimit që mbajti në Ushçe pohimin se betejën për Kosovën e bëri i gjithë populli, «të gjithë qytetarët, pavarësisht nga kombësia», porse kjo tashmë nuk tingëlloi seriozisht. Dy kryesitë e Serbisë, ajo partiake dhe ajo shtetërore, i vlerësuan këto ngjarje jo sipas simetrisë dhe mazohizmit, sipas atij «sindromi patologjik të komunistëve serbë», siç do të thoshte D. Qosiç, por sipas një logjike antitetike, sipas një lloji rregulli të kundërtave: meqë mbledhjet e serbëve e të malazezëve janë revolucion, atëherë manifestimet e shqiptarëve duhet të jenë kundërrevolucion! Ato janë vazhdim i kundërrevolucionit, kundërrevolucion që nuk ndalet. Kërkesat e Serbisë për ndryshimet kushtetuese janë progresive, ndërsa ato që u kundërvihen atyre, duhet të jenë reaksionare! Vlerësohet se ato manifestime ishin antiserbe, pra, edhe antijugosllave, pavarësisht nga thirrja: «Rroftë populli trim serb!», e cila u përkrah dhe u duartrokoi. Meqenëse kërkesat «Duam armë», «Jashtë shqiptarët», «Vdekje shqiptarëve» u aklima-

tizuan, tonet e kundërta me këto u quajtën destruktive! Dikush edhe u kujtua se qenka harruar Serbia, se është brohoritur për Jugosllavinë, për Kosovën dhe udhëheqjen e saj dhe jo për Serbinë dhe Milosheviçin! Megjithatë, nuk u tha ndonjë fjalë solidariteti dhe mirëkuptimi për shqiptarët në aq e aq mitingje që u zhvilluan nëpër Serbi.

Udhëheqjes së Kosovës, të goditur dhe të hutuar keq, të detyruar të sakrifikojë Kaqusha Jasharin për hir të mitingut të triumfalizmit në Ushçe, nën një presion të ashpër dhe me kërkesën për dorëzim pa kushte, të ndodhur nën një mbikëqyrje të vazhdueshme e të gjithanshme, iu desh të mjaftohej me vlerësimin paraprak solomonian: Gjatë ditëve të para, sa kohë që ishin në krye punëtorët, grumbullimet ishin manifestime, më vonë ato degjeneruan në demonstrata!

Pati edhe përpjekje që manifestimet e shqiptarëve të llogariteshin si përkrahje ndaj LKJ-së, dhe, në fakt, në një masë të madhe ato ishin të tilla. Por, ndërkohë, u harrua se brohoritje të tilla masive për Titon, madje edhe më të mëdha sesa kur ai ka qenë gjallë, i bënin edhe një kritikë të fuqishme po asaj Lidhjeje Komuniste, për të cilën edhe brohoritej.

Megjithatë, nuk pati manifestime të ndërgjegjes përçarëse, nuk pati veprime destruktive. Dhe kjo, mbase, shkaktoi habi edhe më të madhe!

A pati në ato kërkesa qoftë edhe diçka të ligjshme, të bazuar, të justifikueshme, apo përsëri filloi të nxjerrë krye indoktrinimi, manipulimi, çorientimi?

Sipas vlerësimeve të bëra duket sikur nuk është kryesore ajo që ndodhi dhe ajo çka u kërkua në të vërtetë në Kosovë gjatë këtyre manifestimeve, ajo që ndodhi para dhe pas tyre. Ngjarjet në Kosovë, proceset dhe qëndrimet që u shprehën fuqishëm gjatë nëntorit, kërkojnë një analizë dhe vlerësim më serioz, politik dhe shkencor, shqyrtimin më serioz të diskursit të deritani-shëm politik për Kosovën dhe të veprimtarisë politike të bazuar në këtë diskurs.

Diskursi për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, shumë i shpeshtë, i bollshëm do të thoja, madje, me inflacion, por kryesisht i pafrytshëm, si edhe shumë gjëra

të tjera në këtë vend gjatë këtij dhjetëvjeçari krize, në radhë të parë, ka qenë politik. Këtu, duke veçuar disa orientime me vlerë të diskursit politik, mendojmë se ai dallohet më shumë nga tendencioziteti, shprehja e intereseve, mbrojtja e qëndrimeve, nga sulmi ose mbrojtja, sesa nga objektiviteti, saktësia dhe përligjshmëria, nga argumentimi logjik dhe faktik, si dhe nga kërkimi i së vërtetës. Ky diskurs politik nuk është unik, në të ka mos-përputhje të konsiderueshme në përmbajtje dhe në orientime.

Me këtë diskurs politik për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, sigurisht, nuk kemi parasysh atë vërshim të «literaturës» së memuarëve dhe të fejtivistikës, prodhime pas 81-it të ish-udbashëve ose të atyre që kanë qenë në pushtet përpara Brionit, të cekëta e të ulëta, plot insinuata dhe gënjeshtër si e si për të vërtetuar se çdo gjë shqiptare është e keqe, se e vërteta është monopol i tyre, se gjithçka që ata kanë bërë e sajuar ka qenë e drejtë dhe plotësisht e efektshme dhe se mëkati më i madh që është bërë është se ata dhe metodat e tyre janë hedhur poshtë e janë dënuar!

Ne nuk kemi parasysh, gjithashtu, as edhe konceptet «e krahut radikal djathtist në nacionalizmin bashkëkohor serb» (M. Kasapoviç), të cilat, për nga qëndrimi i tyre kryesor ndaj «çështjes shqiptare» në Jugosllavi, ndaj gjenezës dhe mënyrës së zgjidhjes së saj, si dhe për nga pohimi se për shkak të mazohizmit nacional kanë rënë Aleksandër Rankoviçi e të tjerë si ai, barazohen me të parët. Megjithatë, duhet thënë se këto dy «rryma» në diskursin bashkëkohor për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, e para nëpërmjet përhapjes së gjysmë të vërtetave, problematizimit me insinuata dhe vënies në dyshim të gjithçkaje shqiptare, ndërsa e dyta, që është shumë e afërt nga ana ideore me strukturat udhëheqëse politike në RS të Serbisë, me anë të fabrikimit të teorive për «karakterin përçarës të ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve të Jugosllavisë» (D. Qosiç), për paradoksin kosovar se «pakica kërcënon shumicën, se kryen genocid mbi të!» (J. Deretiç), për dhunën dhe genocidin e shqiptarëve «me pjesëmarrjen e autoriteteve shqiptare dhe të LKJ-së nën patronatin e një koalicioni

antiserb» dhe për serbët, të cilët, në kohë paqeje, përjetojnë «një agresion të vërtetë të shoqëruar me poshtërime të padëgjuaara nacionale» nga ana e «armikut të paskrupullt» kanë luajtur një rol të madh në krijimin e një mendimi të caktuar për Kosovën dhe shqiptarët, sidomos në Serbi. Nën ndikimin e drejtpërdrejtë të këtyre dy rrymave po ringjallen dhe po thellohen paragjykimet e mëparshme, në bazë të burimeve të vjetra dhe në kushte të reja, gabimet e reja po u shtohen atyreve të vjetra. Në arsenalet e vjetra kërkohen mjete të ndryshme për të zgjidhur problemet dhe vështirësitë bashkëkohore. Po injorohen transformimet që shënoi Lufta Nacionalçlirimtare dhe Revolucioni Socialist dhe me dritëshkurtësi presupozohet, madje dëshirohet, që zhvillimi historik në këto territore të vazhdojë atë çka ishte filluar pa sukses para Luftës së Dytë Botërore ose të paktën që para vitit 1966.

Me politikën për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi ne kemi parasysh, në radhë të parë, qëndrimet dhe vlerësimet e forumeve politike e të instancave shoqëro-politike, si dhe veprimtarinë ideopolitike e informative që i shoqëron ato, megjithëse as vlerësimet, as veprimtaritë nuk kanë qenë të njëjta, si për nga forma themelore e të kuptuarit të ngjarjeve në Kosovë, ashtu edhe për nga gjithçka tjetër që lidhet me to. Këtij diskursi të imponuar nuk mundën t'i shmangeshin plotësisht as edhe ata autorë të rrallë, të denjë për t'u respektuar, të cilët u përpoqën që për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi të mendojnë «kundër rrymës».

Politika, suazat, orientimet, vlerësimet dhe veprimtaritë politike përbëjnë një faktor shumë të rëndësishëm për trajtimin real të marrëdhënieve, problemeve dhe vështirësive ndërnacionale, për vlerësimin dhe kapërcimin e tyre. Megjithatë, në kuptimin dhe vlerësimin, në aksionin për kapërcimin e qëndrimeve e të kontradiktave të caktuara në marrëdhëniet ndërnacionale, politika mund të jetë e suksesshme, në qoftë se nuk është dogmatike dhe sklerotike, e bllokuar nga «reminishenca të ndryshme historike», nga paragjykimet dhe iluzione, në qoftë se ajo është e hapur dhe e aftë për të kuptuar dhe pranuar të renë, në ide dhe në qëndrime. Ajo nuk

do të ketë sukses nëse suazat dhe raportet politike, ashtu si edhe vetë politika, do të jenë vetëm një raport forcash, presionesh, koncesionesh dhe kompromisesh. Sukseset nuk do të ketë edhe në qoftë se me politikën dhe raportet politike do të bëhen manipulime, fryrje të disa problemeve për të mbuluar çështjet dhe problemet e tjera, imponime pseudoproblemesh, ngjallje euforie në funksion të ambicjeve dhe pretendimeve personale apo të grupit, ose, nëse politika do të reduktohet në politikanizëm që synon përfitime të çastit, do të reduktohet në mashtrim dhe hile, në një politikë të faktit të kryer.

Kuptimi dhe vlerësimi i drejtë politik i gjendjes dhe i proceseve ndërnacionale — të shprehura me kategori dhe koncepte që nuk do të kishin terma diskualifikuese, por një gjuhë të qartë, me fraza që nuk do të tingëllonin boshë, me deduksione që nuk do të ishin sofizma, me një logjikë që do të ishte konsekuente — duhet të konfirmohen edhe me një aksion të suksesshëm politik. Dështimet relative të aksionit dhe veprimtarive politike tregojnë edhe dështimet në kuptimin e raporteve dhe të proceseve të caktuara.

Në këtë drejtim, çfarë mund të thuhet për kategoritë themelore të kuptimit dhe shpjegimit politik të situatës, të marrëdhënieve dhe proceseve në Kosovë, midis shqiptarëve dhe ndaj tyre në Jugosllavi, gjatë këtyre tetë vjetëve, që nga viti 1981?

Termi kundërrevolucion është kategoria themelore, me anën e së cilës janë përcaktuar dhe karakterizuar demonstratat e shqiptarëve. Me këtë term sot janë damkosur shumë përpjekje të shqiptarëve, shumë dëshira, synime dhe veprime të tyre. Fjala kundërrevolucion është kualifikim dhe diskualifikim, anatëmë dhe kërcënim i gjithçkaje që shprehet në qëndrimet, kërkesat dhe përpjekjet e shqiptarëve, por që është e padëshiruar nga pikëpamja e politikës zyrtare ose e forcave dhe e tendencave të caktuara politike.

Profesor Horvati e bëri shumë problem legjitimitetin e këtij qëndrimi, bazën e përdorimit të këtij kualifikimi për ngjarjet e vitit 1981. Megjithatë, sado që duket e çuditshme dhe e pakuptueshme, është më se e vërtetë se gjatë këtyre tetë vjetëve është punuar shumë pak për

elaborimin e kësaj kategorie, për vërtetimin e drejtësisë së përdorimit të saj konkret. Kaq i varfër është argumentimi i saj, saqë shpesh të krijohet përshtypja se cilësimi i ngjarjeve të caktuara si kundërrevolucion është vetëm në funksion të legjitimitetit dhe të justifikimit të mjeteve dhe masave që dëshirohen të zbatohen lidhur me këto ngjarje.

Në qoftë se përcaktimi «kundërrevolucionar» ishte në funksion të justifikimit të represioneve, ai është thujse i vjetruar. Por me këtë nuk mendojmë se janë konsumuar mundësitë e kryerjes së represioneve. Për të mos ushqyer iluzione të tilla u përpoqën edhe gjyqet në Shkup, të cilat nga fundi i vitit të kaluar dënuan pjesëmarrësit në demonstratat e zhvilluara për të mbrojtur zhvillimin e mësimit në gjuhën amtare, në shkollat e mesme në Kumanovë dhe në Gostivar. Nga radhët e demonstruesve në Kumanovë, përveç 120 ndëshkimeve për kundravajtje, kryesisht me nga 60 ditë burgim, siç njofton shtypi, pesë veta morën dënimin maksimal me nga 5 vjet burg. Nga pjesëmarrësit e demonstratave në Gostivar, tetë të akuzuar për krijim shoqatash për t'iu kundërvënë klasave të përziara, pra, heqjes faktikisht të mësimit në gjuhën shqipe, u dënuan përkatësisht: njëri me 11 vjet burg, dy veta me nga tetë, njëri me gjashtë dhe katër të mitur me nga 4-6 vjet burg! Megjithatë, duhet të jenë mirënjohës, sepse, po të jenë të shëndetshëm e të dëgjueshëm, shekulli XXI do t'i gjejë jashtë burgut!

Dikur Lenini në të famshmet «Letra drejtuar Kongresit», shkruante: «Nëse çështja ka shkuar deri atje saqë Orxonike të përdorë dhunën fizike... , atëherë mund të merret me mend se në çfarë batakuri kemi rënë...» (V.I. Lenin, Vepra të zgjedhura, XIV, faqe 574). Por Lenini ka vdekur prej kohësh, dhe për çudi, në diskutimet lidhur me marrëdhëniet nacionale gjatë kësaj dekade, te ne, megjithëse mendimi i tij, ashtu si edhe i Marksit, është një nga burimet e legjitimitetit të lëvizjes sonë socialiste, rrallëkush, nëse po, e përmend atë!

Megjithëse mundësitë e kryerjes së represioneve nuk janë konsumuar, siç shihet qartë, megjithatë, ne pohojmë se ato nuk kanë mundësi t'i rregullojnë marrëdhëniet në

Kosovë dhe se dispozita e kundërrevolucionit është bërë joproduktive si legjitimizim dhe përgjigje e represionit.

Që represioni është bërë joproduktiv, madje kundërproduktiv, kjo është parë dhe është thënë prej kohësh në Jugosllavi. Megjithatë, sado e tmerrshme qoftë që për një çështje të tillë të dhimbshme, siç janë dënimet me burgim dhe vitet e burgut, të arsyetosh me kategoritë produktivet-kundërproduktivitet, janë shumë më të këqija hipokrizia dhe cinizmi i atyre që flasin herë-herë për burgimin e «të rinjve të shkretë», «të atyre që sapo kanë hyrë në moshën e rinisë», megjithëse nuk janë shqetësuar shumë kur ata janë dënuar. Përkundrazi, me anë të presionit të vazhdueshëm mbi burokracinë krahinore dhe me akuzën se ajo thuajse nuk kishte bërë asgjë ata kanë ndikuar drejtpërdrejt në shkallën e dënimit. Dhe sot ata shprehen për lirimin e «të rinjve të shkretë», për të krijuar vende në burgje për të rriturit!

Këtë kategori e ka konsumuar më shumë, madje e ka komprometuar, përdorimi i saj më i fundit pa kriter dhe pa rigorozitet. Kështu, në forume plotësisht serioze pohohet pa baza dhe në mënyrë të paargumentuar vazhdimësia e kundërrevolucionit në Kosovë gjatë viteve të okupimit, në vitet 1944-1945, 1968, 1981, si dhe gjatë viteve në vazhdim, pa shikuar, krahas ngjashmërive, edhe ndryshimet thelbësore në kontekstin shoqëroro-politik, në qëllimet dhe kërkesat, në aktorët shoqërorë e të tjera. Në konkluzionet e dy kryesive të Serbisë manifestimet e protestës të nëntorit në Kosovë vlerësohen si kundërrevolucion, sepse ato kundërshtojnë kërkesat e Serbisë për ndryshimin e kushtetutës! «Politika» në shkrimin e njëfarë Tom Miliçi (12.12.1988) përdorimin e etiketës kundërrevolucionar e çon deri në absurditet: «Me katër kundërrevolucione (1912, 1919, 1941 dhe 1981) separatistët shqiptarë janë përpjekur pa sukses që nga Mbretëria e Serbisë, nga Mbretëria e Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve, nga Jugosllavia Federative Demokratike dhe nga RSFJ-ja, të shkëpusin Kosovën...». Pra: rezistenca eventuale ndaj Mbretërisë së Serbisë ose ndaj dhunës së Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve nuk është gjë tjetër veçse kundërrevolucion! Po ky autor vazhdon: «...Dhe kur këtë nuk e arritën me armë, separatistët filluan përpjekjet për

kryerjen e një eksplozioni perfid demografik». Ky mbase do të ishte kundërrevolucioni i pestë, të cilin, për fat të keq, separatistët po e fitojnë!

Nacionalizmi në alternimet separatizëm-irredentizëm, si dhe pastërtia etnike, janë gjithashtu kategori thelbësore të diskursit politik për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi.

Çdo analizë e marrëdhënieve dhe tensioneve të tanishme ndërnacionale në Kosovë, ashtu si edhe në tërë vendin, do të tregonte se sot nacionalizmi, si absolutizim kryesisht i interesave të keqkuptuara kombëtare, si dhe si përpjekje për realizimin e tyre në dëm të interesave reale normale kombëtare të të tjerëve, përbën shkakun dhe bazën e konflikteve ndërnacionale. Nuk është e vështirë të vërtetosh papërshtatshmërinë historike të nacionalizmit sot dhe dëmin objektiv të çdo nacionalizmi, pa varësisht se si mund të duket ai tani nga koniunktura. Ndërkohë, është i pamjaftueshëm, i njëanshëm, i pasaktë dhe i dëmshëm ai koncept, i cili, duke pranuar dëmin e përgjithshëm të nacionalizmit, e fikson dhe e sheh atë vetëm si nacionalizëm të tjetrit, më shpesh, si nacionalizëm dhe separatizëm shqiptar; ai koncept që shikon vetëm nacionalizmin eksisiv dhe jo atë që vepron, do të thoshim gjysmë ilegalisht, për të mos thënë plotësisht legalisht, i cili përpiqet dhe pjesërisht edhe ka mundur të fitojë legjitimitet dhe të drejtën e qytetarisë, i cili depërton në forume dhe imponohet në formën e dispozitave të përcaktimit të kundravajtjeve, të rezolutave dhe ligjeve; ai koncept, i cili është i gatshëm që edhe kërkesën dhe të drejtën kombëtare më normale të të tjerëve, të themi të drejtën dhe kërkesën për mësimin në gjuhën amtare, ta shpallë dhe ta ndjekë si nacionalizëm. Nëse nocioni nacionalizëm do të jetë kaq i papërcaktuar dhe përdorimi i tij kaq pa kriter, sigurisht që popuj të tërë do të shpallen nacionalistë, sepse në qoftë se edhe kërkesa dhe këmbëngulja e shqiptarëve për të drejtën që të shkollohen në gjuhën amtare janë nacionalizëm, atëherë të gjithë shqiptarët janë nacionalistë. Dhe nuk është çudi që, ndërsa për disa nacionalizmi është një njollë e rëndë dhe persekutim, të tjerët e kalojnë lehtë atë,

edhe në qoftë se nuk e theksojnë atë si «epitheta or-nantia».

Pa e minimizuar aspak nacionalizmin shqiptar dhe luftën kundër tij, duhet theksuar se kjo luftë mund të jetë e suksesshme vetëm nëse nacionalizmi reduktohet në përmasat e vërteta, në atë që është realisht, në njohjen e legjitimitetit të të drejtave kombëtare, të interesave dhe të shprehjes së tyre, si edhe duke luftuar me vendosmëri kundër çfarëdolloj nacionalizmi dhe hegjemonie. Ash-tu siç e vuri në dukje me zgjuarsi njëri nga minatorët e Trepçes gjatë bisedës me grupin e udhëheqësve të LK të Serbisë: nuk mund të ketë sukses në luftën kundër nacionalizmit, nëse disave (pra, njërit nacionalizëm) u mprihen brirët, kurse të tjerëve (nacionalizmit tjetër) u pritët koka!

Nacionalizmi shqiptar synon ekskluzivitet etnik, pas-tërta etnike. Kjo është e padiskutueshme sepse këtë synon çdo nacionalizëm, për më tepër, ai që nuk mund të asimilojë të tjerët. Nga kjo natyrë e përgjithshme e naciona-lizmit ka dalë edhe përcaktimi i demonstratave të vitit 1981 si manifestime që synojnë një Kosovë shqiptare et-nikisht të pastër.

Megjithatë, përdorimi ose keqpërdorimet e mëvonsh-me krejtësisht të pamatura dhe të papërgjegjshme të përcaktimit «pastërta etnike», cilësimi me gjuhë vulgare e të bastarduar edhe i kërkesës për shkollimin në gjuhën am-tare, sikur ajo të jetë drejtuar kundër gjuhës maqedone, se kjo është një kërkesë për klasa «etnikisht të pastra», e konsumuan dhe komprometuan këtë përcaktim aq shu-më, saqë ndokush vështirë se mund ta pranojë seriozisht dhe ta përdorë me sukses.

Është interesante se synimi për pastërta etnike u mvishet vetëm shqiptarëve, pra, nacionalizmit shqiptar, dhe kjo bëhet deri në atë masë saqë synohet që përcak-timet «etnikisht e pastër» dhe «shqiptare» të jenë pothuaj sinonime. Akoma më interesant është edhe fakti se ata që thërrasin më shumë kundër mbylljes etnike të shqip-tarëve, janë krejtësisht të verbër kur është fjala për shfaqje të ekskluzivitetit etnik në kombin e tyre. Klasat që e zhvillojnë mësimin në shqip cilësohen «etnikisht të pastra», kurse ato maqedone nuk quhen të tilla! Sikur

këta sulmues që çirren për mbylljen në vetvete të shqiptarëve t'i pyesnim: a është klubi i futbollit «Vardar» «etnikisht i pastër», ata do të ziheshin ngushtë. Nuk do të çuditeshin që asnjë i ri i kombësisë shqiptare ose turke, megjithëse në Shkup ka mbi 100 mijë shqiptarë dhe turq, nuk ka debutuar gjatë këtyre dhjetë vjetëve në ekipin e parë të «Vardarit». Ata do të çuditeshin vetëm me vetë pyetjen, pra, me guximin e bërjes së pyetjeve të tilla!

Kundërrevolucioni, nacionalizmi agresiv, synimi drejt pastërtisë etnike mund të çojnë në dhunën ndaj popullsisë joshqiptare dhe në shpërnguljen me forcë të tyre. Dhuna, shpërnguljet nën presion me modalitete dhe derivate: dhunime nga motive nacionaliste, përdhosje e varreve dhe e vendeve të shenjta, terrori dhe genocidi, këto janë termat më të shpeshta të diskursit për Kosovën. A janë terrori dhe genocidi, dhuna dhe përdhosjet një realitet i ashpër i marrëdhënieve ndërnacionale në Kosovë, apo këto janë vetëm gënjeshtër me bisht?

Kosova është ekonomikisht e prapambetur, e pazhvilluar nga pikëpamja shoqërore, e mbingarkuar me probleme dhe konflikte nga ana sociale. Ajo është rajoni i papunësisë më të madhe dhe i të ardhurave më të ulëta. Në dhjetëra mijë familje nuk ka as edhe një person të punësuar! Varfëria është e madhe, marrëdhëniet janë të rënduara, ashpërsia është e madhe. Në krahasim me rajonet e tjera në Kosovë jetesa është më e vështirë. Megjithatë, asgjë nuk provon se ajo është rajon i dhunës, për më tepër i asaj nacionale.

Numri i vrasjeve dhe i konflikteve të përgjakshme midis individëve gjatë periudhës që nga viti 1981 ka arritur numrin prej tri shifrash, por, vetëm në dy raste shqiptarët janë vrasës dhe serbët janë viktimë dhe, në të dyja rastet, vrasësit janë pushkatuar, kurse në tri raste janë vrarë shqiptarët nga serbët dhe vrasësit, sigurisht, janë dënuar me afate të ndryshme burgimi. Sekretari krahinor i Punëve të Brendshme njoftoi Kuvendin Krahinor në tetor të vitit 1988 se gjatë periudhës prej një viti në krahinë ka pasur 37 vrasje dhe 57 tentativa për vrasje, por asnjë midis pjesëtarëve të kombësive të ndryshme; ka pasur 15 raste përdhunimesh dhe 24 përpjekje për përdhunime, por vetëm një përdhunim dhe dy për-

pjesje për përdhunim në dëm të pjesëtarëve të kombësisë serbe ose malazeze («Rilindja», 26.10.1988).

Në Kosovë, e cila, sipas regjistrimit të vitit 1981, përbën 7.7 për qind të popullsisë së vendit, gjatë periudhës 1981-1986 janë kryer gjithsej 3.3 për qind e numrit të përgjithshëm të krimeve në vend, («Rilindja», 4.12.1988). Tabloja që na japin statistikën duhet thënë se është shumë më e ndryshme sesa ajo që përipiqet të na imponojë diskursi i sotëm politik, sidomos diskursi serb për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi.

Çdo analizë serioze e vlerësimeve të deritanishme të proceseve migruese në Kosovë, nga pikëpamja e marrëdhënieve ndërnacionale, do të ndeshet me një njëanshmëri të theksuar në trajtimin, me mungesë objektiviteti dhe parimësi, me ekstremitet të konkluzioneve të bëra nga premisa krejtësisht të dyshimta, me manipulim me të pavërtetat, me apriorizëm dhe tendenciozitet gjatë diskutimeve lidhur me këtë problematikë.

Të gjitha dokumentet politike flasin për nevojën e luftës kundër shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nën presion, si dhe për nevojën që çdo shpërngulje të ndalohej. Megjithatë, të gjitha njoftimet lidhur me migrimet, si provë të këtyre shpërnguljeve nën presion, japin numrin e përgjithshëm të të shpërngulurve, çka është një sofizëm më se i rëndomtë, pasi, sipas deklaratave të të shpërngulurve, në as edhe një për qind të rasteve të shpërnguljeve nuk mund të vërtetohet se ato janë bërë nën presion.

Meqenëse nuk mund të vërtetohet me fakte ekzistencë e presionit për të nxitur shpërnguljet dhe që pohimi për ushtrimin e presionit të qëndrojë, koncepti presion po përhapet dhe po fryhet në mënyrë të paligjshme, presioni po gjendet në marrëdhëniet e ftohura, në frikën, në atmosferën e mungesës së perspektivës. Në grumbullimet e nxënësve të kombësisë serbe dhe malazeze dhe gjatë bojkotimit të mësimin në fillim të këtij viti shkollor, si presion është cilësuar deri edhe emërtimi i shkollave, nëse emrat e tyre kanë qenë të personaliteteve shqiptare. Kështu, për të vazhduar mësimin, u desh që të ndryshonte emrin edhe shkolla «Halit Ibishi», luftëtar i LNÇI-së dhe viktimë e terrorit fashist! Për disa individë

në Fushë-Kosovë, presion janë edhe shkrimet e Branko Horvatit, vlerësimet e Dragosavacit, fjalimi i Verhovcetit dhe diskutimet e Smoles! Për të gjitha këto fajësohen nacionalizmi shqiptar dhe shqiptarët. Harrohet se ftohje të marrëdhënieve, acarim, mungesë perspektive për bashkëjetesë krijon jo vetëm nacionalizmi shqiptar, por edhe ai serb, jo vetëm manifestimet e separatizmit, por edhe thirrjet për armë dhe administratë ushtarake, jo vetëm traktet dhe parullat e shkruara, por edhe kërkesat e hapura unitariste dhe hegjemoniste.

Nuk shpërngulen vetëm serbët dhe malazezët, por edhe shqiptarët, dhe madje në numër të madh, e jo vetëm nga Kosova. Vetëm gjatë vitit 1988 mbi 20 000 veta kanë kërkuar strehim politik (për arsye ekonomike) në RF të Gjermanisë, kryesisht shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia, si dhe romë, saqë RFGJ-ja është në hall si e si të mbrohet nga dyndjet e emigrantëve nga Jugosllavia. Verës që shkoi Norvegjia u desh të merrte masa të jash-tëzakonshme për t'u mbrojtur nga këto dyndje. Shqiptarët janë thujse të vetmit nga Jugosllavia që u nënshtrohen shpenzimeve dhe rrezikut që, nëpërmjet kanaleve meksikane, apo ç'të gjejnë, të kalojnë në SHBA, ose të ikin për të mos u kthyer kurrë më! E megjithatë, shpërngulja e shqiptarëve nuk është objekt i vëmendjes politike. Ata janë të tepërt! Shpërngulja e shqiptarëve përmendet, dhe jo me saktësi, vetëm nëse është fjala për ndonjë vajtje në Maqedoni.

Për shpërnguljet ekzistojnë shkaqe të shumta: ekonomike, sociale, familjare dhe të tjera. Megjithatë, të gjitha ato injorohen, madje edhe më i rëndësishmi mi-tis tyre, fakti i pamohueshëm se në Serbi, në raport me Kosovën, jetohet më mirë dhe më me bollëk sesa në Kosovë!

Një analizë serioze e dukurisë së shpërnguljeve nga Kosova duhet ta krahasojë këtë dukuri me shpërnguljet thujse të barabarta në numër që bëhen nga Serbia Jugore, nga Sanxhaku apo Bosnja. Mirëpo, në vend të një krahasimi të tillë ne kemi të bëjmë vetëm me një vlerësim arbitrar.

Nëse themi që shpërnguljet nga Kosova bëhen nën presion, si ta kuptojmë që shpërngulje të tilla ka gati njëlloj në të gjitha ato komuna, siç është Leposaviçi, ku

thuaje nuk ka shqiptarë dhe asnjë që të ushtrojë presion? Ose, si ta kuptojmë që gati 1 200 veteranë nga Kosova, të cilët protestojnë shpesh kundër shpërnguljeve dhe presioneve, të gjejnë strehim në Beograd, megjithëse prej vitesh kanë pasur poste drejtuese në Kosovë! Si ta kuptojmë që të shpërngulurit nën presion stabilizohen jo dokudo, por në vendet më të mira në Serbi?

Përkundër gjithë kësaj, një propagandë e madhe politike kryen prej vitesh presionin më brutal që të pranohet me çfarëdolloj çmimi ekzistenca e dhunës dhe e presionit në Kosovë, e terrorit dhe e genocidit mbi serbët dhe malazezët. Egzodi, vuajtjet, hallet e serbëve dhe të malazezëve qahen vazhdimisht. Energji të mëdha shpirtërore dhe materiale shpenzohen për të bindur në radhë të parë popullin serb e më pas publikun jugosllav e atë botëror, si dhe për t'i detyruar shqiptarët të besojnë se gjendja në Kosovë është një mesjetë e re. Pranimi apo mospranimi i këtyre aludimeve është kriter i diferencimit, masë e përshtatshmërisë ose e papërshtatshmërisë së kuadrove. Pa pranimin dhe shpalljen e vazhdueshme të tyre nuk mund të ketë asnjë lloj emërimi të kuadrove.

Fushata për dhunë dhe presione, për genocid dhe terror në Kosovë duket që është jofunksionale dhe e gabuar. Në thelb ajo përmban mesazhin e papunësisë për bashkëjetesë me shqiptarët dhe vetëm i përshpejton proceset e shpërnguljes. Ka nga ata, që në këtë zhurmë për dhunën dhe terrorin e shqiptarëve shohin dukurinë e njohur të thirrjeve dhe zhurmës që ka si qëllim të çorientojë dhe shurdhojë në mënyrë që të mos dëgjohet rënkimi i atyre që vuajnë në të vërtetë. Sepse, të mos harrojmë: varfëria dhe papunësia, në radhë të parë, janë për shqiptarët, myslimanët dhe romët. Për shqiptarët janë edhe pagat mesatare më të ulëta, burgimet më të shpeshta, ndëshkimet më të rënda; ata janë të vetmit që i nënshtrohen testit të përshtatshmërisë për punë, kontrollit për të vazhduar studimet, provës së besnikërisë gjatë procesit të diferencimit. Megjithatë, gjithnjë e më shumë ka nga ata që thërrasin për dhunën dhe terrorin, për ankesat dhe vuajtjet, por që egzodin e shohin në funksion të një diçkaje tjetër. në funksion të realizimit të pretendimeve të reja të Serbisë e të udhëheqjes së saj ndaj Jugosllavisë.

Edhe kategoria e indoktrinimit dhe e luftës kundër tij nuk mundi të ishte e frytshme! Në fakt, ajo shërbeu si justifikim për një sërë masash ndëshkuese dhe për përjashtimin e mësuesve, për heqjen nga përdorimi të disa teksteve të njohura mësimore. Por si një lloj iluminizmi të demoduar, si një lloj tutele mbi ndërgjegjen politike të të tjerëve, të nxënësve e të studentëve, ajo nuk mundi të ofronte më tepër.

Është e qartë, pra, se kategoritë kundërrevolucion, separatizëm, irredentizëm, pastërti etnike, dhunë dhe indoktrinim, të cilat përbëjnë strumbullarin e diskursit të tanishëm politik për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, nuk janë të mjaftueshme për të kuptuar gjendjen dhe marrëdhëniet në Kosovë, e për pasojë, as edhe për kryerjen e një aksioni politik që do ta kapërcente këtë gjendje. Atëherë, si, mbi cilat baza ideore dhe konkrete mund të realizohet fronti i përbashkët i shqiptarëve, serbëve, malazezëve, myslimanëve, turqve dhe i të tjerëve në Kosovë?

*
* *
*

Marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavi janë në krizë. Veçanërisht janë acaruar marrëdhëniet serbo-shqiptare dhe ato shqiptaro-maqedonase. Por ne nuk jemi në luftë, siç trumbetojnë imagjinata e ekzaltuar e nacionalizmit dhe orekset hegjemoniste. Përkundrazi, ne duhet ta shikojmë krizën si të përkohshme dhe kapërcimin e saj si të mundshëm.

Engelsi te «Zhvillimi i socializmit...» shkruan se Sen Simoni në kohën e marrëdhënieve më të acaruar franko-angleze dhe franko-gjermane, kur, pas disfatës së Napoleonit, trupat angleze dhe gjermane pushtuan Parisin, projektoi miqësinë e ardhshme franko-angleze dhe franko-gjermane. Këtë gjë, Engelsi nuk e vlerëson si utopizëm, por si largpamësi historike të Sen Simonit. Si ka mundësi që inteligjencia humaniste, krijuesit e ndjenjës humane, duke jetuar në kohën e sotme dhe në kushte e raporte që s'kanë të krahasuar me të atëhershmet, të

jenë kaq dritëshkurtër, sa të shprehin diçka tjetër dhe jo interesat e vërteta të popujve të tyre, t'u nënshtrohen histerive të momentit, të mbrojnë diçka tjetër, por jo barazinë, si dhe të projektojnë diçka tjetër, por jo miqësinë midis kombeve dhe kombësive?

Në kundërshtim me Dobrica Qosiçin, i cili gjatë bisedave për Jugosllavinë, në Knjizhevne Novine, në fund të fjalëve të tij «plot shqetësim», shpreh dyshimin në mundësinë e dhënies fund të konflikteve shqiptaro-serbe dhe shqiptaro-maqedonase «me anë të demokracisë dhe paqes nacionale», ne mendojmë se vetëm nëpërmjet demokracisë dhe vendosjes së paqes nacionale mund të zgjidhen konfliktet nacionale, për të cilat po flasim, si dhe ato të tjerat.

Lidhur me Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi ka dy premisa. dy kushte kryesore për kapërcimin e antagonizmave të tanishëm ndërnacionalë: demokratizimi konsekuent dhe mbi këtë bazë zhvillimi i kulturës së jetesës së përbashkët.

Lenini, duke vazhduar rrugën e Marksit, çështjen nacionale e trajton si «një nga çështjet e demokracisë». Në «Shënime kritike lidhur me çështjen nacionale» ai shkruan se për çështjen nacionale ka vetëm një zgjidhje dhe kjo është «demokratizimi konsekuent.»

Në kundërshtim me manipulimet dhe abuzimet e ndryshme me demokracinë, me pseudodemokratizmin dhe demokracinë e etatizmit dhe të hegjemonizmit të maskuar, nuk kemi aspak arsye të dyshojmë se çështja serbe në Jugosllavi është demokratike. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për tërësinë e çështjes maqedonase. Por, po kështu duhet të flitet, madje me më shumë të drejtë, edhe për çështjen shqiptare në Jugosllavi. Në kundërshtim me predikimet e vullnetit të keq ose të ndërgjegjes jo të pastër, çështja shqiptare në Jugosllavi nuk është çështje që synon shkëputjen, thelbi i ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve nuk është secesionizmi, thelbi i çështjes shqiptare në Jugosllavi është demokratik dhe vetëm nëpërmjet një demokratizimi konsekuent mund të zgjidhet. Kjo u demonstrua qartë edhe gjatë manifestimeve të protestës në nëntor, të zhvilluara në Prishtinë dhe në pjesë të tjera të Kosovës, dhe kjo ndoshta i ha-

biti më shumë qarqet hegjemoniste dhe një pjesë të opinionit publik të mashtruar.

Barazia është kushti themelor i demokratizimit konsekuent. Barazia ka qenë një nga kërkesat kryesore dhe nga parullat më të shpeshta edhe gjatë manifestimeve të fundit të shqiptarëve në Kosovë. Tutoria hegjemoniste dhe paternalizmi i dyshimtë si ai në Maqedoni, i cili ua ndalon shqiptarëve vënien e emrit Liridon (Slobodoljub), sepse në të vërtetë çfarë liri mund të duan ata tani(!), na shtyjnë të bëjmë pyetjen se ç'barazi është kjo?

Nuk ka barazi, të vërtetë dhe jo verbalizëm egalitar, nëse ajo nuk është kolektive dhe individuale; janë të papranueshme ato mendime që, gjoja sipas një modeli liberal ose francez dhe gjoja kundër zgjidhjeve konservatore, austro-hungareze, do të ofronin barazi individuale dhe personale, por jo edhe kolektive-nacionale. Përkundrazi, në këto qëndrime dhe dëshira duket dobësia prudoniane «e afërt me shovinizmin francez», të cilën Marks-i e vinte në lojë, dobësia e mohimit të nacionales, çka do të thotë, qoftë edhe pa dashje, «absorbim i saj nga ana e kombit shembullor francez». Kjo do të thotë, nxjerr përfundimin Lenini, «t'u nënshtrohesh faktikisht paragjy-kimeve nacionaliste, pra, ta shikosh kombin «tënd» si «komb shembullor» ose ...si komb, i cili ka privilegjin ekskluziv për ndërtimin e shtetit». (Lenin, Vepra të zgjedhura, 1960, 8, 401). Me barazinë individuale dhe kolektive shtrohet faktikisht edhe kërkesa kryesore e shqiptarëve: njohja e subjektivitetit të tyre në Jugosllavi. Kjo është kërkesë që në këtë shoqëri të njihet e të pranohet se shqiptarët, po të përdorim një shprehje të Sartrit, të jenë bashkëbisedues dhe jo vetëm objekt bisedimi në Jugosllavi, që ata të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në ndërtimin e së tashmes dhe të së ardhmes së përbashkët të tyre dhe tonës. Kjo kërkesë, sigurisht, është plotësisht në frymën e demokratizimit konsekuent.

Mirëpo, sado të duket e çuditshme dhe e vështirë për t'u kuptuar, duke pasur parasysh zhvillimin tonë të deritanishëm shoqëror dhe politik, si dhe rezultatet e pa diskutueshme të arritura në Jugosllavi, pikërisht në fushën e marrëdhënieve ndërnacionale, në Serbi dhe Maqedoni strukturat drejtuese politike dhe disa qarqe të

caktuara i pranojnë me vështirësi ose kohët e fundit i refuzojnë hapur kërkesat për njohjen e subjektivitetit e të barazisë së shqiptarëve. Nga mitingu i Beogradit Milosheviçi u dërgoi një mesazh shqiptarëve se Kosova, para së gjithash, është Serbi, porse ata, natyrisht, mund të jetojnë atje, kanë apo nuk kanë ku të shkojnë, janë kalimtarë apo duan të mbeten, sepse «Serbia gjithmonë ka qenë e hapur për të gjithë». Madje, nuk do të jetë keq për ta, nëse do të sillen mirë, nëse nuk do të jenë «të këqij e të ligj». Edhe në Maqedoni, në disa fjalime të fundit të Mojsovit e të Tupurkovskit, shqiptarëve u drejtohen disa pyetje ultimative. Megjithatë, Maqedonia është shprehur, në radhë të parë, për «mesazhe urtësie».

Në formë qortimi dhe tutele, disa udhëheqje, udhëheqësit e Serbisë, në radhë të parë, pas grumbullimeve protestuese të shqiptarëve në nëntor thoshin: kemi të bëjmë me keqkuptime e mosmarrëveshje, nuk do të hiqet autonomia, nuk do të preken shkollat në gjuhën shqipe. Megjithatë, masat shqiptare nuk u trembën për heqjen e autonomisë, sepse e dinë se autonomia mund të japë shpirt edhe pa e hequr. Ata nuk u trembën, gjithashtu, edhe për heqjen e mësimit në gjuhën shqipe, megjithëse kjo gjë u bë pjesërisht në mënyrë brutale e të dhimbshme në Maqedoni. Shqiptarët e dinë se kjo gjë është e pamundur. Të drejtën për të mësuar në gjuhën amtare, të cilën shqiptarëve në këto vise ua ka njohur edhe okupatori fashist, e jo vetëm në të ashtuquajturin shtet shqiptar nën sundimin e Italisë, por edhe nën të ashtuquajturën Serbi të Nediçit, atyre nuk mund t'ua heqësh plotësisht në kohën e sotme dhe në Jugosllavinë Socialiste.

Demokratizëm konsekuent në marrëdhëniet ndërnacionale do të thotë përcaktim konkret dhe parimor i kategorive komb dhe kombësi, si dhe i marrëdhënieve midis tyre. Pa pretenduar të zhvillojmë teorinë për kombësitë, që nuk e kemi, vetëm po theksojmë se çdo sociologji e kombësive duhet të konstatojë relativitetin e ndarjes së grupeve etnike në kombe dhe kombësi, pamjaftueshmërinë e një trajtimi dhe kategorizimi dihotomik të problemit, pamundësinë që përmes këtij trajtimi dhe kategorizimi të përfshihen e të shprehen veçoritë dhe specifi-

kat e qenies e të pozitës së të gjitha grupeve etnike. Nga pikëpamja shoqëro-politike është shumë i dëmshëm synimi, madje përpjekjet e shumta që bëhen sot në këtë drejtim për të absolutizuar ndarjen në kombe dhe kombësi në atë mënyrë që kjo do të implikonte edhe renditjet lidhur me të drejtat dhe mundësitë, përkatësisht pamundësinë e konstituimit politik e të tjera. Në bazë të këtyre absolutizimeve ndodhet mendimi për kombet shtetkrijuese dhe ato që nuk janë të tilla.

Për mendimin e përparuar demokratik dhe socialist nuk ka dhe nuk mund të ketë dallime parimore në qëndrimin ndaj të drejtave politike e të tjera, përfshi të drejtën për vetëvendosje, për konstituim politik etj. midis kombeve dhe kombësive. Është gjë tjetër që kombësitë, zakonisht për shkak të numrit, vendosjes, përqendrimit, të veçorive historike dhe të tjera, duke pasur në parim të njëjtat të drejta si edhe kombet, nuk kanë mundësi t'i realizojnë ato. Megjithatë, në këtë drejtim nuk janë njëlloj të gjitha kombësitë. Në rastin konkret, kombësia shqiptare, më e madhe në numër se disa kombe të Jugosllavisë, me një përqendrim territorial në madhësinë e kombit, me veçori të shumta kulturore e të tjera, e cila e ka pasur të drejtën për t'u vetëvendosur, gjë që e vërtetojnë dokumente të shumta politike e të partisë që nga periudha e Luftës, u vetëvendos dhe e ka shprehur vullnetin e saj politik me faktin që bashkë me kombet dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Kosovë të krijojë Krahinën dhe pushtetin krahinor, si dhe ka shprehur dëshirën për të qenë, si qark autonom ose si krahinë, në përbërjen e Republikës së Serbisë dhe të RSFJ-së. Për shqiptarët në Jugosllavi, të qenët kombësi do të thotë ose do të duhej të thoshte vetëm atë se në Jugosllavi nuk janë të gjithë shqiptarët, se ata nuk janë as shumica e tyre, por vetëm rreth 40 për qind e kombit shqiptar. Sigurisht, ata janë shprehur për të qenë në Jugosllavi si të barabartë. Bashkësia demokratike duhet t'ua njohë atyre barazinë dhe veçoritë e tyre, duke filluar që nga konstituimi politiko-juridik, ku shprehet më dukshëm edhe subjektiviteti i tyre, e deri te mundësitë kulturore dhe detyrat në këtë bashkësi, si edhe në kuadrin e kombit shqiptar në tërësi.

Një mosnjohje eventuale e subjektivitetit të shqiptarëve si kombësi, imponimet jodemokratike në përcaktimin e pozitës dhe të qëndrimit ndaj tyre, gjë që manifestohet aq dukshëm në përpjekjet e tanishme, reduktimet e ndjeshme të autonomisë së Kosovës në kuadrin e të ashtuquajturit konstituim të barabartë të RS të Serbisë, që janë në kundërshtim me dëshirën e shprehur në mënyrën më plebishitare të shqiptarëve të Kosovës për ruajtjen e bazave të Kushtetutës së vitit 1974, do të shënonin disfatën e demokratizimit, një zgjidhje aneksioniste serbe të çështjes së Kosovës, me të gjitha implikimet dhe pasojat e tjera politike.

Një trajtim demokratik konsekuent i çështjes nacionale të Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi, vetëm i kushtëzuar nga shkalla dhe tempi i demokratizimit të përgjithshëm të marrëdhënieve tona, pa dyshim do të pasqyrohej fuqishëm në proceset demokratike në Serbi dhe Jugosllavi. Që nacionalizmat nxisin njëri-tjetrin, këtë e pamë qartë. Megjithatë, njëri-tjetrin nxisin dhe kushtëzojnë edhe demokratizimet. Marksi shkruante se krijimi i një Polonie demokratike është kushti i parë për krijimin e një Gjermanie demokratike. Me plot të drejtë ne mund të themi se vetëm një zgjidhje e mundshme reale, konsekuente demokratike e krizës së Kosovës do të thoshte shumë për proceset e demokratizimit në Serbi. Impulset e demokratizimit nuk do të ishin të tepërta as për Jugosllavinë, as për Serbinë. Pavarësisht nga ajo çka na thonë fjalimet burokratike ose shtypi i manipuluar, problemet e Kosovës ndikojnë në mënyrë bllokuese në proceset e demokratizimit. Me to manipulojnë forca të caktuara burokratike. Krahas relativizimit të nevojshëm, nuk është e tepërt të kujtojmë qëndrimin e Marksit ndaj çështjes irlandeze, lidhur me atë se si është pasqyruar ajo në zhvillimet shoqërore në Angli. Marksi mendonte se çështja e emancipimit të Irlandës për klasën punëtore të Anglisë nuk ishte «një çështje abstrakte humanizmi dhe drejtësie», por «kusht i parë për vetë çlirimin e saj». Nëse klasa punëtore angleze do të lejonte që Irlanda të ishte për të burim shovinizmi, ajo nuk do të mund t'u kushtohej problemeve reale të çlirimit të saj shoqëror. Sepse, siç i shkruante Marksi Kugelmanit (29.11.1869),

me qëndrimet e tanishme ndaj Irlandës, «nuk është paralizuar vetëm zhvillimi i brendshëm social i Anglisë, por edhe politika e saj e jashtme...».

Histeri nacionaliste nuk ka vetëm në Kosovë. Ka mjaft edhe në Maqedoni e në Serbi. Duke ndjekur të ashtuquajturat mitingje solidariteti gjatë vitit të kaluar, thirrjet për dhunë, për vendosje të administratës ushtarake, për linçime, si dhe ndëshkimet më të fundit brutale që u bënë në Maqedoni, njeriu pa dashje kujton fjalët e Sartrit të thëna me rastin e histerisë antialgjeriane në Francë:

«Franca dikur ka qenë emër i një vendi, të kujdesemi se mos bëhet emër i ndonjë neuroze!»

Në bazë të një demokratizmi konsekuent mund të zhvillohet me sukses kultura e bashkëjetesës.

Tradita pozitive në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ndërnacionale, e arritur përmes lidhjeve të shumta të ndërsjella shoqërore-kulturore gjatë historisë, tradita pozitive që nuk është varfëruar, siç paraqitet shpesh, ndaj së cilës po shpesh mbajmë një qëndrim nihilist të pajustificuar, e zhvlerësojmë dhe e njollosim pa përgjegjësi si në rastin e arritjeve pozitive të vëllazërimit gjatë periudhës së LNÇI-së, nuk është e parëndësishme. Ajo mund të jetë një pikënisje e rëndësishme, një frymëzim dhe udhërrëfyes për zhvillimin e kulturës së bashkëjetesës. Kultura e bashkëjetesës presupozon reciprocitet dhe barazi, njohje dhe respekt të ndërsjellë. Miqësia nuk mund të imponohet, ajo krijohet, arrihet duke mbajtur ndaj tjetrit një qëndrim si ndaj vetvetes, shkruan Lenini.

Qëndrimi injorues dhe nihilist ndaj një kombi tjetër, mohimi i vazhdueshëm, sistematik dhe në forma të ndryshme i tij, i qenies dhe identitetit historik, shoqëror dhe kulturor të tij është një anakronizëm, të cilin e ndeshim jo rrallë edhe sot. Problematizimi i vazhdueshëm dhe sistematik i së kaluarës dhe i së tashmes së tij, vënia në dyshim dhe rezervimi i përhershëm ndaj gjithçkaje që i përket dhe vjen prej tjetrit, sikur të vinte «ex partibus infideliam», veshja atij e vullnetit dhe e qëllimeve të këqija, të gjitha këto përbëjnë një pengesë për njohjen e ndërsjellë, për kapërcimin e distancave ndërnacionale, për afrimin dhe bashkëpunimin. Grumbullimet e

nxënësve të kombësisë serbe dhe malazeze dhe bojkotimi i mësimit që shënoi fillimin e këtij viti shkollor, kishin si qëllim kërkesat që t'u ndryshoheshin shkollave emrat e personaliteteve të historisë e të kulturës shqiptare. Që nga Presheva, ku qendra e mesme shkollore është në prag të vendosjes së administratës së detyruar, sepse mësuesit nuk pranuan t'i ndryshohet emri shkollës, e deri në Klinë, janë vënë në shënjestër emrat e Skënderbeut, të vëllezërve Frashëri, Fan Nolit, Luigj Gurakuqit, Shtjefën Gjeçovit. Madje Shoqatës së mësuesve universitarë të Serbisë i duket se ndërtesa e bibliotekës së Universitetit shpreh disa aspirata fundamentaliste të myslimanëve shqiptarë, ndërsa te kupolat e saj i shfaqën qeleshet shqiptare. Dhe këto janë diçka e huaj dhe armiqësore! Në këto kushte, si mund të arrihet ose të pretendohet që shqiptarët të njohin, të respektojnë dhe të duan vlerat historike dhe kulturore të popullit serb dhe maqedon, gjë që është një element i nevojshëm për kulturën e bashkëjetesës?

Dezinformimet për të tjerët dhe lidhur me ngjarjet në fushën e marrëdhënieve ndërnacionale, të cilat janë të shpeshta dhe të shumta e sidomos kur është fjala për shqiptarët dhe Kosovën, të tilla që thuajse as nuk duan ta fshehin tendenciozitetin e tyre e që shpesh janë afër gënjeshtreve të hapura ose provokacioneve, vetëm se mund t'i dëmtojnë marrëdhëniet ndërnacionale dhe të bëhen burim dyshimesh dhe konfliktesh të reja.

Në mënyrë të veçantë të irritojnë përpjekjet dhe presioni brutal që të pranohen akuzat dhe etiketat e bëra a priori dhe diskualifikimet e pabaza që të pranohet ndjenja e fajit dhe që mëkatet të lahen. Nga shqiptarët kërkohet të pranojnë se kanë rënë në baltë dhe se vetëm me ndonjë efekt të Mynhauzenit, duke u kapur për flokësh, mund të dalin që andej. Ata që në protestat e nëntorit panë shprehjen e zemërimit të masave shqiptare dhe vendosmërinë për të hedhur poshtë fajësimet pa baza, e zgjidhën relativisht saktë enigmën e komponentit thelbësor të këtyre ngjarjeve.

Paragjykimet, mitet dhe stereotipet për nacionalitetet e tjera dhe për qëndrimet ndaj tyre, me prejardhje gati hegjemoniste, nuk mund të bëjnë gjë tjetër veçse

ta thellojnë hendekun dhe mosbesimin, t'i fuqizojnë mosmarrëveshjet e vjetra e të shkaktajnë të reja, të rrisin kundërvëniet dhe armiqësitë. Kështu, edhe miti për shqiptarin si zullumqar, despot dhe tiran vazhdon të ruhet, madje punohet shumë që ai të thellohet dhe të përforcohet. Shpesh mund të lexojmë, dhe kemi patur rastin që në formën e reklamës së një libri për marrëdhëniet në Kosovë gjatë shekullit të kaluar të shohim të njëjtin tekst për shtypjen e sotme të serbëve dhe malazezëve dhe për zhvillimet e sotme në Kosovë njësoj si në shekullin e kaluar. Flitet për nevojën e njohjes së shekullit të kaluar dhe të pushtetit turk, në mënyrë që të kuptohet e sotmja e serbëve dhe malazezëve në Kosovë. Sigurisht, dhunën nuk e ushtronin autoritetet turke dhe okupatorët, por arnautët që edhe vetë ishin të pushtuar, ashtu siç bëjnë edhe sot duke pasur bekimin e «kombësisë» dhe të «autonomisë». Mirëpo, këto «zullume», këto «vrasje», «djegie», «dhunime» dhe «përdhunime», duke kapërcyer kohën, kushtet shoqërore dhe shekujt dhe duke ardhur të pagjymtuara nga e kaluara në të tashmen, vetëm se vërtetojnë natyrën e tyre mitikostereotipe, hipnostazinë e tyre në entitete mitike metafizike.

Miqësia arrihet dhe krijohet. Por miqësia nuk ndërtohet mbi plehra. Politika e kuadrit është përgjithësisht një faktor shumë i rëndësishëm i politikës së përgjithshme. Te ne atë e kanë shoqëruar dhe e shoqërojnë dobësitë e seleksionimit negativ, të pengimit të të aftëve dhe të favorizimit të të bindurve etj. Këto dobësi pasqyrohen në mënyrën më negative dhe më të dëmshme në situatat kur ato shprehen si obstrukcion i të aftëve ose favorizim i të bindurve nga ana e një nacionaliteti tjetër, si miratim dhe inkurajim i atyre, që mjedisi i vet kombëtar nuk i pranon. Nuk do të ishte e tepërt nëse do të thuhej se ky është një ndër momentet më të rëndësishëm të lindjes së mosbesimit nacional dhe të krizës në Kosovë.

Diskursi politik për Kosovën gjatë këtyre tetë vjetëve nuk ka qenë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të kuptuar raportet dhe zhvillimet në Kosovë, prandaj nuk ka mundur të ishte bazë për një aksion politik të suksesshëm për kapërcimin e krizës në marrëdhëniet

ndërnacionale. Është e qartë se vetëm një politikë parimore, e frymëzuar dhe e udhëhequr vazhdimisht nga aspirata dhe ideale demokratike dhe humaniste, nga idetë e lirisë, të barazisë dhe vëllazërimit të formuluar aq mirë që para 200 vjetësh, të pasuruara shumë nga mendimi i ri dhe mundësitë e socializmit dhe të vetadministrimit, si dhe nga arritjet moderne në fushën ekonomike, shoqërore, kulturore dhe civilizuese, si dhe një diskurs i ri politik për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, i nisur nga qëllimet e mësipërme, mund të kuptohen drejt dhe të çojnë në zgjidhjen e marrëdhënieve ndërnacionale, në zhvillimin e tyre me sukses. Por marrëdhëniet ndërnacionale në Kosovë nuk krijohen në një Kosovë të izoluar. Shumë konflikte ndërnacionale në Kosovë as e kanë burimin dhe as mund t'u gjendet zgjidhje vetëm brendapërbrenda kësaj krahine.

*«Kritički osvrt na politički diskurs o Kosovu i albancima», referat i mbajtur në tubimin shkencor në Lubjanë me temë «Kosova, Serbia, Jugosllavia», libri «Kosovo-Srbija-Jugoslaviya», Lubjanë, maj 1989.
f. 111-126.*

Rexhep Qosja

NJË GRAM PUSHTET RËNDON MË SHUMË SE NJË TONELATË MEND

— Intervistë për revistën «Danas» —

— *Ka politikanë të pashkolluar që nuk vlerësojnë asnjë intelektual, sepse ata nuk kuptojnë as vlerën e diturisë e as atë të talentit* —

Fjalët e akademikut Rexhep Qosja vazhdimisht kanë pasur jehonë, pozitive apo negative. Me sa duket, për arsye të tonalitetit të tyre intelektual dhe të vendosmërisë që ngjarjet — për më tepër ato kosovare — t'i ndriçojnë nga një kënd i veçantë, i pazakontë, fjalët e Qoses shpeshherë janë pritur edhe me indinjatë. Por ai nuk i ka lënë shteg askujt ta akuzojë se hesht. Ndërsa pikërisht për heshtje kundrejt nacionalizmit të kombit të vet po qortohen që prej disa vjetësh intelektualët shqiptarë të Kosovës. Për këtë arsye e pyesim Rexhep Qosen:

— Ç'mendoni për thënien se intelektualët shqiptarë heshtin?

— Kjo thënie po përsëritet prej shumë kohësh, me-

gjithëse nuk është e vërtetë. Në mjediset ku jetojnë dhe punojnë, intelektualët shqiptarë e kanë provuar se nuk heshtin, por ata që trumbetojnë heshtjen e tyre nuk janë aty që t'i dëgjojnë. Megjithatë, duket se, edhe sikur t'i dëgjonin si flasin dhe ç'flasin, përsëri do të vazhdonin të theksonin se intelektualët shqiptarë heshtin! Përse? Ndoshta që t'i detyrojnë ata të heshtin! Ose, ndoshta, mendojnë se çdo gjë që ata nuk e dëgjojnë, edhe nuk është thënë! Ose, ndoshta, mendojnë se çdo gjë që ata nuk e miratojnë ose nuk përputhet me përcaktimin e tyre nuk duhet thënë! Në qoftë se disa intelektualë dhe disa mjete të informacionit publik prej vitesh ushqejnë opinionin publik me gjithfarë gjysmë të vërtetash, të pavërtetash dhe shpifjesh për realitetin kosovar, për shqiptarët, për historinë, kulturën, mentalitetin, karakterin e tyre, atëherë mund të mendohet se kanë një objektiv të përcaktuar. E në qoftë se kjo fushatë, në fund të fundit, ka për qëllim që shqiptarët t'i ndalojë, t'i kufizojë në rrugën e emancipimit të tyre kombëtar, duke i përshkruar ata vetëm si subjekt politik, pra, duke u dhënë një vend shumë më modest nga ai që kanë në bazë të shkallës së zhvillimit historik, shoqëror dhe shpirtëror dhe nga ai që duhet të kenë objektivisht në bazë të qenies së tyre të pranishme në këtë shoqëri, atëherë u dashka të heshtin ata, të cilët i demaskojnë të tilla të pavërteta dhe shpifje, sepse mund të merren masa! Me ata që heshtin mund të merresh vesh më lehtë: ata i pranojnë gjërat siç u imponohen, sepse nuk mund të thonë se si janë.

— Ç'mendoni për reagimet e disa intelektualëve serbë dhe maqedonë gjatë viteve të fundit ndaj fjalëve të (disa) intelektualëve shqiptarë?

— Ata nuk përdorin fare argumente, por akuza politike! Kjo është një metodë klasike për të të detyruar të heshtësh, por s'ka të bëjë fare me dialog demokratik midis intelektualësh. A keni pasur rastin të ndiqni reagimin e disa institucioneve politike (në Beograd dhe në Shkup) ndaj diskutimeve të dy intelektualëve politikanë shqiptarë në pranverën e vitit 1987 dhe tani, në shkurt të vitit 1988? Edhe këtu është përdorur metoda klasike e detyrimit politik për të heshtur, çka bie ndesh me

kulturën politike që propagandon kjo shoqëri. Duket sikur këtu imponohet konkluzioni se shqiptarët më të mirë janë ata shqiptarë që heshtin dhe se sa më të mençur të jenë, aq më fort u duhet mbyllur goja! Për fat të keq, duket qartë se në disa mjedise shqiptarët shikohen vetëm si një pakicë dhe mendohet se detyra e tyre është vetëm që të dëgjojnë e të zbatojnë, por jo të mendojnë. Në këtë rast harrohet se barazia e njerëzve ka të bëjë jo vetëm me jētën ekonomike e shoqërore, por edhe me shprehjen e lirë të mendimit politik. Përuļja ka qenë gjithmonë tipar i qytetarëve të dorës së dytë e të tretë, kurse ne e konsiderojmë veten si shoqëri e qytetarëve dhe e kombësive të barabarta. Por duhet që si të tillë të jemi edhe në praktikë, jo vetëm në teori.

— A ekziston edhe prirja që intelektualët shqiptarë të Kosovës të vihen në shërbim të politikës së përditshme, pra, në shërbim të burokracisë nacionale?

— Në shërbim të politikës së përditshme — po, ndërsa në shërbim të burokracisë nacionale — jo. Cili sundimtar gjatë historisë nuk ka mbajtur si zbukurim intelektualë rreth vetes: filozofë, poetë, shkencëtarë apo piktorë? Cilat klasa sunduese gjatë historisë nuk janë përpjekur që t'i vënë intelektualët në shërbim të politikës së përditshme? Sidomos kjo prirje është tepër e theksuar në shekullin tonë. Në Kosovë, ndoshta për shkak të traditave të dobëta demokratike, të frymës patriarkale në politikë, si dhe për shkak të pozitës së shqiptarëve si «pakicë kombëtare», kjo prirje është shumë më e theksuar sesa në mjediset e tjera të vendit. Kompleksin që i kanë shkaktuar përuļjet ndaj eprorëve, burokrati ynë e ka shëruar vazhdimisht duke u treguar i pamëshirshëm ndaj atyre që i ka pasur vartës. Nga njëra anë, ai nuk pyet për asgjë, kurse, nga ana tjetër, urdhëron për gjithçka. Njëkohësisht, edhe vetë intelektualët shqiptarë vihen më lehtë sesa në mjediset e tjera në shërbim të politikës së ditës e të burokracisë. Për këtë ka shkaqe të shumta. Intelektualët tanë e kanë prejardhjen nga familje të varfra, si fshatare ashtu dhe qytetare, kështu që, duke u vënë në shërbim të politikës së ditës e të personave me pushtet, ata shpëtojnë nga varfëria e madhe. Privilegjet që u ofrohen atyre për një shërbim të tillë

shpërblehen në një masë të madhe me heqjen dorë prej singeritetit në veprimtarinë krijuese.

Më tej: ne kemi qenë gati pesë shekuj nën sundimin turk, tri dekada nën xhandarmërinë e Jugosllavisë së vjetër, katër vjet nën pushtimin italian e gjerman, ndërsa deri në vitin 1966 plotësisht të kufizuar e të kontrolluar nga udhëbuesit e Rankoviçit. Të gjitha këto e disa të tjera kanë sjellë si pasojë objektive që ne të bëhemi një popull, i cili është detyruar me dhunë që të fetishizojë pushtetin. Ne jemi një popull me besim të dobët fetar edhe për faktin se pushteti ka qenë vetë zot e vetë shkop, dhe ne kemi qenë të detyruar t'i përulemi. Ndoshta për këtë arsye edhe sot te ne akademikët qëndrojnë gatitu para sekretarëve të institucioneve përkatëse, poetëve të popullarizuar me bujë u meket zëri para qatipëve të komunave, punonjësit e shquar shkencorë s'e zënë më lapsin me dorë për tërë jetën kur u ofrohet ndonjë post në fushën e shkencës ose të arsimit. Kurrë nuk kam arritur ta kuptoj nëse një qëndrim i tillë i disa intelektualëve është në fakt pasojë e mëndjeshkurtësisë apo e lakmisë së pa-ngopur.

— A ka ndryshuar ndonjë gjë vitet e fundit?

— Gjatë disa vjetëve të fundit nga radhët e inteligjencies krijuese shqiptare, madje edhe nga ata që mbajnë titujt më të lartë shkencorë, janë rekrutuar disa burokratë të tillë, të cilët kanë nisur të përndjekin kolegët e tyre. Po të mos ishin disa politikanë, madje edhe më të rinj se ata, për t'i frenuar këta të fundit në ndjekjen e synimeve të këtij lloji, kushedi se sa intelektualë do të ishin flakur jashtë jetës sonë kulturore dhe do të përfundonin keq. Për fat, në shumicën e rasteve gjendet ndonjë politikan i çliruar nga zilia, e cila bën që ambicjet krijuese të paplotësuara t'u shtohen dështimeve të tjera. Ky politikan u pret rrugën në çastin e fundit përbindshave të tillë nga radhët e intelektualëve.

Vënia e një numri intelektualësh shqiptarë në shërbim të politikës së ditës në kushtet e Kosovës kurrë nuk ka qenë vënie në shërbim të së ashtuquajturës burokraci nacionale, dhe kjo jo për faktin se nuk duan disa intelektualë, po për faktin se një gjë të tillë nuk e ka dashur burokracia. Burokracia shqiptare, për arsye se është konsi-

deruar dhe konsiderohet si kosovare dhe jo vetëm si shqiptare, — gjë që përputhet me përbërjen shumëkombëshe të Kosovës — gjithmonë e ka pasur frikë inteligjencien shqiptare. Burokracia shqiptare në të vërtetë është burokracia më anacionale në Jugosllavi. Kushdo që dëshiron mund të bindet çdo ditë se si nacionalizmin në shumë raste ajo e redukton në frazeologji nacionale. Ajo e përdor inteligjencien, por në të njëjtën kohë e mban edhe në distancë, në gjendje gatishmërie, në qëndrim gatitu, komunikon me të deri në njëfarë mase. Burokracia shqiptare, përkatësisht kosovare, nuk e vlerëson inteligjencien e vet, megjithëse e shpërblen me privilegje, nga njëra anë, dhe me iluzionet e pushtetit që gjoja i vë asaj në dispozicion, nga ana tjetër. E si do ta vlerësonte atë? Ka politikanë të pashkolluar që nuk vlerësojnë asnjë intelektual, sepse ata nuk kuptojnë as vlerën e diturisë e as atë të talentit. Ka edhe politikanë të mençur e të arsimuar që nuk i vlerësojnë ata intelektualë që u janë vënë atyre në këtë apo atë mënyrë në shërbim të politikës së ditës, sepse ata përbuzin servilizmin, të cilin e hasin aq shpesh, e ndoshta edhe e provojnë në jetë. Ata e dinë se një intelektual i tillë është një lajkatar i mjerë, i cili edhe ata i gënjen ashtu siç ka gënjer edhe të tjerë para tyre. Në fund të fundit, e kush mund t'i vlerësojë intelektualët, në qoftë se nuk ka vetë një sovranitet intelektual dhe moral?

Megjithatë, e gjithë kjo nuk do të thotë se intelektualët krijues duhen mbajtur larg shoqërisë dhe dukurive shoqërore. Jo. Në rrethanat normale, ndoshta, qëndrimi i intelektualëve ndaj politikës mund të krahasohej me iriqët në dëborë: në qoftë se afrohen shumë, do të shpojnë njëri-tjetrin, në qoftë se largohen do të ngrijnë.

— Atëhere, cili është diapazoni i mendimeve të intelektualëve shqiptarë të Kosovës dhe cilat janë mundësitë për t'i shprehur ato publikisht?

— Mundësitë e intelektualit shqiptar në Kosovë për të shprehur haptazi mendimet e tij sot janë më të kufizuara sesa asnjëherë më parë, që nga vitet 50-të e deri sot. Në sferat e kulturës, të shkencës dhe të krijimtarisë te ne kultivohet me konsekuencë monopoli, monoliteti dhe monologu. Nuk do ta besoni, por është e vërtetë se

të gjitha gazetat e përditshme politike, të gjitha të përjavshmet, të gjitha gazetat dhe revistat kulturore dhe letrare në gjuhën shqipe në Kosovë, së bashku me një redaksi të vetme botuese, janë centralizuar në një shtëpi gazetaro-botuese! Të gjitha ato kanë një drejtor të vetëm! Dhe këtu zgjidhen ose emërohen të gjithë kryeredaktorët, të gjithë redaktorët përgjegjës, të gjithë redaktorët.

Dikur pjesa më e madhe e këtyre gazetave dhe revistave për letërsinë, shkencën dhe kulturën u përkisnin institucioneve të tjera, të cilat edhe i themeluan, por ato, para 15 vjetësh, një ideolog dritëshkurtër, në vend të një drejtuesi të kulturës, i grumbulloi nën kapelen e vet, në një institucion. Me këtë akt në jetën tonë intelektuale u hodhën objektivisht themelet e qëndrimit monopolist dhe të të gjitha pasojave që burojnë nga kjo: marrëdhëniet e pronës së grupit, lokalizmat e ndryshëm, masat kufizuese ose represive mbi mendimin. Pasojat e një centralizimi të këtyre të tribunave kulturore dhe krijuese janë shfaqur në mënyrën më drastike vitet e fundit. Burokracisë kulturore, me një centralizim të tillë, i është dhënë mundësia që, nën ikonografinë e demokracisë vet-administruese, t'i zbatojë më lehtë represionet mbi krijimtarinë dhe të pengojë edhe mendimin më të thjeshtë kritik. Përfytyroni: nuk mund ta marrësh fjalën aty ku jeton dhe punon dhe e merr në mjedise të tjera. Ky është sot fati i intelektualëve shqiptarë. Mendimi i tyre duhet të sakrifkohet për hir të karrierës së disa burokratëve kulturorë e të tjerë.

— Në Kosovë është i pranishëm homogjenizimi nacional. As intelektualët nuk janë të imunizuar prej tij. Por, sa janë të pranishëm midis intelektualëve shqiptarë një uniformitet i tillë shpirtëror dhe mendimi njëdimensional?

— Intelektuali dhe individi shqiptar, të cilin shoqëria sinqerisht e konsideron si intelektual, mund të ketë edhe titullin e doktorit, por megjithatë, ai jeton larg krijimtarisë shpirtërore. Sepse e vetmja busull e tij është niveli i jetesës. Ai në rastet më të shpeshta mendon si të fitojë sa më shumë dhe të jetojë sa më mirë. Ai vazhdimisht është i kënaqur me veten dhe botën përreth vetes dhe kjo kënaqësi mund t'i lexohet në sy dhe duket nga shkëlqimi i

fytyrës. Ai me vite nuk lexon libra, historinë botërore dhe kombëtare e quan folklor, dëshirën për njohuri e shuan me gazetat e përditshme. Atë, në mëngjes, rreth orës shtatë ose më vonë, mund ta shikosh se si blen gazetën lokale, se si me të në xhep hyn në zyrë, redaksi, institut, ndërmarrje, fakultet, dhe me të ushqen shpirtin e tij të plogësht gjatë gjithë ditës. Shkencën e redukton në atë që mund të lexojë në gazetat dhe revistat lokale, letërsinë në atë që ka lexuar në librat shkollorë, politikën në atë se është thënë kështu e ashtu. Ky tip në kolektivat e punës intelektuale përfaqëson miellin, me të cilin e ashtuquajtura strukturë udhëheqëse përgatit të gjitha llojet e brumërave. Ai, në fakt, përfaqëson atë pjesë të inteligjencies shqiptare që intelektualët e tjerë shqiptarë e konsiderojnë patriarkale. Me oreks ai i përket botës së sotme, ndërsa me ndërgjegje botës që po zhduket.

— Po tip tjetër?

— Është ai intelektual dhe individ shqiptar, i cili veprimtarinë intelektuale e shfrytëzon vetëm si trampolin për t'u hedhur në veprimtari shumë më të rehatshme: në drejtimin e saj, në vlerësimin e saj ose fusha të përafërta me këtë. Në rastet më të shpeshta edhe ai lexon pak, sepse për të lexuar nuk ka kohë dhe interesin intelektual e ka shumë të kufizuar. Për të dinakëria është kulmi i zgjuarsisë, ecja horizontale — filozofia supreme e suksesit në jetë, ndërsa kolltuku — busulla supreme.

Ai e ka kuptuar me kohë se tani një gram pushtet vlen më shumë se tonelata mend, kurse lidhjet e forta më shumë se gjenialiteti krijues. Për këtë arsye, ka mobilizuar edhe dinakërinë e të menduarit, edhe filozofinë e ecjes horizontale në mënyrë që të futet në nomenklaturë, e cila i jep mundësinë që për 20, 25 ose 30 vjet të jetë në radhët e drejtorëve, të shefave, sekretarëve, dekanëve, rektorëve, kryetarëve të institucioneve, në të cilat është formuar, por edhe nuk është formuar. Ai bën të gjitha kthesat e mundshme, i shmanget çdo padrejtësie, por kurrë nuk mendon se ata që pësojnë ndonjë padrejtësi në jetë mund të rehabilitohen një ditë, ndërsa ata që bëjnë të gjitha kthesat nuk mund të rehabilitohen kurrë. Pronën shoqërore ai e përdor pothuajse si të vetën: me mjetet shoqërore ai korrupton ata që e rrethojnë, për këtë arsye ai ka

edhe shumë miq! Ai mund të vazhdojë të shkruajë ndonjë vjershë, prozë, dramë, të kompozojë ndonjë melodi, të organizojë ndonjë ekspozitë, të bëjë ndonjë artikull ose shkrim, por krijimtarinë nuk e do dhe nuk e vlerëson më. Tepër servil ndaj eprorëve, ai shpeshherë është brutal ndaj vartësve. I shkëputur nga populli, ai më shumë është për të të ardhur keq sesa për t'u respektuar, kështu që në qarqet intelektuale me tallje e quajnë: një nuse për Stasin, që do të thotë një nuse për të gjithë! Vitet e fundit i kanë hequr aureolën filozofisë së jetës këtij tipi intelektual. Për fat, të tillë nuk janë shumë, megjithëse kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë më pas të tillë, sepse në kohëra të vështira ata vullnetarisht ofrojnë shërbimin e tyre.

— Tipi i tretë i intelektualit, mbase është ai i «rrugës së drejtë»?

— Është ai intelektual shqiptar, por edhe individ, që do të veprojë në përputhje me ndërgjegjen e vet, që të mos jetë vetëm një ingranazh në makineri, që do të ecë vertikalisht në jetë, të mendojë me kokën e vet. Për të kryesorja është të veprojë e jo të jetë. Ai ka nevojë për aq sa të ketë mundësi të plotësojë nevojat më themelore shoqërore. Atë e karakterizon kureshtja e madhe shpirtërore, sinqeriteti ndaj vlerave dhe kulturave të ndryshme, njohja e mirë e kulturës kombëtare dhe botërore, e shkencës dhe artit.

Intelektualë të tillë sjellin ide, koncepte, vlera dhe përfytyrime të reja, njohuri të reja në jetën tonë. Ata përpunojnë rryma të reja në krijimtarinë artistike, metoda dhe teori të reja shkencore në punën tonë kërkimore, njohuri të reja bashkëkohore në mendimin e përgjithshëm; ata zbatojnë procedura të reja në fusha të ndryshme profesionale, e të gjitha këto janë kontributi i tyre. Ata, ndonjëherë, nuk vihen re, por janë intelektualët më të rëndësishëm shqiptarë në Kosovë, sepse me të vërtetë mbajnë barrën e zhvillimit shpirtëror, shkencor dhe artistik të kombësisë shqiptare.

— A mbizotëron sot në Kosovë ky tip intelektual, apo janë në shumicë «intelektualët-miell»?

— Për fat, këtij tipi i përket pjesa më e madhe e inteligjencias shqiptare, kështu që ata, me numrin dhe pu-

nën e tyre të rëndësishme, i japin tonin periudhës shpirtërore, mendimin intelektual shqiptar e orientojnë drejt së ardhmes. Duhet thënë se ata janë intelektualët më të dashur për popullin. Megjithatë, ky tip intelektualësh nuk është kuptuar gjithnjë mirë dhe nuk është trajtuar si duhet. Puna dhe krenaria e tyre disa herë bëhen barrë për ta, sepse siç thotë Hana Arent: «Asgjë nuk shkakton zili aq shumë sa pasuria pa pushtet, pra sa pasuria intelektuale».

*Milan Jajčinović, «Gram vlasti
teži od tone pameti», «Danas»,
Zagreb, 15.3.1988.*

Xhemail Mustafa

KOSOVA SI ATLANTIDË

Në mesin e më se njëzet librave që u botuan viteve të fundit për Kosovën, ka të tillë që ndihmojnë kapërcimin e gjendjes në këtë Krahinë, por shumica prej tyre u shkruan, u botuan e po ribotohen në radhë të parë si «mall» për biznes.

Gjatë këtyre katër-pesë vjetëve të fundit interesimi për Kosovën ishte aq i madh dhe aq i gjerë, sa që sot mund të flitet lirisht për rilindjen e këtij interesimi dhe për intensifikimin e tij në të gjitha fushat e aktivitetit dhe të krijimtarisë në vend. Kosova, që deri dje thua se nuk ekzistonte ose ishte fare pak e pranishme në krijimtarinë e autorëve të vendit dhe në mediumet e komunikimit masiv, sot është bërë objekt i vështrimeve dhe i interpretimeve të shumta, i krijimeve dhe i diskurseve të ndryshme, si për nga natyra e tyre, ashtu edhe për nga qasja dhe qëllimi. Për Kosovën dhe popullatën e saj, për realitetin historik dhe atë aktual të kësaj Krahine, viteve të fundit zunë të interesohen me të madhe jo sall politikanët e gazetarët, që këtë interesim e kanë punë dhe obligim të përditshëm profesional, por edhe akademikë e shkencëtarë, historianë e publicistë, shkrimtarë dhe piktorë, regjisorë dhe dramaturgë të ndryshëm.

Në këtë mënyrë Kosova u bë mozaik i të gjithë in-

teresave të mundshme intelektuale dhe pseudointelektuale, i të gjitha temave dhe motiveve deri tash të njohura krijuese dhe pseudokrijuese, sikundër qe pikërisht Kosova dhe temat e saj të «nxehta» nga historia, politika dhe kultura u shndërruan në një kriter tejet të veçantë të diferencimit të njerëzve, të qëndrimeve dhe të botëkuptimeve të tyre. Sipas këtij kriteri, intelektual, krijues dhe punëtor publik i angazhuar, profesionalisht i ngritur dhe kombëtarisht i orientuar merret e konsiderohet ai intelektual, krijues dhe punëtor publik që shkruan ose flet për Kosovën, veçmas për historinë, traditën dhe kulturën e kombësisë shqiptare. Kjo është shkalla e parë e diferencimit të njerëzve në frymën e këtij kriteri tejet të veçantë, kurse shkalla e dytë lidhet me mënyrën e shkrimeve, sepse për të qenë aktual, i lexueshëm dhe i nderuar në opinion. njeriu për Kosovën duhet të shkruajë a të flasë në mënyrë sa më ekskluzive, me një ligjërim sa më hipersensibël dhe me sens të veçantë për dramatzimin e gjërave.

Zbulimi dhe rizbulimi i Kosovës

Mënyra e këtyllë e të menduarit dhe e të shkruarit për Kosovën po shndërrohet përherë e më shumë në normë shoqërore dhe morale, po merr trajtën e një forme të veçantë të ekzistimit dhe të afirmimit edhe ndër intelektualë, edhe ndër krijues të fushave të ndryshme. Si rezultat i kësaj norme shoqërore e morale, i interesimit të shtuar të arsyeshëm rreth Kosovës, por edhe i një euforie përmasash të papara për historinë dhe realitetin aktual të kësaj Krahine, vetëm brenda pesë-gjashtë vjetëve të fundit u botuan më se njëzet libra të autorëve të vendit. Në këtë mënyrë, Kosova u bë objekt dhe temë veçanërisht e preferuar dhe e pranishme në shumë studime me pretendime historike, në një varg librash me kujtime dhe në shumë fejtone e shkrime të tjera publicistike. Po ashtu Kosova u bë temë e preferuar dhe lajtmotiv i fortë i disa romaneve dhe i disa librave me poezi, i disa filmave dokumentarë dhe artistikë, sikundër qe «drama» e Kosovës u nxor në skenë në sajë të dramaturgëve dhe regjisorëve

të ndryshëm të vendit, veçmas të Beogradit e të Serbisë.

Shikuar objektivisht, Kosova dhe popullata e saj shqiptare do të duhej të ishte e kënaqur me vendin që zë sot në literaturën e vendit dhe në mediumet e tjera të artit, sepse nuk është punë e vogël që vetëm brenda pesë-gjashtë vjetëve të shkruhen aq libra shkencorë e letrarë për një Krahinë dhe për popullatën e saj. Mirëpo, po u shikuan konkretisht dhe realisht këta libra, gjithë kjo literaturë formash e përmbajtjesh të ndryshme, atëherë njeriu jo që nuk ka si të jetë i kënaqur, por ekzistojnë një mijë e një motive e arsye që këtë fond botimesh të ndryshme ta marrë me mjaft rezervë, me indinjatë dhe herë-herë me shqetësim të veçantë. Në mesin e këtyre botimeve, vërtet, ka edhe të atilla që problemet dhe kundërthëniet e ndryshme të Kosovës i trajtojnë me përgjegjësi intelektuale, shkencore e ideore. Si të tilla, këto botime serioze krijojnë një pasqyrë më të plotë për Kosovën dhe e ndihmojnë aksionin e përgjithshëm shoqëror për kapërcimin e situatës së vështirë në këtë Krahinë.

Mirëpo, nuk është vështirë të konstatohet se shumica e këtyre librave jo që nuk ndihmojnë aksionin e përgjithshëm shoqëror për kapërcimin e gjendjes në Kosovë, por në forma e mënyra të ndryshme e pengojnë këtë aksion. Fundja, autorët e shumicës prej këtyre botimeve veprimin e nacionalizmit shqiptar e morën vetëm si shkas për të sulmuar kombësinë shqiptare në përgjithësi, për të krijuar hipoteka rrënuese politike rreth shumë personaliteteve, ngjarjeve dhe proceseve të historisë, traditës dhe aktualitetit të kësaj kombësie. Në këtë mënyrë në këtë fond botimesh që po shtohen për çdo ditë, Kosova «zbulohet» dhe «rizbulohet» në një mijë e një ngjyra e forma të ndryshme, sikur të jetë ajo një Atlantidë tejet e veçantë dhe deri tash e panjohur e planetit tonë!

Kosova si formë e veçantë e biznesit

Intensifikimi i botimeve të këtilla, që vërtet janë shumë për një Krahinë si Kosova, jep shkas të konstatohet se në vendin tonë, veçmas në një pjesë të tij, tashmë po

krijohet një tip fare i veçantë i literaturës. Shikuar për nga përmbajtja dhe destinimi, për nga qasja dhe ekskluziviteti kombëtar, mund të thuhet se në pjesën më të madhe kjo literaturë është e instrumentalizuar maksimalisht. Si e këtillë, kjo literaturë tejet e veçantë dhe që nuk udhëhiqet gjithëherë as nga objektiviteti elementar shkencor, as nga etika e shkrimit intelektual dhe as nga humaniteti, po konsumohet me të madhe nga opinioni lexues dhe tashmë ka krijuar një treg të gjerë. Kësaj literature i bëhet reklamë e veçantë në mjetet e informimit, ajo botohet e ribotohet nga disa herë në gazeta e revista dhe gjithë kjo, s'ka dyshim, bëhet me të vetmin qëllim që këto botime të kenë një numër sa më të madh lexuesish dhe një treg sa më të gjerë të shitjes. Në këtë funksion duhet parë edhe ribotimi i disa librave të autorëve serbë, të shkruar gati para një shekulli!

Mbase nuk është kontestuese se motivi i parë pse shkruhen shumica e botimeve të këtilla lidhet jo me ndonjë motiv a arsye më të thellë shkencore e krijuese, por me motive, shkase e arsye të thuash thjesht politike. Në gjiun e një opinioni publik përherë dhe më të politizuar dhe më të ndarë mbi baza kombëtare (është vështirë të thuhet se ç'u bë me «ndarjen» dhe qasjen klasore?) literatura e këtillë e instrumentalizuar maksimalisht gjithmonë i ka konsumuesit e vet të shumtë dhe të pakompromis. Këtë fakt më së miri e dinë disa nga autorët e këtyre botimeve dhe botuesit e tyre, të cilët Kosovën dhe literaturën për të, me gjasë, tashmë e shndërruan në një biznes të veçantë dhe tejet të leverdishëm. Kështu, Kosova dhe problemet e kundërtënieve të saj u bënë të preferueshme dhe të leverdishme për biznes jo sall në fushën e «hierarkisë» shoqërore dhe të karrierës, por edhe në sferën e literaturës, të leverdisë materiale dhe të «prestigjit» që sjellin ato në opinion. Për autorët dhe botuesit e këtyre publikimeve duket se më së paku është i rëndësishëm trajtimi objektiv i Kosovës dhe i problemeve e kundërtënieve të saj, prandaj ajo mund të «zbulohet» dhe të «rizbulohet» si një Atlantidë deri tash e paparë, apo jo!

«Rilindja», Prishtinë, 22.5.1988

TË GATSHËM PËR LUFTIM VETËM TË NACIONALIZMIT TË VËRTETË

Një grup prej 184 banorësh të kombësisë shqiptare nga Fushë-Kosova u dërgoi një petition organeve më të larta të Komunës së Prishtinës, Kosovës, RS të Serbisë dhe Federatës, në të cilin shprehin mendimin e tyre për gjendjen në këtë lokalitet të Krahinës. Nënshkruesit e petitionit që në fillim të tekstit distancohen, siç thonë, nga akuzat dhe kërkesat e papranueshme, të cilat për çdo ditë po lansohen në Fushë-Kosovë dhe po shprehin çudi ngase fqinjët e afërt të tyre, serbët dhe malazezët, asnjëherë nuk janë ankuar për ta «se po ua bëjnë jetën të pamundshme». Shtohet se «në asnjë mbledhje nuk kanë dëgjuar se dikush i ka përmendur me emër e mbiemër».

Çdokund ka hajna e njerëz arrogantë, por....

Pranojmë, thuhet në petition, se ka gjithkund hajna dhe njerëz arrogantë, por individët e tillë nuk mund të identifikohen e të njëjtësohen me tërë kombësinë. Pyesim: ku janë ata shqiptarë, të cilët në Fushë-Kosovë po

e vështirësojnë jetën e serbëve dhe të malazezëve dhe pse komisionet tona nuk i përmendin? Në bazë të sulmeve që vijnë nga Fushë-Kosova, shkruajnë më tej, rezulton se gjithkund ku jetojnë shqiptarët jeta është e padurueshme dhe ekziston vetëm urrejtja e që është e pavërtetë dhe jologjike.

Duke bërë pyetjen: çka nënkuptohet me nacionalizmin shqiptar, nënshkruarit e peticionit theksojnë: nëse nënkuptohet përdorimi i gjuhës dhe i shkrimit të kombësisë shqiptare, shkollimi në gjuhën amtare dhe të ngjashme, atëherë kundër kësaj ne nuk mund të luftojmë, sepse as nuk mund të pritët që të luftojmë kundër ekzistencës sonë. Nëse, në të vërtetë, nënkuptohet ajo që është e vlerësuar dhe definuar cartë në dokumente si nacionalizëm shqiptar, atëherë jemi të gatshëm të luftojmë kundër tij.

Kundër privilegjeve e për bashkëjetesë

Me përgjegjësi të plotë deklarojmë, thuhet në peticion, se asnjë pjesëtar i kombësisë serbe e malazeze nga fqinjësia nuk ka kërkuar mbrojtje e siguri nga nacionalistët shqiptarë nga mjedisi ynë. Nënshkruarit e peticionit gjithashtu theksojnë «se janë kundër kërkesës që gjuha shqipe të mos jetë e barabartë me gjuhën serbokroate» dhe «nuk mund të kuptojnë se si e pengon dikë përdorimi i flamurit kombëtar». Nuk i pranojnë as «akuzat se po tregojnë sjellje fashiste ndaj kombeve e kombësive të tjera». Ata, siç vënë në pah, nuk mund të kuptojnë se «për ç'arsye fqinjët e tyre», «serbët e malazezët», nuk i thërrasin në mbledhje. Me gatishmëri për zgjidhje bashkërisht të të gjitha kërkesave në atë mjedis theksohet se ata janë kundër asaj që «dikush të ketë privilegje vetëm e vetëm ngase i përket ndonjë kombi a kombësie».

Në peticion u bëhet thirrje të gjithë qytetarëve të Fushë-Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare. «të ulen bashkërisht dhe të fillojnë t'i zgjidhin problemet e grumbulluara».

Nënshkruarit e peticionit theksojnë se janë «kundër

manipulimit me problemet, me kombet e kombësitë», si dhe kundër «masave represive, që i kërkojnë për shqiptarët disa forca të caktuara jashtë Kosovës». «Mashtrohen ata që mendojnë, thonë nënshkruesit, se duke i lënë anash shqiptarët, problemet mund t'i zgjidhin vetë».

Nënshkruesit e petitionit u bëjnë thirrje serbëve e malazezëve nga Fushë-Kosova që «po qe se ndiejnë nevojë për siguri, t'u drejtohen atyre për zgjidhjen e problemeve». Nënshkruesit kërkojnë nga serbët e malazezët «të mos kujdesohen vetëm për vete, por edhe për fqinjët e vet, me të cilët jetojnë bashkërisht».

«Rilindja», Prishtinë, 5.1.1988.

AUTONOMIA E PEZULLUAR

— *Diskutim në takimin e shkrimtarëve serbë dhe kosovarë për temën: «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot» —*

Do të flas për disa masa restriktive dhe represive, për padrejtësitë që po u bëhen shqiptarëve qoftë si individë, qoftë si kombësi nga ana e institucioneve. Do të flas për këto dukuri, me besimin e sinqertë se vetëm duke e thënë të vërtetën do të gjendet gjuhë e përba-shkët, besim e respektim me qëllim të afrimit mes shqiptarëve dhe serbëve. Cilat janë këto dukuri?

1. Vitet e fundit në zhurnalistikën, publicistikën, shkencën, letërsinë, madje edhe në kinematografinë serbe (e, nën ndikimin e tyre, edhe në atë maqedonase dhe pjesërisht edhe malazeze), po zhvillohet një fushatë politike që nuk mbahet mend, lidhur me Kosovën dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Kjo fushatë ka zgjuar paragjykime të vjetra dhe ka krijuar paragjykime të reja për shqiptarët; ka nxitur mosbesimin dhe mosdurimin ndaj tyre; ka krijuar një psikozë antishqiptare.

2. Në lidhje me traditën historike të shqiptarëve në shkencën dhe publicistikën serbe është bërë një kthesë me të vërtetë shumë e çuditshme. Në paraqitjen e fakteve, të personaliteteve, ngjarjeve, për të cilat më

herët është shkruar pozitivisht, tash, pothuajse, për të gjitha shkruhet negativisht. Kjo kthesë më parë u bë në shkencën serbe në lidhje me prejardhjen ilire të shqiptarëve. Bile edhe ata arkeologë dhe historianë, të cilët më parë kishin pranuar prejardhjen ilire të shqiptarëve, sot qëndrimet e tyre i revizionojnë, ashtu si dhe të drejtën për vetëvendosje të të gjitha kombeve, pra, edhe të shqiptarëve.

3. Në shpjegimet e historisë shqiptare, si dhe të marrëdhënieve shqiptaro-serbe të shekullit XIX dhe të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX, në shkencën dhe publicistikën serbe justifikohen botëkuptimet dhe metodat e Garashaninit e të Pashiçit.

4. Minimizohet pjesëmarrja e shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht në Kosovë, në LNÇI dhe Revolucion. Veçanërisht mohohet roli dhe rëndësia e Konferencës së Bujanit, e cila, sipas detyrave, qëllimeve dhe konkluzioneve të saj, ishte shprehje e vullnetit të pjesëmarrësve dhe të atyre që ata përfaqësonin, të cilët mbështeteshin në qëndrimet e shpallura të udhëheqësve të PKJ-së për lirinë, barazinë dhe të drejtën e vetëvendosjes së popujve, pra, edhe të shqiptarëve.

5. Në shkencën dhe letërsinë serbe shqiptarët përsëri filluan të quhen «Shiptari». Kjo, në radhë të parë, që të theksohen dallimet e tyre historike, kulturore, gjuhësore dhe të tjera nga ato të shqiptarëve, me të cilët, megjithatë, edhe shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, janë plotësisht të njëjtë edhe nga origjina, gjuha dhe zhvillimi historik etj. Veprohet kështu, mbase që t'u imponohet ndjenja e një vlere më të vogël.

6. Shumë kohë u kërkua dhe në fund u bë ndryshimi i flamurit shqiptar. Respektimi i Flamurit Kombëtar, ashtu siç ka qenë, është kushti themelor për nderimin dhe respektimin e popullit që i përket. Ndërsa kërkesat për ndryshimin e tij prekin identitetin kombëtar, integritetin moral dhe krenarinë e këtij populli. Ndryshimet e një simboli të tillë kombëtar mund të bëhen vetëm me miratimin e popullit — dhe kjo mund të bëhet vetëm me referendum.

7. Ka 7 vjet që në Serbi mbahet qëndrim negativ ndaj bashkëpunimit kulturor me Shqipërinë. Është bërë

e pamundshme të ndiqet programi televiziv i Shqipërisë; nga programi i Radiotelevizionit të Beogradit janë hequr të gjitha këngët popullore shqiptare që këndohen nga artistët e Shqipërisë; janë bllokuar shkëmbimet e informimeve shkencore e kulturore në mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë etj. Për fat të keq, edhe pas nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim kulturor në mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, që u arrit gjatë mbajtjes së Konferencës së vendeve ballkanike, nuk ndihen ndryshime në këto qëndrime alogjike, që vazhdojnë prej 7 vjetësh në marrëdhëniet kulturore midis të dy vendeve (...)¹

9. Vitet e fundit në Serbi bëhet mobilizimi i vetëdijes kombëtare nëpërmjet ndjenjave fetare, të cilat forcojnë psikozën antishqiptare Shën Sinodi në Pejë; ardhja e arqipeshkvit rus në Kosovë; ardhja e patriarkut Vasiljev të kishës ortodokse nga Stambolli në Kosovë; promocionet që u bëhen personaliteteve fetare etj. kanë shërbyer për mobilizimin e ndjenjave kombëtare serbe. Psikozës antishqiptare i shërbejnë edhe shumë shkrime për të ashtuquajturat shkatërrime të përmendoreve kulturore serbe në Kosovë, edhe pse dihet se pas Hilandarit, përmendoret e kulturës serbe në Kosovë janë përgjithësisht më të ruajturat.

10. Promocione të veçanta shoqërore u bëhen edhe personaliteteve të kulturës, shkencëtarëve dhe shkrimtarëve, të cilët u bënë të njohur me krijimet dhe disponimin e tyre antishqiptar. Për herë të parë pas lufte u rishtypën veprat e traditës publicistike serbe, në të cilat në mënyrë joshkencore, me pasaktësi dhe në mënyrë tepër keqdashëse shkruhet për shqiptarët. Nga kuadri i psikozës antishqiptare nuk mund të nxirren as nderimet që i bëhen akademikut Vasa Çubrilloviç.

11. Tashmë është e qartë se ekziston marrëveshja serbo-maqedono-malazeze për një qëndrim të përbashkët ndaj shqiptarëve në Jugosllavi në mënyrë që t'iu tregohet vendi që u përket! Disa ide dhe masa që dëgjohen dhe propozohen në Serbi ndaj shqiptarëve, pas një kohe fare të shkurtër më parë ato zbatohen në Maqedoni.

1) Heqjet janë të redaksisë së revistës «Nin».

Në RS të Maqedonisë janë të cenuara rëndë të drejtat kombëtare të shqiptarëve.(..)

13. Ka më se 7 vjet, që shkrimtarët dhe shkencëtarët serbë migracionin e serbëve e të malazezëve nga Kosova e shpjegojnë me sintagmën politike «shpërngulje nën presion»! Ndërsa të rinjtë, që shkojnë për studime në universitetet e tjera të vendit, individët që punësohen jashtë Kosovës, kurse familjet i kanë në Kosovë, si dhe vajzat serbe dhe malazeze që martohen jashtë Kosovës, të gjithë konsiderohen si «të shpërngulur». Kështu, duke mos e shikuar drejt këtë çështje, përgjithësisht pranohen shpjegimet aktuale politike rreth migracionit në Kosovë, dhe kjo bëhet duke pasur gjithmonë parasysh qëllimet që dëshirohen të arrihen dhe jo e vërteta, së cilës duhet t'i shërbehet. (..)

14. Shkrimtarët dhe intelektualët serbë flasin zëshëm se serbët dhe malazezët në Kosovë janë të pabarabartë, kurse faktet dëshmojnë të kundërtën. Deri në vitet 70-të, në strukturën e të punësuarve në Kosovë shqiptarët merrnin pjesë me 52 për qind, edhe pse në strukturën e përbërjes kombëtare merrnin pjesë me mbi 74 për qind, ndërsa serbët përbënin 36 për qind, megjithëse në strukturën e popullsisë përbënin 23.6 për qind. Malazezët në strukturën e të punësuarve merrnin pjesë me 9.3 për qind, ndërsa në atë të popullsisë 2.5 për qind. Struktura e të punësuarve gjatë viteve 1985-1986 tregon se shqiptarët edhe më tutje janë larg mundësisë që të quhen të barabartë me serbët dhe malazezët, pa le më me maqedonasit. Në vitin 1986, bie fjala, në 1000 banorë të Kosovës kanë hyrë në punë 109 shqiptarë, 228 serbë dhe 258 malazezë, kurse pozita social-ekonomike e serbëve dhe e malazezëve është 2.5 herë më e mirë se e shqiptarëve dhe e të tjerëve në Kosovë.

15. Migrimet prej Kosove janë pasojë e shkaqeve ekonomike dhe e standartit të ulët, kurse serbëve dhe malazezëve po u krijohen kushte më të mira dhe privilegje të tjera, që ata të nxiten që të heqin dorë prej shpërnguljes dhe që të kthehen ata që duan. Atyre u sigurohen punësimi pa konkurs, banesa, punishte, troje për ndërtimin e shtëpive, kredi pa kamata apo me kamata minimale etj., në fshatra serbe futet ujësjellësi, ndërtohen

ambulanca, shtëpi kulture, biblioteka, diku edhe kopshte për fëmijë, fabrika.

16. Autonomia e Kosovës vitet e fundit në praktikë nuk funksionon dhe disa herë është pezulluar. Ndoshta pse konsiderohet se është krijuar mbi parimin etnik, kjo autonomi është treguar bimë e vogël, që e rrëzojnë edhe erërat më të lehta. Mbledhjet e qytetarëve serbë e malazezë në Fushë-Kosovë dhe vende të tjera të Kosovës — natyrisht me iniciativë nga Beogradi — vazhdojnë praktikisht ta pezullojnë autonominë.

*«Prilično instanjena autonomija»,
«NIN», Beograd, 8.5.1988*

Ali Aliu

FSHEHJA E SË VËRTETËS

— *Diskutim në takimin e shkrimtarëve serbë dhe kosovarë për temën: «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot». —*

T'ju kujtojmë se ç'pozitë kanë serbët në Kosovë. Për 200.000 banorë serbë ekzistojnë të gjitha institucionet e arsimit dhe të kulturës, ashtu siç ekzistojnë edhe për serbët e Serbisë së ngushtë: Universiteti, Akademia, Instituti, shtypi, Radiotelevizioni. Serbët punësohen në kushte më të favorshme sesa shqiptarët, çka do të thotë se kanë standard shumë më të lartë jetese, me përfaqësim më të madh në strukturat udhëheqëse, në administratë, në kulturë, në arsim, gjë që mund të shihet edhe në të dhënat statistikore. Në Kosovë punojnë me qindra klasa me 1 deri në 10 nxënës që ndjekin mësimet në gjuhën serbokroate, dhjetëra katedra me nga disa studentë, shpesh me më shumë profesorë sesa studentë. Kjo është në rregull. Natyrisht, në këtë e mbështesim, sepse për të qenë plotësisht e barabartë një pakicë e një populli në një mes, siç është yni, në duhet të bëjmë më shumë sakrifica. Këtë e kupton dhe e pranon Kosova me gjithë varfërinë e vet që ka.

A mund të parashtrojnë kërkesa të ngjashme shqiptarët jashtë Krahinës së Kosovës?

A mund të kërkojnë universitet shqiptarët në Maqedoni, edhe pse ata janë dy e më shumë herë më shumë në numër sesa serbët në Kosovë? A mund të kërkojnë ata që të jenë të pranishëm në Akademi, në Shoqatën e Shkrimtarëve, në jetën politike, në punësim në përputhje me numrin e banorëve (sipas të dhënave të vitit 1981, nga 450.000 të punësuar në Maqedoni, vetëm 29.000 janë shqiptarë)? Kërkesa të tilla eventuale janë të dënueshme. Ashtu siç dëgjojmë e lexojmë, atje për çdo ditë forumet e larta partiake kritikojnë organet udhëheqëse të komunave, në të cilat jetojnë shqiptarët, se nuk janë efikase në luftë kundër nacionalizmit shqiptar! Përkërisht këto ditë Komuna e Shkupit, ku jetojnë mbi 100.000 shqiptarë, por që u shpall qytet njëgjuhësor, u qortua për shpirtgjerësi ndaj shqiptarëve!

(...) Pyetje të tilla ka pa fund, por, po të bëhen, ato janë të rrezikshme. Përkundrazi, bëhen aq shumë kërkesa legale për reduktime të mëtejshme të të drejtave të tepërta, «që u janë dhënë shqiptarëve», e të cilët «janë burimi kryesor i të gjitha të këqijave në Jugosllavi», siç thuhet. Mbisundon ideja se Kushtetuta e vitit 1974 u ka dhënë shumë të drejta shqiptarëve, prandaj ajo është e keqe. Nuk janë të paktë ata që thonë se është indoktrinim edhe fakti që shqiptarët në Jugosllavi përdorin të njëjtën gjuhë si në Shqipëri, se kanë një histori, kulturë dhe letërsi të njëjtë, prandaj shqiptarëve në Jugosllavi duhet t'u çrrënjoset kjo vetëdije, se nga ne shqiptarët në Jugosllavi, duhet të harrohen udhëheqësit kombëtarë të së kaluarës, ndonëse udhëheqësit e popujve të tjerë mund të glorifikohen deri në shenjtëri dhe mund t'u përkujtohen përvjetorët në mënyrë madhështore.

Nuk di ndonjë rast tjetër, që nga të tjerët të shkruhet historia kombëtare e një populli tjetër. Pretendime të tilla, kur është fjala për shqiptarët, mund të shihen në reduktimin e historisë e të kulturës kombëtare në programet shkollore dhe në shtrembërimet e përditshme të historisë. Ky shkombëtarizim i kulturës, gjithsesi, çon në largimin nga qenia jonë kombëtare.

... Pasi u shpall e rrezikshme historia e shqiptarëve, vlerat shpirtërore dhe kulturore, letërsia, folklori, me-

losi etj., pasi u ngrit «Muri kinez» në mes shqiptarëve në Jugosllavi dhe atyre në shtetin mëmë, a nuk është e mundur që të dënohet çdo shqiptar, i cili di të lexojë apo dëshiron të dëgjojë meloditë e tij burimore? Mjafton që të gjendet një libër i botuar në shtetin mëmë dhe, në Maqedoni, Mal të Zi menjëherë të dënohesh. Mjafton që dikujt t'i gjendet shirit me muzikë të incizuar nga Radio-Tirana dhe ai të përfundojë në burg. Gjithmonë është i mundur dënimi i çdo intelektualit shqiptar, duke mos përjashtuar edhe pjesëmarrësit në këtë dialog që po zhvillohet këtu. Mjafton që të kontrollohet në bibliotekat personale (që nuk është praktikë e rrallë), në të cilat mund të gjenden vepra të botuara në Tiranë, që të formulohet akuza: i është gjetur literaturë me përmbajtje armiqësore!

Ky është vetëm një segment i jetës së përditshme të shqiptarëve. A nuk kemi të bëjmë këtu me shpatën e Damokleut kur thuhet: derisa të shpërngulet edhe një serb i vetëm nga Kosova, nuk ka shqiptarë të pafajshëm dhe nuk do të ketë paqe në Kosovë!?

Për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova nuk mbasehet evidencë. Mirëpo numri më i madh i shqiptarëve të shpërngulur jashtë shtetit është nga Maqedonia dhe Mali i Zi. Sipas raporteve të shtypit të përditshëm, vetëm dy-tri vitet e fundit, madje vetëm përmes lidhjes meksikane, nga disa vende të Malit të Zi, për në Amerikë kanë shkuar 1300 shqiptarë, kryesisht të rinj të papunë. Vetëm nga një qytezë, siç është Dibra, përmes kësaj lidhjeje dhe lidhjeve të tjera, nga Maqedonia janë shpërngulur rreth 2500 të rinj shqiptarë, shumica prej tyre me shkollë të mesme ose të lartë. Kështu ndodh edhe nëpër qytete të tjera të Maqedonisë. Është riaktivizuar edhe kanali për në Turqi, i cili në kohën e Rankoviçit përpiu mbi 300.000 shqiptarë pa të drejtë kthimi. Mbase, sipas marrëveshjes së vitit 1939, bazuar në Elaboratin e Çubrilloviçit, i cili nuk guxohet as të përmendet.

Sipas të dhënave të fundit bëhet e ditur se me dhjetëra mijëra shqiptarë gjenden nëpër vende të ndryshme të Jugosllavisë, duke u marrë me punë të rënda fizike, për të cilat të tjerët nuk janë të interesuar.

Një ndër kërkesat e shqiptarëve në komunikimin e

përditshëm është që ata të kenë të drejtë të barabartë për përdorimin e gjuhës shqipe. Jo rrallë është shpallur si kërkesë nacionaliste e drejta për të folur në gjuhën amtare, kur salla ka qenë e mbushur plot me shqiptarë dhe vetëm me disa serbë. Nuk kërkohet nga serbët që të flasin gjuhën shqipe, sepse shqiptarët e kuptojnë dhe e respektojnë gjuhën e tjetrit. Mirëpo, edhe pas kërkesës themelore, që bile të sigurohet mundësia e përdorimit të dy gjuhëve, jepet alarmi se gjoja po diskriminohet gjuha serbe.

Në kohën tonë informacioni ka një rëndësi të dorës së parë. Në të vërtetë ai që e ka monopol këtë fushë, dikton të gjitha kushtet e sjelljes dhe të luftës. Më lejon, pra, të përdor edhe ndonjë shembull në këtë drejtim. Kohë më parë patëm rastin të lexojmë lajmin e TANJUG-ut për 400 nxënësit shqiptarë të çregjistruar dhe të përjashtuar nga shkollat e mesme në Kumanovë. Prej tyre 250 u regjistruan në shkollat e Kosovës, ndërsa për të tjerët nuk dihet asnjë gjurmë. Informatat flasin se si ata paskan kërkuar klasa etnikisht të pastra, prandaj edhe u gjykua ky rast si veprim nationalist. Ata duhet të jenë të kënaqur vetëm me këtë klasifikim, po shtoj unë si lexues i këtyre informatave. Kur nga ana e shqiptarëve kërkohet që të zbatohet kjo e drejtë e garantuar në Kushtetutë, ajo dënohet menjëherë. Gjithashtu edhe kërkesa për përdorimin e gjuhës amtare, për shkolllimin në gjuhë amtare, për punësimin — gjithë veprimtaria e shqiptarëve mund të shpallet e rrezikshme për Jugosllavinë.

Merreni rastin e Martinoviçit. Asnjë raport profesionist për vlerësimin e ngjarjes dhe veprës së tij nuk ndihmoi. Edhe sëmundja e tij duhej të inkuadrohej në fushatën antishqiptare. Prandaj rasti i Martinoviçit u ngrit në nivelin e një të shenjtë. Megjithëse i degraduar deri në fund, ai u bë personazh pozitiv nëpër libra, në piktura, në Akademi, dhe ja, më në fund, këto ditë, edhe në film.

«Prikriwanje istine», «NIN»,
Beograd, 15.5.1988

Ibrahim Rugova

STRATEGJIA ANTISHQIPTARE

— *Diskutim në takimin e shkrimtarëve serbë dhe kosovarë për temën: «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot» —*

Këta shtatë vjetët e fundit janë krijuar disa etiketa të hekurta, të cilat shërbejnë si mekanizëm i një strategjie të fshehtë negative, siç janë: nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar, separatizmi shqiptar, kundërrevolucionari, genocidi, fashistizimi, albanofobia, albanizimi, heshtja e inteligjencies shqiptare, arbitrariteti, paligjshmëria, shpërthimi i lindjeve dhe plot e përplot të tjera. Në anën tjetër, krahas këtyre etiketave, përdoren termat si shpërngulja e serbëve dhe malazezëve, drama kosovare, tragjedia kosovare, egzodi serb, dhunimet, zjarret, zullumet dhe të tjera. Këta terma bëhen etiketa të reja edhe më të fuqishme.

Nëse e shikojmë me kujdes këtë sistem të etiketave, mund të vërejmë se fjala është për të njëjtin problem, pra, për strategjinë antishqiptare, të cilën po e udhëheqin prej 7 vjetësh një pjesë e shtypit, mandej insitucionet e kulturës e të shkencës dhe shoqata të tjera të Beogradit. Në sistemin e parë të etiketave prin sllogani nacionalizëm apo separatizëm shqiptar, ndërsa në të dytin sllogani shpërngulja e serbëve dhe e malazezëve, të

cilat e mbulojnë gjithë situatën në Kosovë. Me sistemin e parë të etiketimeve sulmohet direkt populli shqiptar, kurse me të dytin — në emër të viktimës dhe mbrojtjes së saj, akuzohet dhe sulmohet gjithashtu i njëjti popull. Sidoqoftë, të dy sistemet e etiketave kanë të njëjtin qëllim. Kjo strategji antishqiptare e borgjezisë serbe të fundit të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli është pasuruar në kushtet e reja. Tani ajo mbështetet edhe në konceptet e socializmit shtetëror dhe deformimet e sigurimit të shtetit të dënuara më parë. Pra, kemi gjallërimin e logjikës së UDB-së të viteve 50-të dhe 60-të ndaj shqiptarëve.

Nga kjo strategji e fshehur negative, në planin historik dhe aktual, po veçojmë vetëm disa momente, të cilat po shmangin thelbin e së sotmes. Në aspektin historik deri në maksimum janë shfrytëzuar shkenca borgjeze serbe, duke lansuar tezën se shqiptarët nuk kanë historinë e tyre, duke diskualifikuar origjinën e tyre, dhe këto shërbejnë për mohimin e shqiptarëve si popull në kuadrin evropian. Kështu, shqiptarëve u mohohet edhe e drejta për të sotmen.

Në bazë të rezultateve shkencore, të pranura sot edhe nga shkenca evropiane, dihet se shqiptarët janë pardshtësit e drejtpërdrejtë të ilirëve antikë. Kjo do të thotë se populli shqiptar është fqinji më i vjetër i grekëve dhe romakëve të vjetër, me të cilët edhe sot jeton në fqinjësi. Elementi iliro-shqiptar ishte dhe mbeti nëpër shekuj edhe në Kosovë. Këto janë fakte shkencore, të cilat dikush dëshiron t'i politizojë në emër të luftës kundër nacionalizmit shqiptar, që në të vërtetë është luftë kundër popullit shqiptar. Gjatë gjithë Mesjetës shqiptarët qenë element i rëndësishëm në Kosovë, gjë që vërtetohet nga të gjitha burimet dhe studimet shkencore. Po përmendim vetëm një të dhënë: shkrimtari i vjetër shqiptar, nga rrethina e Prizrenit, Pjetër Bogdani, në parathënien e librit të tij «Çeta e profetëve» (1685), shkruan se librin e tij ia kushton popullit të vet, i cili në Kosovë është shumicë dhe flet gjuhën shqipe.

(...) Strategjinë negative antishqiptare mund ta shohim edhe më mirë në çështjet aktuale... Në prag të Çlirimit, kur shumica ishin të bindur se do të dalë fi-

timtare shoqëria dhe bota e re, siç flitej atëhere, ndodhën ndërlikime të tjera që i shkaktuan organet e Sigurimit Shtetëror. Për t'i mbajtur shqiptarët përgjithmonë nën mbikëqyrje, ato filluan të zbatojnë strategjinë e paraluftës kundër tyre. Kjo strategji kulmin e arriti me grumbullimin e armëve, gjatë të cilit pati edhe raste vdekjesh dhe e pësuan mbi 60.000 shqiptarë. Në atë periudhë u aktivizua edhe teza që shqiptarët të shpërnguleshin në Turqi. Në këtë rast u shfrytëzua edhe Konventa ballkanike mes Jugosllavisë dhe Turqisë dhe shteteve të tjera ballkanike për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova. Sipas statistikave jo të plota, u shpërngulën mbi 300 000 shqiptarë. Filloi edhe fushata kundër inteligjencies shqiptare. Këtyre tezave iu shtua edhe teza tjetër mbi prapambetjen ekonomike të Kosovës, si premisë për presion ekonomik mbi shqiptarët që ta braktisnin Kosovën, pra, si një ndër format më të padëgjua, përmes së cilës dëshirohej të hiqnin qafe elementin shqiptar.

Pas vitit 1966, kur u demaskua disi kjo strategji e fshehur e Sigurimit të Shtetit, serbët dhe malazezët, të cilët dikur bënë ligjin, nuk deshën të hyjnë në rrjedhat e reja të zhvillimit, sepse kishin humbur privilegjet. Ata nuk i pranojnë situatat e reja. Si kundërpeshë u ringjall propaganda e udbashëve të rënë me fushatën që të ndalohet emigrimi i serbëve dhe malazezëve nën etiketën shpërngulje dhe kjo u shndërrua në një çështje të përgjithshme shtetërore. Kjo propagandë ishte njëra anë e strategjisë së fshehtë antishqiptare...

Opinionit jugosllav dhe njerëzit me përgjegjësi duhet ta kuptojnë një herë e mirë se kështu nuk mund të veprohohet ndaj një populli.

*«Antialbanska strategija», «NIN»,
Beograd, 8.5.1988*

Dr. Agim Vinca

EDHE INCESTI MUNGONTE

— Në përgjigje të shkrimit «Gruaja shqiptare pas mureve të larta», «NIN», N. 1971 —

Duke u përfshirë në fushatën antishqiptare, e cila tashmë prej vitesh po zhvillohet në faqet e disa gazetave, poetesha nga Novi Sadi me kombësi rumune, Florika Shtefan, zbulon në faqet e «NIN»-it një detaj deri tani të panjohur: incestin, i cili, sipas saj, jo vetëm që ekziston, por gjoja na qenka një dukuri e përgjithshme te shqiptarët! Dhe gjoja e gjithë kjo qenka në shërbim të qëllimeve separatiste! Kështu, kjo poeteshë bilinguale, F. Sh., me guxim dhe me vendosmëri, pa asnjë lëkundje dhe pa pikë delikatese, bën zhvirgjërimin e një teme deri tani të paprekur e delikate, të një teme tabu: problemi i incestit të shqiptarëve! Me urdhër të irredentës kjo «fabrikë riprodhuese» punon dhe punon pa ndërprerje, me qëllimin e qartë që të realizojë sa më parë objektivin — krijimin e një Kosove «etnikisht të pastër» dhe realizimin e ëndrrave të «Shqipërisë së madhe». Kështu, brutalisht dhe thjesht, me një mënyrë të politizuar banale, F. Sh. shpjegon problemin e lindshmërisë së lartë në Kosovë, pra te shqiptarët, që para së gjithash është pasojë e prapambetjes ekonomike (dhe kulturore), të moszhvillimit dhe të papunësisë, si dhe të traditës, mentalitetit etj.

Femra shqiptare në Kosovë, megjithatë, nuk është vetëm ajo «pas mureve të larta», por edhe ajo që shkollohet, studion, punon, ecën me hapin e kohës, ndjek modën, etj. Femra shqiptare në Kosovë është edhe ajo, që, pas mbarimit të shkollës së mesme e të lartë (të fakultetit), pret vite me radhë në zyrat e punës. Midis tyre ka edhe nga ato që nuk e pranojnë më statusin e «fabrikës së prodhimit të fëmijëve», as forma të tjera të manipulimit e të fyerjes, që rrjedhin nga «jeta fisnore». Që të përforcojë «lezën» e vet për shqiptarët si një popull primitiv e pa kulturë, Florika Shtefan sjell dy shembuj, që i merr nga të tjerët dhe të cilët i shtjellon pa mjesh-tëri.

Shembulli i parë ka të bëjë me një shqiptare të re, e cila një avokati të njohur, mik i Florikës, i kërkoi zgjidhjen e martesës për shkak të «impotencës së bashkëshortit» dhe, kur bëhet e qartë se divorci mund të arrihet, në skenë del vjehrrin, i cili përpiket ta pengojë atë, që gjithçka të mbesë brenda rrethit familjar, sepse «ai ka edhe djem të tjerë» dhe se, në fund të fundit, edhe ai është atje.

Nuk është e vështirë të vihet re se në këtë rast (në këtë histori pa frymëzim), poetesha F. Sh. nuk është shumë origjinale, sepse, siç duket, ka kopjuar nga «Gjaku i papastër»¹.

Shembulli i dytë është disi ndryshe, sigurisht përshtypjelënës, si në historitë patologjike porno-kriminalistike. Sipas Florika Shtefanit, një miku i saj, që ka punuar si profesor në një shkollë të mesme diku në bregdetin e Malit të Zi, gjoja i paska treguar për një vajzë shqiptare, maturante, e cila, një-dy muaj para provimeve të maturës nuk mund ta fshihte më «shtatzaninë e saj». Kur profesoresha, kujdestarja e klasës, u përpoq që ta ndihmonte nxënësen e vet «me qëllim që të mësonte se kush ishte babai dhe eventualisht ta ndihmonte në lidhjen e martesës me të riun e panjohur», kjo vajzë, maturante shqiptare, fare thjesht e me gjakftohtësi, sikur nuk kishte ndodhur asgjë, pranoi se «nuk e dinte se kush

1) «Gjaku i papastër», roman i shkrimtarit serb Borisav Stankoviç (1876-1927), botuar më 1910. Botimi i katërt më 1987.

mund të ishte babai i fëmijës së ardhshme: ndoshta vëllai ose ndonjë prej xhaxhallarëve... Me të dy ka pasur marrëdhënie seksuale»!?

Dihet se incesti (marrëdhëniet seksuale midis pjesëtarëve të një familjeje) ose, siç thuhet në popull, gjakprishja, është një problem i ndërlikuar psikologjik, sociologjik, madje seksual, i cili duke qenë i tillë, është i pranishëm te të gjithë popujt e në të gjitha mjediset, ndërsa te shqiptarët ndoshta më pak se te të tjerët. Por ku e merr dikushi të drejtën morale që nga rastet e veçanta, më shumë të trilluara sesa të vërteta, të nxjerrë konkluzionin se femra shqiptare «që në fëmijëri mësohet të jetë objekt seksual brenda familjes»?

Kushdo që i njeh sadopak shqiptarët, karakterin dhe mentalitetin e tyre, psikologjinë dhe etikën e tyre, zakonet e tyre, bindet se kjo nuk është e vërtetë.

Lind pyetja: ç'e ka shtyrë poeteshën F. Sh. që historinë për një vajzë shqiptare, që gjoja ka marrëdhënie seksuale me vëllanë e vet, e madje edhe me njërin prej xhaxhallarëve, ta botojë në gazeta? Përse e bën ajo këtë dhe përse gjërave të tilla të ulëta u jepet vend edhe në organe të tilla siç është «NIN»-i? Qëllimi është i qartë: shqiptarët duhet të paraqiten si një popull pa asnjë vlerë njerëzore dhe morale, ata duhet të paraqiten të shëmtuar në çdo drejtim. Sikur nuk mjaftojnë gjithë ato akuza të natyrës politike, siç janë nacionalizmi, separatizmi, dhuna ndaj popujve të tjerë, etj., atyre u duhet veshur edhe një mëkat tjetër i natyrës psikologjike, incesti! Të privuar nga vlerat politike, shqiptarëve u duhen mohuar edhe vlerat morale! E gjithë kjo në shërbim të politikës së përditshme.

*«Još i incesti!», «NIN»,
Beograd, 30.10.1988*

Rexhep Qosja

ROJAT E MJEGULLËS

— *Intervistë dhënë gazetarit Zhelko Kardum të gazetës
«Studentski List» —*

Zh. K.: Biseda midis shkrimtarëve serbë e shqiptarë për temën «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot», që u zhvillua këtë vit në Beograd, duhej të vazhdonte në Prishtinë. Përse nuk vazhdoi?

R. Q.: Në bisedat me shkrimtarët serbë në Beograd, temën e të cilave «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot» e kanë formuluar ata vetë, shkrimtarët shqiptarë pak a shumë folën më lirisht për marrëdhëniet midis serbëve e shqiptarëve në Jugosllavi sot, pra, paraqitën pikëpamjet e tyre për gjendjen e sotme në Kosovë. Si referatat e përgatitura, ashtu edhe reagimet e shkrimtarëve serbë ndaj diskutimeve të kolegëve shqiptarë qenë të forta, madje ndonjëherë edhe të ashpra — që të mos përmend ndonjë rast fyes — sepse nuk është zakon, të paktën në traditën shqiptare, që miqtë të priten në këtë mënyrë. Shkrimtarët shqiptarë dëshironin që bisedat të vazhdonin në Prishtinë, dhe kjo jo vetëm sepse kështu ishte rënë dakord, por edhe sepse bisedat në Beograd nuk përfunduan dhe temës, për të cilën u diskutua, nuk iu hy thellë. Në qoftë se në Beograd u fol se si kanë qenë dhe si janë sot marrëdhëniet midis serbëve e shqiptarëve, në Prishtinë kishim për qëllim të flisnim lidhur me atë

se si duhet të jenë marrëdhëniet midis dy kombeve tona sipas konceptimit tonë, se çfarë duhet bërë që të zhvillohet e të forcohet mirëkuptimi, respekti dhe miqësia midis tyre. Donim që shkrimtarët serbë t'i prisnim sa më mirë në Prishtinë, duke e ndier këtë si detyrë, si trashëgimtarë shpirtërorë të gjigantëve dhe humanistëve të tillë si Jeronim de Rada, Naim Frashëri dhe Fan Noli, e duke mos humbur shpresën se edhe midis shkrimtarëve serbë mund të gjenden trashëgimtarë shpirtërorë të gjigantëve të tillë, siç kanë qenë Dositej, Svetozar Markoviçi ose Dimitrije Tucoviçi. Burokracia politike e Kosovës, megjithatë, e këshilloi udhëheqjen e organizatës së shkrimtarëve që bisedat të shtyheshin, pra, me fjalë të tjera, të ndërpriteshin, dhe burokracisë politike të Kosovës ky sugjerim i erdhi nga Beogradi. Përse u pengua zhvillimi i mëtejshëm i bisedave midis shkrimtarëve serbë e shqiptarë? Ndoshta për arsye se elita politike dhe intelektuale serbe dëshiron të ruajë monopolin e së vërtetës serbe për Kosovën, ndërsa burokracia politike shqiptare, që të ruajë me çdo kusht qëndrimin e vet në pushtet, këtë të vërtetë po e përsërit prej vitesh, megjithëse pothuajse çdo njëri në Jugosllavi e ka të qartë se kjo e vërtetë është e imponuar.

Zh. K.: Përse heshtin intelektualët shqiptarë?

R. Q.: Kjo pyetje është bërë në shumë mjedise në Jugosllavi, megjithëse besohet se pjesa më e madhe e atyre që bëjnë këtë pyetje e dinë edhe përgjigjen për të. Megjithatë, jo të gjithë intelektualët shqiptarë heshtin, ata kurrë nuk kanë heshtur, por, siç duket, heshtin ata që këtë pyetje e bëjnë më shpesh, ndoshta sepse nuk dëgjojnë atë që do të donin të dëgjonin. Ndërsa ata që heshtin midis intelektualëve shqiptarë besoj se heshtin sepse nuk mund të thonë të vërtetën...

Pas vitit 1981 intelektualëve shqiptarë të brezit të ri u ra në sy se intelektualët e brezit më të vjetër, ata mbi moshën 60 vjeç, megjithëse të tillë nuk ka shumë, sillëshin në një mënyrë të çuditshme. Këta «baballarë të kulturës sonë», siç i quajnë ata intelektualët më të rinj, menjëherë filluan të përsërisin fraza burokratike për Kosovën, të cilat shpejt u shndërruan në një refren-jehonë në mbarë Jugosllavinë, e më pas e mbyllën gojën. Përse?

Në qoftë se lëmë mënjanë disa individë, midis tyre disa, të cilët prej kohësh, për shkak të pozitës në institucionet arsimore, shkencore e kulturore, kanë humbur integritetin dhe pavarësinë intelektuale, të tjerët u sollën kështu sepse u frikësuan tmerrësisht. Vumë re se u frikësuan kaq shumë jo sepse janë të moshuar, pasi forca morale nuk humbet me kalimin e viteve, por sepse kishin një përvojë të rëndë në jetë. Ata dinin shumë më tepër nga intelektualët më të rinj ose të brezit të mesëm. Ata e dinin se si ka qenë jeta e shqiptarëve në mbretërinë e Jugosllavisë. Ata e dinin se ç'do të thotë administratë ushtarake — për të cilën u fol shpesh në vitin 1981 — pasi e kishin përjetuar në vitin 1945. Ata e dinin përse u organizua i ashtuquajtur i procesi gjyqësor i Prizrenit, në të cilin duhej të akuzohej dhe t'i pritej koka udhëheqjes politike shqiptare të Kosovës. Ata e dinin se si dhe përse shumë shqiptarë ras Luftës u regjistruan si turq, pra se si pas Luftës vërshoi shpërngulja e tyre për në Turqi. Ata kanë përjetuar edhe të ashtuquajturin aksion për grumbullimin e armëve në Kosovë dhe në zona të tjera ku jetonin shqiptarë. Jeta në këtë hapësirë të Ballkanit u ka mësuar atyre që të përsërisnin atë që thoshin autoritetet, pra duhet të përsërisnin atë që u thuhej dhe pastaj të heshtnin. Ja, këta baballarë të kulturës shqiptare (disa prej tyre baballarë të kulturës shqiptare në Kosovë) kanë humbur shumë nga autoriteti i tyre tek intelektualët e brezit më të ri dhe te populli për shkak të këtyre qëndrimeve, por ata për shkak të kësaj janë shpërblyer mirë: mund të flenë të qetë!

Zh. K.: Përse një numër shkrimtarësh serbë dhe malazezë janë larguar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës?

R. Q.: Me sa di unë, tre shkrimtarë nga radhët e serbëve dhe të malazezëve kanë paraqitur dorëheqje si anëtarë të Kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, ndërsa një shkrimtar i kombësisë serbe është larguar nga organizata e shkrimtarëve. Unë nuk jam as anëtar i Kryesisë, as anëtar i Kuvendit të Shoqatës së Shkrimtarëve për të ditur se si qëndrojnë punët... Megjithatë, di se edhe në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, si edhe në të gjitha shoqatat e tjera të shkrimtarëve

ve në vend, zhvillohet një garë rreth manifestimeve letrare, udhëtimeve jashtë shtetit dhe marrjes së çmimeve. Di se në këto manifestime letrare dhe jashtë shtetit, në shumicën e rasteve shkojnë të njëjtët shkrimtarë serbë, shqiptarë, malazezë, ndoshta edhe turq. Di se edhe nëpër juritë zgjidhen të njëjtët njerëz, të njëjtët shkrimtarë, të njëjtët përkthyes, të njëjtët gjysmëshkrimtarë nga radhët e shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve — kryesisht ata, me të cilët manipulohet më lehtë nga ana e strukturave politike, të cilët për shpërblimet vendosin ekskluzivisht mbi bazën e konformitetit politik, pra, pa u bazuar në vlerën e veprës së autorit. Dhe këto fërkime të burokracisë letrare rreth manifestimeve letrare, çmimeve dhe udhëtimeve jashtë nuk janë të rëndësishme për asnjë dhe askujt nuk i interesojnë më. Shkrimtarët e vërtetë e ndiejnë se tani nuk është koha e çmimeve. Shkrimtarët serbë dhe malazezë që janë larguar nga Kryesia e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, në fakt, i përkasin pikërisht kësaj burokracie serbo-shqiptaromalazeze. E njëri prej tyre deri dje ka qenë kryetar në dy mandate i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Sidoqoftë, shkrimtarët serbë dhe malazezë që tani janë larguar nga Kryesia, pra, që kanë ikur nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, e bënë këtë për të njëjtat arsye, mbi bazën e të cilave në vitin 1985 u shkrua letra e 40 shkrimtarëve të kombësisë serbe dhe malazeze: në mënyrë që, brenda mundësive të tyre letrare, të ndihmonin ofensivën propagandistike në Serbi, qëllimi i së cilës ishte që fati kushtetues i Kosovës, në fund të fundit, edhe i Jugosllavisë, të përcaktohej sipas masës serbe. Me largimin e tyre nga Kryesia, pra nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, kolegët serbë dhe malazezë, po ashtu si dhe nënshkruesit e letrës në vitin 1985, në fakt, duan të «konfirmojnë» atë që po bëjnë me kaq këmbëngulje individë dhe grupe në Serbi prej më se shtatë vjetësh: se gjoja shqiptarët janë të prirur për të shpërdoruar pushtetin, prandaj atyre u duhet marrë ky pushtet, se për këtë shkaku autonomia e tyre duhet të reduktohet në autonomi kulturore! Në qoftë se disa nga shkrimtarët serbë e malazezë nga Kosova mbajnë fjalime në të ashtuquajturat mitingje të solidaritetit, ku në radhët e para ndo-

dhen priftërinjtë, ku dëgjohen thirrje «Duam armë!», «Vdekje shqiptarëve!», ku mbahen parulla: «Le ta vrasë zoti murtajën», «Do t'i vrasim» ose «SSSS»¹ ose «Nuk e japim mbretërinë e Dushanit!», domethënë, në qoftë se në mitingje të tilla marrin pjesë kaq aktivisht shkrimtarë serbë e malazezë, atëherë çfarë mund të bëjnë shkrimtarët e tjerë serbë e malazezë, që nuk marrin pjesë në to, për të mos u likuiduar moralisht? — Largohen nga Kryesia, pra nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës! Por, për fat të keq, nuk është hera e parë që kolegët tanë serbë dhe malazezë tregojnë se nuk janë të gatshëm të pranojnë barazinë e shqiptarëve.

Zh. K.: Ç'mendoni lidhur me kërkesën e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë për shpërndarjen e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës pasi është bërë etnikisht e pastër?

R.Q.: Së pari, nuk kam dijeni që Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë të ketë kërkuar shpërndarjen e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për arsye se gjoja është bërë etnikisht e pastër, por këtë e kanë kërkuar disa individë nga ajo Shoqatë në diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e Shoqatës. Së dyti, në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, krahas serbëve dhe malazezëve, ka edhe shkrimtarë me kombësi turke, myslimanë e rome — që do të thotë se nuk mund të jetë një Shoqatë etnikisht shqiptare. Së treti, nëse u larguan katër shkrimtarë me kombësi serbe e malazeze nga Kryesia, pra nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, nuk do të thotë se u larguan të gjithë shkrimtarët e kombësisë serbe e malazeze. Në Shoqatën e Shkrimtarëve të Serbisë ka individë që i përmbahen me këmbëngulje parullës anarkike të Bakuninit: «Sa më keq që të jetë, aq më mirë për ne»! Nuk është hera e parë që ndeshemi me vizionet e tyre vrerëvjellëse për Kosovën. Shpresojmë që këto vizione të jenë çështje e tyre private, në mënyrë që në mendimin e sotëm politik për Kosovën dhe shqiptarët, në fund të fundit, të triumfojnë arsyeja, e vërteta dhe drejtësia...

1) «SSSS» — Sama Siloga Spase Srbe — Vetëm bashkimi i shpëton serbët.

Zh. K.: A do të vini në Kuvendin e shkrimtarëve të Jugosllavisë në Dojran?

R. Q.: Nuk jam ftuar.

Zh. K.: Në numrin e fundit të «Danasit» është botuar letra e Shoqatës së Kineastëve të Serbisë me firmën e kryetarit Purisha Gjorgjeviç, ku thuhet se i keni sulmuar pa të drejtë, duke qenë se filmin «Rojat e mjegullës», realizuar sipas romanit tuaj, as nuk e kanë parë.

R. Q.: Artikulli im «Gjykime pa precedencë» botuar në numrin e kaluar të «Danas-it» nuk ka të bëjë me Shoqatën e Kineastëve të Serbisë. Në atë artikull polemizohet me artikujt dhe deklaratat e atyre kineastëve, regjisorëve, aktorëve, profesorëve serbë të Fakultetit të Artit Dramatik në Beograd, si dhe të atyre gazetarëve serbë, të cilët filmin «Rojat e mjegullës» e kanë gjykuar me pseudoargumente politike, të padëgjuaara deri tani në jetën kulturore të Jugosllavisë. Edhe emrat e tyre janë përmendur në artikullin tim. Ndoshta shumica e tyre janë anëtarë të Shoqatës së Kineastëve të Serbisë. Në qoftë se ata do të qëllonjë me topa të tillë politikë edhe filmat e kolegëve të tyre serbë, kroatë, sllovenë etj, atëherë filmin jugosllav e presin ditë të zeza. Por, megjithatë, shpresoj se nuk do të ndodhë kështu, pasi në këtë rast Shoqata e Kineastëve të Serbisë me siguri do të distancohej nga poetika e tyre politike. Por, me sa duket, Shoqata e Kineastëve të Serbisë nuk është gati të distancohet prej tyre, përderisa qëllon me topa të tillë filmin e kolegëve shqiptarë. E ç'mund të presësh tjetër! Në Serbi edhe shkenca shqiptare, edhe arti shqiptar, edhe filmi shqiptar, pra, gjithçka që është shqiptare, edhe liria e barazia e shqiptarëve, shihen nga një këndvështrim i veçantë, vlerësohen sipas kritereve të veçanta. Kritere të tilla mund të përbëjnë edhe politikën (por në të ardhmen e tyre nuk mund të kesh kurrsesi besim), por në asnjë mënyrë nuk mund të përbëjnë një moral dinjitoz intelektual. Po pres me padurim ç'do të thotë Shoqata e Kineastëve të Serbisë për filmin «Rojat e mjegullës», kur të shihet filmi. Ndoshta do të distancohet nga fushata që kanë ndërmarrë disa anëtarë të saj.

Zh. K.: A u nënshtrohen vallë shkrimtarët shqiptarë në Kosovë kritereve të tjera në krahasim me kolegët e tyre në vend?

R. Q.: Ndaj krijimtarisë shpirtërore shqiptare në Kosovë, natyrisht, ekziston një censurë jozyrtare në dy nivele. Burokracia politike shqiptare, kryesisht nëpërmjet burokracisë kulturore, fshin nga krijimtaria shpirtërore shqiptare atë që, për një arsye ose tjetër, i duket e palejueshme — që është niveli i parë i censurës. Burokracia politike shqiptare, përsëri nëpërmjet burokracisë kulturore, fshin nga krijimtaria shpirtërore shqiptare edhe atë që, për një arsye ose tjetër, është e palejueshme për burokracinë politike e kulturore serbe — që përbën nivelin e dytë të censurës. Vetëm po të kihet parasysh këto dy nivele të censurës në veprimtarinë shpirtërore shqiptare, mund të kuptohen deri ku arrijnë kufizimet në këtë krijimtari. Ja, p.sh. shkrimet që disa intelektualë shqiptarë kanë botuar vitet e fundit në gazetatat e revistat në pjesë të tjera të vendit, nuk mund të botohen kurrsesi në Prishtinë. Pse? Sepse burokracia kulturore shqiptare, të cilën e përbëjnë disa individë të zgjedhur sipas kriterëve të servilizmit e aspak të aftësive, ka frikë se mos burokracia politike e Kosovës e qorton atë për këtë, ndërsa burokracia politike e Kosovës ka frikë se mos burokracia politike e Beogradit i heq asaj vërejtjen për këtë.

Zh. K.: Artikujt tuaj të botuar në «Dello» dhe «Danas» kanë shkaktuar reagime të bujshme në Maqedoni dhe Serbi. Çfarë ka problematike në to?

R.Q.: Në Maqedoni, vitet e fundit, ka nisur një proces i hapur i mohimit të të drejtave të shqiptarëve. Autoritetet maqedone u ndalojnë shqiptarëve që të shkruajnë dhe të shqiptojnë toponimet maqedone në gjuhën shqipe, ashtu siç i kanë shqiptuar dhe shkruar prej shekujsh, që fëmijëve të tyre të porsalindur t'u vënë emra nga thesari kombëtar historik, kulturor e gjuhësor, siç kanë bërë e bëjnë edhe tani lirisht në Serbi dhe në Mal të Zi, që të këndojnë lirisht një numër këngësh popullore, që sot e kësaj dite këndohen në Serbi e Mal të Zi, që të shpërngulen lirisht në disa zona dhe të vendosen lirisht në disa qytete të Maqedonisë, që të vendosin lirisht për numrin e fëmijëve që do të lindin e do të rrisin (në komunën e Tetovës), që t'i shkruajnë lirisht tabelat në dyqanet e tyre dhe në gjuhën e tyre kombëtare! Vetëm për shqiptarët e Maqedonisë u shpik prishja e mureve rre-

thuese të shtëpive, megjithëse ato janë pjesë përbërëse e traditës kulturore shqiptare. Paraqitja e këtyre të vërtetave të dhimbshme ka shkaktuar reagime në Maqedoni, ndërsa në Serbi këto shkrime kanë shkaktuar reagime të bujshme, sepse në to provohet ajo që u dëshmuar edhe me fushatën kundër filmit «Rojat e mjegullës»: se krijuesit shqiptarë nuk janë në pozitë të barabartë me kolegët e tyre në pjesë të tjera të Jugosllavisë jo vetëm sepse mbi krijimtarinë e tyre ushtrohet kontroll i gjerrë, por edhe sepse atyre nuk u lejohet bashkëpunimi shkencor e kulturor me Shqipërinë.

Zh. K.: Çfarë mendoni për demonstratën e nxënësve shqiptarë në Kumanovë?

R. Q.: Vitin e kaluar në Maqedoni filloi procesi i heqjes së arsimit të mesëm në gjuhën shqipe. Në shumë mjedise të kësaj republike janë krijuar të ashtuquajturat klasa paralele të përbashkëta, ku mësimi jepet në gjuhën maqedone, e ndërkohë në të bëjnë pjesë edhe nxënës shqiptarë e turq. Vitin e kaluar kjo vlente vetëm për nxënësit e kombësive shqiptare e turke të klasave të treta e të katërta. Në pamundësi për të marrë mësim në gjuhën amtare shumë nxënës të kombësisë shqiptare të klasave të treta e të katërta të arsimit profesional u sulën drejt Kaçanikut, Gjilanit, Preshevës, madje dhe Prishtinës. Por shkollat atje nuk kishin kapacitetet e mjaftueshme për të gjithë të interesuarit, ndërsa autoritetet maqedone ndërhyjnë që ata të mos i pranohin! Këtë vit klasat paralele të përbashkëta në gjuhën maqedone u bënë e vetmja mundësi e shkollimit edhe për nxënësit shqiptarë e turq të vitit të parë e të dytë të arsimit profesional. Për heqjen e mësimdhënies në gjuhën shqipe autoritetet maqedone në fillim dhanë shpjegimin se nuk mund të ketë klasa «etnikisht të pastra» shqiptare, pasi nxënësit që mbarojnë shkollat e mesme në këtë gjuhë, nuk do të mund të zënë punë, meqenëse nuk do të dinë maqedonisht! Se si kanë mundur deri tani të mësojnë në gjuhën shqipe dhe si kanë ditur edhe gjuhën maqedone, e, megjithatë, nuk kanë mundur të futen në punë — këtyre pyetjeve autoritetet maqedonase as që e kanë marrë mundimin t'u përgjigjen. Këtë vit kërkesave të shqiptarëve të komunës së Kumanovës që fëmijëve të tyre t'u jepet

e drejta kushtetuese e shkollimit në gjuhën amtare, autoritetet maqedone iu përgjigjën disi ndryshe: nuk ka kuadër arsimor për zhvillimin e mësimit në gjuhën shqipe! Po ku humbën mësuesit shqiptarë që deri vjet jepnin mësime në gjuhën shqipe! Autoritetet maqedonase as që deshën të përgjigjeshin. Ç'u mbetej tjetër atëherë nxënësve shqiptarë dhe prindërve të tyre në Kumanovë veçse t'i bënin të ditur opinionit publik jugosllav duke u grumbulluar në qytet, në Kumanovë, se burokracia maqedonase u mohon një të drejtë që ua garanton Kushtetuta e RSFJ-së. Por oligarkia sunduese maqedonase nxitoi të shuante çdo zë tjetër të shqiptarëve, me të cilin ata kërkuan të drejtat e tyre: grumbullimin plotësisht të ligjshëm të nxënësve dhe prindërve të tyre, që thërrisnin: «Jugosllavi, na shpëto», ajo e shpalli kundërrevolucion! Shihni tani, ju lutem! Autoritetet maqedonase quajnë progresive dhe revolucionare grumbullimet e serbëve e të malazezëve në Kosovë dhe të ashtuquajturat mitingje solidariteti me ta nëpër Serbi dhe Mal të Zi, ndërsa në Maqedoni shpallin kundërrevolucion grumbullimin e ligjshëm të nxënësve shqiptarë dhe të prindërve të tyre, në të cilin ata kërkojnë të drejtën e garantuar me kushtetutë të RSFJ-së për shkollim në gjuhën kombëtare! Në Maqedoni priten me buzëqeshje e ngrohtësi të madhe anëtarët e «qeverisë» jokushtetuese të serbëve dhe malazezëve nga Kosova, të cilët shtrojnë kërkesa jokushtetuese dhe lëshojnë parulla luftënxitëse. Ndërkohë në Maqedoni presin me shkopinj gome nxënësit shqiptarë dhe prindërit e tyre që kërkojnë respektimin e normave kushtetuese. Në Maqedoni, anëtarët e «qeverisë» jokushtetuese të serbëve dhe malazezëve nga Kosova, të cilët kërkojnë solidaritetin e maqedonëve që në Jugosllavi në fund të fundit të ligjërohen raportet e hegjemonisë dhe të nënshtrimit, pra dy nivele barazie, çohen në salla solemne të organizatave politiko-shoqërore të Shkupit, ndërsa po në Maqedoni nxënësit shqiptarë dhe prindërit e tyre që kërkojnë që për ta të respektohet Kushtetuta e RSFJ-së, hidhen në burgjet e Kumanovës e të Shkupit! Hajde tani na thoni ju çfarë logjike ka këtu! A ka vazhdimësi këtu! Më e çuditshmja në gjithë këto është fakti se ndaj përfaqësuesve të një populli të vogël, siç janë shqiptarët,

sillen në këtë mënyrë autoritetet e një populli gjithashtu të vogël, siç janë maqedonët, të cilët edhe sot e kësaj dite luftojnë për njohjen e tyre në botë e që kanë ndarë me shqiptarët të mirën e të keqen ndër shekuj në këto hapësira jo fort të qeta e të lumtura të Ballkanit. Por edhe më i çuditshëm është fakti që Jugosllavia, e cila ka nënshkruar dokumentet e Kombeve të Bashkuara dhe Konventën e Helsinkit, lejon që shqiptarëve në Maqedoni t'u mohohen këto të drejta e liri kombëtare dhe të njeriut!

Zh. K.: A mund të na thoni diçka për kërkesën për futjen e një gjuhe zyrtare në të gjithë territorin e Serbisë?

R. Q.: Para një viti në Serbi u zhvillua një fushatë e ashpër për të ashtuquajturin kërcënim të gjuhës serbe në Kosovë: sepse tabelat ishin vetëm në gjuhën shqipe, se vendimet gjyqësore nganjëherë edhe serbëve e malazezëve u jepeshin në shqip, se në shumë mbledhje diskutohet vetëm në gjuhën shqipe etj., gjë që kurrë s'ka qenë dhe s'është e vërtetë. Thuhej se alfabeti cirilik është hequr me qëllim nga përdorimi në Krahinë, se për këtë ishin fajtorë shqiptarët dhe ata e kanë për detyrë që të prodhojnë makina shkrimi me germa cirilike, nga të cilat prej dhjetërvjeçarësh nuk ka pasur në shitje në Jugosllavi! Natyrisht, harrohej fakti se njerëzit në rrugë flisnin ashtu siç donin vetë, sepse shqiptarët gjithnjë u drejtoheshin serbëve dhe malazezëve në serbokroatisht, se nuk ka shqiptar mbi shtatë vjeç që të mos dijë gjuhën serbokroate, se nuk ka serb e malazez që t'i drejtohet shqiptarit në gjuhën e tij shqipe, se mbledhjet, ku politikanët shqiptarë diskutojnë ndonjëherë në gjuhën shqipe, u ngjajnë gati thertoreve të gjuhës, sepse kaq keq flasin shqip ngaqë janë mësuar të flasin në serbokroatisht, se në shumë institucione, madje edhe në praninë vetëm të një serbi a malazezi, të gjithë shqiptarët flasin në gjuhën e tij. Dihej, e tani u vërtetua, se e gjithë kjo fushatë lidhur me të ashtuquajturin kërcënim të gjuhës hegjemone u ndërmor me qëllim që të justifikohet ajo që doli tani publikisht: kërkesa për futjen e një gjuhe zyrtare në të gjithë territorin e Serbisë. Sipas Kushtetutës së RSFJ-së, në Jugosllavi nuk ka gjuhë

zyrtare, pasi të gjitha gjuhët që fliten në Jugosllavi janë të barabarta. Kjo do të thotë se në Jugosllavi nuk ka gjuhë shtetërore. Ndërsa kërkesa për futjen e një gjuhe zyrtare në të gjithë territorin e Serbisë praktikisht do të thotë kërkesë për futjen e një gjuhe shtetërore në këtë republikë, pasi e ashtuquajtura gjuhë zyrtare, që natyrisht do të ishte serbokroatishtja, në fakt presupozohet të jetë gjuhë shtetërore, megjithëse propozuesi nuk e quan të tillë. Kjo është vetëm një nga propozimet që çojnë në thellimin e hendekut midis dy niveleve të barazisë në Serbi.

Zh. K.: Na përshkruani pozitën e intelektualëve shqiptarë sot në kuadrin e këtyre ngjarjeve në Serbi dhe Kosovë.

R. Q.: Populli shqiptar, në fund të fundit, si dhe të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, ndodhet përballë një ofensive propagandistike të tmerrshme e në shërbim të së cilës janë vënë edhe grumbullimet masive të serbëve dhe malazezëve në Kosovë dhe të ashtuquajturat mitingje të solidaritetit me ta në Serbi dhe në Mal të Zi, me të gjithë masivitetin dhe zhurmën që i shoqërojnë. Kush nuk e ka vënë re se pas këtyre mitingjeve edhe Kosova, edhe shqiptarët, edhe inteligjencia krijuese e politike shqiptare dalin si të rrahur! Në qoftë se këto të ashtuquajtura mitingje të solidaritetit me serbët e malazezët, në të cilat vërshon uji nga pusët e helmuara politike, ndërsa urrejtja kundër shqiptarëve vihet në dukje në bajraçet serbe, janë investimi më i keq në marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavinë e sotme, çdo njeri e ka të qartë se cila është pozita e intelektualit shqiptar. Në kuadrin e kësaj që po përjetojmë, ç'mund të jetë më e natyrshme për intelektualin shqiptar veçse ndjenja e nevojës për të shprehur mendimin e vet për gjithçka që dëgjon, që propozohet dhe që projektohet për popullin, të cilit i përket, të shprehë mendimin, siç i duket atij, se politika e sotme serbe ndaj shqiptarëve ka të gjitha shanset që të komprometohet të paktën për 100 vjetët e ardhshëm. Por, në qoftë se pengohet në një gjë të tillë, siç po i ndodh tani, atëherë le të shpresojë se politikat janë kalimtare, ndërsa populli është i për-

jetshëm. Le të vlejë kjo edhe për popullin shqiptar, edhe për popullin serb, që, sipas natyrës së gjërave, megjithatë do të vendosin përsëri gjuhën e respektit dhe të miqësisë.

*«Čuvari magle», «Studentski list»,
Zagreb, 5.10.1988.*

Zenun Çelaj

ME MOHIME E DYSHIME NUK NGRIHEN URA

— *Bisedë e gazetarit Zenun Çelaj me dr. Agim Hysenin, docent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës* —

Shkenca ende po hesht — Krizë marrëdhëniesh ndërnacionale nuk ka vetëm në Kosovë. — Një nga parakushtet për kapërcimin e gjendjes — vlerësimi real i problemeve. — Edhe masat represive, edhe insistimet për diferencim në shpërputhje me realitetin — kundërproduktive.

Shqyrtimi real, në përmasa relativisht adekuate, dhe pasqyrimi i problemeve ndërnacionale me terma relativisht adekuatë, pa minimizime as hijeshime, por edhe pa hiperbolizime as fyerje, pa shtrembërime as çoroditje, siç paraqiten shpesh ato kur është fjala për Kosovën, është parakusht i domosdoshëm për gjetjen e zgjidhjeve fatlume dhe afatgjata për shumë probleme aktuale kosovare e jokosovare, pra edhe të të rinjve të kësaj Krahine. Me këtë moto, kohë më parë, në një këshillim, që u mbajt në KQ të LKJ, e shtroi problemin e pozitës, të vetëdijes dhe të angazhimit të brezit të ri të Kosovës docenti i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, dr. Agim Hyseni.

Çështjet ideopolitike të brezit të ri të Kosovës nga

ky aspekt janë themelore dhe thelbësore për situatën e ndërlikuar, për marrëdhëniet dhe për proceset shoqërore-politike në Kosovë dhe në tërë vendin. Në Kosovë, thotë ai, s'ka pasur mundësi ose mirëkuptim të mjaftueshëm për një analizë shkencore më serioze të kësaj problematike. Para disa vjetësh Instituti i Sociologjisë i Fakultetit Filozofik të Prishtinës pat konkurruar në BVI-në Krahinore të Shkencës me temën mbi lëvizjet ideore dhe orientimet vlerore të rinisë së Kosovës, por që refuzuan ndoshta, pse nuk u kuptua rëndësia dhe pesha e temës, ose për shkak të bindjes së gabuar se temat e tilla janë vetëm për politikë, për shqyrtime e vlerësime politike, që ishte një gabim, konsideron ai.

Situata në Kosovë — pjesë përbërëse e krizës në Jugosllavi

Është e natyrshme që, kur vlerësohet situata në Kosovë, në këtë vështrim edhe çështja e pozitës, e vetëdijes dhe e angazhimit të të rinjve të saj, për mbështetje duhet të merren qëndrimet dhe vlerësimet e deritanishme politike rreth tyre, mirëpo, sipas mendimit të docent Agim Hysenit, do të ishte politikisht e dëmshme të bëhemi rob të skemave të krijuara. Fjala vjen, a është sot frytdhënëse masa e ashtuquajtur preventive për pengimin e regjistrimit në fakultet për shkak të kritereve moralo-politike që zbatohen ndaj një numri kandidatësh, e që si masë aplikohet vetëm në Universitetin e Prishtinës? Sa për ilustrim të përmendim se nga viti 1981 e deri në vitin e shkuar shkollor për këto shkaqe janë refuzuar 1 010 veta, ndonëse të gjitha kushtet e tjera i plotësonin.

Sipas tij, nuk mund t'i qëndrojë provës pohimi se kriza në Kosovë ka edhe tipare plotësuese — krizë e marrëdhënieve ndërnacionale, meqë kriza e marrëdhënieve ndërnacionale tani nuk manifestohet vetëm në Kosovë. Në fakt ajo është pjesë përbërëse e krizës së përgjithshme dhe e tensioneve ndërnacionale përgjithësisht

në Jugosllavi. Po ashtu, edhe pohimet mbi jetesën paralele të dy bashkësive kombëtare, mbi ekzistimin e dy sistemeve të arsimit, të dy mënyrave paralele të jetesës në Kosovë dëshmojnë për mosnjohjen e realitetit kosovar. Ndërkaq, ideja mbi domosdonë e krijimit të një fronti të përbashkët të shqiptarëve, serbëve, myslimanëve, malazezëve, turqve dhe të tjerëve në Kosovë, për të luftuar çdo nacionalizëm meriton kujdes të posaçëm nga të rinjtë kosovarë e të tërë vendit, me qëllim të krijimit të marrëdhënieve të denja për ta, për kohën dhe për qëllimet që synon njerëzimi përparimtar.

Mbi mitin, injorimin e identitetin

Paragjykimet, mitet e stereotipet për popujt e tjerë dhe marrëdhëniet me ta, sidomos me burim nationalist e hegjemonist, me të cilat ndikon shumë shpesh një pjesë e publicistikës sonë, s'kanë tjetër fuqi pos të thellojnë hendekun e mosbesimit, të nxisin dhe të shkaktojnë mosmarrëveshje të reja, të shkaktojnë neveri dhe armiqësi — thotë docent Agim Hyseni.

Ky shton se qëndrimi injorues dhe nihilist ndaj popullit tjetër, mohimi i vazhdueshëm dhe sistematik në forma të ndryshme i qenies dhe i identitetit të tij historik, shoqëror e kulturor, është anakronizëm, i cili ndeshet shpesh. Problematizimi i vazhdueshëm dhe sistematik i së kaluarës dhe së sotmes së tij, vënia në dyshim dhe qëndrimi përherë i rezervuar ndaj çdo gjëje që vjen nga tjetri, ngarkimi i tij me të gjitha të këqijat dhe të ligat janë pengesë e madhe për njohjen e ndërsjellë më të mirë, për ngushtimin e largësive ndërnacionale, për afrimin normal dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Është e papranueshme që, nga një anë, të kërkohet respektimi dhe formimi i identitetit kombëtar për popullin e vet, e, në anën tjetër — të mohohet identiteti i të tjerëve, për shembull, i shqiptarëve, identitetin e të cilëve e njehtë e pranon bota.

Paragjykimet thellojnë hendekun

Për të bërë çfarëdo hapi të suksesshëm për kapërcimin e tensioneve në marrëdhëniet ndërnacionale, sipas mendimit të dr. Agim Hysenit, parakusht është vështrimi real i këtyre marrëdhënieve, i dimensioneve të tyre, i cilësisë, i implikimeve dhe i çaqeve, i problemeve të manifestuara dhe i kundërthënieve në marrëdhëniet ndërnacionale. Shqyrtimi real në përmasa relativisht adekuate dhe pasqyrimi i problemeve ndërnacionale me terma relativisht adekuate, pa minimizime as hijeshime, por edhe pa hiperbolizime e fryrje, pa shtrembërime e çoroditje, siç paraqiten shpesh ato kur është fjala për Kosovën, është parakusht i domosdoshëm për gjetjen e zgjidhjeve fatlume dhe afatgjata për shumë probleme aktuale kosovare e jokosovare, pra edhe të të rinjve të kësaj Krahine.

Ndoshta nuk është e pavend të theksohet se Lenini, të cilin do të mund ta konsultonim më shpesh kur shqyrtojmë e zgjidhim probleme të marrëdhënieve tona ndërnacionale, me të drejtë vinte në pah se ekziston vetëm një zgjidhje e çështjeve nacionale, e kjo është demokratizimi konsekuent. Ai theksonte rëndësinë psikike të çështjes kombëtare, prandaj, sa i përket kërkesës që gjuha ruse të bëhej gjuhë shtetërore, konsideronte se gjuha shtetërore është dajak që dëbon popujt e tjerë nga mësimi i gjuhës ruse, kurse hidhte poshtë vendosmërisht çdo imponim të miqësisë dhe shtronte nevojën që për të fituar miqësinë e popujve të tjerë ndaj tyre duhej të mbahej qëndrim si ndaj të njëjtëve me veten.

Çdo analizë e marrëdhënieve të tashme ndërnacionale dhe e tensioneve të tashme në marrëdhëniet ndërnacionale te ne dëshmon ose do të mund të dëshmonte se nacionalizmi, si absolutizim kryesisht i interesave nacionalë, sot të kuptuar mbrapsht dhe si përpjekje për sendërtimin e tyre, pa marrë parasysh dhe në dëm të interesave kombëtarë realë e normalë të popujve të tjerë, është shkaku themelor dhe bazë e konflikteve ndërnacionale, — pohon ky.

Nacionalizmi ekscesiv, gjysmëlegal dhe legal

Bindja, e cila, duke pranuar dëmin e përgjithshëm që shkakton nacionalizmi, e vendos dhe e sheh atë vetëm si nacionalizëm të tjetrit, në raste më të shpeshta si nacionalizëm e separatizëm shqiptar, jo vetëm që është e papranueshme, por edhe e dëmshme, njësoj si ajo që sheh vetëm nacionalizmin ekscesiv, e jo edhe nacionalizmin, që, do të thoshim, vepron gjysmëlegalisht, nëse jo fare legalisht, që përpiket, bile pjesërisht me sukses, të fitojë të drejtën qytetare dhe legjitimitetin, që depërton në forume dhe imponohet në formë dispozitash ose ndalesash, rezolutash, madje edhe ligjesh, me fjalë të tjera, nacionalizmi që është më i rrezikshëm pikërisht ngase ka më shumë gjasë. Po ashtu, është e dëmshme dhe pengesë e madhe për kapërcimin e situatës së tashme edhe bindja, në bazë të së cilës edhe kërkesat e të drejtat më normale kombëtare, siç janë, ta zëmë, e drejta dhe kërkesa për mësim në gjuhën amtare, në rastin konkret në gjuhën shqipe, shpallen e ndiqen si nacionalizëm, duke përjashtuar nga puna arsimtarët, kurse nxënësit nga shkolla, pos ndjekjes për kundërvajtje dhe ndjekjes penale, ndërkaq nacionalizmi vetjak pajiset me letërnjoftimin e «së mirës së përgjithshme», «të interesit të përgjithshëm» ose «të reagimit të arsyeshëm» ndaj nacionalizmit të të tjerëve, sidomos të shqiptarëve. Kështu thotë docenti i Fakultetit Filozofik, profesor i sociologjisë dr. Agim Hyseni për të shtuar se parakusht për luftë të suksesshme kundër nacionalizmit është prezantimi i tij në përmasa reale dhe lufta e përbashkët e të gjithëve kundër të gjithë nacionalizmave.

Dallimet — si akuzë ndaj komunistëve shqiptarë

Për luftimin me sukses të nacionalizmit shqiptar, por edhe të nacionalizmave të tjerë, parakusht janë qëndrimet dhe vlerësimet unike. Vlerësimet unike mund të jenë të frytshme vetëm nëse janë objektive dhe parimore. E sot mospajtimet dhe dallimet në vlerësimin e çështjeve

përkatëse të marrëdhënieve ndërnacionale e sipas përkatësisë kombëtare janë mjaft të shpeshta, shton docenti i Fakultetit Filozofik të Prishtinës dr. Agim Hyseni. U mor vesh se në rrethanat tona të ndërlikuara manifestimi i ndonjë dallimi mund të jetë i kuptueshëm. Këtë e lejon edhe koncepti i shumësisë së interesave, madje edhe të atyre vetëqeverisëse. Mirëpo, habit fakti se te ne trajtimi dhe vlerësimi i ndryshëm i dukurive përkatëse formulohet si akuzë kundër komunistëve shqiptarë dhe i qëndrimit të tyre. Sikur harrohet se për dallime e mospajtime nevojiten së paku dy e më shumë subjekte.

Gjithnjë e më dendur në konceptin e zhvillimit të vendit dhe të Serbisë insistohet te integrimi, që është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Mirëpo, kjo kategori ka nevojë të saktësohet, sepse çdo integrim, që nuk do të merrte parasysh veçoritë e qenies kombëtare, si dhe veçoritë e tjera të Kosovës, do të ishte i pasuksesshëm. Është gjë e domosdoshme që të kuptohet nevoja dhe interesi i shqiptarëve jo vetëm për të ruajtur disa nga të drejtat kombëtare, por edhe për të marrë pjesë si subjekt i barabartë e kreativ në jetën e bashkësisë sonë. Fundja, është e domosdoshme të hulumtohen mundësitë për intensifikimin e bashkëpunimit ndërnacional në Kosovë, sikundër edhe të kombeve e të kombësive të Jugosllavisë në tërësi.

Kriza në Kosovë ka edhe komponentin burokratiko-etatist. Mirëpo, siç thekson ky docent, dobësitë burokratiko-etatiste të Kosovës duhen parë në tërësinë e deformimeve burokratiko-etatiste si në shkallë krahinore, ashtu edhe në atë republikane e federative, siç është e domosdoshme që nacionalizmi shqiptar të vështrohet në bashkëveprim me nacionalizimin serb, maqedonas dhe të tjerë, të cilët i nxit, por edhe ata e trimërojnë dhe e ndihmojnë atë.

Mundësitë e indoktrinimit

Duhet të jemi të vetëdijshëm për mundësitë relativisht të kufizuara të nocionit të indoktrinimit, kur është fjala për shpjegimin dhe kuptimin e disa ngjarjeve në

Kosovë. Jo vetëm pse përdorimi i tepruar i këtij nocioni mund të bllokojë kontrollin e dallimeve themelore dhe të kundërthëniet objektive, reale, por edhe nga shkak se në kushtet e sotme, kur arsimi dhe edukimi, prandaj edhe vetëdijësimi i të rinjve realizohen në një shumësi burimesh e raportesh, kështu që burim i «indoktrinimit» mund të jenë edhe shtypi, televizioni, publicistika jo vetëm kosovare ose në gjuhën shqipe, por secila, madje edhe me orientim, sa për sy e faqe, të kundërt. Dr. Agim Hyseni thotë se gjëja më e rrezikshme për marrëdhëniet tona, për marrëdhëniet në radhë të parë midis të rinjve, është nëse vetëdija e të rinjve sot e këtu formohet në antishqiptarizëm, antiserbizëm ose në antimalaziasizëm, të cilat liferohen me bollëk përmes shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit. Edhe nacionalizmi shqiptar mund të kultivohet jo vetëm nga tekstet e romantizmit nacional, por edhe nga tekstet antishqiptare të mjedisve të tjera kombëtare.

Përfaqësimi përpjesëtimor s'është dështim

Sikur janë shteruar ose duken të pamjaftueshme disa kategori për të kuptuar ose zgjidhur problemet kosovare. Përvoja e viteve të fundit dëshmoi joefikasitetin e masave represive, sadoqë ato në rrethana përkatëse do të ishin të domosdoshme, madje aplikimi i tepruar i tyre flet për kundërproduktivitetin, siç mund të thuhet njësoj edhe për diferencimin, i cili do të ishte frytdhënës vetëm kur është objektiv dhe në përpjesëtim me nevojat dhe raportet e njëmendta. Dr. Agim Hyseni thotë se edhe çështja e natalitetit të madh në Kosovë është çështje social-klasore, kurrsesi kombëtare ose nacionaliste. Në favor të këtij pohimi përmend të dhëna, sipas të cilave në Kosovë gruaja fshatare brenda periudhës së fertilitetit lind 6.74 fëmijë, kurse të zënat në punë jashtë bujqësisë vetëm 2.74 fëmijë (sipas regjistrimit të popullsisë më 1981).

Universiteti i Prishtinës shpesh apostrofohet në kontekst të aspekteve negative të situatës kosovare, por rrallë përmendet se në krahasim me vitin shkollor 1980-1981 numri i studentëve që studiojnë në të është pakësuar

rreth 46 për qind, e në anën tjetër 17 për qind e të regjistruarve në vitin e kaluar shkollor ishin nga territoret jashtë Krahinës, gjë që dëshmon se ky është Universiteti më i hapur në vend. Sigurisht, sikur universitetet në Maqedoni të kishin mirëkuptim ndaj nevojës për mësim në gjuhën amtare të studentëve shqiptarë nga ky territor, ky i Prishtinës do të shkarkohej nga shpenzimet materiale, të cilat janë të mëdha e mundësitë janë të vogla.

Sipas mendimit të dr. Agim Hysenit, nëse është vlerësuar se në Kosovë pati dështime në politikën e kuadrove, dhe me siguri kishte, madje shumë, përfaqësimi relativ përpjesëtimor kombëtar i kuadrove nuk është dështim dhe një politikë e tillë nuk u kundërvihej aftësive, meqë ka të aftë në çdo grupacion kombëtar. Dështim ka qenë fakti se nuk u është bërë e mundur të afirmohen kuadrot e reja e të afta të të gjitha nacionaliteteve. Duke vënë në jetë reformat e proklamuarra e të paralajmëruara në shumë segmente, pikërisht kuadrot e reja do të fusin dinamikë më të madhe, frymë të re, më shumë vendosmëri. Këto të gjitha janë parakushte të domosdoshme jo vetëm për nxjerrjen e Kosovës nga kriza, por edhe të tërë vendit.

«Rilindja», Prishtinë, 8.1.1989.

«N. N. - SHQIPTAR I IZOLUAR»

— *Intervistë në «Mlladina»*

Pyetje: Kur dhe si ju «izoluan»?

Përgjigje: Mendoj se ishte data 28 mars, e njëjta ditë kur u shpall ora policore. Rreth orës 8 e 20 minuta erdhën te unë agjentë të sigurimit të shtetit dhe më thanë se duhej të shkoja pas tyre sepse donin të «bisedonin me mua». Më çuan në Sekretariatën e Punëve të Brendshme të më pyesnin se ç'kisha bërë në vitin 1981, gjatë ngjarjeve të nëntorit të kaluar dhe të shkurtit dhe marsit të këtij viti. Iu përgjigja se nuk kisha bërë asgjë që të binte në kundërshtim me ligjet (ai që më mori në pyetje ishte serb, inspektor i sigurimit të shtetit). E pyeta se përse më kishin thirrur atje. M'u përgjigj me fjalët: ti je i dyshimtë dhe që tani ndodhesh i paraburgosur.

Pyetje: Për ç'gjë tjetër të pyetën dhe si u përgjigje?

Përgjigje: Më pyetën se ç'mendoj për plenumin e 17-të të KQ të LKJ, për ngjarjet e nëntorit, për grevat e shkurtit dhe demonstratat e marsit, sa fëmijë kam rreth moshës 18 vjeç. U thashë se nuk jam i detyruar t'u përgjigjem dhe se ne, shqiptarët, nuk jemi të barabartë me të tjerët në Jugosllavi. Hetuesi bërtiti, më goditi me grushte dhe tha se kjo nuk është e vërtetë. Pastaj hapi tranzistorin në stacionin e Beogradit, i cili po transmetonte punimet e Kuvendit të Serbisë për miratimin e ndryshimeve në kushtetutë. Ishte duke folur B. Joviçi, i cili po thoshte se

kushtetuta e ndryshuar do të garantonte të drejta të barabarta për të gjithë në RS të Serbisë.

Pyetje: Ku ju çuan pastaj?

Përgjigje: Më hipën në një autobus që qëndronte në oborrin e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Prishtinës. Në autobus ndodheshin edhe të tjerë dhe atje qëndruam për një kohë të gjatë, derisa erdhën autobusët nga Peja dhe Prizreni, të cilët gjithashtu ishin plot me të izoluar. Na vunë prangat në duar dhe rreth orës 17 u nisën për rrugë dy autobusë të mëdhenj dhe një mikrob-us, në të cilët ndodheshin rreth 120 deri 130 të izoluar. Autobusëve u paraprinte një makinë e milicisë, e cila i binte vazhdimisht sirenës sikur të shoqëronte ndonjë delegacion me rëndësi. Na thanë se ishte e ndaluar që të shikonim nga dritaret e autobusit (por edhe pa këtë paralajmërim nuk mund të shihnim asgjë, sepse dritaret ishin me perde të trasha). Vetëm munda të kuptoj se po kalonim nëpër rrugët e Prishtinës dhe po dilnim jashtë qytetit, sepse unë vetë jetoj në Prishtinë. Më në fund arritëm në Leskovac.

Pyetje: Ku ju çuan në Leskovac dhe si u sollën me ju?

Përgjigje: Autobusët qëndruan në oborrin e burgut. Sapo arritëm, na «përshtëdetën» me sharjet e tyre të rënda, si ato që dikur feudalët serbë u thoshin skllëvërve të tyre. Milicët po luanin me top dhe, kur na panë, qeshën me të madhe duke thënë: «Erdhi darka për ne». Sapo zbritëm nga autobusi, filluan të na godisnin me grushte e shqelma, të na shajnë nënat tona shqiptare dhe çdo gjë shqiptare. Pastaj na futën në një sallë ku pritëm të na merrnin në pyetje. Kur hyra në zyrën e hetuesisë, atje ishte inspektori dhe një oficer me 10 milicë. Më panë me urrejtje dhe më thanë që të kthehesha me fytyrë nga muri. Pastaj filluan të më rrihnin, të më godisnin me grushta, me shqelma dhe me shkopinj gome. Më torturuan në mënyrë të pamëshirshme. Më urdhëruan që të zhvishesha lakuriq dhe pastaj filluan të më godisnin përsëri në kokë, në trup dhe ku mundnin. Pa më marrë fare në pyetje, më dërguan në një qeli të burgut, ku milici më tha: «çlodhu pak se me ty, këlysh, nuk kemi mbaruar punë ende». Kur hyra në qeli, pashë se atje kishte shumë të tjerë, të gjithë të rrahur për vdekje dhe asnjëri nuk

ishte në gjendje të fliste, t'i thoshim ndonjë fjalë njëri-tjetrit. Nga plagët që kishim marrë, nuk ishim në gjendje as të flisnim, pavarësisht se nuk kishte as vende të mjaftueshme të shtriheshim të gjithë. Megjithatë i hapnim vend njëri-tjetrit me radhë që të mbështetnim pak trupin në betonin e ftohtë të qelisë për të pakësuar dhembjet e plagëve. Gjatë gjithë natës dëgjoja rënkimet e shokëve të qelisë, thirrjet e tyre për një pikë ujë, për ndihmë mjekësore, por pa dobi. As mjek dhe as infermiere nuk erdhi. Kur u gdhi, pashë se midis nesh në qeli kishte edhe të mitur dhe pleq 70-vjeçarë.

Pyetje: Kur mbaruan torturat dhe ju morën në pyetje?

Përgjigje: Mendoj se gjërat ndryshuan «për mirë» të dielën më 2 prill, kur na vizitoi sekretari për Drejtësinë i RS të Serbisë dhe sekretari për Drejtësinë i Kosovës, Të izoluarit i mjekuan dhe na paralajmëruan që të mos thoshim asgjë përpara delegacionit të institucioneve të drejtësisë për rrahjet dhe torturat se, përndryshe, do të na vrisnin më vonë. Sekretarët e drejtësisë na thanë se kishin dhënë porosi që me ne të silleshin mirë dhe se kushdo që do të shkelte porositë e tyre do të vihej përpara përgjegjësisë.

Pyetje: Pas kësaj vizite u sollën më mirë me ju?

Përgjigje: Po, nuk na torturuan më fizikisht, por gjendja jonë vazhdoi të mbetej e rëndë.

Pyetje: A kishit mundësi të merrnit vesh se çfarë ndodhte jashtë, se si i kishit njerëzit e familjes?

Përgjigje: Nuk kishim asnjë mundësi të tillë. Nuk shikonim televizor, nuk dëgjonim radio dhe nuk lexonim gazeta. Nuk dinim asgjë se çfarë kishte ndodhur me familjet tona. As ato nuk kishin asnjë të dhënë për ne, nuk e dinin nëse ishim gjallë apo jo.

Pyetje: A u zhvillua ndaj jush procedurë e rregullt penale?

Përgjigje: Jo. Të martën, më 4 prill, filluan hetimet, të cilat i drejtonte inspektori i sigurimit të shtetit nga Beogradi (ishte serb). Në fillim më pyetën: për ç'arsye je këtu? Iu përgjigja: Më keni izoluar për shkak të masave të jashtëzakonshme në Kosovë. Ma ktheu: Nuk je në izolim, por në paraburgim dhe përgjigju për gjithçka ke bërë. Më lanë

njëfarë kohe që të mendohesha «mirë». Pastaj më thirrën përsëri dhe më pyetën se ç'mendoja për plenumin e 17-të të KQ të LKJ, për ngjarjet e nëntorit, të shkurtit dhe të marsit, se me se jam marrë kohët e fundit në Prishtinë. Përdorën marifetet dhe mashtrimet e zakonshme të policisë, duke më thënë se kishin prova materiale për fajet e mia, se më kishin parë midis demonstruesve në stadiumin dhe në rrugët e Prishtinës. Më kërkuan të tregoja se çfarë flitej në rrethet e ngushta në Kosovë për ndryshimet në kushtetutën e Serbisë. Pasi nuk u pëlqyen përgjigjet e mia, në fund më thanë: mirë, po do ta shohësh se çfarë të pret. Mua m'i kërkuan përgjigjet me gojë, por shumë drejtorëve dhe inxhinierëve të disa ndërmarrjeve kosovare ua kërkuan përgjigjet me shkrim.

Pyetje: Po çfarë ju priti më vonë?

Përgjigje: Na detyruan që në çdo orë të lyheshim me një lloj boje, pastaj na dhanë për të pirë disa tableta (na thanë se ato ishin vitamina). Një ditë na thanë të hiqnim teshat tona dhe të vishnim ato të burgut. Teshat tona ishin gjithë gjak, prandaj thanë se do t'i lanin dhe do t'i rregullonin, pas disa ditësh na i dhanë përsëri teshat të pastruara.

Pyetje: A qëndruat shumë në Leskovac?

Përgjigje: Jo. Të gjithë të izoluarit i hoqën nga Leskovaci dhe i shpërndanë nëpër burgje të ndryshme në Serbi: në Beograd, Zajeçar, Prokuplje dhe në Shabac.

Pyetje: Si u sollën me ju në burgjet e tjera?

Përgjigje: Në krahasim me Leskovacin, mendoj se u sollën korrektë. Në fillim na vizitoi mjeku, i cili na pyeti se përse na kishin torturuar më parë. Këtu jetuam në mënyrë «normale», na lejuan të shëtisnim në oborrin e burgut, na lejuan t'u dërgonim letra familjeve, por na porositën që t'i shkruanim serbisht, në qoftë se dëshironim që ato të arrinin më shpejt në destinacion, në rast të kundërt (për shkak të censurës), ato do të arrinin shumë vonë. Në fakt letrat tona ishin vonuar deri tri javë.

Përsëri na mori në pyetje inspektori i shërbimit të sigurimit të shtetit, na bëri të njëjtat pyetje dhe na paralajmëroi që të thoshim të vërtetën, përndryshe do të përgjigjeshim penalisht për dëshmi të rreme. Në këtë burg na lejuan të dëgjonim radion, të lexonim gazeta.

Çdo orë ishim të detyruar të dëgjonim këngët «Kush thotë, kush gënjen se Serbia është e vogël», «Oj vojvodo sinjgeliçu», «Atje larg» dhe shumë këngë të vjetra serbe. Sa herë që në emisionet e lajmeve flitej për ngjarjet në Kosovë, e mbyllnin menjëherë radion. Nuk mund të lexonim shtyp tjetër përveç atij të Beogradit dhe kryesisht gazetën «Politika», duke na thënë se vetëm kjo gazetë shkruan në mënyrë objektive për të gjitha ngjarjet në Kosovë.

Pyetje: Kur u liruat?

Përgjigje: Më 25 maj. Më thirrën përsëri në hetuesi. Pas «racionit» të zakonshëm të pyetjeve dhe përgjigjeve të njëjta nga ana ime, hetuesi më tha: «Së shpejti do të shkosh në shtëpi». Fillova të qesh me ironi. Hetuesi më pyeti: pse qesh? Iu përgjigja: «Ju vetë nuk më lironi, në qoftë se nuk ju detyrojnë për një gjë të tillë». Nuk më besohej se do të më lironin. Më parë na kishin thënë se do të qëndronim në izolim deri në muajin shtator ose edhe më vonë, derisa të hiqej gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë. Pas dy ditësh na thirrën dhe na thanë se jemi të detyruar të nënshkruajmë një deklaratë, në të cilën të thoshim se në burg ishin sjellë në mënyrë korrekte me ne. Pastaj na dhanë vërtetime që dëshmonin se nuk ishim në «izolim». Pas kësaj na hipën në autobus dhe na çuan në Prokuplë. Aty na prisnin dy autobusë: në njërin hipëm ne që ishim liruuar, kurse në tjetrin ata që do të vazhdonin në izolim dhe që transferoheshin në burgjet e Kosovës.

Pyetje: Cila ishte struktura e të burgosurve?

Përgjigje: Me sa munda të mësoj, në «izolim» ndodheshin njerëz të të gjitha llojeve: drejtorë ndërmarrjesh, inxhinierë të ferronikelit, profesorë të shkollave të mesme, politikanë, nipërit e Azem Vllasit (Agim dhe Selim Vllasi që e kanë Azemin xhaxha etj.)

Pyetje: Si i konsideroni tani ato që përjetuat në izolim?

Përgjigje: Të them të vërtetën, tortura të tilla deri atëherë i kisha parë vetëm nëpër filma: gjendja jonë ishte jashtëzakonisht e rëndë. Mendoja se kurrë nuk do të dilja i gjallë, se do të kisha vdekur shumë shpejt në burg, sidomos kur isha në atë të Leskovacit. Për mua, tani që e mblodha veten pas izolimit, më duket për të ardhur keq

dhe për të qeshur kur dëgjoj kryetarin e Kryesisë së Lidhjes Socialiste të Jugosllavisë, Bozhidar Çollakoviçin, të deklarojë se ne, shqiptarët, jemi të barabartë me qytetarët e tjerë të Jugosllavisë, pa thënë asnjë fjalë të vetme për të izoluarit».

*«N. N. albanec izoliran», «Mladina»,
Lubjanë, 9.6.1989*

Rexhep Qosja

EVROPA NË MËNYRËN BALLKANIKE

— Intervistë në gazetën «Oslobogjenje» —

Pyetje: Takimi juaj i kohëve të fundit me delegacionin e Parlamentit Evropian në Prishtinë shkaktoi reagime të ndryshme në opinionin tonë publik.

Përgjigje: Ky takim shkaktoi reagime të ndryshme në opinionin publik dhe, për fat të keq, kishte më shumë reagime keqdashëse sesa dashmirëse. Është me të vërtetë për t'u habitur që reagohet në këtë mënyrë ndaj takimit të intelektualëve shqiptarë me një delegacion kaq përfaqësues, sikurse është ai i Parlamentit Evropian, që erdhi këtu me ftesën e Kuvendit të Jugosllavisë dhe të cilit mikpritësit i patën premtuar se do të mund të «bisedonin lirisht me cilindo që do të dëshironin». Të habit edhe më shumë fakti se në reagimet keqdashëse paraprinin intelektualët serbë, madje profesorë të Universitetit të Beogradit, doktorë të shkencave dhe akademikë. Por s'ke ç't'i bësh. Një numër intelektualësh serbë jo vetëm që e mbështetin, por edhe e frymëzojnë politikën represive ndaj shqiptarëve, ndaj inteligjencies shqiptare. Ata dinë të protestojnë kundër masave represive në Kinë, por jo kundër masave represive në Kosovë, ata dinë të protestojnë kundër arrestimit të Vasllav Havelit në Çekosllovakia, por jo kundër të ashtuquajturit izolim të inte-

lektualëve shqiptarë në Kosovë, ata dinë të mbrojnë lirinë e komunikimit të tyre me botën, por nuk pranojnë që një liri të tillë ta kenë edhe intelektualët shqiptarë. Ata do të dëshironin që t'i afroreshin sa më shumë Evropës, por me kusht që fati ynë të vendoset në mënyrë ballkanike, me mjete dhe metoda ballkanike.

Pyetje: Duke respektuar mundësinë e një bisedimi demokratik të një qytetari të lirë, por edhe për shkak të informimit objektiv të publikut, ju lutemi të na thoni se çfarë u interesoi parlamentarëve dhe çfarë u thatë ju?

Përgjigje: Delegacioni i Parlamentit Evropian u interesua për ato gjëra, për të cilat u interesua edhe në bisedimet me zyrtarë kosovarë: për gjendjen në Kosovë. U përpoqëm t'i parashtronim pikëpamjen tonë rreth kësaj gjëndjeje dhe pozitës së shqiptarëve sot.

Pyetje: Duke pasur parasysh faktin se ishte pranuar një takim me ju dhe intelektualë të tjerë, si ndodhi që të nesërmen ky takim u mbajt në një dhomë hoteli në një atmosferë protokollare dhe pa praninë e ndonjërit nga zyrtarët e vendit tonë?

Përgjigje: Më mirë për këtë pyesni zyrtarët kosovarë, veçanërisht kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Vukashin Jakanoviç, i cili në Kosovë ishte mikpritës i parlamentarëve evropianë. Pas takimit me anëtarët e delegacionit e kuptova se zyrtarët kosovarë, nën pretekste të ndryshme, ishin përpjekur të pengonin delegacionin për t'u takuar me ne dhe për këtë arsye ata u detyruan të na ftojnë vetë në takim. Personalisht më vjen keq që edhe unë nuk isha në sallën e rektoratit të Universitetit të Prishtinës, ku delegacioni i Parlamentit Evropian u takua me burokracinë intelektuale e ku, në sy të të gjithëve, do të thosha më shumë sesa thashë në dhomën e hotelit për pozitën e shqiptarëve sot, gjë që përbën një pjesë shumë të vogël të asaj që kam shkruar dhe botuar deri tani. Më refuzimin që i bënë delegacionit të Parlamentit Evropian për të pasur një takim normal me intelektualët shqiptarë, me të cilët dëshironte të takohej, besoj se zyrtarët kosovarë, në njëfarë mënyre, u thanë atyre për pozitën e shqiptarëve sot shumë më tepër sesa u thanë ne vetë.

Pyetje: Zhurma rreth miratimit të kushtetutës së RS

të Serbisë ende nuk është shuar. Çfarë i shqetësoi kaq shumë shpirtrat në Kosovë rreth kësaj kushtetute?

Përgjigje: Me ndryshimin e kushtetutës, shqiptarëve në Kosovë iu mohua një pjesë e historisë së përjetuar. Shqiptarët janë të vetmit në Jugosllavi, që me anën e ndryshimeve në kushtetutë u kufizohen të drejtat, janë të vetmit, e fati kushtetueso-juridik dhe politik i të cilëve pësoi një regres. Kushtetuta tani është ndryshuar. Unë respektoj detyrën qytetare për t'u sjellë në përputhje me ligjet, që rrjedhin nga kushtetuta. Por si demokrat, për të cilin çështja nacionale shqiptare është çështje demokratike, dëshiroj të them edhe këtë: jam i bindur se udhëheqja serbe ka bërë gabim që vendosi për kufizimin e pozitës kushtetuese të Kosovës. E parë nga pikëpamja historike, udhëheqja serbe ka gabuar që aktin e ndryshimeve në kushtetutë e realizoi në Kosovë me anë të forcës, të tankeve. Udhëheqja serbe vazhdon të gabojë duke e mbajtur nën represionin politik dhe shtetëror, i cili, për fat të keq, do të lërë gjurmë të thella në shpirtin e disa brezave. Politikanët e sotëm serbë sikur harrojnë se serbët janë kombi më i madh në numër, se ata janë kombi sundues, se ata për tetë dekada vendosin për fatin tonë dhe për këtë arsye, si nga pikëpamja historike, ashtu edhe ajo morale, janë të detyruar të jenë të ndjeshëm ndaj nesh, të kenë më shumë mirëkuptim për ndjenjat tona kombëtare. Për fat të keq, njëqind herë për fat të keq, politika e tanishme serbe e kërkon të ardhmen e Serbisë në të kaluarën e saj. Këtë konkluzion nuk e nxjerr nga fakti se në kohën kur bota pushton hapësira të reja kozmike, eshtrat e car Llazarit udhëtojnë nëpër Serbi, nga fakti se 600-vjetori i betejës së Kosovës është shndërruar në një spektakël të politizuar ose nga fakti që kisha ortodokse është bërë një këshilltar politik i rëndësishëm për politikën rreth Kosovës. Këtë konkluzion e nxjerr nga orientimi i politikës serbe për paqësimin ushtarako-politor të Kosovës, ashtu sikurse dikur. Ka më se 8 vjet që nuk kemi dëgjuar asnjë fjalë të mirë për veten tonë, asnjë mendim, që të shprehë respekt për ne, nuk kemi ndier asnjë lëvizje që do të dëshironte të na afronte, në asnjë rast nuk na është shtrirë dora, nuk është shprehur as dëshira më e vogël për një dialog të barabartë. Vetëm sulme,

fyerje, diskriminim, shpifje, shantazh, diferencime, arrestime, thirrje në hetuesi, izolime, burgosje. Sikurse është harruar se me një fjalë miqësore, me tolerancë, me respektim, me dialog, me mirësi mund të bëhet shumë më tepër sesa me terrorin verbal, me represionin politik dhe shtetëror. Në traditën kulturore shqiptare ka një mendim të tillë: një fjalë e mirë të bën për vete, një fjalë e keqe vetëm të largon nga vetja. Dhe politika serbe sot vetëm na largon nga vetja. Politikanët serbë sikur kanë harruar se shqiptarët dhe serbët kanë jetuar për shekuj në këtë hapësirë bashkë, se kanë nderuar dhe respektuar njëri-tjetrin në pjesën më të madhe të kohës, se në momentet më të vështira historike kanë mbështetur njëri-tjetrin dhe i kanë dhënë strehim, se kuptimin e jetës e kanë gjetur në unitetin dhe jo në persekutimet. Në çdo rast ndërgjegjja shoqërore e të parëve tanë ka qenë në një nivel moral më të lartë se sot.

Pyetje: Si intelektual, krijues, pedagog dhe akademik, a e ndieni veten si shqiptar qytetar të dorës së dytë në Kosovë?

Përgjigje: Nuk është vështirë të konstatohet se sot numri më i madh i shqiptarëve, sidomos në Kosovë dhe Maqedoni, ndihet si Jozefi i Kafkës, i cili pret vazhdimisht që të vijë ta marrin. Numri më i madh i shqiptarëve pret sot me ankth trokitjen në derën e shtëpisë pas orës 21. Numri më i madh i shqiptarëve shkon me ankth në punë dhe me ankth kthehet nga puna. Në bazë të këtyre fakteve, vlerësojeni vetë nëse kjo është ndjenjë e qytetarit të dorës së dytë, të dorës së tretë apo më shumë. Pas takimit me delegacionin e parlamentarëve evropianë shumë veta interesoheshin në telefon se si jam, gjë që do të thotë nëse jam ende i lirë. Dhe pas kësaj interviste, shqiptarët, që do të kenë mundësi ta lexojnë, do të pyesin se si jam, gjë që do të thotë nëse vazhdoj të jem i lirë. Por një interesim i tillë flet më shumë për ata, të cilët pyesin, sesa për atë, të cilit i drejtohet pyetja. Shqiptarët sot e ndiejnë vetën si qytetarë, për të cilët vendosin të tjerët dhe jo qytetarë që mund të vendosin sadopak për fatin e tyre. Vullneti politik i shqiptarëve praktikisht është mohuar, ndër të tjera, edhe për shkak se nuk ekziston më vullneti politik i përfaqësuesve politikë

shqiptarë: ata i emërojnë ose i shkarkojnë jashtë Kosovës, sikur të jenë pa emra dhe pa mbiemra.

A e ndiej veten unë si qytetar të dorës së dytë? Unë nuk mund të ndihem ndryshe nga populli, të cilit i përkas. Unë shpeshherë kam thënë se intelektualët shqiptarë duhet të përpiqen të shprehen aq lirisht sa edhe intelektualët e tjerë në Jugosllavi. Në qoftë se ata, p.sh., munden që pa autocensurë, me guxim, të shprehin mendimet e tyre për çështje shoqërore dhe politike, në qoftë se pa autocensurë mund të parashtrajnë pikëpamjet e tyre për Kosovën, dje dhe sot, atëherë përse të mos mund të flasim edhe ne pa autocensurë dhe publikisht? Por qindra herë jam bindur se për ne vlejné disa kritere të tjera. Në takimin e shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë në muajin maj të vitit të kaluar në Beograd, në të cilin u bisedua rreth temës «Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavi sot», ne u përpoqëm që pak a shumë të parashtronim lirisht mendimet tona për realitetin kosovar, por shpejt u bindëm se as autoritetet dhe as ndonjë intelektual serb nuk janë të gatshëm që ta pranojnë këtë liri për ne. Po ju pyes unë juve, në qoftë se Dobrica Qosiçi ose Predrag Palavestro, Sllobodan Selenici apo Nikolla Milosheviçi do të takoheshin me delegacionin e Parlamentit Evropian, jo në një dhomë hoteli, e cila ka veshë të gjatë, por në shtëpitë e tyre, vallë ndonjëri në Serbi do të vendoste t'i quante ashtu, sikurse i quajti dy intelektualët shqiptarë pas takimit me këtë delegacion një akademik serb: «shkatërrues të Jugosllavisë»? Vallë për shkak të një takimi të tillë do të bëhej aq zhurmë dhe kërcënime sa u bënë kundër ne të dyve?

Pyetje: Ndarjet rreth gjendjes në Kosovë janë të dukshme dhe askush nuk i fsheh më e as që mund t'i fshehë. Sipas mendimit tuaj, si mund të kapërcehen këto dallime?

Përgjigje: A e dini çfarë ka thënë Dobrica Qosiçi në diskutimin e tij në forumin e «Knjizhevne novine», të organizuar me rastin e 70-vjetorit të krijimit të shtetit jugosllav? Ai tha: «Shqiptarët e shpërbëjnë strukturën etnike dhe shtetërore të Jugosllavisë». Mos vallë krahas Kosovës, nga shqiptarët dhe për shkak të shqiptarëve janë të kërcënuar edhe Maqedonia dhe pjesë të

Malit të Zi? Sipas logjikës së Qosiçit, Mali i Zi me 500 deri 600 mijë malazezë, rrezikohet nga rreth 30.000 shqiptarë, të cilët po shkojnë gjithnjë e në mënyrë më masive në SHBA, kurse Jugosllavia me 21 milionë serbë, kroatë, sllovenë, myslimanë, maqedonë etj., rrezikohet nga rreth 2 milionë e gjysmë shqiptarë. Le të lëmë mënjanë shkollën e historisë, në të cilën mund të mësojmë se shqiptarët gjatë historisë së tyre nuk kanë mundur të kërcënojnë, se fati i tyre, në të vërtetë fati i mbrojtjes së vazhdueshme, ka qenë fati i një populli të varfër dhe shpeshherë të nënshtuar. Le t'i lëmë mënjanë të gjitha këto fakte të dhimbshme edhe le të bëjmë pyetjen: Si mundet dikush, i cili nuk disponon asnjë mekanizëm shtetëror, prapa të cilit nuk qëndron forca që quhet shtet, të rrezikojë ndonjë tjetër që disponon të gjithë mekanizmat shtetërorë dhe prapa të cilit qëndron forca që quhet shtet? A nuk është ulur në këtë rast Dobrica Qosiçi nga lartësia e së vërtetës dhe ka rënë në kënetën e propagandës?

E vërteta që ofrohet sot nëpërmjet mjeteve të informimit publik për shqiptarët mbështetet në tezën e Qosiçit, dhe kësaj teze logjika e shëndoshë nuk mund t'i besojë. Duke qenë se njerëzit mund të bashkohen vetëm rreth së vërtetës, atëherë është e arsyeshme që ndarjet në vlerësimin e gjendjes në Kosovë të jenë të dukshme, pavarësisht nga presionet që bëhen nga të gjitha anët që për Kosovën të mendohet sipas tezës së Qosiçit. Nuk duhen shumë mend për të kuptuar se cili do të ishte fati i shqiptarëve, në qoftë se strategjia e qëndrimit politik dhe shtetëror ndaj tyre do të bazohej në një tezë të tillë. Në këtë mënyrë, për fat të keq, shkrimtari i madh nuk lë asnjë minimum mekanizmi për të ardhmen tonë.

Pyetje: Jeni nënshkruar Apelin të 215 intelektualëve shqiptarë nga Kosova. Çfarë mendoni tani për këtë veprim dhe për Apelin, mbas gjithë vlerësimeve dhe qëndrimeve zyrtare në Krahinë dhe Republikë?

Përgjigje: Si një nga nënshkruarit dhe iniciatorët e tij, mendoj se Apeli i lartpërmendur është një lutje e zakonshme, të cilën e parashtruan dhe e nënshkruan intelektualët, që gjendja politike i detyron të shkruajnë apele në vend të memorandumeve. Megjithatë, strukturat poli-

tike e shfrytëzuan këtë lutje për t'i vënë edhe më shumë pas murit intelektualët shqiptarë, në mënyrë që të mos kuptoheshin më për atë që shkruanin në lutjen e tyre dhe të mos e hapnin më gojën për të thënë diçka pa miratimin e këtyre strukturave. Zhurma shumë mujore rreth këtij Apeli tregon mjaft qartë se sa delikate dhe politikusht e pasigurtë është pozita e inteligjencies shqiptare. Intelektualët serbë kanë shkruar memorandume, pastaj projekt kushtetutë, një numër të madh peticionesh, kanë bërë një numër të madh propozimesh, me anë të të cilave ofrojnë vizione të reja të Jugosllavisë, me të cilat ndryshon plotësisht fakti kushtetues ose mohohet identiteti i disa kombeve dhe, megjithatë, atyre nuk u ka rënë asnjë fije floku nga koka. Akademiku Antonie Osakoviç është një nga autorët kryesorë të memorandumit të Akademisë Serbe, por vazhdon të jetë shef edhe sot, nënkryetar i së njëjtës akademi. Për shkak të Apelit të 215 intelektualëve shqiptarë, këta të fundit dënohen nga partia dhe përjashtohen prej saj, pushohen nga puna, shkarkohen nga pozita e dekanit, zëvendësohen apo e redaktorëve etj. Reagimet politike ndaj Apelit në fjalë tregojnë se represionet politike, fushatat kundër njerëzve, demaskimet dhe poshtërimet për shkak të mendimit të shprehur në mënyrë demokratike, në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo, janë në dëm të të gjithëve, pra, edhe në dëm të vetvetes. Nuk ka dyshim se fushata kundër nënshkruesve të Apelit është shumë kundërproduktive për kulturën e jetës në Kosovë.

Pyetje: Si e shikoni zgjidhjen e problemit të Kosovës në kuadrin e Serbisë dhe të Jugosllavisë?

Përgjigje: Pikë së pari, zgjidhja e problemit të Kosovës duhet të kërkohet në zhvillimin e Kosovës. Shumë fatkeqësi të Kosovës janë kushtëzuar nga prapambetja ekonomike, nga papunësia, nga niveli i ulët i jetesës. E dyta, sipas mendimit tim, zgjidhja e problemit kosovar duhet të kërkohet në vendosjen e ekuilibrit në marrëdhëniet ndërnacionale, dmth, në vendosjen e ekuilibrit në të drejtat e kombeve në Jugosllavi.

Nga shkencat e natyrës dihet se në natyrë ekziston harmonia universale, e cila mbështetet në ekuilibrin e forcave dhe të ligjeve të saj. Nga shkencat historike dihet

se më të stabilizuara janë ato shoqëri, në të cilat është vendosur ekuilibri midis pjesëve të tyre. Për mungesë të ekuilibrit në të drejtat e liritë, barazinë kolektive dhe individuale, lindin pakënaqësi dhe mosmarrëveshje. Politika e ndërtuesve të Federatës Jugosllave synonte një ekuilibër sa më të plotë në marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavi, por sot ky ekuilibër është prishur shumë. Kërkesa për heqjen e parimit të paritetit është faktikisht desubjektivizim i disa njësive federative, kurse regresi kushtetues në Kosovë është një argument tjetër që provon praktikisht orientimin për prishjen e ekuilibrit. Represioni është një mjet, me anën e të cilit ekuilibri ruhet në mënyrë artificiale, sepse ekuilibri real mbështetet në demokraci, në barazinë nacionale të vendosur në bazë të vullnetit të lirë të të gjitha pjesëve të së tërës dhe jo në bazë të detyrimit me forcë të ndonjë apo të disa pjesëve të saj.

Pyetje: Kur flitet për kërcënimin e Jugosllavisë nga armiku i brendshëm, shikimi hidhet drejt Kosovës. Sa e ndiejnë shqiptarët e Kosovës këtë Jugosllavi si atdhe të vetin?

Përgjigje: Dihet se kur në politikë flitet për armikun e brendshëm dhe të jashtëm, kjo do të thotë se qytetarët duhet të futen në vrimën e miut. Dhe përrallat për rrezikimin e Jugosllavisë nga shqiptarët janë vetëm përralla. Njerëzit me arsye objektive dhe dashamirës e kanë të qartë se shqiptarët dëshirojnë stabilizimin dhe një përparim sa më të madh të Jugosllavisë, sepse në çdo drejtim kjo është edhe në interesin e tyre. Por nuk janë fajtorë shqiptarët për vështirësitë e sotme të shoqërisë jugosllave. Megjithatë, me përjashtim të sllovenëve dhe pjesërisht të kroatëve, të tjerët i konsiderojnë shqiptarët si të huaj, si një trup të padëshirueshëm në organizmin e Jugosllavisë. Fajtoje për këtë është propaganda 8-vjeçare anti-shqiptare. Kurse pyetjes si e konsiderojnë sot shqiptarët Jugosllavinë, në të cilën dy herë gjatë 8 vjetëve janë vënë përballë masave të jashtëzakonshme, mund t'i përgjigjesh lehtë: si shtetas të Jugosllavisë, por është e vështirë t'i përgjigjesh objektivisht. Përgjigja për këtë pyetje mund të sigurohej me anën e ndonjë ankete. E vërteta është se shqiptarët sot janë në ankth, druhen përpara politikanëve,

përpara milicëve, përpara ushtarëve, përpara hetuesve, përpara gjykatësve; janë në ankth për punën e tyre, për familjen e tyre, për dinjitetin e tyre, për sigurimin e tyre, për të ardhmen e tyre. Shteti, sikurse ka thënë një politikan i urtë dikur, i cili, me sa duket, nuk jetonte në Ballkan, që të gëzojë dashurinë e qytetarëve të vet, duhet të jetë një shtet i tillë, nga i cili qytetarët të mos kenë frikë.

Pyetje: Ju jepni mësim në universitet dhe jeni në dijeni të të gjitha zhvillimeve në këtë institucion arsimor. Sa i saktë është pohimi se Universiteti i Prishtinës është «truri i separatistëve», ose «çerdhe e nacionalizmit»?

Përgjigje: Përpara disa ditësh mund të lexoje në gazetatat e përditshme konstatimin politik se «veprimtaria e nacionalistëve shqiptarë vazhdon të jetë e theksuar në mënyrë të veçantë në Universitet, në institucionet arsimore, në Arkivin e Kosovës, në Institutin e Historisë, në Institutin Albanologjik dhe në mjetet e informacionit publik në gjuhën shqipe». Sipas këtij konstatimi, të gjitha institucionet arsimore, kulturore dhe shkencore në gjuhën shqipe janë politikisht të dyshimta. Ç'do të thotë kjo? Të gjitha institucionet, në të cilat flitet në gjuhën shqipe, sipas këtij konstatimi, veprojnë në mënyrë nacionaliste. Vallë një konstatim i tillë nuk e barazon ndërgjegjen kombëtare shqiptare me nacionalizmin? Nuk shpallen kështu nacionaliste të gjitha veprimtaritë kulturore, arsimore dhe shkencore të shqiptarëve? A mund të flasim intelektualët shqiptarë për historinë, kulturën, gjuhën, folklorin, shkencën e tyre, për marrëdhëniet serbo-shqiptare dhe të mos akuzohen si nacionalistë? Një qëndrim i tillë ndaj kulturës, shkencës, arsimit dhe inteligjencies shqiptare ka pasoja shkatërrimtare për zhvillimin tonë kulturor dhe integritetin tonë shpirtëror. Ka vite që revistat shkencore, letrare dhe kulturore në gjuhën shqipe nuk mund të sigurojnë punime për botim. Forcat krijuese shqiptare gati janë paralizuar në fushat e shkencës, të artit dhe kulturës. Nuk ka më komunikime kulturore me botën, komunikime kulturore brenda kulturës kombëtare në vetë Jugosllavinë. Propaganda e pamëshirshme, e cila nuk po pushon edhe pas kufizimit të pozitës kushtetuese të Kosovës dhe që po e thellon gjithnjë e më shumë geton tonë

kulturore, diferencimi, i cili shkakton hapur imigrimin e brendshëm të krijuesve, dyshimet e vazhdueshme politike dhe të tjera të drejtuara për të shkaktuar pasiguri, brutaliteti i pafund politik, represioni i gjithanshëm shtetëror që shkakton dëshpërim, a nuk janë të gjitha këto një klimë genocidi me pasoja të rënda politike, kulturore, shpirtërore, psikologjike dhe shëndetësore për popullin shqiptar?

Pyetje: Shpërngulja e popullsisë joshqiptare nga Kosova është e evidente. Më shpesh përmenden dy arsye: presioni i shqiptarëve dhe shkaqet ekonomike. Në cilin vend është më mirë dhe përse shqiptarët nuk shpërngulen, por vendosen?

Përgjigje: Në Kosovë e ndiejnë veten shumë keq të gjithë. Shumë do të dëshironin të jetonin në ndonjë vend tjetër. Largimi i serbëve dhe i malazezëve nga Kosova me të drejtë ndihet më shumë. Por largohen edhe shqiptarë dhe në një numër gjithnjë e më të madh. Shqiptarët nga Maqedonia dhe nga Mali i Zi më parë vinin në Kosovë, po tani jo. Tani shqiptarët nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi shpërngulen shumë larg, në Turqi, në vendet e Evropës Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mirëpo për ta askush nuk mban ndonjë evidencë, askujt nuk i interesojnë shkaqet e shpërnguljes së tyre. Shqiptarët që shpërngulen sot nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi asnjëri nuk do t'i ftojë kurrë që të kthehen në vatrat shekullore. Përse? Mbase për arsye se janë në numër të madh.

Pyetje: A mund të flitet për një konflikt midis inteligjencies shqiptare dhe politikës zyrtare?

Përgjigje: Sipas mendimit tim, në Kosovë mund të flitet për një politikë, e cila do të dëshironte që të asgjësonte çfarëdolloj autonomie intelektuale dhe për fat të keq në këtë drejtim kjo politikë në Kosovë është mjaft e suksesshme.

Pyetje: A mund të flitet për një krizë morali dhe besimi?

Përgjigje: Kriza jugosllave është njëkohësisht edhe krizë morale. Kur njeriu dëgjon dhe shikon se çfarë flitet, çfarë bëhet, si vlerësohet, çfarë synohet të bëhet, atëherë e kupton se kriza morale është më e thellë. Një perëndi e

di se sa individë të ndryshëm kanë hyrë në skenën politike dhe kanë mundësi që të vendosin për fatet e njerëzve, për të sotmen dhe të ardhmen, madje edhe për jetën dhe vdekjen. Nga tribunat politike prodhohen aq shumë brutalitete, shqetësime, pandjeshmëri morale, kërcënime, sa njeriut i zihet fryma dhe trembet për fatet individuale dhe kolektive. Mohohet çfarëdolloj lidhjeje midis politikës dhe moralit, midis politikës dhe parimeve politike e morale. Dhe kur politika shkëputet plotësisht nga morali, atëherë çdo gjë është e mundur.

*«Evropa na balkanski način»,
«Oslobodjenje», Sarajevo,
18.6.1989*

Jusuf Buxhovi

LETËR E HAPUR DREJTUAR KRYETARIT TË KRYESISË SË RSFJ JANEZ DËRNOVSHEK

I nderuar shoku Kryetar,

Në letrën tuaj që u botua në gazetën «Dello» të Lubjanës ju shkruani se «izolimi, pavarësisht nga numri i të izoluarve, është një maskë që rëndon shumë jo vetëm mbi ata, kundër të cilëve është ndërmarrë, por edhe mbi të gjithë ne» dhe se Kryesinë e kanë informuar se «masat e izolimit janë në fuqi vetëm për një numër minimal njerëzish, ndërsa edhe kundër tyre do të hiqen së shpejti». Në këtë letër, ashtu si dhe në intervistën dhënë «Shpigelit» gjermanoperëndimor, ju shpreheni për një shtet juridik dhe për «respektimin me konsekuencë të kushtetutës e të ligjeve, si dhe për efikasitetin e të gjitha institucioneve të sistemit».

Me keqardhje konstatoj se shteti juridik në Kosovë ka një kohë të gjatë që nuk vepron. Kjo ndodh për shkak se normat dhe ligjet që rezultojnë nga kushtetuta dhe që janë miratuar ligjërisht nga viti 1971 e këtej, në pjesën më të madhe janë zëvendësuar nga qëndrimet parti-ake dhe projekte të ndryshme politike, nga një numër i madh rezolutash dhe konkluzionesh, që miratohen vazhdimisht, çdo javë. Partia, e cila duhej të siguronte bazat ideologjike e politike për realizimin e kushtetutës dhe të

ligjshmërisë, ka kontribuar për likuidimin e pushtetit juridik. Mendoj se kryesia e mëparshme e RSFJ mban një përgjegjësi të madhe dhe një pjesë të madhe të fajit, sepse ka lejuar që partia të marrë në dorë udhëheqjen e shtetit dhe madje ka caktuar vetë se kur dhe kush mund të punësohet, kush dhe kur mund të bëhet drejtues i ndonjë ndërmarrjeje, cili dhe kur mund ta zgjedhin delegat, kush mund të udhëheqë mjetet e informacionit publik dhe kush dhe kur mund të ulet mbi këtë apo atë kolltuk, kush dhe kur mund të shkruajë një libër, ç'duhet të flasë në forumet etj. Madje ajo ka marrë vendime se kush dhe kur duhet të arrestohet dhe të ndiqet penalisht. Në kohën e tanishme partia «në emër të stabilizimit të gjendjes së këtushme» vendos edhe se cili duhet të pushohet nga puna, cili duhet të zgjidhet në organet vetadministruese dhe cili nuk duhet të zgjidhet.

A mund të ekzistojë vallë në këto kushte shteti juridik dhe kushtetutshmëria, për të cilën shpreheni ju, shoku Kryetar, në qoftë se në Kosovë njerëzit japin llogari, sepse kanë shprehur mendimet e tyre gjatë debateve për kushtetutën? Pra, a mund të ekzistojë një shtet juridik në qoftë se te ne ndiqet penalisht kushdo që ka përsëritur, perifrazuar ose cituar ndonjë autor apo libër të botuar në pjesët e tjera të shtetit tonë për ndonjë problem aktual? Vallë, a mund të flitet për një shtet të lirë dhe juridik, në qoftë se intelektualëve shqiptarë u mbyllet të gjitha mundësitë për të shprehur çfarëdo mendimi të lirë në mjetet e informacionit në gjuhën shqipe? Vallë, mund të flasim për shtet juridik dhe demokraci, në qoftë se dikë e persekutojnë vetëm se i ka dërguar një letër ndonjë reviste brenda shtetit tonë, në të cilën ka shprehur mendimin e tij që dallohet nga mendimi i të tjerëve? Vallë, a mund të ekzistojë shtet juridik atje ku njerëzve u gërmohen dosjet e së kaluarës për arsye se me një të parë të tij të largët e kanë shpallur «irredentist»? Vallë, a mund të jetë shtet juridik ai, në të cilin një 18-vjeçar nuk mund të regjistrohet në fakultet vetëm për faktin se ndonjë fisi i tij i largët ka rënë në konflikt me shtetin dhe partinë dhe s'dihet përse? Vallë, a mund të flasim për shtet juridik në qoftë se ndonjëri mban emrin e ndonjë personaliteti, të cilin dikush e ka shpallur

si emër që të kujton nacionalizmin? Vallë, a mund të quhet shtet juridik ai ku dikë e ftojnë dhe i hapin të gjitha mundësitë për t'u punësuar vetëm sepse është pjesëtar i ndonjë kombi të caktuar?

Po t'i shfletoni këto ditë gazetatat, mund të shikoni se çfarë po ndodh me nënshkruesit e Apelit të 215 intelektualëve shqiptarë. Pa pikë mëshire ata përjashtohen nga partia, pushohen nga puna dhe shumë prej tyre do të përfundojnë në burg. Kryesia e Komitetit të LK të Prishtinës (për shkak të autorizimit dhe kompetencave që i janë dhënë nga masat e jashtëzakonshme) mendimin e lirë të intelektualëve shqiptarë, të shprehur gjatë debateve për kushtetutën, e shpalli si «Pamflet politik» dhe «veprimtari antikushtetuese» për «shkatërrimin e Jugosllavisë»! Në qoftë se dikë në Kosovë e cilësojnë në këtë mënyrë, mund të merret me mend se në ç'pozitë do të ndodhet ai.

Si nënshkrues i këtij Apeli nuk e ndiej veten të fyer për shkak se Kryesia e Komitetit të LK të Prishtinës më ka përjashtuar nga LKJ-ja, më ka shpallur «armik» etj., (kam lindur në vitin 1946 dhe jam rritur e edukuar në këtë bashkësi jugosllave), por më fyen fakti se veprimtarët partiakë filluan të fyenin dinjitetin tim njerëzor dhe dinjitetin e intelektualit me anën e kërcënimeve të ndryshme dhe në këtë rast u orvatën të më bindnin se kam shpërdoruar të drejtën kushtetuese për shprehjen e lirë dhe demokratike të mendimit me qëllim që të «shkatërroj Jugosllavinë»! Mendoj se edhe në shtetin afrikan të Biafras do të respektonin shprehjen lirisht të mendimeve gjatë debateve të shpallura si demokratike dhe asnjërin nuk do ta persekutojnë për shkak të mendimeve të tij. Por te ne për mendime të tilla dënohesh në mënyrë drakoniane.

Si shkrimtar, autor i 12 librave të botuara, nuk kam frikë për fatin e librave të mi dhe as për fatin tim (sepse dëshiroj që të kem fatin e tanishëm dhe të ardhshëm të popullit tim). Nuk frikësohem për fatin e veprave të mia për shkak se veprat e botuara hyjnë në histori, por kam frikë për lexuesit e librave të mi, pasi do ta pësonin rëndë në qoftë se gjatë kontrolleve policore do t'u gjenin në shtëpi libra të shkrimtarëve «që kanë rënë në konflikt me partinë»!

Jam i ndërgjegjshëm se nuk mund të përgjigjemi për punën e LKJ-së dhe veprimet e saj. Përveç kësaj, mendoj se është e qartë se tani represionet partiake dhe ato shtetërore janë binjakë, gjë që do të thotë se «mëkatet partiake» mundet shumë lehtë dhe shpejt të shndërrohen detyrimisht në «veprimtari» antishtetërore. Pyes, cilat do të jenë instrumentet e Kryesisë së RSFJ-së që të mund të ndalohet një gjë e tillë?

Jusuf Buxhovi, shkrimtar,
Prishtinë

*«Otvoreno pismo književnika
Jusuf Budzovija, Predsedniku
Predsedništva SFRJ dr. Ja-
nezu Drnovšek», «Borba»,
Beograd, 19.6.1989*

Dr. Zekeria Cana, historian shqiptar,
për Kosovën sot

FSHESA E ÇELIKTË NUK KURSEN ASKËND

— Intervistë në «Nedelna Dalmacija» —

Në emër të «diferencimit» po kryhet një spastrim rrënjësor, po shkatërrohet e tërë struktura e kuadrove për t'u ngritur, gjoja, një e re. Praktakisht kjo do të thotë që, në postet drejtuese, në vend të specialistëve të aftë, të vendosen njerëz medio-kër, cilësia e vetme e të cilëve është të bindurit dhe të përulurit. — Në Kosovë ranë viktima pa as edhe një fjalë keqardheje ose proteste publike. — Forcat që e ndotën klimën kosovare me gazra të rrezikshme helmuese vazhdojnë të jenë shkatërruese. Kush do t'i ndalojë ato? Mbase një plenum i ri i Brionit.

Ante Ivković

Në listën e intelektualëve shqiptarë «të padëshiruar» në Kosovë, menjëherë pas Ibrahim Rugovës dhe Rexhep Qoses, ndodhet Zekeria Cana, historian i njohur shqip-

tar. Dr. Cana iu nënshtrua sulmeve, sidomos kur e kritikoi ashpër dhe publikisht kolegun e tij, dr. Gani Jasharin, tani kryetar i Organizatës së Partisë së Prishtinës, për qëndrimin e tij ndaj nënshkruesve të «Apelit të të 215-ve» dhe për cilësimin e këtij dokumenti sikur është bërë nga pozitat e separatizmit shqiptar. Për këtë arsye, është me interes të marrim vesh se çfarë thotë ai lidhur me këto sulme dhe cila është pikëpamja e tij për gjendjen në Kosovë.

Apeli nuk është i diskutueshëm

— «Apeli 215» është sulmuar ashpër. Përse ndodhi kështu dhe cilat ishin qëllimet tuaja kur e shkruat dhe e nënshkruat atë?

— «Apeli 215» në shtypin e verdhë është paraqitur nën një dritë shumë të keqe, tamam si ndonjë akt i një tradhtie të lartë. Është një e keqe e madhe që teksti i tij nuk u botua në të gjitha gazetat. Ai nuk është botuar as edhe në «Rilindja», e përditshmja e vetme në gjuhën shqipe, e cila, për fat të keq, është bërë fushë veprimi e vasalëve të bindur. Kundër «Apelit» është hapur një zjarr i kryqëzuar për të vetmen arsye se atë e kanë nënshkruar punonjës shqiptarë të kulturës dhe të shkencës. Në të nuk ka asgjë të diskutueshme. Megjithatë, në rolin e prokurorit shtetëror u vu edhe Sinan Hasani. Shkrimtari i njohur mbase duhet pyetur: A e konsideron ende romanin «Era dhe lisi», (sipas të cilit është xhiruar filmi dhe seria televizive me të njëjtin emër) vepër të tij? Binak Maxhari, profesor universiteti dhe sekretar ekzekutiv i sapozgjedhur i LK të Komunës së Prishtinës, sillet si ndonjë kuestor në detyrë. Shkrimtari për fëmijë Rifat Kukaj (anëtar i ri i Komitetit të LK të Komunës së Prishtinës) vepron më i kujdesshëm: ai bisedon vetëm për vetëm me poetët dhe shkrimtarët «duke iu lutur» atyre të pendohen dhe ta tërheqin firmën. Në intervistën dhënë NIN-it Agim Mala (drejtor i Televizionit të Prishtinës), megjithëse për intelektualët shqiptarë shprehet me një dozë të madhe respekti, thekson edhe «dëmin e dukshëm

politik të Apelit». Disa nga pikëpamjet e tij lidhur me dramën kosovare përputhen me «vlerësimet» e Gani Jasharit.

— Megjithatë, disa e kanë tërhequr nënshkrimin nga Apeli?

— Deri tani këtë gjë e ka bërë vetëm dr. Liman Matoshi. Si shpërblim ai u përjashtua nga Komiteti i LK të Komunes së Prishtinës dhe mori vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga partia. Me të vërtetë, në vend që të vinte vetulla, ai nxori sytë, dhe që këtej «apelistët» e lëkundur nxorën një mësim shumë të dobishëm se çfarë mund t'i presë ata, pavarësisht nga pendimi. Akoma më keq po e pësojnë edhe ata intelektualë të rrallë që nuk e nënshkruan Apelin. Atyreve u janë gjetur «mëkate» të tjera. Fshesa e çeliktë nuk kursen askënd.

— Megjithatë, ndaj jush nuk janë marrë masa. Ju punoni i qetë në punën tuaj dhe askush nuk ju prek, përveçse ju sulmojnë verbalisht.

— Kush e thotë këtë? Masat ligjore, mbase, janë më të durueshme se represioni psikologjik. A mund ta mendoni se si ndihet njeriu në moshën time kur ka përshtypjen se atij i përgjojnë telefonin, i kontrollojnë postën, i mbajnë gazetat, madje edhe revistat shkencore dhe, veç këtyre, ndihet edhe në një mbikqyrje të vazhdueshme? Të gjitha këto së bashku të krijojnë një ndiesi të dhimbshme e të vrasin dëshirën për jetë e për punë. Bashkësia krahinore për punën shkencore nuk e financoi botimin e dorëshkrimit tim, për të cilin kam bërë një punë shkencore shumëvjeçare. Të njëjtin fat pati edhe dorëshkrimi i dr. Hajrullah Goranit, nga fakulteti ekonomik. Këto nuk janë më sanksione, por hakmarrje.

— Si e kanë kaluar «apelistët» në izolim?

— Përpara disa kohësh i bëra një vizitë dr. Rexhep Ismailit dhe kolegut më të ri dr. Muhamed Shatrit. Ata dukeshin sikur ishin kthyer nga kampi i përqendrimit. Ç'mund të thotë për këtë Jusuf Karakushi, i cili ka nënshkruar vendimin për izolimin? Ndërkohë që të izoluarit ndodheshin nën bravën e burgut, shefi i policisë së Kosovës deklaronte para kamerave televizive se zërat për keqtrajtimin e tyre ishin dezinformata të kulluara

armiqësore, ndërsa sekretari i komitetit krahinor të LK të Kosovës, Tomislav Sekuliç, i deklaronte revistës «Danas» se «kjo nuk është e mundur të ndodhë te ne».

— A do të thotë kjo se intelektualët shqiptarë i kanë detyruar të heshtin?

— Intelektualëve shqiptarë u është cinguar prej vitesh e drejta demokratike qytetare e të shprehurit lirshëm të mendimit dhe ideve (sado progresive të kenë qenë këto) dhe ata janë dënuar të zhvillojnë vetëm një monolog të shurdhër. Kjo heshtje shumëvjeçare më në fund u çka me hapjen e diskutimit publik për ndryshimet kushtetuese. Por kjo klimë politike demokratike ishte jetëshkurtër. Pas votimit të amendamenteve kushtetuese në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes së kushtetutës së re të RS të Serbisë filloi stuhia. Ata që i shprehnin lirisht mendimet e tyre në debatin kushtetues, në të cilin u ftuan, tani duhet të paguajnë me radhë një haraç të madh, madje edhe me çmimin e flakjes nga puna. Në forumin përfaqësues të Kosovës luhen skena tragjikomike. Delegati Agim Kastrati u ndoq nga Kuvendi, sepse e quajti Rexhep Hoxhën, kryetarin e ri të organizatës së rinisë të Kosovës, produkt të laboratorit të Frankenshtajnit. I njëjti fat po e pret edhe Riza Lukën dhe të gjithë delegatët e tjerë «të rebeluar».

«Kështjella nacionaliste»

— Institucioni ku punoni, Instituti Albanologjik, është quajtur kështjellë e nacionalizmit shqiptar. Deri në çfarë mase qëndron ky vlerësim?

— Kjo etiketë iu ngjit më parë Universitetit të Prishtinës. Për unitaristët dhe kundërshtarët e betuar të politikës së barazisë nacionale dhe të transformimeve kulturore të kombësisë shqiptare krijimi i Universitetit ka qenë halë në sy. Instituti Albanologjik, në kohën para plenumit të Brionit, në mes të viteve 50-të, u suprimua për t'u ringjallur vetëm pas plenumit IV të KQ të LKJ-së. Për këtë arsye nuk është rastësi që fill pas shpërthimit të demonstratave të studentëve (në vitin 1981) Univer-

siteti u gjend nën goditje, si «kështjellë e nacionalizmit shqiptar». Këtë cilësim të rëndë e shprehu i pari Milan Daljeviç me përkrahjen e fuqishme të bashkëmendimtarëve të tij dhe gati të tërë shtypit të Beogradit. Pas plot tetë vjetëve, rektori i Universitetit të Prishtinës, dr. Stefan Balosheviç deklaroi: «Doli se kjo diagnozë është vendosur saktë».

Në valën e fushatës kundër trashëgimisë shpirtërore dhe historike shqiptare nuk duhet të befasohej as edhe nga kërkesa për heqjen e një institucioni kaq të shquar e të mirënjohur në botë, siç është Instituti Albanologjik. Kjo për faktin se Kosova po kthehet në gjendjen para Brionit. Tani po fillon beteja që shënon deshqiptarizimin e plotë. Kështu, ndërsa, nga njëra anë, kërkohet suprimimi i Institutit Albanologjik, nga ana tjetër, krijohet Instituti për Sllavistikën.

— Si e kuptoni dhe e përjetoni diferencimin në Kosovë?

— Në emër të «diferencimit» po kryhet një spastrim rrënjësor vertikal dhe horizontal në organizatat shoqëro-politike, në organet e administratës, në forumet përfaqësuese, në organizatat ekonomike, në mjetet e informacionit publik, institucionet shkencore etj. Me një larje të tillë hesapesh, të paparë që nga çlirimi i vendit e këtej, po shkatërrohet e tërë struktura e kuadrove për t'u ngritur një e ashtuquajtur e re. Praktikisht kjo do të thotë që në postet drejtuese, në vend të specialistëve të aftë, të sprovuar dhe që e meritojnë, të vendosen mediokër dhe fillestarë, por të bindur dhe të përlulur. Struktura nacionale po «përmirësohet» me zëvendësimin e kuadrove shqiptarë me serbë dhe malazezë — sidomos në ekonomi. Del se këtë qëllim ka pasur edhe izolimi i inxhinierëve, teknologëve, ekonomistëve, juristëve dhe specialistëve të tjerë. Asnjë nga ish-të izoluarit nuk është kthyer në vendin e mëparshëm të punës ose është vendosur në një post, nga i cili është i detyruar të japë dorëheqje «vullnetarisht». Qëllimi final i këtyre «masave preventive» policore është krijimi i terrenit të përshtatshëm dhe i të gjitha premisave paraprake për realizimin e një plani të përpunuar mirë që më parë lidhur me integrimin e gjigantëve të Kosovës (Elektroekonomia, Trepça) në sistemin ekonomik

të Serbisë. Nuk duhet shumë mend për të kuptuar se në këtë mënyrë shkohet drejt restaurimit të politikës ekonomike sipas modelit të njohur metropol-koloni.

— Ndërkohë, termi «shqiptar i ndershëm» po përdoret shpesh. Me sa duket, këta janë ata që mendojnë ndryshe nga ju. Për këtë arsye ju pyesim, cilët janë këta shqiptarë të ndershëm në Kosovë?

— Para së gjithash, ata janë persona me qëndrim prej të binduri dhe të përluluri, të cilët e tregojnë dashurinë dhe besnikërinë ndaj këtij vendi me atë që kanë bërë martesë të përziera, që në shtëpinë e tyre nuk flitet shqip, që nuk u bie aspak ndërmend për identitetin e tyre kombëtar. Më pas vijnë dallaverexhinjtë dhe intrigantët, njerëzit pa shtyllë kurrizore dhe shpifësit, të cilët nuk kursejnë askënd dhe mund të shkelin edhe mbi kufoma për të arritur qëllimin e tyre. Në Kosovë, diferencimi kryhet edhe brenda familjeve shqiptare, në atë mënyrë që fëmijët distancohen nga baballarët e tyre, të padenjë për emrin prind, ose anasjelltas. Që të mos zgjaten, sipas mendimit tim, një «shqiptar gjoja me orientim jugosllav» është vetëm sinonim i renegatit. Në fund të fundit, (siç e ka treguar edhe historia) ata do të përfundojnë të mjerë e të urryer, të përbuzur nga populli i tyre dhe do të flaken tej nga padronët e tyre.

Ç'është genocidi?

— Në Kosovë u derdh gjak. Po të përdorim gjuhën e gazetarëve, viktima pati si nga njëra, ashtu edhe pala tjetër. Pjesëtarët e sulmuar të forcave të sigurimit u përgjigjën me zjarr. Gjakderdhja në Kosovë përmendet me ngjyresa të ndryshme.

— E si të mos përmendet kur është derdhur gjaku i të rinjve e të rejave! A duhet të arrihej deri këtu? Nga ana zyrtare është njoftuar se në Kosovë shpërtheu një kryengritje e armatosur dhe se milicia iu nënshtrua sulmit të armatosur, prandaj u detyrua të vëjë në përdorim masat ekstreme të vetëmbrojtjes. Po çfarë tregon fakti se nga ana e organeve të sigurimit publik u vranë dy veta, ndërkohë që numri i demonstruesve të vrarë

mbase nuk do të merret vesh kurrë? Edhe në Gjeorgji u shkaktua gjakderdhje, por u shpall zi kombëtare dhe fajtorëve të dramës së përgjakshme iu dhanë dënime shumë të ashpra. Dhunën në Kinë e dënuan shumë institucione dhe organizata rinie të Jugosllavisë. Numri i viktimave në Kosovë, po ta marrim në raport me përqindjen e popullsisë, nuk është aspak më i vogël se në Kinën e largët. Megjithatë, zëri i keqardhjes dhe i protestës nuk u dëgjua. Kështu pra: jashtë interesohemi për një shoqëri humane, të civilizuar dhe për ruajtjen e jetës së njerëzve, në vendin tonë miratojmë dhunën dhe mbajmë një qëndrim indiferent ndaj viktimave.

Demonstratat e fundit, të zhvilluara në maj, morën një cilësim të ri: ato nuk janë më «shkallëzim i nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar», por «shpërthim shkatërrues i terrorizmit dhe egërsisë». Nëse dikush është i interesuar për të vërtetën e vetme, ajo është kjo: natën e parë studentët u grumbulluan rreth qendrës së tyre, kënduan dhe hodhën parulla, ndërsa organet e sigurimit publik bllokuan hyrjen dhe nuk ndërhyjnë. Në të vërtetë, për këtë ato nuk patën asnjë arsye, sepse rinia nuk bëri asnjë hap larg rrethit të saj. Megjithatë, natën e dytë (kur parlamentarët evropianë ishin larg nga Prishtina) milicia u hodh në aksion. Ajo nuk u mjaftua me shpërndarjen e studentëve me gaz lotsjellës dhe shkopinje prej gome, por përdori edhe shkallën e fundit të masave «të nevojshme» — i ndoqi nëpër shtëpi, u fut nëpër korridore dhe dhoma dhe goditi kë zuri. Kjo ishte një hakmarrje klasike. Përballë kësaj, studentët e bllokut të pestë, në hyrjen e katit të pestë ngritën një barrikadë me krevate, dyer dhe gjithçka tjetër që u ndodhej pranë. Kurse Balosheviçi, nga kolltuku i rektorit, i deklaroi gazetarit të TV të Beogradit se studentët kanë thyer dyert, dritaret dhe kanë shkatërruar inventarin. Sipas pikëpamjes së tij, ky ishte «terrorizëm dhe egërsi».

— Ju përmendët parlamentarët evropianë, takimi i të cilëve me intelektualët shqiptarë në hotelin «Grand» është vlerësuar në mënyrë të ndryshme. Kush qëndron në të vërtetë pas këtij takimi?

— Disa dukuri dhe ngjarje duhen shikuar në lidhje të ngushtë dhe në vazhdimësi historike. Nuk do të ishte

keq po të bëhej një paralelizëm midis vitit 1913 dhe 1989. Gjatë kohës së luftërave ballkanike, kur në kabinetet evropiane shkonin njoftime lidhur me persekutimet e popullsisë «së çliruar», kryetari i qeverisë serbe, Nikolla Pašić, nuk i lejonte gazetarët e huaj të vinin në Kosovë dhe Metohi. Megjithatë, ai nuk mundi të bllokonte depërtimin e së vërtetës për pozitën e shqiptarëve dhe të maqedonasve nën pushtetin serb. Kuvendi i RSFJ-së nuk ua refuzoi mikpritjen parlamentarëve evropianë, por u cungoi atyre mundësinë për t'u informuar plotësisht në vendin e ngjarjes. Sigurisht, delegacioni i Parlamentit Evropian u largua nga Prishtina para kohe dhe plotësisht i pakënaqur e i fyer. Por kjo, ndoshta, u foli atyre edhe më shumë sesa do të mund të merrnin vesh nga bisedat me intelektualët shqiptarë ose me ndonjë delegat të Kuvendit të Kosovës.

Pra, fjala nuk është për ndonjë bisedë «me dyer të mbyllura» ose për «ndonjë takim të fshehtë». Disa intelektualë, si Agim Vinca, nuk e patën guximin qytetar t'u dilnin përpara parlamentarëve nga frika se do të kishin pasoja të rënda ose ndoshta nga motive të tjera. Megjithatë, sa keq që Vinca nuk iu përgjigj ftesës, sepse ai do të kishte mjaft për të thënë për gjendjen e padurueshme të kombësisë shqiptare në Maqedoni.

— Përse atëherë flitet për genocid në Kosovë, kur në të gjitha dokumentet zyrtare përmendet se serbët dhe malazezët shpërngulen nën presionin e shqiptarëve?

— Kjo përrallë është e vjetër, prej më se 100 vjetësh. Dihet se çfarë është genocidi dhe me çfarë mjetesh kryhet ai. Megjithatë, gjatë tetë vjetëve të fundit është bërë e zakonshme që nga rastet e grindjeve, të dëmeve të shkaktuara, kërcënimeve, ekseseve, ndonjë përdhunimi, si edhe nga disa rrahje të veçanta, të krijohet përshypja për shfarosje, ose, të paktën, aktet penale të cilësohen sikur janë kryer nga motive nacionaliste. Por, a do të quhet genocid përdhunimi i një vajze 11-vjeçare (e kombësisë shqiptare) nga një 77-vjeçar në Podujevë, sulmi fizik kundër një nxënëseje të klasës së shtatë në Titograd, goditja me gurë e një plaku në Verushë nga një grup të rinjsh të kombësisë malazeze ose keqtrajtimi i një gruaje në dyqanin «Beograd» në Titograd?

Dhunimi i fakteve

— Në vend të fërkimeve ndërnacionale, si dhe të konflikteve të hapura, ne të gjithë kemi interes që në Kosovë të sundojë paqja. Si mund të arrihet kjo? A është e mundur bashkëjetesa e popujve në Kosovë?

— Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje shumë të ndërlikuar kërkon mjaft hapësirë. Është fakt i pamohueshëm se në Kosovë janë shkatërruar urat e vjetra të komunikimit të nevojshëm dhe janë minuar themelet e bashkëjetesës, të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, të respektit dhe ndihmës reciproke. Kredoja historike se njerëzit e ndajnë bashkërisht të mirën dhe të keqen është shkatërruar brutalisht. Studimet e ardhshme shkencore do ta tregojnë më mirë se kush e ka kryer këtë krim. Mirë, po ç'duhet bërë më tej që nga këto marrëdhënie ndërnacionale të ftohura, madje do të thoja, të ngrira, të krijohet klima e marrëdhënieve disi normale? Është krejtësisht e sigurtë se kjo kthesë nuk varet më vetëm nga kombësia që përbën shumicën në Kosovë. Ajo nuk është më subjekt aktiv. Shembulli më i freskët është festimi i 600-vjetorit të betejës së Kosovës, e cila mori tiparin e festës serbe, duke dhunuar kështu faktin historik se në këtë betejë morën pjesë të gjithë popujt që ndesheshin me pushtimin turk. Kështu, del se të tjerët kanë qenë në anën e kundërt — në atë të armikut.

E dyta, e gjithë kjo u zhvillua me ndjenjën e ekzaltuar për kohën e artë të popullit serb, të lulëzimit të shtetit të Nemanjiçit, të marshimeve pushtuese të car Dushanit. U derdhën paratë lumë në kushtet e varfërisë së përgjithshme, kur, për shembull, në Kosovë spitalet nuk kanë ilaçe. Në këtë «Heroike» të Bethovenit, e cila ekzekutohet sipas shkopyt të dirigjentit ballkanik me opinga, kumbon grumbullimi imponant në «Kosovën serbe», krahas aromës së fortë të temjanit. Në ekranin e vogël të TV në Beograd shfaqet parulla: «Pa të kaluar nuk ka të ardhme». Kjo është një thirrje për të drejtën historike të serbizmit, «djep» i të cilit qenë Kosova e shenjtë. Do të guxoja të thoja se kjo gjë të irriton, madje të provokon. Mbase në këtë hapësirë, gjatë tërë periudhës së robërisë turke, kurrë nuk ka pushuar rezistenca e arma-

tosur e popullsisë tjetër, asaj të vjetër e autoktone, derisa në shekullin e 19-të dhe në fillim të këtij shekulli shpërthyen kryengritjet më të mëdha të popullit shqiptar, në të cilat serbët nuk kanë marrë pjesë.

Duhet pranuar se forcat, që e ndotën klimën kosovare me gazra të rrezikshme helmuese, janë ende të fuqishme dhe shkatërruese. Kush do t'i frenojë e t'i sjellë në vete ato? Ndoshta një plenum i ri i Brionit?! Por, për këtë, mbase duhet pritur ende. Ndërsa flasin për krijimin e një fronti të përbashkët të kombeve dhe kombësive dhe për bashkëjetesën në Kosovë, të gjithë kujtojnë edhe legjendën e njohur për ndërtimin e kalasë së Shkodrës mbi Bunë.

*Ante Ivkovič: Čelična metlla
në štidi nikoga», «Nedeljna
Dalmacija», Split 23.7.1989.*

Ramiz Kelmendi

SITUATË KAFKIANE

I fyer si njeri dhe intelektual, jam i detyruar t'ju shpreh ndjenjën time të rezistencës dhe të revoltës për pozitën dhe rrethanat ku gjendem jashtë vullnetit tim. Jam i detyruar të flas dhe të protestoj, të shprehem dhe të mbaj qëndrim, të bëj diferencimin tim dhe të tjerëve, të rrëfhem dhe të pendohem, të akuzoj dhe të pështyj veten në mënyrë masonike, t'i bëj lajka vetes dhe të mallkoj, të luaj rolin që më imponojnë si mashtrues dhe servil, të nënshtrohem me përulje dhe të pranoj mendimet dhe vlerësimet e të tjerëve, të pranoj vetëm një të vërtetë dhe vetëm një, për të cilën unë mendoj ndryshe; të heq dorë nga kriteret e mia, nga etika, dinjiteti dhe integriteti im. Shtrohet pyetja: «Përse? Për ç'arsye? Çfarë pune të keqe kam bërë, çfarë krimi, për të cilin duhet të dënohem, madje me vetëdashje, deri në fyerje të vetes? Jam bashkautor dhe nënshkrues i Apelit të 215 intelektualëve shqiptarë.

Njeriu duhet të shprehë menjëherë shqetësimin e tij të thellë për një «diferencim» të tillë të bërë kushedi për të satën herë këtu te ne gjatë këtyre tetë vjetëve dhe vetëm për ne, gjë që bie në kundërshtim me të gjitha rrjedhat demokratike dhe të civilizimit, sepse ky është shembulli më i qartë, madje shembull klasik i mosbarazisë, sepse deri tani nuk gjëndet asnjë shembull në Ju-

gosllavi që dikush të thirret dhe t'i kërkohet llogari, sepse është nënshkrues i ndonjë apeli drejtuar ndonjë organi legal në rrugën më legale.

Jam i detyruar të them se nuk mund të pajtohem me një besnikëri dhe shenjtëri të tillë, e cila nënkupton nënshtrimin dhe mohimin e identitetit e të entitetit personal. Pikërisht te një absurditet dhe praktikë e tillë e pashembullt që i duhet vënë epiteti «nonsens» i një shoqërie demokratike, e ka burimin qëndresa ime. Këtu e ka burimin ndjenja ime që gati për dy muaj rresht gjendem në një situatë paradoksale dhe të pakuptueshme, pikërisht si në situatën e Kafkës, i akuzuar me paramendim, madje dhe i dënuar pa të drejtë për t'u mbrojtur dhe ankuar, ndërkohë që nuk di aspak se përse jam akuzuar dhe ku mbështetet ajo. Është jashtë çdo logjike mendjehetësia, me të cilën ndonjëherë «vlerësohen» dhe u vihen epitete njerëzve, merren vendime, shqiptohen dënime, shumë të rënda dhe aspak të argumentuara, njerëzit diskualifikohen dhe çohen në bangon e të akuzuarve pa asnjë faj.

Këtu qëndron edhe mëdyshja ime: të filloj të flas apo të hesht, ç'qëndrim të mbaj dhe si të orientohem në një konfuzion dhe situatë të tillë jologjike?

Inteligjencia shqiptare për vite me radhë është akuzuar dhe kritikuar se përse hesht, pse nuk flet të paktën një herë. Nuk dëshiroj të kujtoj se në sferën e të drejtave të njeriut, krahas së drejtës për të folur, futet edhe e drejta për të heshtur (në rastin tonë heshtja flet më shumë se e folura).

Nuk dëshiroj të flas për presionin e ushtruar ndaj inteligjencies shqiptare për vite me radhë, e veçanërisht kohët e fundit, për zhgënjimin dhe kompleksin që i është imponuar asaj si faktore e përhershme dhe për dyshimet që i qëndrojnë vazhdimisht mbi kokë si shpata e Damokleut, madje duke u shpallur edhe si armik, në bazë të shprehjes antiqytetëruese «Shqiptar i ndershëm është vetëm shqiptari analfabet». Kur mblodhi forca dhe filloi të flasë, inteligjencia shqiptare, 215 veta nga radhët e saj, u gjend menjëherë në rendin e ditës: u hartuan listat e zeza, ku u akuzuan të gjithë, u bënë fajtorë, madje u shpallën armiq.

Nuk dëshiroj të flas se çfarë shkruan dhe mendon opinioni publik botëror e ai jugosllav për këtë patologji politike, e cila të kujton kohët e egra të së kaluarës, kur fabrikoheshin armiq të të gjitha ngjyrave, krijoheshin dyshime, ku dominonte gënjeshtria dhe demagogjia e udhëhequr nga praktika e njohur dhe famëkeqe e përdorimit të forcës dhe e pushtetit në vend të argumentit. Në Apelin e 215 intelektualëve faktet janë krejt të kundërta me ato që dalin nga «vlerësimi» i kryesisë së KK të LK të Prishtinës. Aq më keq për ta — kur dëgjoj përgjigjen e tyre. Sa paradoksal dhe i pashembullt është ky aksion. Ai lind pakënaqësinë dhe rezistencën, sepse para tij, në Prishtinë, pikërisht nga flamurbajtësi më i shkathët dhe luftëtari kundër «apelistëve» prej kohësh ishte hartuar dhe nënshkruar një peticion drejtuar studentëve joshqiptarë që të bojkotonin mësimin, në të cilin, nëpërmjet 13 kërkesave të shprehura në mënyrë ultimative, kërkohej heqja e të drejtave të shqiptarëve të garantuara nga Kushtetuta e RSF të Jugosllavisë.

Asgjë nuk është më e rrezikshme dhe që shkakton reaksion më të madh sesa e drejta e monopolit të një numri të caktuar njerëzish mbi të vërtetën e shumicës. Monopol për një qëndrim që nuk lejon asnjë vërejtje, mospranim, për të mos folur për të drejtën për një qëndrim tjetër apo të kundërt sapo që ai të përputhej plotësisht me parimet demokratike kushtetuese dhe statuore, për të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit dhe të drejtën për mendim të ndryshëm, madje dhe të kundërt.

Nuk dëshiroj të flas jo sepse jam oportunist apo se mos më akuzojnë për formulën e Koncilit, për simetri apo paralelizëm, ku njerëzve nuk u lejohet të thonë qoftë edhe një fjalë, për peticionin e rektorit Balosheviç me bashkëpunëtorët e tij, që është shumë më i rëndë dhe i pakrahasueshëm me peticionin e 215 intelektualëve, për apele shumë më të këqija, për kërkesa dhe memorandume të panumërta dhe të shumta, të cilat shkatërrojnë kushtetutën, shkelin ligjet, anulojnë republikat, nuk njohin kombet, fshijnë kombësitë, nuk pranojnë gjuhët, i kundërvihen barazisë, kërkojnë homogjenizim e shpesh edhe armë dhe prerje kokash, u kundërvihen rrjedhave demokratike, revokojnë të kaluarën e errët. Them edhe një

herë se nuk kam dëshirë të flas për «elaboratet» famëkeqe të Çubrilloviçit dhe Andriçit për të përzënë të gjithë shqiptarët nga k'ý mjedis, nuk dëshiroj të flas për të ashtuquajturin memorandum «fantazëm» që tashmë njihet nga të gjithë, i cili u ribotua edhe këto ditë në një numër të posaçëm të «Dugës», nuk dëshiroj të flas për protestat dhe mitingjet, nuk dëshiroj të flas për peticionin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë të 27 marsit 1988, as për apelin e fundit të udhëheqjes së Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë, me anën e të cilit kërkohet «heqja e sistemit të një partie, e monopolit politik, ideologjik e shoqëror të Partisë Komuniste dhe të privilegjeve të anëtarëve të saj» etj. Por, jam i detyruar të them se asnjë prej tyre deri më sot nuk është thirrur për t'i kërkuar llogari, pa le të dënohet.

Këtu e ka bazën fyerja ime e thellë, për shkak të metrit të dyfishtë, për shkak të logjikës së dy «kuteve», sepse fjala është për dy kritere (për të mos thënë për dy morale) që në mënyrë artificiale dhe të imponuar duhet të zënë vend në ndërgjegjen tonë, në diskutimin, votimin dhe orientimin tonë. Pra, të zëjë vend ky qëndrim dhe vlerësim i pakundërshtueshëm, zyrtar, për Apelin e të 215-tëve që është një debat i llojit të vet.

Meqë dihet nga të gjithë se asnjë njeri deri më sot nuk i ka mohuar vetvetes të drejtën për barazi, aq më pak mund të pritet kjo nga intelektualët, të cilët, si rezultat i prirjes së tyre të natyrshme, janë gjithmonë të pakënaqur me ekzistuesen e arritur.

Negacioni i tyre është i barabartë me «formën familjare të pranimit të realitetit» (Kërlezha), prandaj nuk thuhet kot se inteligjencia është «ajka dhe lulja e një kombi, është shtresa e sipërme e tij që krijon kulturën». Prandaj, mbase me këtë «fushatë» synohet cungimi, e pse jo, edhe likuidimi i inteligjencies shqiptare dhe në këtë mënyrë të bëhet e pamundur edhe e ardhmja e kombit të saj. Këtu e kanë bazën dyshimet dhe rezistenca.

Mungesa e objektivitetit për vlerësimin e Apelit, mungesa e argumenteve bindëse kompensohen me vendimin se Apeli nuk duhet të lexohet në organizatat bazë të LK-së, por të gjithë duhet të nënshtrohen dhe të veprojnë «sipas urdhrit». Do të thosha se këto janë «tempi

passati». Po për ne jo! Te ne duhet të respektohet pa fjalë dhe të zbatohet nën kërcënimin e dënimit vlerësi-mi i zi i dhënë për Apelin. Çdo mendim tjetër shpallet herezi, armiqësi, madje edhe kundërrevolucion, megjithëse dihet mirë se vetëm uji që rrjedh është i pijshëm, ndërsa uji i ndenjtur është ujë moçali! Prandaj më shqetësojnë shumë dhe gati më tmerrojnë ndërgjegjet tona të fjetura, më frikëson qoftë edhe një shembull i vetëm i nënshtrimit ndaj kolltukut për të provuar lojalitetin dhe besnikërinë tënde, më frikëson dhe më shqetëson fakti që harrohet që secili nga ne gjithmonë dhe kudo, pra edhe në këtë rast, jep provim për ndërgjegjen e tij morale, intelektuale dhe njerëzore ndaj së vërtetës.

«Kafkijanska Situacija», «Danas», Zagreb, 25.7.1989

RUGOVA

— Intervistë botuar në revistën «Start» —

«Kohët e fundit nga disa mjedise po kritikohet shpesh intelektual i lartë dhe shkrimtari shqiptar Ibrahim Rugova, i cili «Startit» i flet për vizitën e parlamentarëve evropianë, për «gabimet» e Vllasit, për shpërnguljet nga Kosova, për homogjenizimet, për zgjimin e ndërgjegjes së shqiptarëve të Jugosllavisë, për kontradiktat e tjera të shumta në këtë mjedis. . . »

START: Ju akuzojnë se jeni «armik i deklaruar i këtij vendi», «efikas në veprimtarinë tuaj nacionaliste» e të tjera, ndërsa kohët e fundit në një emision të Radio-Prishtinës u tha se shëtisni «ende i lirë» nëpër qytet. Si i vlerësoni qëndrime të tilla në mjedisin tuaj?

RUGOVA: Jam mësuar me këto gjëra pa shije e marrëzira, por jam i lodhur nga këto. Ato ndikojnë mbi mua. Është vështirë kur njerëzit të takojnë në rrugë dhe çuditen që je ende i lirë. Por ky është një qëndrim i përgjithshëm ndaj intelektualëve shqiptarë. Pas vendosjes së masave të jashtëzakonshme u krijua një psikozë e tillë sa të gjithë mendoam se do të gjendeshim në izolim. Mua më kanë vënë etiketa nga më të ndryshmet, sidomos në shtypin e Beogradit. Për fat të keq, nuk e kanë lënë të

qetë as familjen time. Ç'është kjo? Çfarë lloj etike kanë këta gazetarë? Pas intervistës sime dhënë «Shpigelit», Lidhja Socialiste e Kosovës dhe Komiteti i komunës në vendlindjen time nisën çështjen e zbatimit «të masave administrative» kundër meje. Nuk e di çfarë do të ndodhë. Nuk e kuptoj ç'gjë të tmerrshme kam bërë.

START: Nuk keni qenë në të ashtuquajturin izolim. E, me sa duket, izolimit iu shmangën edhe një numër i madh intelektualësh nga Kosova?

RUGOVA: Po, e pësoi kryesisht inteligjencia teknike. Nisi me organizatat e punës, ku kishte pasur grumbullime e diskutime publike për ndryshimet e kushtetutës së Serbisë. Në fakt në listë gjendej edhe një anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Flitej edhe për një listë tjetër. Por ajo nuk u zbatua. Nuk pyeta shumë për të. Nuk e kam zakon të merrem me ata njerëz që merren me mua dhe jo me punën time.

START: Ku i shihni shkaqet kryesore të një gjendjeje të tillë në Kosovë?

RUGOVA: Mendoj se problemi kryesor filloi kur ne, shqiptarët, kërkuam më tepër demokraci, e kjo do të thotë — forcë argumentesh, debate mendimesh, konceptesh, programesh. Edhe ne dëshirojmë të bashkëpunojmë aktivisht për reformat në Jugosllavi, pasi edhe ne jemi qytetarë të këtij vendi dhe, natyrisht, na takon edhe neve të dimë se në ç'rrugë do të ecë më tej Jugosllavia. Por neve kjo e drejtë na u kufizua. Shqiptarët nuk janë ndonjë grup i vogël etnik, i cili nëpërmjet ndonjë shoqate kulturore-artistike do të kultivonte traditat e veta kombëtare ose në ndonjë gazetë do të trajtonte vetëm problemet e veta nacional-kulturore. Ne jemi të ndërgjegjshëm për vazhdimësinë e jetës në Jugosllavi dhe dëshirojmë të kontribuojmë për zhvillimin e kësaj Jugosllavie. Dëshirojmë të bashkëpunojmë në të gjitha fushat e jetës në shoqëri. F. kur kjo filloi të realizohej, politika serbe këtë nuk dëshoi ta pranonte.

START: Me sa dimë ne, serbët problemin e shohin në diçka krejtësisht tjetër, në nacionalizmin shqiptar dhe në kërcënimin e serbëve e të malazezëve në Kosovë.

RUGOVA: Ky është një mitizim i problemeve në Kosovë. Është krijuar miti për kërcënimin e serbëve në

Kosovë, gjë që atyre tani u jep të drejtë të ndryshojnë politikën, të marrin pushtetin, të caktojnë njerëz pa marrë parasysh nëse këta njerëz u përgjigjen edhe shqiptarëve. Duhet respektuar fakti se edhe shqiptarët dëshirojnë ose u besojnë disa njerëzve. Përse atëhere kjo menjëherë shihet me dyshim apo shpallet si nacionalizëm, separatizëm dhe nuk di se çfarë tjetër? Mementalisht në pushtet janë njerëz që i përgjigjen vetëm politikës serbe. Ndodh që dyshohet edhe për disa kuadro të tanishëm shqiptarë në politikë vetëm se ata janë shqiptarë. Në qoftë se dikush u shmanget mendimeve të proklamuar, ai ka marrë fund. Është e nevojshme që menjëherë të zgjidhen njerëz që gëzojnë besimin e të dy palëve, pasi ashtu siç po veprohet tani, kjo gjë çon në thellimin e mosbesimit dhe të ndasive nacionale. Duhet të çlirohemi menjëherë nga ato logjika të vjetra, bardhë e zi, mik-armik. Sipas kësaj logjike, shqiptarët janë armiq nacionalë e politikë. Shqiptarët vendosen në anën tjetër të «barrikadës», dhe kjo për ta është alibi — me armiqtë nuk ka dialog.

START: Thatë se duhet zgjedhur një garniturë politikanësh që të gëzojë besimin e të dy palëve. A është e mundur kjo në këtë situatë?

RUGOVA: Në qoftë se vazhdohet kështu, do të jetë gjithnjë e më vështirë. Prandaj duhet ndryshuar klima jo vetëm në Kosovë, por në gjithë Jugosllavinë. Duhet të çlirohemi nga kuadri nacional që mbizotëron sot, diku më shumë e diku më pak, në Jugosllavi.

START: Përmendët mitin e kërcënimit të serbëve në Kosovë. Megjithatë, paraqiten të dhëna që flasin për pakësimin drastik të numrit të serbëve e malazezëve në Kosovë, kryesisht për shkak të shpërnguljeve.

RUGOVA: Harrohet fakti se në të njëjtën kohë Kosovën e kanë lënë pothuajse 200 mijë shqiptarë, duke shkuar në republika të tjera dhe jashtë vendit. Së dyti, një numër i konsiderueshëm intelektualësh dhe specialistësh serbë e kanë lënë Kosovën duke shkuar në Beograd për shkak të prosperitetit të këtij qyteti, pasi Beogradi është qendër e fuqishme dhe e njohur. Përveç kësaj, ai është edhe qendra e tyre kombëtare. Është logjike që një qytet i tillë dhe një qendër e tillë shkencore e kulturore t'i

tërheqë ata ndonjëherë thjesht nga ana profesionale. Ndërsa në planin kombëtar ata nuk humbasin asgjë. Ne, intelektualët shqiptarë, deri diku jemi «të dënuar» në Prishtinë, si e vetmja qendër, në të cilën mund të veprojmë në gjuhën tonë dhe ku mund të realizojmë në një masë të plotë edhe nevojat tona kombëtare. Me këtë nuk mendoj që ne të mbyllemi, por të veprojmë në një mënyrë të tillë që zhvillimit të përgjithshëm jugosllav t'i kontribuojnë qendra të tilla siç janë Beogradi, Zagrebi, Lubjana apo Shkupi. Shikoni, shkuarja ime në ndonjë qytet tjetër tonin mund t'i plotësojë nevojat profesionale. Por gjithsesi zvogëlohen nevojat e mia kombëtare. Pra, përdërisa ekzistojnë këto lojëra politike, madje edhe nacionaliste rreth Kosovës, përdërisa bëhen spekulime dhe interpretime të ndryshme të politikës së ditës, atëhere nga Kosova do të largohen edhe shqiptarë, edhe serbë, edhe të tjerë.

START: Shumë flitet për nacionalizmin dhe separatizmin shqiptar. Sipas mendimit tuaj, sa është i pranishëm ky në Kosovë?

RUGOVA: Nacionalistë ka, por kjo është sëmundje e çdo populli. Megjithatë, në masat shqiptare nuk do të thosha se ka nacionalizëm. Sot gjithçka merr me lehtësi etiketën e nacionalizmit shqiptar, në fakt edhe ndonjëherë kur është fjala për synimet lidhur me identitetin kombëtar. Në këto kohë të turbullta njerëzit frikësohen se do të humbasin edhe atë minimum të garancisë së identitetit — gjuhën, shkollën, kulturën. Shfaqje të tilla ka pasur dhe këto nuk duhet t'i nënvleftësojmë. Nga ana ligjore ne kemi të drejta, por në praktikë është krejtësisht ndryshe, dhe, meqë praktika është krejtësisht ndryshe, do të ndryshojnë edhe ligjet. Njerëzit në pushtet tani dëshirojnë të harrohet gjithçka që ndodhi në mitingjet, gjithçka që ka shkruar e shkruan shtypi i Beogradit, apo çfarë flasin disa politikanë serbë. E gjithë kjo harrohet dhe fshihet dhe na sulmojnë ne për shkak të qëndrimeve në diskutimet publike rreth ndryshimeve kushtetuese. Kërkesa jonë për identitet kombëtar quhet nacionalizëm. Ne tani kërkojmë një identitet më të gjerë kombëtar, në përputhje me kohën dhe hapësirën në të cilën jetojmë. Ne nuk jemi një grup i vogël, as nuk jemi emigrantë të ardhur. Ne jemi autoktonë në Jugosllavi. Ne jemi më tepër se dy mi-

lionë. Shqiptarët janë një komb i ri, por kemi potencialin tonë — punëtorë, fshatarë, kemi krijuar edhe inteligjencien tonë. Shqiptarët dëshirojnë të funksionojnë si shoqëri, ashtu si të gjithë popujt në Jugosllavi. Megjithatë, politika e tanishme serbe dëshiron që të mbetemi një etnikum i mbyllur, në një kuptim më tepër fisnor. Jugosllavia duhet ta kuptojë se ne kemi nevojë për një zhvillim të mëtejshëm e me këto do t'i kontribuonim edhe zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Ç'do t'i duhej Jugosllavisë, por edhe neve, një grumbull i mbyllur, i prapambetur kombëtar? Për ne është e nevojshme një autonomi e caktuar, e cila do të forconte përfshirjen në proceset e zhvillimit jugosllav.

START: Shqiptarët kanë universitet, televizionin, gazetat dhe shtëpinë botuese në gjuhën e tyre. Lind pyetja, a i ka këto të drejta çdo kombësi në botë?

RUGOVA: Ky nuk është universitet shqiptar, por i Prishtinës, ku mësimi zhvillohet në dy gjuhë. Megjithatë, problemi qëndron në diçka tjetër. Tani duan që numri i studentëve në universitet të reduktohet, në kuptimin nacional, në raportin gjysmë për gjysmë, sot 5 shqiptarë konkurrojnë për një vend. Së dyti, një numri të madh të nxënësve që mbarojnë shkollën fillore, për shkak të mësive administrative, u është bërë i pamundur regjistrimi në shkollat e mesme. Shkolla e mesme në kushtet e sotme është ajo që formon bazën. Ç'na duhet ky kuadër i arsimuar jo aq sa duhet, të papunë potencialë, e për këtë arsye, edhe njerëz të pakënaqur?

START: Kur flitet për Universitetin e Prishtinës, thuhet se ka mbetur prapa në cilësi dhe se atë e shndërronjë në geto shqiptarët që flasin keq ose që nuk flasin fare serbokroatisht.

RUGOVA: Po, kështu flitet. Ne, natyrisht, nuk kemi traditën e një universiteti si ai i Zagrebit ose i Beogradit, por thënia lidhur me cilësinë mund të jetë e diskutueshme. Përsa i përket gjuhës, kjo thënie nuk është e vërtetë, serbokroatisht flasin edhe fshatarët, pasi kjo është gjuha e shumicës në këtë vend. Na akuzojnë edhe për getoizëm dhe separatizëm, por kam bindjen se pikërisht ata që flasin më tepër për këtë e dëshirojnë një gjë të tillë, dhe jo vetëm në universitetin tonë, por lidhur me shqiptarët në

përgjithësi. Për mua çdo universitet është i mbyllur në goftë se nuk komunikon me botën, me arritjet e reja të shkencës, në goftë se nuk shfrytëzon literaturën e përvorjën profesionale të të tjerëve. Pothuajse të gjithë profesorët dhe lektorët tanë flasin të paktën një gjuhë botërore e të gjithë flasin e shkruajnë lirisht gjuhën kroate ose serbe.

START: Si i konsideroni mitingjet e vitit të kaluar të serbëve e të malazezëve, në fillim në Kosovë dhe më pas në mbarë Serbinë e në Mal të Zi? A mendoni me të vërtetë se serbët ndihen të kërcënuar?

RUGOVA: Bindja dhe realiteti, sipas meje, janë dy gjëra të ndryshme. Nuk mundet që unë të jetoj vazhdimisht me bindjen se, për shembull, jam më pak i vlefshëm ngaqë jam pjesëtar i një pakice kombëtare, në goftë se ekzistojnë të drejtat që mund të realizohen. Shqiptarëve u duhej njëfarë kohe të kuptonin se nuk janë më inferiorë. Ne nuk mund të jemi fajtorë sepse apo vetëm sepse ekzistojmë dhe në Kosovë përbëjmë shumicën. Duhet bashkëpunuar e jetuar së bashku. Për sa u përket mitingjeve, unë i kuptoj ato si një farë mjeti në luftën për pushtet. Së dyti, e dimë se çfarë është thënë në këto mitingje për shqiptarët, por për këtë edhe atëherë, edhe tani, për më tepër në Serbi, hesitet.

START: Vazhdimisht në mbledhjet politike thuhet se shqiptarët në Kosovë, si shumicë, mbajnë përgjegjësi për pakicën, e të kthehemi përsëri tek ajo se nacionalizmi shqiptar, siç thuhet, është më i rrezikshëm.

RUGOVA: Gjatë pothuajse dhjetë vjetëve të fundit vazhdimisht dëgjon të flitet për nacionalizmin shqiptar, për disa lloj qendrash të organizuara. Thuhet se të gjithë nacionalizmat janë të rrezikshëm, por ai shqiptar është më i rrezikshëm, vetëm ai veçohet. Përse flitet vetëm për përgjegjësinë tonë ndaj serbëve në Kosovë, përse nuk flitet edhe për përgjegjësinë e serbëve ndaj nesh, pasi ne në RS të Serbisë jemi pakicë? Ku është gjetur kjo e drejtë që çdo shqiptar, i cili thotë diçka ndryshe nga ato që në këtë moment janë proklamuar politikisht, shpallet si nacionalist dhe as nuk denjohet të dëgjohej?

START: Në intervistën tuaj, dhënë «Shpigelit», rreth së cilës u bë një zhurmë e madhe, keni thënë edhe këtë:

«Në qoftë se serbët vazhdojnë të kërcënojnë identitetin tonë, atëherë do të shkohet deri në kryengritje». A nuk është ky një kërcënim?

RUGOVA: Ky është konstatimi im dhe jo kërcënim. Unë jam shkrimtar, një individ, unë nuk kam as pushtet, as mundësi e as dëshirë që të kërcënoj dikë. Kam thënë «kryengritje» në kuptimin e ribalansit dhe nuk kam përmendur atë që më atribuohet tani në shtypin e Beogradit — «kryengritje e armatosur». Edhe në vetë «Shpigelin» shkruhet «Aufstand», që përkthehet «kryengritje» e që gjermanët e kanë shkruar mirë, nuk thuhet «bewaffneter Aufstand», që do të thotë «kryengritje e armatosur». Nga ana tjetër shumë zyrtarë nga Serbia, madje edhe nga Federata, flasin për përpjekje dhe përgatitje për kryengritje, flasin për terrorizëm, bëjnë klasifikime maksimale. Por disa, me sa më duket mua, pikërisht këtë e dëshirojnë. Ky konstatimi im i ka shqetësuar mjaft, sepse është bërë në shtypin e huaj. Kam lexuar plot intervista të intelektualëve serbë në shtypin tonë e të huaj, ku nuk kanë thënë asnjë fjalë të mirë për shqiptarët, madje disa kanë folur hapur me një predispozicion racist. E askush në Jugosllavi nuk ka bërë ndonjë kritikë rreth kësaj, nuk ka ngjitur ndonjë etiketë ose ta ngrinte si problem. Te ne asnjëherë nuk ka pasur konflikte të tilla nacionale, siç ka në BRSS, e kam frikë se neve diçka e tillë dëshirohet të na imponohet.

START: A mendoni se me të vërtetë mund të ketë turbullira me përmasa të gjera? Kjo atëherë do të kërcënohet të gjithë Jugosllavinë.

RUGOVA: Në qoftë se vazhdohet me një presion dhe politikë të tillë, që çon në kufizimin e të drejtave tona, mund të priten turbullira. Vetëm nuk e di se në ç'formë. Pasojat mund të jenë katastrofike. Nuk kemi më të drejtë të shprehim mendimin tonë. Të drejtat tona bazë demokratike janë vënë në pikëpyetje.

START: Kur flisni për të drejtat demokratike, a mendoni se demokracia dhe pluralizmi kanë shanse në Kosovë?

RUGOVA: Përse jo? Vetëm se është çështje e predispozicionit të pushtetit për këtë, pasi të gjitha shoqatat

dhe lëvizjet alternative në Slloveni e Kroaci janë lejuar nga pushteti. Dëshira tek intelektualët për një këshill të ngjashëm demokratik ose komision për të drejtat e njeriut ekziston. Vetëm se kjo nuk lejohet dhe ne nuk dëshirojmë të veprojmë ilegalisht.

START: A mundet që një këshill i tillë në Kosovë të jetë i përbërë nga ana nacionale?

RUGOVA: Sipas predispozicionit të tanishëm të serbëve, vështirë se mund të arrihet një gjë e tillë. Shkrimtarët serbë braktisën Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës me të tilla kualifikime saqë Shoqata jonë nuk funksionon më normalisht. Mbizotëron mendimi se Kosova më mirë funksionon kur në të asgjë nuk funksionon. Më mirë e kalojnë ata që nuk bëjnë asgjë, apo vetëm punojnë sipas diktatit. Në fushën tonë intelektuale diferencimin e bëjnë shkencëtarët dhe specialistët më të dobët. Të tillë ndoshta në këtë moment politik koketojnë mirë. Por një sistem që dëshiron begati, e për këtë të gjithë çirren, nuk duhet të heqë dorë nga puna, nga mendimet, nga e drejta e njeriut për mendimin e tij. Disa nuk mund dhe nuk dëshirojnë të pranojnë faktin se edhe shqiptari ka të drejtë të ketë mendimin e vet, se atë ai di edhe ta shprehë e ta profilizojë, se ne kemi nevojë që të kemi një inteligjencie që dëshiron barazi me inteligjenciet e tjera kombëtare, se dëshirojmë të bashkëpunojmë e të veprojmë si në kuadrin e Jugosllavisë, ashtu edhe në atë të Evropës e të botës. Sipas tyre, unë jam shqiptar i mirë ose «i ndershëm» ose intelektual i tillë, në qoftë se them atë që kërkohet prej meje, pa asnjë lloj qëndrimi timin kritik. Atëherë çfarë intelektual i jam unë? Në qoftë se diferencimi do të vazhdojë me këtë ritëm, do të kemi atë që unë me një shaka të hidhur e quaj: Kosovë ideologjike të pastër.

START: A keni miq serbë, si i keni marrëdhëniet me ta?

RUGOVA: Kontaktet pothuajse janë ndërprerë. Gjithçka është reduktuar në përsëritje rrugës e asgjë më tepër.

START: Kur flitet për shqiptarët në Kosovë, në mënyrë të pashmangshme lind edhe çështja e marrëdhënieve të tyre me RPS të Shqipërisë.

RUGOVA: Nuk do të hyj në marrëdhëniet ndërshtetërore midis të dy vendeve tona. Mua ekzistenca e shtetit shqiptar nuk më pengon, por, më sa duket, disa në Jugosllavi i pengon. Shqipëria është shtet kombëtar i shqiptarëve, por unë kam lindur në Kosovë dhe Jugosllavinë e përjetoj si shtetin tim. Mendoj se neve shumë shpesh na e shtyjnë këtë Shqipëri nën hundë. Por në qoftë se vazhdon një politikë e tillë në Kosovë, disa, ndoshta, me të vërtetë do ta kërkojnë në Shqipëri shtetin dhe do ta konsiderojnë atë «si diçka më të mirë».

START: Ju thatë se Jugosllavinë e përjetoni si shtetin tuaj. A kanë një mendim të tillë edhe shqiptarët e tjerë? Rreth kësaj, në fakt, vazhdimisht dyshohet.

RUGOVA: Natyrisht, që po. Kujtoni ato grumbulime të nëntorit e të marsit, ku brohoritej për Jugosllavinë, Titon, Kardelin, Shuvarin, e përsëri nuk ishte e mjaftueshme. Menjëherë në Beograd u tha se kjo është një maskë. Kjo do të thotë se gjithçka që bëhet nga shqiptarët, nuk u shkon për shtat. Por të vë në dukje se më vjen mirë që atëherë as nuk u fye, as nuk u nënvleftësua, as nuk u sulmua, as nuk u kërcënua, as populli serb e as ndonjë komb e kombësi tjetër.

START: A mundet, ndoshta, të hiqet ndonjë paralele midis ngjarjeve të vitit 1981 dhe atyre të nëntorit të kaluar e të shkurt-marsit të këtij viti?

RUGOVA: Në vitin 1981, në revoltë morën pjesë kryesisht të rinj e studentë dhe ajo nuk u përhap në popull. Sot, kur u prekën disa të drejta bazë të shqiptarëve, me sa më duket mua, protesta është më masive. Shumica e shqiptarëve në vitin 1981 u distancuan nga këto ngjarje. Demonstratat e fundit ose «ngjarjet» e fundit, si të doni, do t'i quaja edhe dëshirë të njerëzve për një demokraci më të madhe. Dhe në vend që ky potencial demokratik në Kosovë të shfrytëzohej, ndodhi e kundërta. Atje ishte e pranishme dëshira që të «futej» në këto procese demokratike jugosllave. Tashmë e kam thënë, shqiptarët kanë se çfarë t'i japin Jugosllavisë, kanë një potencial të madh ende të pazbuluar.

START: A mendoni se minatorët e Trepçes kanë qenë të manipuluar, pra, gurë shahu në dorën e dikujt?

RUGOVA: Sipas mendimit tim, jo. Kjo, thjesht,

ishte një revoltë e këtyre njerëzve dhe asgjë e organizuar.

START: A bëni përpjekje ta kuptoni «palën serbe»? A bëni përpjekje ta vini veten në pozitën e tyre, si do t'i shihnit atëherë gjërat? Nisem nga fakti i ndarjes së territorit të Serbisë në tri pjesë.

RUGOVA: Në fillim flitej se serbët janë të kërcënuar në Kosovë. E tani, thuhet se janë të kërcënuar të gjithë serbët në Jugosllavi. Përsa i takon Kosovës, ajo gjithmonë ka funksionuar në kuadrin e shtetit e të politikës serbe e asaj jugosllave. Asnjëherë në vendet kyç nuk kanë qenë vetëm shqiptarë. Mendoj se kushtetuta e 1974-ës nuk e ka kërcënuar veprimtarinë e RS të Serbisë, duke pasur parasysh se gjithçka ka qenë nën juridiksionin republikan. Autonomia e Kosovës vetë Serbinë do ta bënte më demokratike, por tani është e qartë se po shkohet drejt centralizmit republikan dhe heqjes së autonomisë. Politika serbe është aq agresive, an blok, saqë nuk lejohet që dikush të vihet në pozitën e tyre. Nuk mund të vihesh në pozitën e tyre, në qoftë se ata falsifikojnë, diskualifikojnë, imponojnë dhe hedhin poshtë argumentet e të tjerëve. Me sa më duket mua, e gjithë kjo që ndodh sot me shqiptarët, ajo që shkruhet në shtypin e Beogradit, ose ajo që thuhet nga intelektualët serbë, është në funksion të një lloj revanshizmi, të një rrafshimi me të keqen. Duke u nisur nga kjo logjikë, serbët kanë qenë të kërcënuar dhe tani le ta ndiejnë pak edhe shqiptarët si ata. Po t'i shohim me qetësi gjërat, rrugëdalja, me siguri, nuk gjendet në veprimet hakmarrëse.

START: Përballë homogjenizimit serb më duket se po nis edhe procesi i homogjenizimit shqiptar. Marrim vetëm faktin e faljes së gjakmarrjes, gjë që bëhet vetëm në kohërat e ndonjë rreziku të madh.

RUGOVA: Të gjitha homogjenizimet e monizimet janë të rrezikshme, por midis shqiptarëve ndodhi një homogjenizim spontan, pasi ne nuk kemi një politikë që do ta organizonte këtë ose do ta shpallte zyrtare, siç ndodh kjo në Serbi. Kjo është pjesë e revoltës dhe prandaj ndodhin edhe grumbullimet. Falja e gjakmarrjes, nga ana tjetër, është një gjë e mirë, sepse kjo plagë jona na

ka mbetur nga e kaluara. Kanuni i Lekë Dukagjinit, që ka funksionuar më parë, nuk mund të ekzistojë në botën bashkëkohore. Kjo është një relike që bart mjaft të këqija. Kur ka homogjenizim, nuk ka kritika të brendshme, eliminohet qëndrimi kritik ndaj grupit të vet nacional, dhe kjo është joproduktive e nuk sjell asgjë të mirë. Nuk ka shtresa autonome, në qoftë se të gjitha shtresat nacionale fillojnë të veprojnë njësoj. Atëherë mungon qëndrimi i natyrshëm pluralist brenda kombit. Homogjenizimi, sipas mendimit tim, nuk ka perspektivë dhe kam frikë se edhe homogjenizimi serb do të përfundojë në mënyrë tragjike. Kur nuk funksionojnë shtresat shoqërore brenda një kombi, atëherë kjo është e rrezikshme para së gjithash për vetë atë popull.

START: Ç'mendoni për Slllobodan Mileosheviçin si bartës i politikës së homogjenizimit të serbëve?

RUGOVA: Mendoj se politika e tij nuk e ka të gjatë. Ai ka shkuar mjaft larg dhe këtu nuk është fjala më vetëm për Kosovën e Serbinë, por për të gjithë Jugosllavinë.

START: Milosheviçi në funksionin e presidentit të RS të Serbisë u zgjodh nën parullën — president i të gjithë qytetarëve të Serbisë, që do të thotë jo vetëm i serbëve.

RUGOVA: Ky është një term i ri, me të cilin shmanget përmendja e krahinave. Kur thuhet «qytetarë të RS të Serbisë», dëshirohet të fshihet karakteri i saj shumëkombësh. Ky është një unitarizëm republikan. Kur vazhdimisht thuhet «qytetarë të RS të Serbisë», atëherë kuptohet se qytetarët e Serbisë janë serbët. Mendoj se ai dëshiron të krijojë një shtet të fortë brenda shtetit.

START: Keni thënë se shqiptaret kanë dëshirë të dalin nga rrethi i tyre i mbyllur dhe të integrohen në mënyrë të barabartë në shoqërinë jugosllave. Në çfarë konteksti, cila është, për shembull, pozita e shqiptareve?

RUGOVA: Pozita e shqiptares ka ndryshuar shumë, e ky është një fakt, për të cilin pjesët e tjera të Jugosllavisë dinë pak ose nuk duan ta dinë. Natyrisht nuk mund të thuhet se kjo vlen për të gjithë Kosovën, pasi ka dhe pjesë të saj, ku mbizotëron ende qëndrimi tra-

dicional ndaj grave. Shqiptarja, megjithatë, po emancipohet. Kemi gra që janë specialiste shumë të mira dhe me arsim të lartë. Në brezat e pasluftës pothuajse nuk ka analfabete. Mijëra vajza mbarojnë shkollat e mesme e fakultetet. Ato janë një potencial që ende presin fatin e tyre, po ky fat duhet t'u ofrohet. Kohët e fundit, për shkak të papunësisë së madhe midis grave, disa edhe kanë hequr dorë nga shkollimi i mëtejshëm.

START: Për shqiptaret thuhet se është «fabrikë që prodhon fëmijë».

RUGOVA: Përsëri nuk shihet ose nuk dëshirohet të shihet se shumë gra të shkolluara nuk kanë shumë fëmijë. E shoh edhe te njerëzit e mi. Kanë një, dy ose më së shumti tre fëmijë. Nëpër qytetet midis shtresave të ndryshme sociale kryesisht kështu është. Le t'i lejojmë gratë të shkollohen, të emancipohen, e më pas edhe problemi i lindshmërisë do të jetë ndryshe. Me disa veprime të politikës bëhet e kundërta, përsëri synohet të spostohet shqiptarja. Për mua këto epitete «fabrikë prodhuese», janë fyese. Flitet për njëfarë «shqiptarizimi të Jugosllavisë» e nuk shihet se lindshmëria po bie, ashtu siç nuk shihet se edhe serbët në Kosovë kanë shumë fëmijë.

START: Kuvendi i RS të Serbisë para pak kohësh ndërmoi iniciativën e rishikimit të ligjit të vitit 1945 për ndalimin e kthimit të kolonëve në Kosovë e Maqedoni.

RUGOVA: Kjo do ta bëjë edhe më të ndërlikuar situatën kosovare. Shqiptarëve shumë herë u është marrë toka. Shpeshherë ata kanë blerë tokën e vet, që atyre u është marrë. Këtë e di edhe nga familja ime. Në qoftë se bëhet rishikimi, shumë shqiptarë do të mbeten pa tokë, e këta janë fshatarë, njerëz të lidhur me këtë tokë. Do të preket shtresa e fshatarëve, e fshatarët kanë logjikën e vet, konceptimin e vet për jetën. Por në qoftë se dikush dëshiron që epidemia e pakënaqësisë midis shqiptarëve të përhapet dhe të përfshijë të gjitha shtresat, atëherë ky është një kontribut për këtë politikë.

START: Tani në Maqedoni po diskutohet rreth këtij ligji, si edhe për karakterin e luftërave ballkanike. Në Serbi theksohet karakteri çlirimtar i këtyre luftërave,

ndërsa maqedonët flasin për okupacion. Si qëndrojnë punët me Kosovën? Cila nga këto luftëra i ka takuar Serbisë?

RUGOVA: Në Kosovë për këtë nuk diskutohet, pasi nuk na e japin një mundësi të tillë. Në vitin 1912 Kosovën e çliruan vetë shqiptarët dhe atëherë erdhi ushtria e rregullt serbe dhe vendosi pushtetin. Për ne ato, megjithatë, kanë qenë luftëra pushtuese.

START: Më parë keni përmendur si periudhë të zezë në historinë e Kosovës periudhën e Rankoviçit. Si i shikoni propozimet për rehabilitimin e tij?

RUGOVA: Për këtë nuk na pyet askush. Por në qoftë se rehabilitojnë politikanë të tillë, do të thotë se do të rehabilitohet edhe politika, bartës të së cilës ata kanë qenë. Ne jemi shumë të ndieshëm ndaj kësaj, sepse kjo periudhë ka qenë periudha e represioneve të mëdha. Qëllimi kryesor ka qenë neutralizimi i shqiptarëve, që ka vazhduar nga vitet 50-të deri në vitin 1968. Shqiptarët u shpërngulën në Turqi, pasi ishin në fuqi marrëveshjet e paraluftës. Përmendet shifra nga 100 000 deri në 200 000 veta. Disa fshatra u shkretuan, disa lagje qytetesh mbetën të zbrazëta. Pastaj u ndoq politika e asimilimit. Na shpallën ne shiptarë, për të provuar se dallohemi nga shqiptarët e Shqipërisë. Ne përdorim emrin «shqiptar», por ai në gjuhë të huaj përkthehet «all-banac», dhe ky dyzim yni duket se është shfrytëzuar për qëllime politike. Edhe sot Shoqata e Etnologëve të Serbisë po e ngre përsëri këtë çështje. Megjithatë, shqiptarët sot janë në një nivel tjetër intelektual e shoqëror. Deri në vitin 1966 e gjithë administrata ishte serbe dhe çdo gjë bëhej në këtë gjuhë. Aty-këtu gjendej ndonjë shqiptar. Kjo politikë e Rankoviçit, të cilën kam frikë se dëshirojnë ta ndjekin edhe të tjerët, ka qenë vazhdim i procesit që ndiqej ndaj shqiptarëve në Kosovë që nga bashkimi i Kosovës me Serbinë. Që të mos keqkuptohemi, shqiptarët e kanë pasur shumë vështirë edhe nën pushtimin turk. Në Jugosllavinë e vjetër ka ekzistuar plani i famshëm i Çubrilloviçit, i cili duhej që nëpërmjet kolonizimit me banorë serbë dhe malazezë të shkaktonte konflikte e tensione të vazhdueshme midis tyre e shqiptarëve, të cilat, natyrisht, me ndihmën e pushtetit e të

policiisë do të zgjidheshin në dëm të shqiptarëve. Sot nuk është më kështu, por serbët me vështirësi e pranojnë faktin se as shqiptarët nuk janë më analfabetë e punëtorë krahu, por të kualifikuar, politikanë, shkencëtarë e të shkolluar...

START: Sipas konventave ndërkombëtare, pakicat nacionale ose kombësitë kanë të njëjtat të drejta si dhe kombet, veç të drejtës së territorit. E një nga argumentet për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974 është ai se krahinat po shndërrohen në shtet, që, sipas kushtetutës sonë, mund të përcaktohet si republikë.

RUGOVA: Bëtë mirë që e përmendët termin «pakica nacionale», që, me sa duket, përsëri po kthehet në përdorim dhe atë e përdorin edhe disa politikanë tanë. Po le t'i kthehemi pyetjes. Shqiptarë ka edhe në pjesë të tjera të Jugosllavisë, veçse Kosova është specifike, pasi ajo ka etninë e vet historike e aktive. Tani në Serbi thonë — Krahina nuk u krijua për shkak të shqiptarëve. Por në qoftë se këtu nuk do të kishte shqiptarë, kombe e kombësi të tjera, as që nuk do të ekzistonte nevoja për autonomi. Kosova duhet të mbetet krahinë, pasi ajo është rezultat i zhvillimit historik dhe kështu edhe në të ardhmen do të zhvillohet më lehtë dhe më me efikasitet.

START: Të mos e harrojmë temën e nacionalizmit. Inteligjencias shqiptare kosovare i atribuohet se zhvillon një politikë nacionaliste në vend që popullit t'i shpjegojë dëmin e ndasive nacionale.

RUGOVA: Mendoj se teoria për inteligjencien si drejtuese e popullit është e vjetruar. Ne nuk kemi as forcë e as mundësi të tillë. Të shkolluarit gjithnjë janë fajtorë për gjithçka. Ata i pengon fakti që inteligjencia shqiptare për herë të parë u shfaq si një e tërë autonome, e kjo pikërisht në një situatë kaq të rëndë. Mendoj se në këtë fatkeqësi të vet, të paktën, është gjë e mirë që qëndrimi ynë është i pavarur, megjithëse kjo është e rrezikshme. Rreziku ynë është cilësia jonë e re dhe, ndoshta, e teproj, por edhe shenjë e pjekurisë sonë. Nuk ka shumë nga ne që i janë ekspozuar rrezikut, por kjo është e kuptueshme e njerëzore. Duhet të luftojmë për një shtet juridik dhe kjo së bashku me të gjithë intelektualët jugosllavë.

START: Megjithatë, vallë në këto poste drejtuese në Krahinë nuk ka shqiptarë? Madje edhe «Rilindjen» e redaktojnë dhe e shkruajnë shqiptarë.

RUGOVA: Shqiptari, siç thashë, dëshiron të jetë një faktor përkatës shoqëror. kështuqë për të nuk është e mjaftueshme që presidenti të jetë shqiptar, por sheh se ç'politikan është ai. Simbolika nacionale nuk është më e mjaftueshme. S'mjafton që presidenti të jetë shqiptar dhe gjithçka u zgjidh. Kërkohej një cilësi tjetër. Në qoftë se do të niseshim nga logjika e homogjenizimit, atëherë edhe kjo simbolikë nacionale do të kishte kuptim. Ne dëshirojmë që në mënyrë të hapur e kritike të flitet për gjendjen në Jugosllavi e në Serbi, e përse jo, do të thosha, edhe në Kroaci ose në Maqedoni. Mendoj se këtë tashmë e kam thënë. Por do ta përsëris. Vallë me të vërtetë shqiptarët duhet të jenë të prapambetur e gjysmë analfabetë që t'i shkonin për shtat Jugosllavisë? «Rilindja» gjithashtu është nën goditjen e diferencimit dhe gjendja po bëhet gjithnjë e më e ngjashme me atë në politikë. Vetëm një shembull: pak kohë më parë në Institutin Albanologjik zhvilluam një konferencë me rastin e 200-vjetorit të Revolucionit Francez. Në gazetën «Rilindja» u botua lajmi për zhvillimin e konferencës, por nuk përmendej asnjë emër. Në të folën kolegu Qose, unë dhe disa të tjerë, po kështu intelektualë të kritikuar e të etiketuar. Emri im në «Rilindja» mund të gjendet vetëm në kontekstin e sulmeve e të sharjeve kundër meje. Të paktën është mirë që në organet kroate, sllovene dhe kohët e fundit edhe në Bosnjë e Hercegovinë ne mund të themi se ç'mendojmë dhe si i shohim gjërat. Është mirë që dikush në Jugosllavi po merret me izolimin që të dëgjojë edhe pala tjetër. Më parë kjo ishte e pamundur.

START: A jeni anëtar i LKJ-së?

RUGOVA: Ende jam, megjithëse lidhur me anëtarësi-në time janë lëshuar retë e zeza të diferencimit. Sidoqoftë, në qoftë se vazhdon një politikë e tillë në Kosovë, do të largohem vetë pasi kjo nuk është më politika ime dhe unë nuk mund ta përkrëh. Për sa i takon diferencimit, në të janë përfshirë një numër i madh njerëzish, te ne

në Kosovë ai po zbatohet qysh prej 10 vjetësh. Sapo vjen një garniturë politike, ajo zbaton diferencimin e vet, sipas kriterëve të veta. E të gjithë u referohen të njëjtave qëndrime, dokumente e programe...

START: Në vjeshtë është njoftuar për gjyqin e A. Vllasit, politikan, i cili kaloi për një kohë relativisht të shkurtër nga lavdërimet në arrestim.

RUGOVA: Vllasi dhe grupi i politikanëve të rinj të shkolluar deshën që Kosovën ta tërhiqnin në proceset integruese jugosllave, madje edhe në Evropë. E shohim se nuk ia arritën. Përsa i përket Vllasit, ai në vitin 1981 ishte shumë i ashpër dhe për këtë fitoi pikë të mëdha. Kur u kthye në Kosovë, filloi t'i shihte problemet në të gjitha anët dhe këtu, me sa duket, gaboi. Ra për shkak të politikës normale që donte të zbatonte. Nuk iu përmbajt atyre linjave negative, të cilat kanë qenë dhe janë në modë, kur është fjala për Kosovën. Thuhet se Vllasi ka një orientim antijugosllav. Për mua kjo është marrëzi. Në fakt, duhet pritur se si do të rrjedhë dhe çfarë do të provojë procesi. Por kur njeriu është në burg, atëherë me etiketime të ndryshme përpiqen t'i krijojnë atmosferë, mbi bazën e së cilës të paraqiten edhe provat. Politikës agresive serbe nuk i përgjigjej në Kosovë një politikë e tillë, e qetë e normale, por ajo e ekseseve dhe e tensionit, tek e cila ata këmbëngulin dhe mbi bazën e së cilës kanë ndërtuar politikën e tyre. Etiketat që shpërndajnë ata me shumicë në Kosovë, për fat të keq, shpesh janë e vetmja «provë» dhe «argument» për ndonjë lloj faji.

START: A mund të pritet ndonjë takim i inteligjencies shqiptare dhe asaj serbe, qoftë edhe në kuadrin e Shoqatës suaj të Shkrimtarëve?

RUGOVA: Tani për tani është shumë e vështirë. U përpoqëm të bënim diçka të tillë vitin e kaluar, por nuk u arrit asgjë. Dhe më keq për Shoqatën tonë të Shkrimtarëve. Ne dëshironim që në këtë takim të konfrontonim

dhe të shkëmbenim mendimet e faktet, por kolegët tanë serbë këtë e kishin menduar ndryshe. Ata prisnin që ne të kishim qëndrime identike si ato të politikës zyrtare, sepse pikëpamjet e tyre nuk dallojnë nga ato të politikës serbe. Dhe kur panë se kjo nuk ndodhi, atëherë u lëshua një orteq i tërë mbi ne. Udhëheqësit e atëhershëm kosovarë, të cilët tani kanë rënë, gjithashtu na quajtën nacionalistë, na sulmuan, ndërsa për pozitën e shkrimtarëve serbë askush në Serbi nuk foli në mënyrë kritike.

START: Si vajti puna deri në prishjen e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe si janë punët tani? Flitet se jeni një shoqatë etnikisht e pastër.

RUGOVA: Shkrimtarët serbë na braktisën, veç Vuk Filipoviçit, ndërkohë që mbetën edhe shkrimtarë me kombësi turke e myslimane. Dorëheqjen ata e dhanë për të destabilizuar Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës dhe ky ishte fillimi i praktikës së mëvonshme që serbët në të gjitha funksionet nisën të jepnin dorëheqje. Kështu në shkurt-mars filluan të jepnin dorëheqjet edhe serbët në organet krahinore të pushtetit. Kjo bëhej për paralizimin e Krahinës. Tani kjo nuk përmendet më. Kur para dy vjetësh kryetar ishte Milenko Jevtoviçi, gjithçka ishte në rregull, madje ndryshuam edhe statutin që ai të mbetej kryetar dhe kjo sipas direktivës së Lidhjes Socialiste Krahinore. Tani kjo harrohet. U përpoqëm ta zgjidhnim këtë problem tonin, caktuam edhe mbledhjen, por serbët nuk erdhën. Mbledhjen tani dëgjoj se po e cakton Lidhja Socialiste dhe po formon edhe një komision iniciator. Duan të zhvillojnë zgjedhje në shoqatën tonë. Ne askush nuk na njofton për këtë. Askush nuk konsultohet as me mua, të paktën, si kryetar i Shoqatës. Unë këmbëngul për zgjedhje të lira me shumë kandidatë dhe pa asnjë lloj etiketimi.


START: Mendoj se nuk mund të shmangim as pyetjen lidhur me takimin tuaj me delegacionin e Parlamentit Evropian që qëndroi në Kosovë. Organet zyrtare kosovare

nuk e kishin parashikuar që edhe ju të bisedonit me atë delegacion. Më vonë ju akuzuan dhe thanë se dëshironit «të ndërkombëtarizonit» çështjen e Kosovës.

RUGOVA: Së pari, atë e ndërkombëtarizoi vetë shteti ynë, duke e ftuar delegacionin në Jugosllavi dhe në Kosovë. Së dyti, parlamentarët deshën të dëgjonin edhe palën tjetër, jo vetëm të personave zyrtarë që atyre u vunë në dispozicion. Me ta biseduan kolegu Qose dhe unë, ja kështu, duke pirë normalisht kafe. Unë përfaqësova veten në këtë bisedë e jo ndonjë organizatë. Tani organet e Beogradit flasin për udhëtimet e mia nëpër botë, ndërsa unë vitet e fundit, për fat të keq, nuk kam qenë askund. Rroga ime nuk mbulon as shpenzimet për të shkuar deri në Paris.

*Ibrahim Rrugova, intervistë
dhënë gazetarit Vllado Vru-
shić, «Start», Zagreb,
5.8.1989.*

**III. HISTORIA
DHE TRADITAT
E SHQIPTARËVE**



Ç'NUK QENKA SHQIPTARIZIM!

— *Edhe firmat në shkolla apo në institucione të shkruara, përveç në gjuhën serbokroate edhe në gjuhën shqipe, edhe tekstet me vula në të dy gjuhët, edhe toponimet, edhe etnonimet, edhe antroponimet, bile edhe arkitektura, qenkan në shërbim të nacionalizmit e të separatizmit shqiptar!*

Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Kosovës na dërgoi një reagim që kohë më parë ia kishte dërguar gazetës, ku ishin sulmuar vlera të pakontestueshme të kulturës e të traditës së kombësisë shqiptare, madje edhe frytet që konsiderohen si arritjet më të mëdha të fitores së revolucionit, me të cilat mburremi para botës. Në përputhje me rolin dhe detyrat që shtrohen para mjeteve të informimit sipas qëndrimeve partiake të forumeve më të larta, po e botojmë në dy vazhdimë në gazetën tonë. (*Redaksia e gazetës «Rilindja», Prishtinë*).

Në tre numra (më 10, 11 dhe 12.12.1989) «Politika» boton një reagim të Shoqatës së Pedagogëve Universitarë

dhe të Punonjësve Shkencorë të tjerë të RS të Serbisë dhe të Shoqatës Shkencore të RS të Serbisë ndaj artikullit «Në emër të qëllimeve më të larta qytetëruese», i cili doli në «Politika» më 20.11.1988. Pastaj morëm, me të vërtetë, një përgjigje të gjatë për artikullin që nuk i kishte plot dy faqe, në të cilin reagohet ndaj disa mendimeve të tyre, sidomos ndaj propozimit për të suprimuar Institutin Albanologjik dhe një numër fakultetesh në Universitetin e Prishtinës. Në përgjigjen e vet, Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të tjerë dhe Shoqata Shkencore e RS të Serbisë kanë përfituar nga rasti për të përsëritur shumë nga ato që mund të lexoheshin me mijëra herë për vite të tëra në shtypin e Beogradit ose të dëgjoheshin në tribunat politike, shkencore e kulturore të Beogradit rreth Universitetit të Prishtinës, rreth bashkëpunimit të këtij universiteti me Universitetin e Beogradit, rreth bashkëpunimit të këtij Universiteti me Universitetin e Tiranës, rreth institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës. rreth barazisë e pabarazisë së gjuhëve në Kosovë, rreth pozitës kushtetuese të Kosovës siç është ajo sot, sipas Kushtetutës së vitit 1974 dhe se si u dashka të jetë nesër, sipas Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1989 etj. U përsërit kështu edhe një pllakë «long play» rreth shqiptarëve dhe rreth Kosovës, por këtë herë e nxjerrë nga institucioni autoritativ — Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të tjerë si dhe nga Shoqata Shkencore e RS të Serbisë.

Përdorimi dhe keqpërdorimi i një nocioni

Prej vitit 1981 e deri më sot, shqiptarët kanë dëgjuar dhe kanë lexuar për vete shumë kallëzime që nuk i kemi dëgjuar kurrë më parë prej askujt dhe që nuk kanë mundur t'i marrin me mend as në ëndërr e lëre më në zhgjëndër. Meqënëse këto kallëzime ishin dhe, natyrisht, vazhduan të jenë pa argumente, fragmentare, të para-

qitura në versione të ndryshme, prandaj jobindëse, pedagogë universitarë dhe punonjës shkencorë të Serbisë, u përpoqën më shumë individualisht, kurse tash edhe kolektivisht, me shoqatat e veta të sipërpërmendura, për t'u gjetur atyre çelsin metodologjik, domethënë një mbulesë shkencore çfarëdo. Atë çelës metodologjik për shpjegimin e situatës kosovare, siç shihet nga përgjigjja e tyre, Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë e ka gjetur në nocionin politik shqiptarizim (albanizacija), të cilin nganjëherë e zëvendësojnë me nocionin, me ngjyrim stilistik për ta, shqiptarizacija! Nocioni «shqiptarizacija» në serbokroatishte, deri vonë i lënë pasdore, pak a shumë për shkak të nocioneve politikisht më të efektshme, prandaj shumë më shpesh të përdorura, siç janë nacionalizmi, separatizmi, irredentizmi shqiptar, terrori dhe genocidi, po hyn vetëm tash, në saje të meritës së Shoqatës së Pedagogëve Universitarë dhe të Punonjësve Shkencorë të Serbisë, në përdorim politik dhe publicistik të gjerë. Nocioni shqiptarizim — të cilin së pari e kënduan poetë serbë, e përhapën gazetarë, ndërsa më pas e bënë zyrtarë politikanë — po bëhet një nocion, të cilin ishte dashur ta përkufizojnë pikërisht ata, të cilët përpiqen që t'i sigurojnë legjitimitetin shkencor me anë të autoritetit të vet, të Shoqatës së Pedagogëve Universitarë dhe të Punonjësve Shkencorë të Serbisë. Përkufizimin e këtij nocioni, ndërkaq, ata as që janë përpjekur për ta dhënë: «të painformuarit shtrojnë shpesh pyetjen se ç'nënkuptohet me shqiptarizim të Kosovës dhe se deri në ç'shcallë është kryer ai. Mendojmë se nocioni nuk duhet të shpjegohet, ai është vetvetiu i qartë!» I qartë, natyrisht, në mënyrën e tyre! E përse të përpiqen fare ta përkufizojnë këtë nocion? Nocionet e papërkufizuara janë edhe nocione më të përshtatshme për përdorim dhe për keqpërdorim politiko-propagandistik. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë me të vërtetë nuk e ka përkufizuar nocionin shqiptarizim, por për përmbajtjen e tij ka hedhur çdo gjë; mendimet e veta, ndjenjat e veta dhe paragjykimet

e veta për shqiptarët. Sepse, me shqiptarizim ata nënkuptojnë dukurinë historike që ka filluar të veprojë pothuaj njëkohësisht kur shqiptarët filluan të marrin islamizmin, aty nga shekulli i 16-të — në mos edhe kur u dëgjua për herë të parë për ta në histori — dhe e cila po zgjat deri në ditët tona! Sepse, me shqiptarizim ata nënkuptojnë dukurinë që shtrihet kryq e tërthor Kosovës dhe që përfshin të gjitha fushat e jetës shoqërore, politike dhe kulturore të Kosovës, e cila në mbështetje të energjisë që ka kërcënon që të zgjerohet edhe përtej Kosovës në të katër anët e horizontit!

Ç'janë të gjitha ato që Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë i fusin brenda nocionit shqiptarizim (albanizacija), përkatësisht shqiptarizim (shqiptarizacija)? Ku e shohin ata shqiptarizimin e Kosovës?

Mbi vulat e firmat

1. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh, së pari, «nga vula shkollore e deri te vula gjyqësore». Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka nëse janë bërë, përveç në gjuhën serbokroate, edhe në gjuhën shqipe vulat edhe të atyre shkollave të mesme dhe fillore, në të cilat shumica e nxënësve janë të kombësisë shqiptare. Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka nëse janë bërë, përveç në gjuhën serbokroate, edhe në gjuhën shqipe vulat e gjyqeve kosovare, në të cilat shumicën absolute të atyre që dënohen në to e përbëjnë shqiptarët!

2. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe «nga firma e shkollës e deri në firmën e institucionit a entit». Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka nëse firmat përveç në gjuhën serbokroate,

janë shkruar edhe në gjuhën shqipe edhe në shkolla fillore e të mesme, në të cilat shumica e nxënësve janë të kombësisë shqiptare! Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka edhe nëse është shkruar, përveç në gjuhën serbokroate, edhe në gjuhën shqipe firma e Institutit Albanologjik, në të cilin studiohet edhe më tej tradita historike dhe kulturore e popullit shqiptar!

3. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Puno-njësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në emrat e shkollave dhe të rrugëve të qytetit. Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka edhe nëse një numër i shkollave dhe i rrugëve të qyteteve të Kosovës janë emërtuar, përveç me emra të personaliteteve të njohura kulturore dhe historike të popullit joshqiptar, edhe me emra të krijuesve kulturorë të njohur të popullit shqiptar, siç janë Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Fan Noli. Luigj Gurakuqi ose me emra të personaliteteve historike të njohur, siç janë Skënderbeu, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini.

Mbi toponimet, etnonimet dhe antroponimet

4. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Puno-njësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në toponiminë shqiptare. Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizimi i Kosovës qenka nëse emrat e vendeve shqiptarët i shkruajnë, ndoshta edhe i shqiptojnë, ashtu siç i kanë shqiptuar dhe shkruar në shekuj të parët e tyre: nëse, për shembull, Gjakovës i thonë Gjakovë, Pejës-Pejë, Ferizajt-Ferizaj, domethënë ashtu siç janë quajtur para se të quhen Gjakovica, Uroshevac, ose para se Han i Elezit, të quhej Gjeneral Jankoviç, domethënë ashtu siç është quajtur para se ta ketë pushtuar ky gjeneral, e të tjera.

5. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Puno-njësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe

në etnonimi. Sepse, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës na qenka nëse shqiptarët i shkruajnë dhe i shqiptojnë edhe emrat e popujve ashtu siç i kanë quajtur me shekuj edhe të parët e tyre: nëse, për shembull, e quajnë veten shqiptarë, nëse i quajnë malazezët-malazezë, maqedonasit-maqedonas, kroatët-kroatë, hungarezët-hungarezë, gjermanët-gjermanë. E kështu me radhë.

6. Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në antroponiminë. Meqë, sipas mendimit të tyre, shqiptarizim i Kosovës qenka edhe atëherë kur shqiptarët fëmijët e vet gjithnjë e më rrallë i emërtojnë me emra turq e arabë, siç janë emrat Hasan, Azem, Jakup, Bajram, Naser, Muhamed, ndërsa gjithnjë e më shpesh i emërtojnë me emra ilirë e shqiptarë, siç janë Agron, Teuta, Genc, Kastriot, Arbër, Shqipe, Valbona, Dite, Rozafa, e kështu me radhë. Pedagogët universitarë dhe punonjësit shkencorë të Serbisë filluan kështu sot të shohin «albanizimin» atje ku pedagogët maqedonë e punonjësit shkencorë të Maqedonisë si dhe burokracia politike e saj filluan ta shohin para 3-4 vjetësh. Prandaj, mbase ata e shohin shqiptarizimin edhe në heqjen e asaj «iç» nga mbiemrat shqiptarë, ndërsa dukurinë e kundërt me shqiptarizimin në kthimin e këtij «içi». Shoqata e Pedagogëve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë duhet ta dijë se mbiemrat shqiptarë nuk mbajnë në fund «için» përveç në disa raste të rralla, sikundër as «ov»-in apo «ski»-në, që janë karakteristikë për mbiemrat sllavë. Në mbretërinë e Jugosllavisë së vjetër shqiptarët ishin të shtrënguar që mbiemrat e vet t'i shkruajnë me «iç» në fund, ndërsa kjo praktikë në disa vise ku jetojnë shqiptarët u vazhdua një kohë edhe pas Luftë. Ata pa dyshim këtë e dinë, por heqja e mbaresës «iç» nga mbiemrat shqiptarë mbetka për ta dëshmi e shqiptarizimit kryq e tërthor të Kosovës!

Edhe arkitektura fyhet

7. Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në arkitekturë. Si shembull të paprekshëm të shqiptarizimit të Kosovës edhe përmes arkitekturës ata theksojnë ndërtesën e Bibliotekës Popullore dhe Universitare në Prishtinë. Sipas mendimit të tyre, «roli shqiptarizues i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës», i bika çdokujt në sy menjëherë, «çdokujt që viziton Prishtinën»! Sa intelektualë serbë, sidomos gazetarë, janë ndier para kësaj godine si para një diversioni artistik! Meqë kjo bibliotekë për mësimdhënësit universitarë dhe punonjësit shkencorë të Serbisë me pamjen e vet qenka «kallëzim më vete»! Meqë, sipas pikëpamjes së Shoqatës të mësimdhënësve Universitarë dhe të Punonjësve Shkencorë të Serbisë «kjo godinë u ndërtua në stilin lindor për të theksuar njëfarë fundamentalizmi të shqiptarëve islamikë»! Nëse ndërkaq me pamjen e vet, qenka dëshiruar të theksohej «fundamentalizimi i shqiptarëve islamikë», me kulmin e saj qenka dëshiruar të theksohet nacionalizmi shqiptar! Sipas mendimit të Shoqatës së Mësimdhënësve Universitarë dhe të Punonjësve Shkencorë të Serbisë, «shumësia e kubeve të bardha» në kulmin e kësaj godine «karakterizon plisat shqiptare, që do të thotë simbolet e kombësisë shqiptare!»

Ç'mund t'u përgjigjemi të gjitha këtyre? Nëse thuhet se godina e Bibliotekës Popullore dhe Universitare në Prishtinë është ndërtuar sipas projektit të arkitektit të shquar kroat, se kubetë e bardha në kulmin e saj janë simbol i trurit njerëzor e jo i plisave shqiptare, se me këto trure njerëzore, të prodhuara në Gjermaninë Perëndimore, u desh të simbolizohet dituria njerëzore, të cilën e përbëjnë librat e vendosur në këtë bibliotekë, atëherë shtrohet domosdo pyetja: «Ç'shohin mësimdhënësit universitarë dhe punonjësit shkencorë të Serbisë — godinën e Bibliotekës Popullore dhe Universitare, apo ndonjë ki-

merë të tyre? Godinën, në të cilën janë vendosur librat e shkruara në shumë gjuhë të botës, apo shumë koka shqiptare «të vëna në allçi», madje edhe shpatën e profetit, kundër së cilës edhe shqiptarët luftuan pothuaj 500 vjet?»

Ndryshe nga mësimdhënësit universitarë dhe punonjësit shkencorë të Serbisë, të cilët rolin «shqiptarizues» të arkitekturës kosovare e dëshmojnë vetëm me pamjen e godinës së Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Prishtinës, disa studentë të tyre këtë e bëjnë shumë më gjerësisht, me shumë më tepër shembuj. Kështu, njëri prej tyre me cilësinë e udhëheqësit të rinisë në Leposaviç, diç të ngjashme me këtë bibliotekë, të ngjashme, kuptohet, me pamjen «shqiptarizuese», e sheh pothuaj në të gjitha anët e Kosovës: «shqiptarizimi i Kosovës — thërret ai me patetikë para masës — aq ka marrë hov, saqë nuk ekziston asnjë sferë e jetës dhe e punës ku ai nuk i ka lëshuar rrënjët thellë (...), madje edhe në arkitekturë në dhjetë vjetët e fundit po humbet karakteristika e kësaj treve. Ja, shikoni shtëpinë tonë të shëndetit. Vallë a nuk i ngjan shqiponjës dykrerëshe? Ndërsa, në këtë stil janë ndërtuar edhe stacioni hekurudhor, posta, shtëpia e mallrave, (...) Vallë kulmi i ndërtesës së organizatave shoqëroro-politike në Leposaviç, nuk është «zbukuruar» me plisa?» Shtëpia e Shëndetit, stacioni hekurudhor, posta dhe shtëpia e mallrave atij po i ngjasin me shqiponjën dykrerëshe! Si kanë mundur arkitektët të projektojnë ato dy koka të asaj shqiponje? Kjo nuk është punë e lehtë! Ndërsa godina e organizatave shoqëroro-politike është e «zbukuruar» me plisa dhe pikërisht në Leposaviç, ku pothuaj nuk ka fare shqiptarë! A i ngjasin vërtet këto ndërtesa shqiponjës dykrerëshe, a janë «zbukuruar» këto ndërtesa me plisa apo udhëheqësit tonë të rinisë diçka po i fanitet në formë të shqiponjës së tmerrshme dykrerëshe? Ç'mund të përgjigjemi për të gjitha këto?

Një shkrimtar i njohur kroat pat thënë se njerëzit shpesh nuk lexojnë atë që është shkruar, por atë që u

duket se është shkruar. Kështu mund të thuhet edhe për leximin e arkitekturës: njerëzit nganjëherë nuk shohin atë ç'është, por atë që u duket. Mbase këto halucinacione sot në kohën e krizës së gjithanshme, deri diku, janë të kuptueshme: shovinizmi nuk është ndjenjë normale e shpirtit njerëzor, ai është ndjenjë jonormale që shkon bashkë me temperaturat e larta, ndërkaq me temperaturat e larta shkojnë edhe halucinacionet e herëpashershme!

Mbi emigrantët

8. Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në numrin e emigrantëve nga Shqipëria. Çështja e emigrantëve shqiptarë është njëra nga ato çështje, për të cilën vitet e fundit kanë folur jo vetëm politikanët profesionistë, por edhe luftëtarët, të rinjtë, gratë, pionierët e tash, ja, edhe mësimdhënësit universitarë dhe punëtorët shkencorë. Pse folën nuk është çudi, meqë nuk ka asnjë çështje, për të cilën nuk do të duhej të flitet, por të çudit mënyra si folën. Në raste të ndryshme u cekën të dhëna të ndryshme për numrin e emigrantëve shqiptarë në Jugosllavi. U tha se janë njëqind mijë, pastaj dyqind mijë, pastaj dyqind e pesëdhjetë mijë, pastaj rreth treqind mijë, që në fund të arrijnë deri te numri katërqind mijë! Në njërin nga mitingjet e ashtuquajtura të solidaritetit me serbët dhe malazezët, një vajzë 14-vjeçare nga foltorja, në një qytet të Vojvodinës, kërkoi të kthehen në Shqipëri as më pak e as më shumë se 300 mijë emigrantë shqiptarë, të cilët e paskan kaluar kufirin me qëllim që të «albanizojnë» Kosovën dhe Jugosllavinë.

Organet shtetërore të Kosovës disa herë dhanë të dhëna, nga të cilat shihet se në Kosovë jetojnë gjithsej rreth 800 emigrantë shqiptarë. Por, ashtu si të vërtetat e tjera për Kosovën, të cilat i shprehin shqiptarët, ato nuk u pranuan nga burokracia, prandaj disa nga mjetet

e informimit publik të Beogradit vazhduan që me numrin e emigrantëve shqiptarë të manipulojnë opinionin sipas nevojave të politikës ditore. Të vetmen të vërtetë për numrin e emigrantëve shqiptarë, siç po shikohet, nuk e pranon as Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë të Serbisë, meqë sikur ta kishin pranuar nuk do të nxitnin këtë çështje në përgjigjen e tyre të gjerë, duke kërkuar «kthimin e shqiptarëve të ardhur nga Shqipëria në Shqipëri, apo shpërndarjen e tyre në viset e tjera të Jugosllavisë!» Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe Punëtorëve Shkencorë të Serbisë nuk e pranoi numrin për afro 800 shqiptarë emigrantë, meqë ky numër me gjasë nuk i përgjigjet numrit të shqiptarëve, të cilët do të ishte mirë «të kthehen» përtej kufirit, apo së paku të vendosen në viset e tjera të Jugosllavisë!

Ç'të thuhet për një propozim të tillë të Shoqatës së Mësimdhënësve Universitarë dhe të Punëtorëve Shkencorë të Serbisë? Le të thuhet vetëm kjo: mësimdhënësit universitarë dhe punëtorët shkencorë, sidomos ata që veten e stolisin me epitetet «qytetarë të botës», «humanistë-internacionalistë», siç e quan vetveten prof. dr. H. C. Voislav K. Stojanoviç, kurrë nuk janë marrë me «kthimet» apo «transferimet» e njerëzve. Përkundrazi, ata gjithmonë kanë predikuar marrëveshjen, miqësinë, jetën e përbashkët mes njerëzve pavarësisht nga raca, përkatësia kombëtare, fetare apo ideologjike e tyre.

Lindjet politike

9. Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në natalitetin e shqiptarëve. Çështja e natalitetit shqiptar është e vetmja çështje e Kosovës, për të cilën tash sa kohë po flitet gjithnjë e më shumë e gjithnjë e më zëshëm, madje gjithnjë e në mënyrë më patetike. Kjo është çësh-

tja, për të cilën flasin jo vetëm politikanët profesionistë, por edhe të rinjtë, luftëtarët, pensionistët, ndërsa tash edhe Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë të Serbisë, që fjalorin politik për natalitetin shqiptar e pasuroi me shprehje të reja figurative: «shpërthim i natalitetit të popullatës humane shqiptare».

Shpërthim!

Ç'nuk kanë shkruar për këtë «shpërthim» apo nuk kanë folur disa mësimdhënës universitarë serbë dhe punëtorë shkencorë! Veç kësaj, sipas tyre, ky është një diversion i menduar i arsyes politike shqiptare në Kosovë (sikur fëmijët lindin nga motivet politike!) dhe se kjo është pasojë e fundamentalizmit islamik (sikur fëmijët lindin sipas urdhrit të hoxhallarëve dhe të priftërinjve), si dhe që kjo është pasojë e pranimi të teorisë së «Lebensraumit», përkatësisht të pushtimit të hapësirës jetësore, përkatësisht gjeografike (sikur fëmijët lindin që të pushtohen livadhet, pyjet e kreshtat!). Disa prej tyre shkuan edhe më larg, prandaj llogaritën sa shqiptarë do të ketë në vitin 2000, sa do të ketë në vitin 2025, madje sa do të ketë edhe në vitin 2050! Llogaritën sa do të jetë numri i shqiptarëve në këto vite, që të dëshmojnë se sa do të jenë të rrezikuar prej tyre Maqedonia, Serbia, Jugosllavia, madje edhe Evropa Juglindore! Do të thotë, pra, se prej pak më shumë se dy milionë shqiptarëve është rrezikuar hapësira jetësore e dhjetë milionë serbëve, madje e njëzet e një milionë banorëve të Jugosllavisë! Kur parullat e këtilla i publikojnë gazetatat, kjo mund të kuptohet disi, por kur fabula të tilla i përsërisin mësimdhënësit universitarë dhe punëtorët shkencorë, atëherë kjo është vërtet tragjike, madje tragjikomike, meqë akti i lindjes së qenieve njerëzore nuk është kurrfarë «shpërthimi» thjesht nga arsyeja që shpërthimi është një dukuri kërcënuese, ndërsa lindja e qenies njerëzore është një akt sovran, nga i cili nuk është ndier i rrezikuar asnjë religjion, asnjë ideologji dhe asnjë shtet. Përkundrazi: ky

është një akt i bekuar, të cilin e përshkruajnë me shprehje shumë më humane të gjitha religjionet, të gjitha ideologjitë e të gjitha shtetet. Për të gjithë këto, të gjitha nënat, të gjithë etërit e sidomos të gjitha qeniet e pafajshme e të pabëra që i quajmë foshnja kanë qenë plotësisht të barabartë.

Çfarë universiteti iu dashka Prishtinës

10. Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh edhe në Universitetin e Prishtinës. Për këtë arsye mbase disa prej tyre iu kundërvunë me kohë themelimit të këtij universiteti në mjedisin që, sipas mendimit të tyre atëherë, e me gjasë nuk është larg nga mendimi i tyre edhe sot, «ende nuk është i aftë as për një gjimnaz të plotë», pra ky mjedis në pjesën e dytë të shekullit të njëzet nuk iu afruaka as Serbisë së Knjaz Milloshit të para 150 vjetësh, kur është themeluar Shkolla e Madhe! Argumentet më largpamëse që janë theksuar dikur kundër themelimit të Universitetit të Prishtinës edhe sot janë instruktive dhe për arsye të instruktivitetit të tyre nxirren në shesh edhe tash! E argumenti i parë nga këto është: «Ne kemi pranë një vend që ka një territor kompakt të pakicës me afro 3 milionë banorë, ndërsa askujt nuk i shkoi ndër-mend t'i hapë universitetin. Po ashtu nuk dimë ndonjë vend në botë që i ka hapur universitet pakicës kombëtare siç është rasti në Kosovë». Argumenti i dytë është:

Meqë u vendos të themelohet Universiteti në Prishtinë, atëherë qenka dashur të jetë universitet «kryesisht me mësim në gjuhën serbokroate, në të cilin do të sigurohej mësimi i gjuhës shqipe»! Kjo do të thotë se: disa mësimdhënës universitarë e punëtorë shkencorë të Serbisë, sikundër, pa dyshim, edhe nënshkruesi i përgjigjes së tyre, «qytetari i botës, humanisti-internacionalist i shquar» prof. dr. H. C. Voisllav K. Stojanoviç, u përpoqën që

Universiteti në Prishtinë, e kjo do të thotë që edhe universiteti për Kosovën, në të cilin shqiptarët qysh atëherë përbënin 73 për qind të popullsisë, të jetë universitet i tillë, në të cilin gjuha shqipe do të mësohej ashtu siç mësohen në Universitetin e Beogradit greqishtja e vjetër, latinishtja apo japonishtja, ndërsa lëndët e tjera studentët shqiptarë është dashur t'i dëgjojnë në gjuhën serbokroate! Vërtet në frymën e «qytetërimit botëror, humanizmit e internacionalizmit». Mbase duke pasur parasysh raportin e atëhershëm të Universitetit në Prishtinë, mësimdhënësit universitarë dhe punonjësit shkencorë të Serbisë, sidomos nënshkruesi i përgjigjes së tyre, H.C. Voisllav K. Stojanoviç na përkujtojnë: «Kur është fjala për gjuhën në Universitetin e Prishtinës, çdokund në botë përdoret gjuha zyrtare, me të cilën flet shumica e popullsisë, ndërsa në Serbi si shtet, pa dyshim, populli shumicë është ai serb»

Ç'të thuhet për të gjitha këto?

Të thuhet vetëm kjo: «Qytetarët e njohur të botës, humanistët, internacionalistët, gjithmonë kanë luftuar që të gjithë njerëzve të botës t'u mundësohet që natyrën, shoqërinë dhe historinë ta njohin në gjuhën, të cilën ata e dinë më së miri dhe që e duan më shumë dhe që njohuritë e veta t'i shprehin në atë gjuhë, të cilën e dinë më mirë dhe e duan më shumë, në gjuhën e vet amtare. Mësimdhënësit universitarë dhe punëtorët shkencorë, që veten e nderojnë me fjalët «qytetarë të botës, humanistë-internationalistë të shquar», nuk kanë luftuar për gjuhën zyrtare, por për gjuhët e lira. Por kjo kohë është e krizës së përgjithshme, ndërsa kriza shembi edhe humanizmin e disa punëtorëve universitarë shkencorë e humanistë!

Një koncept si instrument politik

Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë të Serbisë shqiptarizimin e sheh kudo

ku ka shqiptarë, meqë e sheh në çdo gjë që bëjnë ata, kudo që shkruhet në gjuhën shqipe, në çdo gjë që mendojnë shqiptarët. Kjo, praktikisht, do të thotë, kudo që, përveç asaj serbe, shohin edhe diç shqiptare, aq më parë atje ku shohin vetëm shqiptarë. Me një fjalë: çdo gjë shqiptare për ta është shqiptarizim! Prandaj mund të thuhet se koncepti shqiptarizim është instrument politik, me të cilin synohet represioni, me të cilin rrezikohen vlerat historike, shpirtërore dhe kulturore shqiptare — identiteti kulturor dhe integriteti i popullit shqiptar. Shqiptarizimi i trilluar është shembull i qartë i shqiptarofobisë. Sikur të mos ishte kështu, atëherë nuk do të propozohej heqja e Institutit Albanologjik dhe e Bibliotekës Popullore dhe Universitare në Prishtinë, nuk do të kërkohesh vendosja e gjuhës mësimore serbokroate në Universitetin e Prishtinës, nuk do të kërkohesh ndërrimi i emrave të shkollave, që mbajnë emrat e personaliteteve më të ndritshme të historisë dhe të kulturës shqiptare: Skënderbeut, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Naim Frashërit, Fan Nolit, Luigj Gurakuqit etj. Mësimdhënësit universitarë dhe punëtorët shkencorë të Serbisë, si duket, harrojnë se shqiptarët kanë gjuhën e vet dhe që kjo gjuhë duhet të ekzistojë edhe përmes vulave shkollore e gjyqësore; se kanë historinë dhe kulturën e vet dhe që kjo histori dhe kulturë duhet të tregohet edhe përmes emrave të shkollave dhe të rrugëve të qytetit; se kanë arkitekturën e vet kombëtare dhe se është fare e natyrshme që edhe kjo arkitekturë të ndikojë në arkitekturën bashkëkohore të Kosovës. Ata, si duket, harrojnë se shqiptarët ndodhen në atdheun e vet të lashtë, ku jetuan edhe paraardhësit e tyre ilirë dhe se për këtë arsye pamja kulturore e Kosovës kurrë nuk ka qenë, e mbase nuk mund të jetë edhe më tutje pa tiparet e kulturës së tyre.

Për arsye se e respektojnë dhe e duan kulturën serbe në Kosovë si dhe të gjitha kulturat kombëtare të botës, shqiptarët kurrë nuk kanë folur për serbizimin e Kosovës.

Meqë e respektojnë dhe e duan kulturën serbe në

përgjithësi, shqiptarët kanë të drejtë që të kërkojnë që edhe Shoqata e Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punonjësve Shkencorë të Serbisë të respektojë kulturën dhe historinë e tyre. Shqiptarët nuk mund të kenë as histori tjetër e as kulturë tjetër përveç kësaj që kanë, e me të cilën krenohen.

Të themi edhe këtë se nuk shkon në favor të bashkim-vëllazërimit pohimi se «imponimi i dhunshëm i kushtetutës së vitit 1974 ishte fatal për Serbinë e kështu edhe për Jugosllavinë», e kjo do të thotë se kushtetutën e imponoi sundimtari pa bashkëpunim me parlamentin, sikur RSFJ në vitin 1974 të ishte të paktën mbretëri.

Ndërkaq, sa i përket vërejtjes rreth bashkëpunimit ndërmjet Shoqatës së Mësimdhënësve Universitarë dhe të Punëtorëve të tjerë Shkencorë të RS të Serbisë e të Shoqatës së Mësimdhënësve Universitarë të Kosovës e të Punëtorëve të tjerë shkencorë të KSA të Kosovës, kolegëve tanë mund t'u themi këtë: Jemi për bashkëpunim, në të cilin dëshirojmë të besojmë se nuk do të sulmohen e të shpifet për njerëzit, duke u mbështetur me këtë rast edhe në fjalë të dëgjuara rrugëve (siç janë ato në «Politika» e 9 qershorit të vitit 1981 për kryetarin e shoqatës sonë), ne jemi për këmbimin e mendimeve, për dialog, në të cilin respektohen faktet dhe me të cilin zgjerohet dhe pasurohet fryma e respektimit dhe e miqësisë.

Kryesia e Shoqatës së Mësimdhënësve Universitarë dhe e Punëtorëve të tjerë Shkencorë të KSA të Kosovës.

*«Rilindja», Prishtinë, 11 dhe
12.1.1989.*

Rabit Rexhepi

ZENEL HAJDINI E JO ZEJNEL AJDINOVIÇ

Kohët e fundit u aktualizua edhe çështja e së drejtës së pjesëtarëve të kombësive për përdorimin e lirë të emrave dhe mbiemrave në gjuhën e tyre amtare.

E drejta e pjesëtarëve të një kombi, pra edhe të një kombësie, që të mbajnë mbiemrat në përputhje me natyrën e gjuhës së vet, është element alfa i barazisë sonë. Këtu historianët, në të cilët mbështeten autorët, nuk kanë çka të gjurmojnë. Ata madje duhet të shpjegojnë se si ka ndodhur të deformohen mbiemrat, e pse është mënjeluar deformimi. Më kujtohet deklarata e një akademiku e revolucionari të nderuar, tash i ndjerë, Mihaillo Apostollski, i cili këtë fenomen me mbiemrat e ka shpjeguar në mënyrë plastike në një intervistë në TV. Ai thotë se «unë në kohën e okupimit bullgar jam quajtur Apostollov, në kohën e ish-Jugosllavisë Apostolloviç, ndërsa vetëm revolucioni ynë më mundësoi që mbiemrin tim ta përshtatja me natyrën e gjuhës sime kombëtare, me identitetin e qenies kombëtare maqedonase». Pra, autori i shkrimeve të 22, 23, 24 dhjetorit të vitit 1987 në «Politika» le të ofrojë mendim më të shëndoshë se ky. Pse biem në disa kurthe dhe kërkojmë armikun edhe atje ku nuk është? E drejta e mbiemrit, që është në përputhje me

natyrën e gjuhës dhe në traditën e çdo populli, te ne është fryt i revolucionit tonë socialist, për të cilin dha jetën edhe Heroi i Popullit Zenel Hajdini.

Befason se pothuaj të gjithë maqedonasit në kohën e ish-Jugosllavisë në mbiemrin e vet kishin edhe mbraspashtesën «viç» dhe të gjithë këtë padrejtësi e flakën pas Çlirimit, gjë që është normale dhe e natyrshme. Askujt, pra, nuk i ra ndër mend të shtrojë problemin pse profesor Apostollski nuk quhet më Apostolloviç. Me mbiemrat shqiptarë është çështje tjetër. Duke shfrytëzuar diskursin aktual, këtu shtrohet edhe çështja e sufiksit «viç» te mbiemri dhe ai shfrytëzohet për ndërlikimin e kthimin prapa të historisë. Autorët e këtyre tezave dhe tendencave nuk ngurrojnë që te pjesëtarët e kombësisë shqiptare të zgjojnë ndjenjën e mosbarazisë, që këtë ata ta përjetojnë si element të cenimit të lirive të tyre dhe t'u përkujtojnë përvojën e hidhur historike të tyre. Dikush edhe para 100 vjetësh shkroi: «Qëllimi justifikon mjetet, pos atyre që nuk janë në përputhje me qëllimin». Në përputhje me këtë, pra, edhe mjetet që e drejta më e natyrshme e njerëzve që të mbajnë mbiemrin e vet të kontestohet. Shkrimet e shpeshta në shtyp, masat e diferencimit përkitazi me mbiemrat në Mal të Zi dhe Maqedoni dhe në disa vise të Serbisë, flasin qartë për mungesën e madhe të respektimit të parimeve dhe për nxitjen e problemeve me qëllime të caktuara. Për fat, këtë po e nxisin vetëm forcat destruktive, pra, në këtë kohë të ndërlikuar dëshirojnë dhe imponojnë shkëlqimin e vet të rremë në emër të kinse interesave të larta të kombit të vet.

Heroi i Popullit Zenel Hajdini nuk është Zejnel Ajdinoviç. Ai me shumë heronj të tjerë nga radhët e të gjitha kombeve dhe kombësive, në epopenë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të Revolucionit dha jetën e vet për çlirimin klasor-social e kombëtar. Ky çlirim nënkupton edhe të drejtën që të flaket padrejtësia historike rreth mbiemrit të tij. Çfarë të drejte ka dikush

që këtë ta kontestojë? Dikush fare qartë dëshiron që këtyre idealeve t'ua marrë atë bukuri që stolis edhe burimin e tyre.

«Rilindja», Prishtinë, 1.2.1988

Dr. Kajtaz Rreçaj

PLANPROGRAMI I PAPRANUESHËM

Dihet se një grup ekspertësh ka hartuar një (Projekt) Planprogram të gjuhës e të letërsisë shqipe, por në momentin e fundit tërhiqet dhe i dërgohet Pleqësisë Krahinore të Arsimit të KSAK për miratim Planprogrami që po shqyrtohet tani. Për fat të mirë, Pleqësia Krahinore e Arsimit nuk e miratoi këtë Planprogram, por e lëshoi në diskutim publik dhe në këtë mënyrë iu ofrua mundësia institucioneve profesionale e shkencore si dhe individëve të japin mendimin e vet për këtë Planprogram.

Pohoj me përgjegjësi profesionale e morale se ky Planprogram (pjesa e letërsisë) është planprogrami më i dobët prej Çlirimit e deri tashti. Kjo shihet edhe nga emërtimi i tij, meqënëse nuk jep mundësi të nënkuptohet se është program i mësimi të letërsisë shqiptare, por vetëm i mësimi të letërsisë (!).

Konceptimi i Programit, sa i përket letërsisë, është krejtësisht i gabuar. Me këtë Planprogram nuk u mundësohet nxënësve që mësojnë në gjuhën shqipe, të mësojnë letërsinë kombëtare në masë të mjaftueshme. Atyre, në këtë mënyrë, u merret e drejta kushtetuese për të mësuar kulturën kombëtare që mundëson formimin e personalitetit të tyre në frymën e përcaktimeve tona ideopolitike

e ideoestetike. Në vend që në Planprogramin e gjuhës e të letërsisë shqipe të ketë vend qendror letërsia shqiptare, këtu ndodh e kundërta. Letërsia shqiptare futet si shtojcë e parëndësishme dhe u ndajmthet letërsive të përthyer. Është e tepërt të pohohet se bazë e programit të letërsisë që u dedikohet nxënësve shqiptarë të jetë letërsia shqiptare. Kjo ka qenë realitet yni, sidomos prej gjysmës së dytë të viteve gjashtëdhjetë. E çka ndodhi tashti? Si është e mundur të rrudhet kaq shumë mundësia e mësimit të letërsisë shqiptare nga nxënësit shqiptarë? Në emër të cilave parime, në emër të cilave kritere, në emër të cilës drejtësi? Si është e mundur që Noli të përfaqësohet vetëm me dy poezi? Këshu ndodh edhe me Mjedën! A mund të mësohet krijimtaria poetike e Poradecit vetëm me vjershën «Kroi i fshatit tonë», me pretekst se me të përfaqësohet modernia në poezinë shqiptare? Kështu janë cunguar të gjithë shkrimtarët shqiptarë duke u përfaqësuar vetëm me nga një, dy apo tri poezi ose vetëm me nga një prozë. Deri tashti, krijimtarisë letrare të Çajupit i kushtoheshin 5-6 orë mësimi, në të cilat analizohej lirika sociale e tij, lirika patriotike e tij, lirika erotike e tij, lirika satirike e tij, vajet e tij dhe dy komeditë e tij.

Tashti, sipas Planprogramit që është lëshuar për diskutim, arsimtari duhet të flasë vetëm për katër vjersha të Çajupit! Ç'është edhe më keq, për një grup shkrimtarësh dhe për disa individë duhet të flitet vetëm në mënyrë informative e të përgjithshuar, si, psh, për bejtexhinjtë, për Sami Frashërin etj. Pse është vepruar kështu? Kur i është dhënë aq shumë hapësirë letërsisë së përthyer, është e qartë se nuk ka mbetur hapësirë e mjaftueshme që të përfaqësohet letërsia kombëtare në mënyrë të mjaftueshme. Si duket, hartuesi i Planprogramit nuk ka pasur parasysh se nxënësit shqiptarë e mësojnë letërsinë e kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë edhe në kuadër të lëndës mësimore, gjuhën serbokroate si gjuhë joamtare të obliguar. Në këtë mënyrë, nxënësit

shqiptarë do të mësojnë dy-tri herë më shumë e më gjerësisht letërsinë jugosllave sesa letërsinë kombëtare, kurse disa shkrimtarë të letërsisë jugosllave do të mësohen nga dy herë — një herë në kuadër të lëndës së gjuhës e të letërsisë shqipe, e së dyti në kuadër të lëndës së gjuhës serbokroate. Si mund të arsyetohet fakti që nga 35 vepra letrare të lekturës shkollore, 23 të jenë vepra të përkthyer dhe vetëm 12 sosh të letërsisë shqiptare? Kjo nuk ka nevojë të komentohet. Kështu është puna edhe me mësimin e shtuar, madje edhe më keq.

Në këtë Planprogram është vështirë të dihet se kush është në pozitë më të keqe — a shkrimtarët që janë përfshirë në të apo ata që nuk janë përfshirë fare. Ndoshta do të ishte më mirë, bie fjala, të mos përfshihej fare De Rada sesa të përjetësohej vetëm me një vepër. Apo, kur është fjala për letërsinë bashkëkohore, me të drejtë mund të shtrohet pyetja: në atë program të letërsisë shqiptare, ku nuk gjendet Jakov Xoxa, Hivzi Sulejmani (përveç në lekturë), Kolë Jakova, Rrahman Dedaj (përveç në lekturë), Ali Abdihoqha, Din Mehmeti e të tjerë, çka lyp X Y shkrimtar, i cili, në krahasim me ta, është minor.

Gabimet në këtë Planprogram janë të shumta e të lloj-llojshme, kështu që është i pamundshëm korrigjimi i tij. Prandaj, propozoj që Plani dhe programi i përbashkët mësimor i gjuhës shqipe dhe i letërsisë për arsimin dhe edukimin e mesëm të hidhet poshtë dhe të formohet një grup prej ekspertësh kompetentë që të hartojë dokumentin e ri që do të quhej (Projekt) Plani dhe Programi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe.

«Rilindja», Prishtinë, 2.4.1988

Agim Vinca

MITIZIM I REALITETIT

Njëfarë dr. Prof. Jovan Panovski nga Shkupi, me sa duket, është bërë «specialist» për të shkruar letra, sidomos kur është fjala për shqiptarët. Që prej disa muajsh ai e ndryshon variantin e së njëjtës letër — po me atë përmbajtje, po me atë gjuhë dhe frazeologji — në redaksitë e ndryshme në linjën Shkup-Beograd-Zagreb. Kështu, së pari, në «Nova Makedonija» të 30 janarit të këtij viti ai boton letrën me titull: «Çfarë kërkon Agim Vinca?», e cila më shumë i përngjan një akuze politike, sesa një shkrimi polemizues; së dyti, në «Politika» të 23 shkurtit të po këtij viti boton një letër të gjatë mbi politikën e popullimit, ku *en bloc* sulmon një grup autorësh (bashkëpunëtorë të «Danasit»), pikëpamjet e të cilëve për këtë çështje nuk përputhen me të tija dhe, së fundi, në revistën «Danas» (nr. 317), për herë të tretë qëllon me të njëjtin «plumb», me të cilin, në mënyrën e vet, bën replikë me «intelektualët kosovarë», duke përfshirë aty edhe mua, autorin e letrës «Vështrim i shtrembëruar» («Danas», nr. 309), e cila në mjetet e informacionit publik të RS të Maqedonisë, dhe jo vetëm në to, është pritur, siç thuhet, në majë të thikës!

Meqenëse, të paktën tani për tani, kjo letër e fundit

e këtij letraxhiu maqedon nuk është gjë tjetër, veçse një version i përsëritur i letrës së botuar nga «Nova Makedonia» nën titullin kërcënues «Çfarë kërkon Agim Vinca?», më poshtë po jap përgjigjen që i kam dërguar lidhur me këtë «Nova Makedonias», por edhe «Danasit», në një variant më të shkurtër dhe të modifikuar.

Në letrën time të botuar në «Danas», e cila, siç dihet, që një përgjigje për letrën e dr. Juraj Magjaricit nga Zagrebi, u jam referuar disa çështjeve lidhur me realizimin e politikës së barazisë nacionale në RS të Maqedonisë, me mendimin se në momentin e tanishëm të demokratizimit të përgjithshëm shoqëror kjo nuk do të ishte as mëkat e as temë tabu.

Së pari, është çështja e mbishkrimeve publike, të cilat në këtë republikë, madje edhe në ato mjedise, ku shumicën e banorëve e përbëjnë pjesëtarë të kombësisë shqiptare, nuk shkruhen në dy gjuhë, gjë që e kam provuar me shembuj konkretë dhe bindës. Megjithatë, me këtë rast do të përmend edhe një shembull drastik. Është i njohur rasti i shkollës fillore «Liria» të Shkupit, ku një grup arsimtarësh u shpallën nacionalistë dhe separatistë dhe në përputhje me këtë u dhanë masa disiplinore partie pasi kërkuan që vula dhe mbishkrimi i shkollës (vetëm këtë dhe asgjë tjetër) të jenë në dy gjuhë — në maqedonisht dhe në shqip. Vallë ky është «një absurditet qesharak» dhe «një gënjeshtër e paturpshme», siç shprehet dr. prof. Jovan Panovski? Gjithashtu dihet se lidhur me këtë nëpërmjet shtypit është dhënë arsye-timi zyrtar se komuna qendër, sipas statutit, nuk është cilësuar si mjedis dygjuhësor, megjithëse në të, përveç maqedonëve, jetojnë edhe pjesëtarë të kombësive të tjera. Shtrohet pyetja: a duhet që aktet normative t'i përshtaten realitetit apo e kundërta, realiteti akteve normative? Për këtë le të mendojë pak shoku Panovski dhe ata që mendojnë si ai, veçse në mënyrë dialektike.

Çështja e dytë është shkrimi dhe shqiptimi i emrave të disa vendbanimeve, pra, çështja e përdorimit të emrave paralelë të disa qyteteve dhe fshatrave, për të

cilët ekzistojnë dy, madje edhe tri emërtime, siç është rasti me kryeqytetin dhe disa qytete të tjera në RS të Maqedonisë (Skoplje-Shkup, Debar-Dibër, Kiçevo-Kërçovë, Ohrid-Ohër, Bitola-Manastir etj.), gjë që është një dukuri e njohur jo vetëm te ne, por në të gjithë botën. Është fakt se në Maqedoni, në emisionet e RTV të Shkupit në gjuhët shqipe dhe turke, në tekstet shkollore, në mësim etj., (për fat ende jo, ndoshta rastësisht, në gazetën «Flaka e Vëllazërimit»), vitet e fundit këta emra nuk shkruhen në përputhje me drejtshkrimin e gjuhës shqipe (dhe turke), por ekskluzivisht në variantin maqedonisht. Dhe e gjithë kjo, gjoja, për të penguar «shqiptarizimin» e toponimeve dhe, natyrisht, në emër të luftës kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar dhe në frymën e bashkim-vëllazërimit, megjithëse ata emra shqiptarët (dhe turqit) i përdorin në atë formë vetëm kur flasin dhe shkruajnë në gjuhën e vet dhe nuk kërkojnë të veprojnë kështu edhe të tjerët. Është ende i freskët shembulli i redaktorit të shtëpisë botuese «Prosvetno Dello», i cili u dënua pasi kishte lejuar që në tekstin në gjuhën shqipe emrat e disa qyteteve të RS të Maqedonisë të shkruheshin ashtu siç janë shkruar dhe shqiptuar në shekuj, ashtu siç janë shkruar pa asnjë problem që prej 40 vjetësh pas Çlirimit — Shkup, Dibër, Kërçovë, Ohër, Manastir etj. Pra, po e përsëris, bëhet fjalë për rastet, kur flitet dhe shkruhet në gjuhën shqipe. Vallë, a nuk është ky një kufizim i llojit të vet i së drejtës gjuhësore; vallë fakte të tilla janë «gënjeshtra të paturpshme» dhe «absurditete qesharake» të R. Qoses, A. Vincës, etj., siç shkruan në mënyrë absurde dhe të paturpshme prof. dr. Panovski?!

E njëjta gjë ndodh edhe me emra njerëzish dhe familjesh, ku gjithashtu zbatohen masa kufizuese. Është fakt, dhe për këtë shumë herë është informuar opinioni publik nëpërmjet shtypit dhe organeve të tjera të informacionit, se në Maqedoni emrat Arben, Alban, Kreshnik (megjithëse vetë lingvistët shqiptarë thonë se vjen nga

Krajishnik), Kushtrim, Flamur, Kastriot, Valon, Vlora, Shqipe, Besa (megjithëse kjo fjalë e bukur dhe e vetme shqipe gjendet edhe në fjalorin e gjuhës maqedone) dhe emra të tjerë të ngjashëm njerëzish janë shpallur të «papërshtatshëm» dhe janë nxjerrë «jashtë ligjit», sepse kanë lidhje me flamurin, historinë dhe të kaluarën kombëtare. Unë di raste që prindërit janë vënë në një situatë të tillë që të mos mund të ripërtërijnë emrin e fëmijës së tyre të vdekur (gjë që është një traditë e vjetër dhe e bukur jo vetëm te shqiptarët, por edhe te maqedonët, ashtu si edhe te popujt e tjerë ballkanikë dhe evropianë), për faktin se fëmija e vdekur, i cili ka lindur dhe ka vdekur në «kohë të tjera», është quajtur, psh. Arben ose Kushtrim! Vallë a nuk është ky një fat tronditës njerëzor, ndaj të cilit nuk mund të qëndrojmë indiferentë, jo si shqiptarë apo maqedonë, por thjesht si njerëz?! Le të kujtojmë proverbën e famshme të Monteskjës: «Unë detyrimisht jam njeri, ndërsa francez jam rastësisht!» Por, në të vërtetë jemi shumë larg të kuptuarit të tillë të botës, megjithëse jetojmë jo në kohën e Monteskjës, por në prag të shekullit të 21-të.

Më gjerësisht në letrën e tij Panovski merret me çështjen e shkollimit të të rinjve (edhe të të rejave) shqiptarë në RS të Maqedonisë, pastaj me çështjen e planifikimit të familjes, gjë që domosdo, lidhet me të parën, por, për fat të keq, përsëri në mënyrë të sipërfaqshme dhe të pasuksesshme. Përse? Sepse ai nuk dallon pasojën nga shkaku, dhe anasjelltas, gjë që është kusht paraprak bazë i çdo meditimi intelektual (pra edhe kusht bazë i meditimit si akt njerëzor në përgjithësi), e jo më i një diskutimi publik. Në fakt, Panovski pohon, në bazë të «përvojës», siç thotë vetë ai, dhe jo të statistikave të verifikuara, se 50 për qind e të rejave shqiptare në Maqedoni nuk mbarojnë dot as klasën e tetë dhe një për qindje edhe më e vogël e tyre arrin deri në shkollë të mesme, ndërsa nga ana tjetër justifikon heqjen e mësimin të fazës së dytë të arsimit të orientuar në gjuhën

shqipe pothuajse në të gjitha komunat e Maqedonisë Perëndimore. Për këtë gjithashtu është folur mjaft në publik. Panovski, duke cituar fjalët e kolegut të tij në kohën e studimeve në Beograd (i cili për të është Belgrad), të Ali Shukrisë, thekson se lënia pasdore e gjuhës joamtare ka qenë një «gabim i madh». Por nuk bëhet më fjalë për mësimin e maqedonishtes si gjuhë joamtare, gjë që është shumë e drejtë (megjithëse në Maqedoni askush i gjallë nuk e zë në gojë mësimin e gjuhëve shqipe dhe turke, për shembull në mjediset e përziera nacionale), por për heqjen e mësimin në gjuhën amtare shqipe. Sepse të ashtuquajturat paralelet e përbashkëta «nuk janë gjë tjetër veçse klasa, ku mësimi zhvillohet ekskluzivisht në gjuhën maqedone»! Në praktikën e shkollimit të pjesëtarëve të kombësive në RS të Maqedonisë me këtë është bërë një hap i madh mbrapa, dhe kjo në një kohë kur ishte e natyrshme të pritej të bëhej një hap i ri përpara. Arsyetimi shoqëruar zyrtar ose gjysmëzyrtar se kjo është forma e luftës kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, pra e forcimit të bashkim-vëllazërimit dhe të marrëdhënieve ndërnacionale, nuk është gjë tjetër veçse cinizëm dhe demagogji e qarqeve burokratike, të cilat e mbajnë fort në duart e tyre parullën «shpëtimtare» të «klasave të përziera». Shtrohet pyetja: në këtë mënyrë ndihmohet apo pengohet shkollimi i të rinjve nga radhët e kombësisë shqiptare? A rritet apo pakësohet kështu numri i shqiptarëve dhe i shqiptareve të shkolluara? Përgjigjja shpresoj se është e qartë edhe për Panovskin, i cili nuk e bën, ose nuk do ta bëjë dallimin midis shkakut dhe pasojës.

Në lidhje të ngushtë me problemin e shkollimit dhe të zënies në punë, sidomos të femrave, është edhe problemi i planifikimit të familjes, pra lindshmëria, i cili kohët e fundit, në saje të rezolutës famëkeqe të Tetovës për familjen katëranëtarëshe, ka dalë në plan të parë të organeve të shtypit. «Shqiptaret gjysmëanalfabete shndërrohen në moshë të re në makineri për lindjen e fëmijëve», shkruan Panovski. Pikërisht kështu! Një njeri, i

cili, siç mësojmë nga letrat e tij, ka studiuar për mjekësi dhe që para emrit të tij vë titullin e prof. dr., nuk është mirë, madje as dinjitoze të shprehet në këtë mënyrë, kur bëhet fjalë për njerëz, pra për femrat, qofshin ato edhe shqiptare! Por ç'të bësh! Ndodh që nën bluzën e bardhë fshihen njerëz të ngarkuar me paragjykime të rënda nacionale, fetare si dhe rajonale. Sepse, femrat, të çdo kombi, feje e race qofshin, mund të jenë nëna, motra, bashkëshorte etj., por jo makineri! Njerëz si Panovski, me sa duket, i ka përfshirë një panik i çuditshëm nga «makineri» të tilla çudibërëse. Ata kanë sajuar të ashtuquajturën «recetë tetovare», për të cilën në opinionin publik ka patur shumë reagime. Në fakt, bëhet fjalë për vendimin e kësaj komune, një nga më të mëdhatë në republikë, ku më se 70 për qind e popullsisë është e kombësisë shqiptare, qe lindshmëria e lartë, e cila është shkaktare e zhvillimit të pamjaftueshëm dhe e prapambetjes, të kufizohet me masa administrative, përkatësisht me masa ligjore, në mënyrë të tillë që për çdo fëmijë të tretë prindërit të paguajnë vetë për shkollimin, shërbimin shëndetësor, e madje edhe tatim, një lloj haraçi modern ky.

Një veprim i tillë, si dhe miratimi i ligjit për mospagimin e kompensimeve të fëmijëve për fëmijën e tretë, nga njerëz të shquar dhe institucione të vendit është cilësuar si «hyrje politike në shtratin bashkëshortor», është quajtur «model kinezo-tetovar», madje edhe genocid, siç tha kohët e fundit shumë qartë profesori i shquar i Universitetit të Zagrebit dhe kryetar i Shoqatës Botërore të Viktimologëve, prof. dr. Zvonimir Sheparović: «Rasti i Tetovës dëshmon se Jugosllavia nuk është më e imunizuar ndaj genocidit, sepse në territorin e saj merren masa, me të cilat pengohet zhvillimi i një populli. Ky është genocid...»¹

1) Nga intervista dhënë Radio-Zagrebit, e cila pjesërisht është botuar edhe në «Rilindja», 21.2.1988.

Në letrën e tij të shkruar në panik Panovski me të drejtë ngrihet kundër mitizimit të së kaluarës. «Vallë R. Qosja dhe të tjerët, pyet ai, nuk e kuptojnë se mitizimi i së kaluarës ka pasoja tragjike?» Megjithatë, i entuziazmuar me fluturimin e kultit të tij kundër së kaluarës, ky J. P. student i mjekësisë para luftës dhe pensionist i tanishëm, i ngeshëm, kalon në ekstremin tjetër, edhe më të dëmshëm, mitizon të sotmen, pra idealizon realitetin bashkëkohor. Letra e tij në revistën «Danas» nuk është gjë tjetër veçse mitizim, që do të thotë një tablo e rreme e realitetit në RS të Maqedonisë, të paktën për sa i përket pozitës së kombësisë shqiptare në të. Sipas tij, del se atje gjithçka është në rregull, e bukur, si s'ka më mirë, mund të thuhet parajsë e vërtetë! Por, ja, këtë mirësi, këtë harmoni, këtë parajsë të zotit, po e prishin, askush tjetër, veçse shqiptarët, të cilët plaçkisin nëpër Maqedoni si disa fantoma mesjetare apo si supermenë të ardhshëm të filmave të zhanrit fantastiko-shkencor dhe po pushtojnë çdo gjë: qytete, fshatra, lumenj, ara, Tetovën, Ohrin, Shkupin, maqedonët myslimanë... , po pushtojnë hapësirën e republikës së tyre, në të cilën, për fat të keq, atyre po u ngushtohet gjithnjë e më shumë hapësira jetësore!

*«Mitologizacija Stvarnosti», «Danas»,
Zagreb, 12.4.88.*

Besim Bokshi

DO TË FRENOJ TË QESHURIT

Diskutim në takimin e shkrimtarëve serbë dhe kosovarë me temë: «Shqiptarët dhe serbët në Jugosllavi sot».

Dihet se mendimi për origjinën ilire të gjuhës shqipe ishte konkluzioni i parë logjik që iu imponua shkencëtarëve. Ky mendim është ngulitur thellë në shekullin e kaluar, në fillim nga ana e historianëve dhe pastaj nga linguistët e njohur.

Hipoteza për origjinën trake të gjuhës shqipe ishte një bindje e sigurtë e shkencëtarëve P. Skok dhe H. Bariç, më vonë edhe e I. Popoviçit (si dhe e disa shkencëtarëve të tjerë jashtë Jugosllavisë), kurse punimet dhe studimet e të dy palëve, si një ndihmesë e rëndësishme për njërën apo tjetrën hipotezë, dhe për ndriçimin e problemit në tërësi, kishin një trajtim të njëjtë dhe botoheshin edhe nga ana e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve. Sot, kur nga njëra anë, pas I. Popoviçit u ndërpre vazhdimësia e ndihmesës së shkencëtarëve serbë për ndriçimin e kësaj çështjeje të albanologjisë, dhe kur, nga ana tjetër, të gjithë albanologët e sotëm janë të mendimit se gjuha shqipe rrjedh nga gjuha ilire (me përjashtim të Georgievit, teza e të cilit për origjinën dake të gjuhës shqipe mbeti e izoluar qysh në fillim),

opsioni për origjinën trake të gjuhës shqipe pushoi së qeni një bindje shkencore me të vërtetë e sigurtë...

Gjuha unike letrare shqipe u krijua në vitin 1972 në Kongresin e drejtshkrimit në Tiranë. Në këtë Kongres morën pjesë edhe linguistë dhe intelektualë shqiptarë nga Jugosllavia, të cilët kanë dhënë një kontribut me vlerë për këtë unifikim që në Konsultën gjuhësore në Prishtinë në vitin 1968.

Krijimi i gjuhës letrare të unifikuar është vlerësuar gjithmonë si një akt kulturor mjaft i rëndësishëm i një kombi. Kjo gjuhë hap rrugët për depërtimin në masat e popullit të kulturës, shkencës dhe teknikës më të lartë. Ky akt vërteton shkallën e lartë të përparimit të një populli dhe përbën bazën e domosdoshme për përparimin e mëtejshëm me ritmin e zhvillimit të kulturës bashkëkohore.

Gjuha letrare unike e një populli integron forcat e tij krijuese në të gjitha anët, për të ndikuar në mënyrë të barabartë për pasurimin e kulturës së tij kombëtare të pandashme. Ajo pasqyron identitetin kombëtar, unitetin e kulturës, me të cilat një popull hyn në marrëdhënie me popujt e tjerë — i aftë për të respektuar të tjerët dhe i denjë për t'u respektuar nga të tjerët.

Pohohet se gjuha letrare shqipe është një ngjarje e ndritur, që kurorëzoi mundin e brezave të linguistëve më të mirë dhe të intelektualëve më përparimtarë të popullit shqiptar që në kohën e Rilindjes Kombëtare.

Dhe është e drejtë e çdo populli që të vendosë vetë për krijimin, normimin dhe kodifikimin e gjuhës së tij letrare unike.

Por kjo, sidomos unifikimi i gjuhës shqipe, nuk u pëlqeu disave të ne. Te shqiptarët, thanë ata, kjo vepër është regresive dhe e rrezikshme. Ata thanë publikisht në shtyp se është gabim që u pranua përdorimi i gjuhës shqipe të unifikuar edhe nga shqiptarët e Jugosllavisë. Sipas tyre, do të ishte dashur të krijohej një gjuhë standard e ndryshme nga gjuha që përdoret në Shqipëri. Nuk

ka rëndësi fakti që pjesëtarët e kombësive të tjera në Jugosllavi përdorin gjuhën letrare të shtetit mëmë, si për shembull, hungarezët, rumunët, italianët, turqit etj. dhe sllovenët e kroatët në Itali e Austri, rëndësi ka, thënë ata, që vetëm shqiptarët të kenë një gjuhë të ndryshme.

Në këtë frymë disa «shkencëtarë» në Mal të Zi zbuluan se e folmja shqipe në Malësi qenka një gjuhë tjetër, që ndryshon nga gjuha shqipe dhe se ky dallim ka bazë historike. Madje u tha gjithashtu se malësorët janë një popull tjetër dhe të gjitha këto arritën deri në gazetë qendrore, sikurse është «Borba», si një «kontribut serioz» në diskutimin për krijimin e një gjuhe të veçantë letrare në Mal të Zi.

Në të vërtetë nuk ka kuptim që të merremi me shkaqet e trajtimit dhe të vlerësimit të tillë të gjuhës letrare unike shqipe, sepse ato burojnë nga mënyra primitive e arsytimit, nga ekskluziviteti nacionalist, që funksionimin e vet shoqëror e mbështet në rrezikun e shpikur që kërcënon bashkësinë tonë.

Por, megjithëkëtë, çështja është serioze, sepse edhe disa anëtarë të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve shprehën mendimin se shqiptarëve në Jugosllavi nuk duhej t'u lejohej përdorimi i gjuhës letrare unike shqipe, sikurse mund të shihet nga ajo që doli publikisht në Memorandumin e papërfunduar të kësaj Akademie. Kështu arsyet e një qëndrimi të tillë tani janë në dorën e «shkencës» së lartë, prandaj do të ishte shumë interesante që të na jepej mundësia t'i dëgjonim. Përsa më përket mua, jam i sigurtë se do ta frenoj të qeshurit.

*«Uzdržaču se od smeha», «NIN»,
Beograd, 15.5.1988.*

Rexhep Osmani

**NUK U PRANUAN AS TË
«PAOBLIGUESHMET»**

*Pas miratimit të planeve dhe programeve mësimore
të gjuhës shqipe për arsimin dhe edukimin fillor
në KSAK¹, RSS², RSM³ dhe në RSMZ⁴*

Një ndër kërkesat themelore të shkollës sonë është edhe përparimi dhe përsosja e vazhdueshme e planeve dhe programeve mësimore. Kohët e fundit u miratuan planet dhe programet mësimore të të gjitha lëndëve për arsimin dhe edukimin fillor.

Lidhur me planin dhe programin mësimor të gjuhës shqipe u bënë shumë fjalë e biseda në nivele të ndryshme profesionale dhe joprofesionale.

Grupi punues profesional i përbërë nga përfaqësuesit e enteve republikane (RSS, RSM, RSMZ), përgatiti propozimin e planit dhe programit mësimor të përbashkët të gjuhës shqipe për arsimin dhe edukimin fillor. Ç'është e vërteta, propozimi i programit në fjalë u përgatit në

-
- 1) Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës.
 - 2) Republikën Socialiste të Serbisë.
 - 3) Republikën Socialiste të Maqedonisë.
 - 4) Republikën Socialiste të Malit të Zi.

mbështetje të qëndrimit të kryetarëve të komiteteve për arsim, shkencë e kulturë të KSAK, të RSS të RSM dhe të RSMZ. Organet arsimore të KSA të Kosovës respektuan plotësisht qëndrimin e përmendur dhe punën e përbashkët të grupit punues profesional. Kështu, Pleqësia e Arsimit të KSA të Kosovës miratoi propozimin e planit dhe të programit mësimor të përbashkët të gjuhës shqipe pa ndryshime, edhe pse propozimi i programit në fjalë kishte dobësi të shumta në aspektin profesional dhe shkencor. Kjo u bë sigurisht nga dëshira e madhe për kapërcimin e vështirësive rreth harmonizimit të qëndrimeve.

Ndryshim i strukturës së programit

Përkundër bisedave, harmonizimeve të qëndrimeve dhe të punës së grupit punues profesional, organet arsimore të njërive të përmendura me rastin e miratimit të planit dhe programit të përbashkët mësimor të gjuhës shqipe për arsimin fillor bënë ndryshime të shumta dhe në këtë mënyrë e hodhën poshtë punën rreth nxjerrjes së programit të përbashkët të gjuhës shqipe. Është çështje e organeve arsimore të njërive të përmendura, por jo vetëm e tyre, se për ç'arsye bënë ndryshime, plotësime, reduktime në shkallë të papranueshme në propozimin e planit dhe të programit të përbashkët mësimor të gjuhës shqipe, i cili kryekëput është fryt i punës së tyre të përbashkët.

Së pari, Republika Socialiste e Serbisë miratoi planin dhe programin mësimor të gjuhës shqipe me shumë ndryshime. Ajo ndryshoi strukturën e programit, bëri ndarjen e përmbajtjeve në të obligueshme dhe në jo të obligueshme. Asnjë program i gjuhës amtare në republikat socialiste dhe në KSA të Vojvodinës nuk e ka këtë ndarje. Kjo ndarje është e papranueshme sidomos për programet e arsimit fillor. Kështu u veprua vetëm për

programin e gjuhës shqipe në RS të Serbisë. Në këtë mënyrë u eliminuan 38 përmbajtje të letërsisë shqipe. Vendosja e këtyre përmbajtjeve në pozicionin «jo të obligueshëm» është në kundërshtim me konceptimin e programit si dokumenti më i rëndësishëm dhe i obligueshëm për shkollën fillore.

Nga propozimi i planit dhe i programit të përbashkët të gjuhës shqipe, me të cilin janë pajtuar edhe vetë përfaqësuesit e Entit Republikan për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit, u hoqën ose nuk janë të obligueshme të përpunohen një varg përmbajtjesh. Nga lektura shkollore u eliminuan 19 përmbajtje programore, ndërsa nga lektura shtëpiake edhe 19 sish. Të gjitha këto janë krijime në gjuhën shqipe.

RS e Malit të Zi, po ashtu, ka miratuar planin dhe programin mësimor të gjuhës shqipe për shkollën fillore, duke reduktuar propozimin e përbashkët në shkallë të papranueshme. Në programin në fjalë nuk u përfshinë 43 përmbajtje të përbashkëta. U hoqën të gjitha përmbajtjet, të cilat në programin e gjuhës shqipe në RSS janë paraparë si jo të obligueshme ose janë hequr fare. Përveç kësaj, në programin e gjuhës shqipe për shkollën fillore në RS të Malit të Zi janë hequr edhe këto përmbajtje: «Vajza dhe lulja» — Spiro Çomora, «Puna në kopsht» — Lutfi Rusi, «Treni i kaltër» — Anton Çetta, «Stafeta e Dashurisë» — Mustafa Spahiu, «Trëndafilat» — Zihni Sako, «Ylli i vogël lart në qiell» — Kostandin Kristoforidhi, «Fisheku në Pajë» — Fadil Kraja.

Organet arsimore në RS të Malit të Zi shkuan edhe më larg. Në programin e gjuhës shqipe për shkollën fillore shtuan edhe 12 përmbajtje, për të cilat asnjëherë nuk është biseduar, p.sh.: «Ura» — Dushan Gjurishiç, «Nëna e Heroit» — Dushan Kostić, «Më mirë i vdekur se tradhtar» — Marko Milanov, «Shokët do të hakmerren» — Mihaillo Llallic, «Malësia kodrinore» — Zuvdia Hoxhiç, «Mali i vdekur» — Sreten Arsenoviç, «Korita e Ivanovit» — Jevrem Bërkoviç, «Në tarën e Gjergjeviçit» — Janko Gjonoviç, «Syri i uritur» — Streten Peroviç, «Mbe-

ti shtëpia ime» — Qamil Sijariç, «Njerëzit krenarë» — Gjoko Dapçeviç.

Republika Socialiste e Maqedonisë nga propozimi i planprogramit të përbashkët mësimor të gjuhës shqipe për arsimin dhe edukimin fillor, nga njëra anë, hoqi më tepër se gjysmën e përmbajtjeve programore të krijuara në gjuhën shqipe, nga ana tjetër, shtoi krijime në gjuhën maqedonase dhe turke, dhe në këtë mënyrë sajuan një program të veçantë, por pa «fytyrë» shqipe.

Nuk u respektuan kriteret profesionale e shkencore

Sajuesit e këtij programi nuk respektuan kriteret profesionale dhe shkencore. Në program vendosën një material të konsiderueshëm të përkthyer nga gjuha maqedone dhe turke. Përmes Bërthamës së përbashkët programore, në programin e gjuhës shqipe hynë 15 autorë maqedonas. Për sajuesit e programit, si duket, kjo nuk ishte e mjaftueshme. Përveç këtyre në programin e gjuhës shqipe për arsimin dhe edukimin fillor u morën edhe një varg veprash të tjera, për të cilat asnjëherë nuk është biseduar. Në kuadër të lekturës shkollore u përfshinë këta tituj dhe autorë: «Mësuesja» — Genadi Bolinovski, «Tito na shikon ne» — Peni Trpovski, «Biliana» — Cana Andrijevska, «Pranë rrugës» — Kosara Goçkova, «Pika e argjendtë» — Tiho Najdovski, «Tito» — Vasil Kunovski, «Druri agulicë» — Sane Shernovski, «Zëri i Maqedonisë» — Kolo Ndelovski, «Më mirë do të ishte të mos ishte luftë» — Erih Maria Remark, «Lejleku silian» — Marko Çeperkov, «Malli për jugun» — Kostandin Milladinov, «Dasma e përgjakur maqedonase» — Vojdan Çernodrinski, «Mbledhësit e duhanit» — Koço Racin, «Dojçini i sëmurë» — tregim popullor.

Në kuadër të lekturës shtëpiake u shtuan këto vepra: Olivera Nikollova: «Zoki Poki», Sllavko Janevski: «Tre-

gime për sheqerin», Gligor Popovski: «Druvari», Vanço Nikolleovski: «Goce Delçev», Mira Aliçkoviç: «Lam-tumirë fshehtësi e madhe», Gligor Popovski: «Dora e kuqe», Vllado Maleski: «Të kuqtë e Gjurgjes», Stalle Popov: «Kalesh Angja», Blazhe Koneski: «Vreshta», Zhivko Çingo: «Borërat e argjenda».

Po ashtu në programin e gjuhës shqipe u përfshinë edhe disa autorë që krijojnë në gjuhën turke: Nexhat Zekiria, Hasan Merxhan, Shukri Ramo, Elhami Emin, Nazim Hikmet.

Se cili është qëndrimi ndaj kulturës dhe gjuhës shqipe në RSM le të gjykojnë vetë lexuesit, por edhe ata, të cilët «kontribuan» për nxjerrjen e këtij programi.

Rritja e nivelit të formimit letrar e gjuhësor të nxënësve, në radhë të parë, varet nga sigurimi i materialit lëndor nga krijimet origjinale. Vjelja e materialit lëndor nga letërsia origjinale krijon mundësi të mëdha për t'i aftësuar nxënësit për të mbajtur qëndrim të drejtë ndaj fakteve gjuhësore dhe t'i përdorin drejt në të folur dhe në të shkruar në gjuhën amtare. Vendosja e materialit mësimor në programin e gjuhës shqipe nga letërsia e përkthyer ngushton mundësinë për shijimin e vlerave të njëmendta letrare dhe gjuhësore. Formimi gjuhësor i nxënësve nuk mund të arrihet nga veprat e përkthyer. Përkundër kësaj, edhe veprat më të dobëta origjinale ofrojnë mundësi më të madhe për përvetësimin e gjuhës amtare. Vendosja e krijimeve letrare të letërsisë së kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë nga rajoni gjuhësor i serbokroatishtes dhe maqedonishtes në programin e gjuhës shqipe ndryshon thelbësisht fizionominë e programit.

Fundja, ky është cenim i drejtpërdrejtë në formimin e identitetit kulturor dhe gjuhësor të nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën amtare shqipe. Vallë mos kemi të bëjmë me nismën e një pabarazie të legalizuar, meqë programet në fjalë janë miratuar në pleqësitë e arsimit të republikave të përmendura.

Ç'është e vërteta, edhe programi mësimor i gjuhës

shqipe për arsimin dhe edukimin fillor, të cilin e miratoi Pleqësia e Arsimit e KSA të Kosovës, para disa kohësh, vuan nga ngarkesa sasiore e përmbajtjeve, meqë edhe këtu në mënyrë mekanike u vendos një raport joadekuat midis letërsisë shqiptare dhe letërsisë së kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë.

«Rilindja», Prishtinë, 9.11.1988

MARGJINALIZIMI I ÇËSHTJEVE TË RËNDËSISHME

Bisedë me akademikun Rexhep Qosja

Në fund të këtij viti, i cili ndoshta do të hyjë në analet e historisë sonë si vit i tronditjeve të mëdha shoqërore, ekonomike e politike, si vit i inflacionit të pakontrolluar dhe i aferave financiare e diplomatike, vit i daljes së masave në rrugë dhe i reformave të proklamuar, si vit i debateve kushtetuese dhe i politizimit të skajshëm të kulturës e të jetës në përgjithësi, bisedojmë me akademikun Rexhep Qosja, pa dyshim, njërin ndër intelektualët tanë më të shquar, i cili është i njohur për guximin intelektual dhe qytetar, përkatësisht qëndrimin kritik ndaj dukurive dhe realitetit tonë përgjithësisht. Autori i romanit «Vdekja më vjen prej syve të tillë», që sivjet u inskenua në teatër dhe u luajt në film, i «Historisë së letërsisë shqipe» dhe i një sërë veprash shkencore e letrare, krahas punës intensive në këto dy plane, vitet e fundit, përmes shkrimeve publicistike, polemike, i dha krahtë përpjekjes së intelektualëve shqiptarë, që të ndriçohen në një grumbull çështjesh të historisë, të kulturës, të gjuhës, përgjithësisht të qenies sonë kombëtare, të ngritura në një pjesë të mjeteve të informimit dhe të propagandës në Jugosllavi e të vendosura në shërbim të luftës politike.

Këtë bisedë, prandaj, e konceptuam ashtu që të përfshijmë në të probleme e çështje, me të cilat merret intensivisht bashkëbiseduesi ynë dhe për të cilat ai ka përgjigje që dalin jashtë stereotipeve dhe modeleve të ngurta të të menduarit, me një fjalë, këtyre përgjigjeve u shkon bukur ajo thënia e njohur italiane: *E sola colpa mia, se écosi?* (Dhe mos e kam fajin unë që është kështu?).

Akademia e heshtur

— *Tash sa kohë është duke u bërë shumë zhurmë lidhur me albanologjinë. Na intereson mendimi juaj për rezultatet dhe për problemet, me të cilat ballafaqohet albanologjia aktualisht, duke përfshirë këtu edhe perspektivat e saj.*

— Viteve të fundit këtu, në Prishtinë, janë botuar disa vepra të fushave të ndryshme albanologjike, që janë punuar prej autorëve kosovarë. Në pjesën më të madhe të rasteve ato janë teza doktorate apo magjistrature, të paraqitura shumë kohë përpara, janë botuar edhe përmbledhje studimesh e artikujsh. Por, situata politike, dhe jo vetëm politike, nëpër të cilën kalon Kosova prej afro tetë vjetësh, ka lënë pa shkruar dhe pa botuar shumë vepra në gjuhën shqipe, shumë përmbledhje vjershash, drama, tregime, romane, shumë vepra të fushave të ndryshme albanologjike e të fushave të tjera të shkencës. Për shkak të ndërprerjes së komunikimit normal në gjithë hapësirën kulturore kombëtare janë cenuar fort vullnetet dhe dëshirat tona krijuese, janë pakësuar motivet e krijimtarisë, janë rrudhur dhe cenuar idealet tona. Por, duhet të shpresojmë se kjo ishte një zbatim, të cilën do të gjejmë forcë intelektuale dhe morale ta tejkalojmë, duhet të shpresojmë, më në fund, se, siç e thotë një mendimtar, as përmbytja s'ka zgjatur përgjithmonë.

— *Meqë një pjesë e aktivitetit tuaj shkencor lidhet*

me punën në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dëshirojmë të dimë se a është duke u punuar në ndonjë projekt nga fusha e shkencave albanologjike?

— Në planin kërkimor shkencor të Akademisë sonë figurojnë edhe tema albanologjike, por nuk dihet se kur do të kryhen. Në përgjithësi, në këtë institucion të lartë shkencor punohet pak. Ka disa vjet që njerëzit pyesin: Ku është Akademia, ç'ka po bën Akademia, pse nuk po dëgjohej Akademia? A pikërisht ashtu duhet të silllet Akademia? E Akademia jonë nuk dëgjohej apo, kur rrallë e tek dëgjohej — dëgjohej si Lidhja e Sindikatave të Kosovës apo Konferenca për Aktivitetin Shoqëror të Grave. Pse? Në Akademinë tonë të Shkencave dhe të Arteve, përpos disa anëtarëve që me punën e tyre do të nderonin çdo akademi, kanë hyrë edhe disa njerëz, të cilët kurrë nuk janë shquar për ndonjë punë të veçantë krijuese, shkencore apo artistike, sado dikur një rol e kanë luajtur në jetën tonë kulturore. Në Akademinë tonë të Shkencave dhe të Arteve, ndërkaq, kanë hyrë edhe disa njerëz, të cilët nuk kanë kurrfarë meritash për krijimtarinë shkencore a për jetën tonë kulturore, të cilët ambicjeve dhe mundësive të tyre shkencore u kanë dhënë fund me mbrojtjen e tezave të doktoratës, të cilët, me të vërtetë, kanë hyrë në Akademi për shkak se gjithnjë janë sjellë dhe sillen rreth politikës, e më shpesh, rreth atyre që kanë pushtet politik në duar. Dhe, pikërisht këta anëtarë kanë bërë që të heshtet, të mos them të paralizohet, Akademia jonë gjatë shtatë-tetë vjetëve të fundit, të paralizohet si institucion shkencor e kulturor. Dhe si të mos heshtet! Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është e vetmja Akademi në shtet, e, besoj, edhe në Evropë, një e treta e anëtarëve të së cilës janë në funksione politike, që nuk merren fare me punë krijuese. Nuk është e çuditshme, prandaj, pse prej vitit 1981 e këndeje disa prej anëtarëve të Akademisë aq shpesh edhe janë përdorur për aktivitete politike e joshkencore a kulturore, kurse disa prej anëtarëve të saj u janë nënsh-

truar masave të ndryshme politike e të tjera vetëm se s'kanë pranuar të intrumentalizohen prej institucioneve politike.

Kujtojeni pozitën e Akademisë sonë gjatë diskutimit kushtetutor! Kujtojeni kumtesën që ka lëshuar kjo Akademi për diskutimet kushtetutare në fund të nëntorit! Kujtojini diskutimet kushtetutare të disa anëtarëve të kësaj Akademie! Mjerim! Në vend se të jetë institucion, prej të cilit do të rrezatojë mendimi që ngre ndërgjegjen dhe e forcon moralin në këtë kohë të rënies më të rëndë edhe të ndërgjegjes edhe të moralit shoqëror, në vend se të jetë institucion, prej të cilit do të rrezatojë mendimi i guximshëm, liridashës, emancipues, Akademia jonë bëhet institucion poltronist që e dekurajon mendimin e guximshëm, me të vërtetë që e ndihmon katandisjen e mendimit çlirues. Shkurt e thënë, Akademia jonë deri sot nuk e ka arsyetuar veten si institucioni më i lartë i shkencës dhe i kulturës.

— *Nga projekti juaj Historia e Letërsisë Shqipe, i paramenduar si sintezë studimore e letërsisë sonë, deri tani a keni realizuar studimin e njërës prej formacioneve më të rëndësishme — të Romantizmit? Në cilën pjesë të këtij projekti tani punoni?*

— Punoj rreth letërsisë së vjetër. Por, studimi i letërsisë së vjetër shqipe është një punë e përbërë, që do shumë kohë. Njëkohësisht kjo letërsi nuk mund të studiohet mirë pa shfrytëzuar, para së gjithash, fondet e saj në bibliotekat në Tiranë.

Ngjarje që kanë të bëjnë me qenien tonë

— *Vepra juaj «Vdekja më vjen prej syve të tillë» sivjet u inskenua në teatër dhe u realizua në film dhe, gjykuar sipas kritikës dhe sipas shikuesve, pati jehonë të mirë. A mendoni se është ruajtur mesazhi dhe vlera artistike e veprës në dramë dhe në film?*

— Si shfaqja e teatrit ashtu edhe filmi, që janë punuar në bazë të prozës «Vdekja më vjen prej syve të tillë», kanë pasur, jo si thoni ju, «jehonë të mirë», por jehonë të jashtëzakonshme — sidomos te shikuesit. Njerëzit kanë ardhur kolektivisht prej qyteteve të tjera të Kosovës për të parë shfaqjen, kurse, sikundër ka shkruar «Rilindja» para disa ditësh, vetëm për afër një muaj filmi e kanë parë mbi 80 mijë shikues — domethënë më tepër se çdo film tjetër gjatë gjithë kohës së shfaqjes në kinematë e Kosovës. Pse shfaqja e filmit, që është punuar sipas prozës në fjalë, ka zgjuar një interesim aq të madh? Besoj se ky interesim nuk i detyrohet vlerës artistike të veprës «Vdekja më vjen prej syve të tillë», që mund të jetë fare modeste, të shfaqjes apo të filmit, sa vetë ngjarjeve, për të cilat flitet në to. Ngjarjet janë ato që e tërheqin shikuesin, sepse ato janë ngjarje që kanë të bëjnë me qenien tonë, me historinë tonë, ato janë ngjarje, përmes të cilave e shohim veten në të djeshmen, përmes të cilave mund ta shohim veten në të sotmen dhe përmes të cilave, drojmë shumë, mos do të shohim veten edhe në të nesërmen. Gjendja e sotme na bën të drojmë, vërtet! Pse? Sipas shënimeve zyrtare, prej 1981 e deri në gjysmën e këtij viti në Kosovë janë ngritur fletëdenoncime penale kundër 75.000 vetëve, fletëdenoncime për kundërvajtje 95.000 vetëve, në mënyra të tjera, prej organeve të sigurimit dhe gjyqeve janë trajtuar 314 000, kurse prej të njëjtave organe 100 000 vetëve u është tërhequr vërejtja! Për shtatë vjet vetëm në Kosovë — prej organeve të sigurimit dhe prej gjyqeve — në mënyra të ndryshme janë trajtuar 584 000 vetë — dhe kjo është gjysma e popullatës së rritur kosovare. Në qoftë se kësaj shifre ia shtojmë edhe numrin e shqiptarëve që gjatë kësaj kohe janë dënuar apo, në mënyra të tjera, janë trajtuar nga organet e sigurimit dhe nga gjyqet në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Ushtri, atëherë, sigurisht, numri rritet shumë! Në kushte të tilla, është plotësisht e kuptueshme që një shfaqje apo një film, që trajtojnë fatin e nje-

riut në pushtetin represiv, të zgjojnë interesim të jashtëzakonshëm të shikuesve.

Kuptimi dhe porosia e prozës «Vdekja më vjen prej syve të tillë» më mirë janë ruajtur në dramën sesa në filmin.

Shkrimtari, i cili lejon që prej veprës së tij të bëhet shfaqje apo film artistik, nuk duhet të japë mendime për vlerën e tyre artistike më në fund, si as për vlerën e veprës së tij. Ne, pa dyshim, kemi regjisorë dhe aktorë të talentuar edhe për teatër edhe për film: mangësitë që mund të vërehen në shfaqjet e teatrove dhe në filmat tanë të paktë, ndërkaq, më shpesh janë pasojë e kushteve, në të cilat punojnë, e organizimit të dobët të punës rreth projekteve kolektive dhe, më në fund, e intervenimeve të censurës që vetë burokracia e institucioneve kulturore, si dorë e zgjatur e burokracisë politike, ushtron projektet që realizohen në institucionet ku ajo, e konservuar intelektualisht e moralisht e harxhuar, sundon me dekada.

— *Protagonisti i veprës është sinonim i intelektualit dhe i fatit të tij në kushtet e jetës së çrregulluar shoqërore. Ai ngrihet kundër dhunës shpirtërore dhe fizike që ushtrohet mbi të e mbi kolektivitetin e reagimi i tij vjen nga pozita intelektuale e humaniste. A është ky mision i intelektualit edhe në jetë?*

— Nuk ka dyshim se njerëz të shtresave të ndryshme e kuptojnë në mënyra të ndryshme rolin e intelektualit në shoqëri. Por, se si e kuptojnë vetë intelektualët rolin e tyre në shoqëri, varet prej disa faktorësh e, në radhë të parë, prej karakterit dhe formacionit të tyre kulturor. Personalisht mund të mendoj vetëm kështu: intelektualit duhet të jetë gjithmonë e në çdo situatë, pavarësisht prej pasojave, në anën e të voglit e jo të të madhit, në anën e të sunduarit e jo të sunduesit, në anën e progresit e jo të interesit, në anën e lirisë e jo të shtypjes, në anën e humanizmit e jo të politikës. Intelektuali ka një bibël — të vërtetën dhe një zot — popullin. Intelektual dome-

thënë ai që përdor trurin, intelektin, në qoftë se intelektin e vet nuk e vë në shërbim të të voglit, të të sunduarit, të lirisë, të progresit, të së vërtetës dhe të masës së gjerë — të popullit, intelektualit, objektivisht, i ka të gjitha gjasat që të vihet në shërbim të palës së gabuar. Dhe, ashtu ia shqipton vetes dënimin historik. Shikoni përreth në Prishtinë! A s'jemi duke parë disa intelektualë që ia kanë shqiptuar vetes dënimin historik! Ata kanë harruar se, siç e thotë një filozof francez, sa më konservative të jetë klasa sunduese, aq më e obligueshme bëhet detyra e intelektualit që të mbrojë traditën e humanizmit, të arsyes, të progresit, që përfaqësojnë vlerat më të rëndësishme në krejt historinë e njerëzimit.

— *Pse atëherë disa intelektualë janë instrumentalizuar në shërbim të burokracisë politike, duke braktisur pozitën intelektuale e humaniste?*

— Motivet e instrumentalizimit të intelektualëve, ç'është e vërteta, mund të jenë të ndryshme. Prej historisë dihet se disa intelektualë kanë pranuar të instrumentalizohen duke shpresuar se ashtu do t'i realizojnë më lehtë idetë, shikimet, idealet e tyre sociale, morale e shoqërore. Prej historisë, ndërkaq, dihet se intelektualët e tillë herë kanë pasur më pak, e herë më shumë, e më së shpeshti aspak sukses në realizimin e qëllimit të tyre. Rastet e tilla janë shënuar, kryesisht, në kulturat e mëdha dhe, kryesisht në kohët e kaluara, kur edhe numri i njerëzve që merrnin pjesë në pushtet, ishte larg më i vogël se sot, kur në të vërtetë, nuk mund të flitej për burokracinë në kuptimin e sotëm, që është shndërruar në një masdant, që i thith gjakun popullit. Sot, në rastet më të shpeshta, intelektualit instrumentalizohet për arsye të interesave të ngushta, që sendërton më lehtë duke i shërbyer burokracisë si argat i thjeshtë i saj, pa e përdorur intelektin, domethënë pa luajtur rolin e atij që i sheh dhe i thotë të vërtetat e hidhura të realitetit shoqëror. Nuk ka dyshim se pushteti prish, e, sikundër

është thënë, pushteti absolut prish në mënyrë absolute. Kam vërejtur se intelektualët që janë vënë në shërbim të burokracisë politike, që kanë filluar të flasin me gjuhën e saj, me frazat e saj boshe, në rastet më të shpeshta, janë njerëz të llojit të veçantë, me shprehi të veçanta. Shumica prej tyre luajnë bixhozin, nuk e mbajnë fjalën, e ndërrojnë mendimin fare lehtë, sot flasin kështu e nesër flasin ndryshe, nuk flasin kur duhet të flitet ose flasin vetëm çka u thotë burokracia të flasin, i lënë miqtë në baltë, s'kanë kurrfarë ideali. Me një fjalë, janë njerëz të pa karakter. Kam vërejtur se intelektualët e tillë nuk mund të kenë talent, në të vërtetë janë njerëz me një si gjysmë talenti, por të shkathët e bërrylaxhinj. Më në fund, talent të fortë pa karakter të fortë nuk mund të ketë. Kam vërejtur, gjithashtu, se intelektualë të tillë, të instrumentalizuar, edhe gënjejnë shumë, por gënjeshtreve të tyre gati gjithmonë kujdesen t'ua vënë kapakun e pushtetit, të rezolutave e të platformave të miratuara «njëzëri». Personalisht nuk kam kurgjë kundër intelektualëve të tillë të instrumentalizuar. Më në fund, çdokush varet në gozhdë të vet. Por një numër i këtyre intelektualëve kanë bërë dhe bëjnë dëme në jetën kulturore dhe politike; bëjnë dëme ose vetë drejtpërdrejt ose duke i nxitur të tjerët, burokratët, të bëjnë dëme; bëjnë dëme duke folur siç nuk është e vërtetë ose duke heshtur para së keqes; dhe bëjnë dëme, sepse në kushtet tona të sotme, kur e kur, intelektin e tyre burokracia e shfrytëzon për të mbuluar masa politike e të tjera, që s'do të duhej të gëzonin pëlqimin e njerëzve që e përdorin ndershëm intelektin në jetë.

Një parim vetëvrasës i burokracisë

— Tash një kohë të gjatë në publicistikë, në fejonistikë, në memoaristikë etj, po publikohen shkrime pseudoshkencore lidhur me historinë dhe kulturën tonë.

Përveç rasteve e individëve, mendojmë se nuk është bërë punë në drejtim të kundërvënies së kësaj fushate të pararenduar. Ku janë shkaqet sipas mendimit tuaj?

— Ku janë shkaqet që ne, megjithëse mjedis me Universitet, me shkolla të larta, me një sërë institucionesh shkencore e kulturore, me Akademi të Shkencave e të Arteve, kemi lejuar të na mbulojë një propagandë e ndër-tuar mbi konstruksione politike, gënjeshtër, shpifje, që u ka sjellë pasoja të rënda shqiptarëve në jetën politike dhe shoqërore? Ku janë shkaqet?! Para disa vjetësh njëri prej punonjësve politikë shqiptarë ka thënë kështu: Në qoftë se shqiptari sot me një gjysmë fjale tjetrin vetëm e gërrith një herë, vetes duhet t'i bjerë tri herë! Në pajtim me këtë parim vetëvrasës burokracia jonë politike prej gati tetë vjetësh vazhdon qafëvarur të dëgjojë çka flitet për Kosovën dhe të pajtohet me çdo gjë që urdhërohet në Kosovë, vazhdon të pajtohet me të gjitha konstatimet, konkluzionet dhe rezolutat, pavarësisht prej argumenteve, në të cilat bazohen dhe prej vlerësimeve që bëhen në to. Historinë politike dhe kulturore të Evropës besoj se e njoh relativisht mirë, por nuk e di të ketë ngjarë në historinë e këtij kontinenti që një shtet 21 milionë banorësh të merret tetë vjet me dy milionë; që përfaqësuesit politikë të atyre dy milionëve e në mesin e 21 milionëve, ta shtypin popullin e vet dhe, më në fund, vetëm me fjalë, me fjalime e masa të urdhëruara pa thënë asnjëherë për ata tetë vjet: mjaft, se është bërë tepër! Mjaft, se është kaluar çdo masë! Dukë iu përmbajtur verbërisht një parimi të tillë, burokracia politike as ka provuar vetë, as e ka lejuar inteligjencien që t'i kundërvihet asaj fushate. E tani, burokracia politike, kur është gjetur e kërcënuar edhe vetë, e ka kuptuar se sa i gabuar ishte ai parim, por tani është bërë vonë. Fushata po e arrin qëllimin: pozita kushtetutare e Kosovës, sipas të gjitha gjasave, rrezikohet të kthehet pas!

Në këtë kohë kërkohet dialog, mirëpo në atë dialog nuk përfillen argumentet.

Prej disa vjetësh, megjithatë, ne na ftojnë të marrim pjesë në dialog, kryesisht, në dialog rreth gjendjes në Kosovë. Por, kur marrim pjesë në atë dialog, atëherë, në rastet më të shpeshta pësojmë akuza për ato që themi. Kjo domethënë se jemi të ftuar të marrim pjesë në një dialog, në të cilin do të duhej të flasim ashtu sikundër don ai që na fton në dialog. Ky është dialog, në të cilin nuk përfillen as argumentet tona, as e drejta jonë, as e vërteta jonë. Ne sot nuk na ndihmon asnjë argument, asnjë e vërtetë, burokracia politike serbe (dhe maqedonase) nuk duan të njohin asnjë argument dhe asnjë të vërtetë tonën. Burokracia politike e kulturore serbe i është kthyer mitologjisë mesjetare serbe, Kultit të Sveti Savës¹ dhe vizioneve pravosllave të Kosovës dhe të shqiptarëve. Sjellja negative e asaj burokracie ndaj argumenteve dhe të vërtetave tona ka shkuar aq larg saqë në shtypin serb (dhe maqedonas) ndiqen edhe ata intelektualë apo politikanë kroatë, slovenë, serbë dhe malazezë, që për Kosovën dhe, në përgjithësi për shqiptarët, nuk janë të gatshëm të flasin në gjuhën zyrtare propagandistike të Serbisë. Të marrim vetëm sjelljen ndaj tubimeve të shqiptarëve prej 17-21 nëntor në Prishtinë. Udhëheqja e Serbisë e, nën ndikimin e saj, edhe udhëheqja e Jugosllavisë, i ka vlerësuar pozitivisht tubimet e serbëve dhe të malazezëve në Kosovë dhe mitingjet e të ashtuquajturit solidaritet me ta në Serbi, në Mal të Zi dhe në Vojvodinë — edhe pse në ato tubime ka pasur aq parulla reaksionare dhe është shprehur një shovinizëm i papërmbajtur ndaj shqiptarëve. Udhëheqja e Serbisë, ndërkaq, tani i vlerëson deri në fund negativisht tubimet e shqiptarëve, edhe pse në to nuk ka pasur asnjë paraqitje kundërserbe, madje, as paraqitje joopurtune politike. Nuk ka dyshim se tubimet e punëtorëve dhe të të rinjve shqiptarë prej 17-21 nëntor në Prishtinë tregojnë pasojat që në ta kanë lënë masat represive gati

1) Sveti Sava, shenjtor i kishës ortodokse serbe.

9

tetëvjeçare; më në fund, pozitën paradoksale politike, në të cilën janë shqiptarët sot. Kjo shihej fare qartë prej parullave që thoshin dhe prej transparenteve të rralla që bartnin në ato mitingje, që të shpeshtën, nuk dilnin prej kornizave të kështu të përditshëm politik burokratik! Pse sot në Serbi, pothuaj a priori, nuk pranohen argumentet e shqiptarëve? Sepse udhëheqja e sotme e Serbisë është deklaruar për politikën e dobësimit kombëtar të shqiptarëve.

— Në Jugosllavi diskutohen shumë çështje të së kaluarës, të aktualitetit dhe të ardhmërisë. Sa është ky proces prezent në Kosovë, përkatësisht, a ka çështje të rëndësishme që të na margjinalizohen për shkak të oportunitetit?

— A ka çështje që margjinalizohen te ne?! Në të gjitha fushat e jetës sonë shoqërore, politike dhe, madje kulturore, tradicionalisht janë margjinalizuar dhe vazhdojnë të margjinalizohen çështje të rëndësishme të pozitës së shqiptarëve. Kur e kur ato çështje zëvendësohen prej çështjesh më pak të rëndësishme apo, në një moment, të tejkaluara në këtë mënyrë, në jetën tonë politiko-shoqërore vazhdimisht ngjet inversion çështjesh të shqiptarëve. Dhe, kështu nuk ngjet sepse duam që të ngjasë kështu, por kështu ngjet sepse jemi të detyruar të bëjmë të ngjasë ashtu. Kështu ngjet për arsye se ne, më në fund, nuk jemi subjekt politik, për gati asnjë çështje nuk mund të flasim e lëre më të vendosim kur duam e siç duam. Dhe, kështu ngjet kryesisht për dy arsye: e para, për arsye se te ne politika, deshe s'deshe, është politikë, në të cilën zbatohet parimi: lidhe kalin ku të thotë zotëria dhe, e dyta, për arsye se ata që e lidhin kalin ku u thotë zotëria, më në fund, duan të ruajnë interesat e veta. Për këto dy arsye pa dyshim edhe kohët e fundit në jetën tonë çështjet kryesore ose margjinalizohen ose zëvendësohen prej çështjesh tani joaktuale. Që disa javë burokracia jonë politike, e cila, ç'është e vërteta, s'e ka fare lehtë sot, është ngritur në këmbë të mbrojë kulturën, historinë,

zakonet, gjuhën kombëtare prej asaj fushate që zgjat prej gati tetë vjetësh. Burokracia politike tani flet për diçka që është dashur të flasë para 5-6 vjetësh, por nuk flet si duhet apo nuk flet fare për ato, për të cilat tani duhet të flasë, nuk flet për çështje, që janë çështje themelore të jetës së shqiptarëve! Nuk flet sa nxënese shqiptare kanë mbetur pa u përfshirë në shkollat fillore e të mesme, sa vajza shqiptare kanë hequr dorë nga shkollimi i mëtejshëm, sa po rritet numri i analfabetëve, sa është zvogëluar numri i studentëve shqiptarë në Universitetin e Prishtinës, sa studentëve shqiptarë u është marrë e drejta e studimeve, sa është numri i familjeve shqiptare që nuk kanë asnjë të punësuar, sa është numri i shqiptarëve që bredhin rrugëve të Evropës duke kërkuar punë, sa është numri i shqiptarëve që kanë marrë apo kërkuar azil në vendet e ndryshme evropiane; sa është numri i shqiptarëve që kërkojnë punë nëpër republikat e Jugosllavisë; sa është numri i të rinjve shqiptarë të moshës jomadhore, që pësojnë shfrytëzimin më të rëndë prej punëdhënësve të ndryshëm nëpër Jugosllavi, sa është numri i shqiptarëve të burgosur politikë. E të tjera. Burokracia politike, me 5-6 vjet vonesë mbron prej asaj fushate historinë, kulturën, gjuhën kombëtare, por tani, pothuaj, ose e shpjegon rrejshëm ose e hesht çështjen kryesore: pozitën kushtetutore të Kosovës, të cilën e ngushton edhe projekti i amandamenteve në Kushtetutën e KSA të Kosovës, por të cilën e ngushton thelbësisht Projekti i amandamenteve në Kushtetutën e RS të Serbisë. Të mbrosh historinë, kulturën, gjuhën kombëtare prej një fushate në shtyp në këtë kohë, kur po humbin cilësitë kushtetutore të Kosovës, të cilat, po të ruheshin a përparoheshin, do të mbroheshin vetvetiu historia, kultura, gjuha kombëtare, domethënë të fshehësh çështjen kryesore; kjo domethënë të demonstrosht një hipokrizi, që doktrinën politike tradicionalisht e quajnë demagogji; kjo domethënë, vërtet, pa kërkuar shpjegime dhe pa thënë jo, ta lidhësh kalin ku thotë zotëria, pavarësisht se për veten tënde mund ta kesh lidhur tepër papërshtatshëm!

Teza për gjoja vetizolimn tonë është instrument politik

— Në varganin e akuzave, që kemi dëgjuar viteve të fundit, është edhe ajo për gjoja vetizolimn kulturor të shqiptarëve në Jugosllavi. Cili është mendimi juaj?

— Çdo kulturë autentike e shquajnë dy prirje: prirja për realizimin e përmbajtjeve të veta dhe prirja për pasurimin e atyre përmbajtjeve. Prirja e parë realizohet duke dhënë, kurse prirja e dytë duke pranuar. Në çdo kulturë veprojnë njerëz që janë të ndërgjegjshëm për këto dy prirje, të rëndësishme për qenien e çdo kulture, por edhe njerëz që mund të jenë të ndërgjegjshëm vetëm për njërën prej tyre, kryesisht për të parën. Ne kemi pasur dhe kemi individë që në kulturën tonë veprojnë si krijues apo edhe si drejtues të saj, që janë të ndërgjegjshëm për prirjen e parë, por s'janë mjaft të ndërgjegjshëm për prirjen e dytë të saj. Shumë më tepër kemi pasur dhe kemi, ndërkaq, krijues që janë të ndërgjegjshëm për prirjen e dytë të saj. Shumë më tepër kemi pasur dhe kemi, ndërkaq, krijues që janë të ndërgjegjshëm për dy prirjet e theksuara të kulturës. Kultura shqiptare, si kulturë autentike, gjithmonë ka qenë kulturë e hapur, gjithmonë është takuar dhe gjithmonë ka bashkëvepruar me kultura të hapësirave të ndryshme dhe të popujve të ndryshëm. Në truallin shqiptar, mbi bazën e kulturës iliro-shqiptare, gjatë shekujsh janë takuar Lindja e Perëndimi, sepse janë takuar kultura e grekëve, romakëve, bizantinëve, sllavëve, turqve dhe arabëve e, mandej, kulturat moderne evropiane, duke filluar prej Rilindjes italiane e këndej.

Pasuria mahnitëse e muzikës shqiptare popullore, e veshjeve kombëtare shqiptare dhe, në përgjithësi, e kulturës shqiptare, letërsia romantike shqipe, rrëfejnë qartë për takimet e kulturës shqiptare me kulturat e popujve të tjerë dhe për gjininë e popullit shqiptar, i cili prej atyre takimesh do të dalë më i pasur shpirtërisht, më i ndërgjegjshëm për veten, më në fund me një identitet edhe më të fortë kulturor. E, megjithatë, prej gati tetë vjetësh ne na e përplasim në vesh akuzën: kultura shqiptare është kulturë e mbyllur, e izoluar. Kështu flasin e shkruajnë

jo vetëm ata që nuk e njohin, por më shpesh ata që nuk kanë dëshirë ta njohin kulturën shqiptare. Kështu flasin ata që mbylljen dhe hapjen e çdo kulture tjetër kombëtare e kuptojnë vetëm në raport me kulturën e popullit, të cilit i takojnë ata, që e kuptojnë jo si raport të kulturave të barabarta, por si raport të kulturës imperiale dhe të kulturës koloniale. Kështu, në të vërtetë, flet burokracia politike dhe kulturore e Serbisë, që procesin e zhvillimit të pavarur, të lirë, të kulturës shqiptare, duket, mund ta mendojë vetëm si proces të integritimit e, në fund, të dez-integritimit të saj. Ndoshta për këtë arsye në Projektin e amendamenteve në Kushtetutën e RS të Serbisë parashi-heshin lidhjet e Serbisë me pakicën serbe në shtete të tjera, ku jeton ajo pakicë (në Hungari dhe në Rumáni), por në Projektamendamentet e Kushtetutës së KSA të Kosovës nuk përmenden fare lidhjet kulturore të shqiptarëve të Kosovës me shqiptarët në Maqedoni dhe në Mal të Zi, e lëre më lidhjet kulturore me Shqipërinë! Për këto arsye mund të thuhet se mendimet për gjoja izolimin e kulturës shqiptare sot janë vetëm për instrument politik, më në fund, sikundër edhe fjalët indoktrinim, albanizim, kontrarevolucion e të tjera, me të cilat pushteti arsyeton masat e represionit në jetën tonë.

Të kultivohen shikimet humaniste

— *Kjo çështje vetvetiu lidhet me komunikimin e përgjithshëm kulturor midis popujve e që është një nevojë imanente. Në këtë mes do të shtrënim edhe këtë pyetje: cilat janë mundësitë e perspektivat e komunikimit kulturor në Ballkan në kohën tonë, kur edhe kanë filluar disa procese pozitive në këtë plan?*

— Ballkani, siç thotë historiani i shquar Aleks Buda, «përbën një njësi gjeografike, historike dhe kulturore». Kjo njësi e Ballkanit, në të cilën jetojnë popuj të ndryshëm, vetvetiu nënkupton edhe ndryshueshmërinë. Gjatë historisë, posaçërisht në periudhat e saj më vendimtare, popujt e Ballkanit kanë pasur fat të përbashkët. Dhe kjo është shprehur në jetën e tyre shoqërore dhe kulturore.

Në qoftë se popujt e Ballkanit kanë pasur fat të përbashkët në të kaluarën, ç'ka është më e natyrshme sesa të besohet se fati i përbashkët u takon edhe në të ardhmen? Dhe në qoftë se Ballkani përbën një njësi ndryshueshmërisht të kuptueshme kulturore, çka është më e natyrshme se komunikimi i kulturave të popujve të Ballkanit? Pavarësisht pse historia popujve të Ballkanit u ka lënë trashëgim edhe shumë probleme e çështje të hapura, mungesa e komunikimit kulturor, që po zgjat aq shumë, sidomos midis disa prej këtyre popujve, por e komunikimit kulturor të gjithanshëm dhe pa kurrëfarë pengesash, është një anakronizëm i kuptueshëm, që nuk e nderon Ballkanin si vatrë të qytetërimit perëndimor. Në botë, ndërkaq, sot vjen duke u artikulluar një filozofi e re politike që nxit lidhjet, marrëveshjet, barazinë e popujve, që ngre lart liritë dhe të drejtat e tyre. Dëshiroj të besoj se Ballkani gjithnjë e më fort do të bashkohet ekonomikisht. Dëshiroj të besoj se popujt e Ballkanit do të mësohen ta shikojnë më drejt historinë e tyre të përbashkët në të kaluarën dhe historinë e tyre të përbashkët në të ardhmen, prandaj do të afrohen dhe do të lidhen gjithnjë e më shumë në gjithë fushat e jetës: Dëshiroj të besoj në Ballkanin e popujve të ndërjegjshëm për fatin e përbashkët historik, në Ballkanin e popujve të Ballkanit, ku do të shihen drejt edhe padrejtësitë e së kaluarës dhe ku do të kultivohen e të zbatohen shikime humaniste, më të gjera e më të drejta se sot dhe se deri sot. Dëshiroj të besoj në Ballkanin e popujve të barabartë dhe, si të barabartë, të afruar dhe të miqësuar. Dëshiroj të besoj në Ballkanin e bashkuar, në të cilin edhe shqiptarët si komb do të kenë arsye reale dhe të realizuara kombëtare historike ta quajnë veten të barabartë me popujt e tjerë të Ballkanit. Ne, sigurisht, nuk do ta arrijmë një Ballkan të tillë, por le ta arrijnë pasardhësit tanë dhe le të jetojnë në të pa brengat, pa vuajtjet dhe pa pasiguritë tona historike.

— *Këtë bisedë po e bëjmë në fund të këtij viti, por, kur do të jetë ajo para lexuesve, do të jemi në vitin tjetër. Nga ky asociacion për kohën që vjen, si e vështroni jetën tonë?*

— *Ka disa vjet që jeta jonë është varfëruar shumë, sepse është rrudhur vetëm në aspektin politik. Ne, po-*

thuj, kemi harruar të mendojmë për anën shpirtërore dhe morale të jetës. Jetët tona individuale janë të push-tuara prej brengash për fatin tonë kolektiv, sepse si një popull i vogël, na kanë rënë zavalle të mëdha mbi supe. Ne, tani, për herë të tretë në shekullin XX, gjendemi në situatë historike, në të cilën vendoset për kuptimin e fatit tonë. Ne, në të vërtetë, për herë të tretë në këtë shekull gjendemi në situatë historike, kur nuk mund të vendosim vetë për fatin tonë. Në vend që të fitojë kuptim dhe trajtë më të larë e historike, jeta jonë ngadalë, por vendosmërisht, është shtyrë teposhtë, drejt një kuptimi e trajte më të ulët. Por nuk duhet dëshpëruar. Se historia nuk ecën vijës së drejtë. Në dialektikën e zhvillimit të saj ngecjet apo kthesat mund të jenë mbledhje e energjive për hope dhe të arritura kuptimesh dhe trajtash të reja dhe më të larta të genies historike.

*Bisedës i priu Milazin Krasniqi
«Fjala», Prishtinë, janar 1989*

Astrit Shezimani

PA KRITERE

Në Maqedoni, e jo vetëm atje, por edhe gjetkë, në pjesë të tjera të vendit, prej kohësh janë fshirë kriteret midis asaj që përbën afirmimin nacional të shqiptarëve, nga njëra anë, dhe asaj që përbën nacionalizmin shqiptar, nga ana tjetër. Letra e titulluar «Pa pardon» e provon më së miri këtë, pra, faktin se nuk ka një vijë të qartë ndarëse midis nacionales dhe nacionalistes. Autorin e saj, njëfarë V. V., e pengojnë edhe shkollat, edhe gjuha, edhe lindshmëria e shqiptarëve, dhe kundër tyre ai lufton me të vërtetë «pa pardon»! Sepse, përndryshe, si mund të shpallet nationalist një i ri, i cili me portretin e Titos në dorë dhe me parullën: «Rroftë Jugosllavia» në gojë kërkon që të shkollohet në gjuhën e vet amtare, pra, kërkon atë që të gjithë moshatarët e tij e kanë në këtë vend? E pikërisht kjo ka ndodhur (dhe po ndodh) në Kumanovë, Gostivar dhe në vendbanime të tjera në Maqedoni, ku nën flamurin e luftës kundër nacionalizmit e të separatizmit shqiptar dhe të forcimit të bashkim-vëllazërimit, pra të bashkëjetesës, po formohen të ashtuquajturat «klasa të përziera», në të cilat mësimi jepet vetëm në gjuhën maqedone, gjë që, natyrisht, çon në heqjen nga përdorimi të gjuhës shqipe në shkollat e mesme në Maqedoni. Para ca kohësh lexova në gazetën «Nova Make-donija» njoftimin mbi mbledhjen e Komitetit Republi-

kan për Arsimin, Shkencën e Kulturën, ku disa delegatë kërkuan që të shihet nëse është e nevojshme që mësimi në shkollat e ciklit të ulët t'u jepet nxënësve edhe në gjuhët e kombësive, sepse, gjoja, nxënësit pas mbarimit të këtij cikli e kanë të vështirë në shkollën e mesme, kështuqë, sipas këtyre delegatëve që kanë të njëjtin mendim me Veskovin, duke mos njohur gjuhën maqedone, të rinjtë nuk mund të përfshihen në «proceset civilizuese». E kjo do të thotë se, nëse në RS të Maqedonisë do të vazhdohet të ecet në këtë rrugë, atëherë mund të pritet madje edhe heqja graduale nga përdorimi e gjuhëve të kombësive, kryesisht të gjuhës shqipe, nga mësimi i ciklit të ulët.

Në letrën e tij Veskovi ankohet se të rinjtë shqiptarë në Maqedoni, në fshatrat «etnikisht të pastra» të Kumanovës, nuk dinë maqedonisht. Por, me sa di unë, e mund të them se e njoh mirë gjendjen në atë mjedis, shumica dërrmuese e shqiptarëve në Maqedoni e dinë mjaft mirë gjuhën maqedone dhe e përdorin atë. Njihet fakti se në asnjë rast nuk janë shqiptarët ata që kërcënojnë statusin dhe pozitën e kësaj gjuhe në Ballkan dhe më gjerë.

Nga ana tjetër, po ky Veskov shkon deri atje sa thotë se ka individë (sipas tij «nacionalistët shqiptarë»), «që janë aq të paturpshëm saqë kërkojnë që edhe maqedonët në Republikën e tyre të vetme Maqedone të mësojnë gjuhën shqipe». Ç'paturpësi! Por e kujt?

Duke qenë një specialist i llojit të vet për kushtetutën, Veskovi thotë se në Jugosllavi ka tri gjuhë zyrtare (duke vënë në vend të parë maqedonishten) dhe shton se Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë ka hedhur poshtë kërkesën e shkrimtarëve (!) nga Kosova që të rishikohen nenet për barazinë e gjuhëve, ndërsa harron propozimin e paraqitur kohët e fundit në Kuvendin e Republikës së «vet» për ndryshimin e nenit të parë të kushtetutës së RS të Maqedonisë, i cili në të ardhmen (në qoftë se miratohet) do të ketë këtë përmbajtje: RS e Maqedonisë është «një shtet i popullit maqedon», si dhe i «bashkësive shoqëroro-politike të të tjerëve që jetojnë në të», dhe jo siç ka qenë deri tani se «RS e Maqedonisë është shtet i popullit maqedon dhe i kombësive shqiptare dhe turke që jetojnë në të». Nëse Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë

do ta pranojë një amendament të tillë, kjo i takon së ardhmes, por është e qartë se ku të çon kjo dhe çfarë do të thotë. Për Veskovin dhe për «pushtetmbajtësit» që mendojnë njëloj si ai, në republikën «e tyre» ka vend vetëm për «shqiptarët e ndershëm». Ç'kategori interesante! Vallë, çfarë kushtesh duhet të plotësojë njeriu që të fitojë epitetin «shqiptar i ndershëm»? A mund të na përgjigjet Vanço apo ndonjë tjetër? Mos vallë duhet të heqë dorë nga gjuha e vet, nga shkollimi në gjuhën amtare, nga kultura dhe e kaluara e vet historike, nga toponimet dhe antroponimet e veta, nga paraardhësit dhe stërgjyshërit e vet, nga identiteti dhe vetëdija, pra, me një fjalë, nga përkatësia e vet nacionale. Le të shpallen një herë këto kushte në formë konkursi që njerëzit të paktën t'i dinë ato!

«Danas», Zagreb, 20.12.1988

Bajram Kabashi

KËRKESA QË PROVOKOJNË

Sa janë të dëmshme kërkesat për ndërrimin e emrave të disa institucioneve dhe heshtja e strukturave politiko-shoqërore ndaj këtyre kërkesave?

Këto ditë filloi sërish sulmimi dhe etiketimi i disa personaliteteve të historisë dhe të kulturës së popullit shqiptar, emrat e të cilëve, në shenjë nderimi, mbajnë disa shkolla të KSA të Kosovës. Kësaj radhe, pas disa «suksesive minimale» që mendohet se u korrën në këtë drejtim vitin e kaluar, meqë u arrit me presion dhe me sjellje primitive të ndërrohen emrat e disa shkollave (shkolla fillore «Vëllezërit Frashëri» në Miradi të Epërme dhe heqja e emrit të dëshmorit të LNÇ, Halit Ibishi, që e mban-te deri dje shkolla fillore e Babushit të Serbëve të Ferizajt), po insistohet dhe më me këmbëngulje për ndërrimin e emrave të disa shkollave të tjera, posaçërisht të QAMO¹ «Luigj Gurakuqi» të Klinës dhe të shkollës fillore «Hasan Prishtina» të Prishtinës.

Sa është i madh presioni për ndërrimin e emrave të këtyre personaliteteve të shquara të traditës sonë dhe për zëvendësimin me emra të tjerë tregon e dhëna se në shkollën e mesme «Luigj Gurakuqi» të Klinës arsimtarëve

1) Qendra e Arsimit të Mesëm të Orientuar.

iu desh të mbanin mbledhje dy ditë, pra, siç u kumtua, rrafsh njëzet orë (!), kurse mbi 600 prindër të nxënësve serbë dhe malazezë të shkollës fillore «Hasan Prishtina» të Prishtinës bënë një «studim të thukët historik» dhe zbuluan se Hasan Prishtina na paskësh qenë, siç pohuan ata, agjent i Austro-Hungarisë dhe i Italisë fashiste; se na paskësh bërë zullum mbi popullsinë serbe e malazeze dhe se, këtë e theksojnë me mllef, e paska kundërshtuar depërtimin e ushtrisë serbe në Kosovë dhe paska bërë luftë kundër shqiptarëve progresivë, domethënë të ndershëm. Në këtë mënyrë vazhdon përdhosja e personaliteteve të shquara të kulturës dhe të kujtesës sonë historike me metoda të panjohura e të patolerueshme deri më tash, e kjo ilustruhet me etiketimet tashmë të njohura që u janë bërë Isa Boletinit, Bajram Currit, Azem Bejtës, Hasan Prishtinës, si dhe me mohimin e hapësirës kulturore shqiptare me të dhëna të habitshme se ky apo ai poet nuk ka lindur e krijuar në Jugosllavi. Të gjitha këto sulme dhe etiketime të ulëta e kërkesa për heqjen e emrave të institucioneve, në stilin e politikës së ditës, bëhen për ta zhveshur një popullsi të tërë nga e kaluara e vet, nga historia, tradita, kultura dhe nga krenaria kombëtare.

Për arritjen e qëllimeve po përdoren metoda të ndryshme, duke nxitur dhe stimuluar bojkotimin e mësimit të nxënësve serbë e malazezë në shkolla të caktuara, ndarjen dhe përçarjen duke absolutizuar të vërtetën «vetëm për vete», duke dhënë dorëheqje nga organet vetëqeverisëse në shkolla, duke u kërcënuar se do t'i dorëzojnë librezat partiake nëse nuk veprohet në atë mënyrë «dhe vetëm në atë mënyrë» etj.

Ku qëndron domethënia e tërë këtij presioni të organizuar deri në përpikëri?! Me siguri e kanë të qartë më shumë se të tjerët ata që e bëjnë këtë organizim, por tashmë e kanë kuptuar edhe mësimsdhënësit e kombësisë shqiptare në shkollat e caktuara, të cilët janë gjendur në një situatë mjaft provokative, ngase kërkesat për ndërrimin e emrave janë fare të pabaza, andaj edhe lëshimet në këtë drejtim, domethënë heqja dorë vullnetarisht dhe zhveshja nga identiteti nacional do të ishin vetëshkatërrim. Hapa të tillë, normalisht, nuk ndërmerr asnjë njeri inteligjent i cilitdo popull, përpos anacionalët kokëboshë

dhe shpirtzbrazur. Me këtë rast, pa dyshim, shtrohet pyetja se si mund të kuptohet një urrejtje e këtillë ndaj personaliteteve të një populli të caktuar, qoftë ajo e nxitur nga shovinistët shqiptarë apo serbë. Sigurisht një hap i tillë i mjerë nuk ka shpjegim tjetër pos se është fjala për kërkesa nacionaliste të atyre njerëzve, të cilët, fatkeqësisht, kujtojnë se strumbullar i çdo gjëje në botë është vetëm kultura vetjake. Pajtimi me kërkesa të këtilla dhe veprimet e ngutshme në raste të tilla mund të kenë pasojat tepër të rënda për marrëdhëniet ndërnacionale në KSA të Kosovës, të cilat, pastaj, zor të qetësohen.

Shembull tipik i veprimit të pamatur dhe i pasojave të tilla mund të merret rasti i ndërrimit të emrit të shkollës fillore «Halit Ibishi» të Babushit të Serbëve të Ferizajt, ku u veprua krye më vete, pa u pyetur të gjithë mësimdhënësit dhe banorët e mjedisit të caktuar, andaj edhe sot e kësaj dite e kemi gjendjen të nderë në këtë kolektiv, por edhe në tërë bashkësinë lokale. Nëse serbët e duan Vojvodën Vojin Mishiç, malazezët Mark Milanin, përse shqiptarët të mos e duan Isa Boletinin, deputetin Hasan Prishtina dhe poetin e shquar Luigj Gurakuqi? Gjithkush ka të drejtë ta dojë atë që simbolizon diçka në jetën e një populli, që është i lidhur me synimet dhe idealet e tij, prandaj janë ofenduese të gjitha etiketimet që bëhen nga pala tjetër, ngase ato shpesh nuk shprehin thelbin e çështjes.

Fundja, asnjëri nga personalitetet e traditës shqiptare që po sulmohen dhe që po kërkohet që disa shkolla dhe institucione të mos mbajnë emrat e tyre, nuk u kanë sjellë ndonjë të keqe popujve të tjerë, pos që janë angazhuar për lirinë e popullit të vet, duke respektuar njëherësh edhe dinjitetin e të tjerëve.

A thua si është e mundur që ndaj këtyre kërkesave destruktive të mos reagohet ashpër nga strukturat politiko-shoqërore, në radhë të parë të komunave, por edhe të KSA të Kosovës; si është e mundur që dukuritë e tilla për gjykim të shikohen me kaq indiferencë si të mos ndodhte asgjë! Sjelljet e tilla njëmend janë për gjykim dhe zemërojnë, ashtu siç befasojnë sjelljet e disa udhëheqësve të komunave, të cilët kujtojnë se problemin mund ta zgjidhin me lëshime përpara kërkesave të tilla, pra me

ndërrimin e emrave të shkollave dhe me masa të jashtëzakonshme e administrative.

Veprime të tilla janë të padobishme. Prandaj, LK me aksion konkret në mjedisin, ku lindin këto kërkesa, duhet t'ua shpjegojë njerëzve se veprimet e tilla janë të dëmshme, të patolerueshme e të pakuptueshme për një bashkësi shumë nacionale, sepse si të tilla cenojnë dinjitetin e një nacionaliteti dhe krijojnë ndasi ndërnacionale. Kështu, ndaj iniciatorëve dhe organizatorëve të këtyre kërkesave, që në esencë kanë për qëllim që situatën ta mbajnë vazhdimisht të tendosur, lypset të merren masa më të rrepta ideopolitike dhe t'i gjykojnë në rend të parë pjesëtarët e vetë atij kombi apo kombësie prej nga janë. Sepse njohja dhe respektimi i ndërsjellë i vlerave kulturoro-historike na nevojitet më tepër se kurrë.

«Rilindja», Prishtinë, 14.1.1989

KËRKESA E QËNDRIME QË ZHVLERËSOJNË HISTORINË DHE TRADITËN

Reagim kundër petitionit të 600 pjesëtarëve të kombësisë serbe dhe malazeze, me të cilin kërkojnë që t'i ndërrohet emri shkollës fillore në Prishtinë «Hasan Prishtina», dhe kundër kërkesave të tjera të ngjashme, që kohët e fundit janë përherë e më të shpeshta.

Të frymëzuar, përpos të tjerash, edhe prej shkrimeve të shumta në serbokroatishte, në të cilat prej pozitash të borgjezisë serbomadhe edhe më tutje flitet për historinë dhe kulturën e popullit shqiptar, zhvlerësohen figura të shquara të traditës së tij historike dhe kulturore, tirren përralla të gjata për gjoja albanizimin e Kosovës, të Serbisë Jugore dhe të Maqedonisë Perëndimore, disa nga pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze, në kohë të fundit gjithnjë e më shpesh, përmes tubimesh dhe peticionesh të ndryshme, po kërkojnë që disa shkollave fillore dhe disa qendrave të shkollimit të mesëm në Kosovë dhe në Preshevë, t'u ndërrohen emrat që mbajnë: emrat e figurave të shquara të historisë shqiptare — sikundër janë Skënderbeu dhe Hasan Prishtina; të letërsisë dhe të kulturës shqiptare — sikundër janë vëllezërit Frashëri dhe Luigj Gurakuqi; të dëshmorëve a heronjve shqiptarë të LNÇ-së sikundër është Halit Ibishi! Në kohë të fundit në radio dhe në televizion ka mundur të dëgjohet, kurse në disa gazeta edhe të lexohet, se si pjesëmarrës të kombësisë serbe dhe malazeze kanë deklaruar se nuk e ndiejnë

veten mirë, kur qoftë fëmijët e tyre, qoftë edhe vetë janë të shtrënguar të hyjnë në ndërtesat që mbajnë emrat e këtyre figurave shqiptare. Tamam ashtu: nuk e ndiejnë veten mirë pse vetë dhe fëmijët e tyre shtrëngohen të hyjnë në ndërtesat e pakta shkollore apo të kalojnë nëpër rrugët edhe më të pakta që në Kosovë e në tri komunat e Serbisë Jugore, ku jetojnë shqiptarë, mbajnë emrat e figurave më të ndritura të historisë dhe të kulturës shqiptare!

Ç'përgjigje t'u jepen deklaratave të tilla?

Pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze, të cilët kërkojnë që institucioneve shkollore në Kosovë dhe në Preshevë t'u hiqen emrat e figurave historike dhe kulturore shqiptare, për më tepër, deklarojnë se nuk e ndiejnë veten mirë kur vetë dhe fëmijët e tyre hyjnë në ndërtesat që i mbajnë ata emra, harrojnë se aso mendimesh, në çfarë ata mbështesin pakënaqësinë dhe kërkesat e tyre, mund të thonë edhe pjesëtarët e kombësisë shqiptare, fëmijët e të cilëve e ndjekin mësimin në shkollat që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës serbe, përkatësisht malazeze. Por, jo! Nxënësit shqiptarë, prindërit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre, mendime dhe argumente të tilla kundër shkollave me emra serbë e malazezë nuk kanë shqiptuar deri sot dhe nuk po shqiptojnë as sot.

Përkundrazi. Nxënësit shqiptarë, prindërit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre, prej Çlirimit e këndeje, nuk janë dëgjuar të thonë se s'hyjnë me qejf në ndërtesat shkollore që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës serbe, sikundër janë Dositej Obradoviçi, Vuk Karaxhiçi, Branko Radiçeviçi, Svetozar Markoviçi, Gjura Jakshiç, Branišllav Nushiçi e të tjerë, ose në ndërtesat shkollore që mbajnë emrin e poetit të madh të kombësisë malazezë Petar Petroviç Njegosh. Gjithashtu, prej Çlirimit e këndeje ata nuk janë dëgjuar të thonë se s'hyjnë me qejf në ndërtesat shkollore që mbajnë emrat e dëshmorëve e të heronjve popullorë serbë dhe malazezë, sikundër janë Boró Vukmiróviçi, Jóvańka Radijóviç-Kica, Trajko Gerkóviçi, Aca Maróviçi, Vllada Qetkóviçi e të tjerë.

Fëmijët shqiptarë dhe prindërit e tyre në Beograd,

në Novi-Sad, në Kragujevc, në Nish, në Bor dhe në qytete të tjera të Serbisë e të Vojvodinës, ku kanë shkruar të fitojnë bukën e gojës, ku jetojnë duke bërë punët më të rënda fizike, që të tjerët me qejf s'i bëjnë, s'është dëgjuar të kenë thënë ndonjëherë se nuk e ndiejnë veten mirë kur hyjnë në ndërtesat shkollore, që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës serbe, sikundër janë Millan Bakiç, Jovan Cvijiç, Ivo Andriç e të tjerë, edhe pse në ato shkolla asnjë lëndë s'u bëhet e mundshme ta dëgjojnë në gjuhën shqipe. Deri në ditën e sotme s'është shënuar që ndonjëri prej këtyre nxënësve shqiptarë e prindërve të tyre të kenë thënë se nuk e ndiejnë veten mirë kur hyjnë në ndërtesat shkollore ose kalojnë nëpër rrugët e sheshet, që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë, të letërsisë dhe të kulturës serbe sikundër janë: Millan Rakiçi — edhe pse ai ka shkruar jo vetëm vjershën e njohur kundër shqiptarëve «Simonida», por edhe shumë letra konsulare kundërshqiptare; Jovan Cvijiçi edhe pse ai në punimet e tij antropogjeografike ka lënë mjaft mendime shoviniste mbi shqiptarët në tërësi, duke i «privuar» të drejtat historike dhe etnike jo vetëm në Kosovë; Jovan Duçiçi — edhe pse ai në udhëpërshkrimet e tij, sidomos në Letrën nga Deti Jon, për shqiptarët ka shkruar mendime aq brutale shoviniste që mund të krahasohen vetëm me marrëzirat që ka shkruar për ta Vlladan Gjorgjeviçi; Ivo Andriçi — edhe pse në projektin e tij politik-diplomatik, të bërë për nevojat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë jugosllave më 1939, gjysmën e Shqipërisë ia ka bashkëngjitur Serbisë, kurse shqiptarët në Jugosllavi i ka përzënë në Anadoll — atje, ku një vit e dy më parë i kishte përzënë frymëzuesi i tij për projekte të tilla Vasa Çubrilloviçi; Millosh Cernjanski — edhe pse ai, në kohë të tij, edhe me penë, edhe me punë e madhonte fashizmin dhe në kuadrin e publicistikës dhe të praktikës së tij fashiste zotohej për zgjidhjen e çështjes shqiptare, ashtu sikundër dihet se zotohej borgjezia serbomadhe e ish-Jugosllavisë!

Por, jo! As prindërit e fëmijëve shqiptarë, as mësuesit dhe pedagogët shqiptarë, as intelektualët shqiptarë, s'kanë kërkuar ndonjëherë që shkollave, rrugëve, shesheve a bibliotekave t'u ndërrohen emrat e personaliteteve të

shquara të historisë, të letërsisë dhe të kulturës serbe. Jo se prindërit e nxënësve shqiptarë, mësuesit, pedagogët dhe intelektualët shqiptarë nuk mendojnë se Vuku, Njegoshi, Rakiçi, Cvijiçi, Duçiçi, Andriçi, Cernjanski kanë mundur të mendojnë pikë për pikë sikundër u duhet brezave të sotëm, se është dashur të kenë parasysh të gjithë interesat e brezave të sotëm, se është dashur t'u përmbahen të gjitha parimeve të vërteta dhe të gjitha parimeve të rreme të këtyre brezave. Jo!

Më në fund, prindërit e nxënësve shqiptarë, mësuesit, pedagogët dhe intelektualët shqiptarë nuk i japin vetes të drejtë të vendosin për rëndësinë dhe vendin e figurave historike e kulturore serbe në historinë dhe kulturën e popullit serb, siç po i japin të drejtë vetes disa pjesëtarë të kombësive serbe që të vendosin për rëndësinë dhe vendin e figurave historike e kulturore në historinë dhe kulturën e popullit shqiptar.

Për të gjitha këto arsye nxënësit shqiptarë, prindërit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre — sikundër njoftojnë mjetet e informimit — nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollore në Preshevë që mban emrin e Skënderbeut, të figurës madhore të historisë shqiptare, i cili plot 25 vjet e ka udhëhequr popullin shqiptar në luftën kundër pushtimeve turke në Ballkan, i cili, duke luftuar edhe për lirinë e të gjithë popujve të Ballkanit, duke mbrojtur Ballkanin, njëkohësisht ka mbrojtur edhe Evropën.

Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe asaj malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollore në Prishtinë, që mban emrin e Hasan Prishtinës, të luftëtarit të shquar për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha turke, i cili, duke luftuar për lirinë e popullit të vet në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë, njëkohësisht ka luftuar edhe për çlirimin e të gjithë popujve të Ballkanit prej sundimit turk, i cili, tek e mbramja, edhe ka lindur në Vuçiternë afër Prishtinës.

Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe asaj malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollore në Klinë, që mban emrin e Luigj Gurakuqit, të shkrimtarit të shquar shqiptar të fundit të shekullit XIX

dhe të dhjetëvjetshave të parë të shekullit tonë, i cili, gjithashtu, ka luftuar për çlirimin e popullit shqiptar nga robëria turke, dhe si ministër demokratik në qeverinë demokratike të Fan Nolit, ka luftuar kundër të gjitha llojeve të tiranisë e të shtypjes, i cili në të kaluarën shqiptare simbolizon flijimin për liri, për nder dhe dinjitet kombëtar dhe njerëzor, në përgjithësi.

Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk hyjnë me qejf në ndërtesën e shkollës në Miradi të Epërme në Komunën e Prishtinës, e cila mban emrin e vëllezërve të famshëm Frashëri, të cilët në zemër të Turqisë kanë bërë betejën më vendimtare politike, intelektuale dhe morale për lirinë e popullit shqiptar, të cilët i kanë dhënë kontributin më të madh kulturës shqiptare dhe mendimit demokratik shqiptar. Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollë, që mban emrin e vëllezërve, pa të cilët nuk mund të merren me mend as historia, as letërsia, as shkenca, as kultura e popullit shqiptar prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e deri sot. Nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollë, që mban emrin e Naim Frashërit, të poetit dhe të humanistit të madh shqiptar, i cili në historinë dhe në kulturën shqiptare ka atë rëndësi që e kanë — Njegoshi në historinë dhe në kulturën e malazezëve, Vuk Karaxhiçi në historinë dhe në kulturën e serbëve, Ludeviti Faji në historinë dhe në kulturën e kroatëve ose, më në fund, Francë Presherni në historinë dhe në kulturën e sllovenëve.

Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk hyjnë me qejf në godinën shkollë në komunën e Ferizajt, e cila mban emrin e dëshmorit shqiptar, Halit Ibishi, i cili, si të gjithë dëshmorët serbë e malazezë, emrat e të cilëve i mbajnë një sërë shkollash, ndërmarrjesh punuese, rrugësh dhe sheshesh në Kosovë, në Serbi dhe në Jugosllavi, ka luftuar kundër fashizmit dhe, duke luftuar kundër fashizmit si të gjithë dëshmorët e kombësive të tjera, sigurisht, ka kontribuar për fitoren e përbashkët!

Për të gjitha këto arsye nxënësit shqiptarë, prindë-

rit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze, vërtet, nuk e ndiejnë veten mirë kur hyjnë në godinat shkollore që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës shqiptare, sikundër janë Skënderbeu, Hasan Prishtina, vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqi e të tjerë, prandaj kërkojnë që ata emra t'u ndërrohen. Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze në atë mënyrë kërkojnë që prej historisë dhe kulturës shqiptare, për më tepër prej memories shqiptare, të fshihen disa nga emrat më të mëdhenj historikë dhe disa nga veprat më të mëdha kulturore, domethënë të fshihet pjesa thelbësore e përmbajtjes së traditës historike dhe kulturore të popullit shqiptar.

Ata nuk dëshirojnë të besojnë se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze nuk e ndiejnë veten mirë, kur hyjnë në ndërtesat shkollore që mbajnë emrat e Skënderbeut, të Hasan Prishtinës, të vëllezërve Frashëri, të Luigj Gurakuqit dhe të figurave të tjera të mëdha të historisë dhe të kulturës shqiptare vetëm e vetëm pse janë figura të mëdha të historisë dhe të kulturës së popullit shqiptar, pse e kanë dashur popullin e vet, pse për popullin e vet kanë bërë atë që ishte e mundshme si më e mira, më e mençura, më e nevojshmeja, në kohën kur kanë jetuar. E sikur për popullin e vet të mos kishin bërë krejt ç'kanë bërë, sikur të mos e kishin dashur ashtu dhe aq sa e kanë dashur popullin e tyre, populli shqiptar nuk do të kishte arsytet që ka, që në përparimin e vet të inkuadrojë veprat dhe mendimet e tyre, në etiketën e vet të mishërojë shembullin e flijimit të tyre, në kujtesën e vet të shënojë përgjithmonë emrat e tyre.

Për të gjitha arsytet e sipërthëna, nxënësit shqiptarë, prindërit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre — që deri sot kurrë s'kanë kërkuar t'u ndërrohen emrat e figurave të shquara të historisë e të kulturës serbe a malazeze shkollave a rrugëve në Kosovë dhe në Preshevë — me të drejtë i konsiderojnë jo vetëm kundërshtqiptare, por edhe kundërqytetëruese kërkesat e disa pjesëtarëve të kombësisë serbe e malazeze që t'u hiqen emrat shqiptarë shkollave në Kosovë dhe në Preshevë. Ato janë kërkesa që cenojnë historinë dhe kulturën e një populli dhe, si të tilla kërkesa,

fyejnë arsyen, tolerancën dhe lirinë si vlera, mbi të cilat qytetërimi edhe ndërtohet. E këto janë, besojmë, arsye të mjafta të besohet se pjesëtarët e kombësisë serbe dhe malazeze do të heqin dorë nga kërkesat që shkollave në Preshevë, në Prishtinë, në Klinë, në komunat e Prishtinës e të Ferizajt t'u hiqen emrat e Skënderbeut, të Hasan Prishtinës, të vëllezërve Frashëri, të Luigj Gurakuqit, të Halit Ibishit dhe të figurave të tjera historike e kulturore të popullit shqiptar.

Por, ato janë arsye të mjafta të besohet se nxënësit shqiptarë, prindërit e tyre, mësuesit dhe pedagogët e tyre do të jenë të vendosur sot dhe të vendosur nesër që të ruajnë emrat e figurave të ndritura të historisë dhe të kulturës së vet edhe në godinat shkollore, prej të cilave, mjerisht, po kërkohet që të hiqen. Dhe do të jenë të vendosur t'i ruajnë ata emra, sepse ruajtja e atyre emrave është akt i ruajtjes së qenies shpirtërore të popullit shqiptar.

Punonjësit shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

«Rilindja», Prishtinë, 28.1.1989

KUR TË MIRËT PRISHEN

— *Letër e tetë arsimtarëve dhe nxënësve të shkollës «Skënderbeg» të Preshevës*

Deri kohët e fundit qendra arsimore «Skënderbeg» e Preshevës konsiderohej si kolektivi shkollor më i mirë në komunën e Preshevës dhe përfshihej në radhën e qendrave më të mira të arsimit të mesëm të orientuar në rajonin e Moravës së Jugut. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e arritura si në planin arsimor, ashtu dhe në atë edukativ. Po përmendim vetëm disa prej tyre dhe secili do ta ketë të qartë se për çfarë kolektivi bëhet fjalë. Kemi zënë vendin e dytë dhe të tretë në republikë përsa i përket rregullimit të mjedisit shkollor, kemi marrë fletëlavdërim nga konferenca e RS të Serbisë për kontributin e dhënë në zhvillimin e RS të Serbisë, fletëlavdërimi nga Kongresi i 9-të i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Serbisë, kemi organizuar takimin e bashkim-vëllazërimit që çoi në organizimin e takimit në nivelin e krejt RSF të Jugosllavisë në vitin 1985, kemi realizuar vëllazërimin me shkollën kulturore «Dimitrije Tucoviç» të Beogradit si dhe kemi organizuar një numër aksionesh e manifestimesh të tjera, me anën e të cilave ky kolektiv ka provuar me vepra se i përket këtij vendi.

Ndryshe nga kjo periudhë, që karakterizohet nga sukseset dhe kur ne ishim për opinionin e gjerë publik anonim, këtë vit shkollor, bashkë me situatën e përgjithshme të pafavorshme, u bëmë të njohur, por në kuptimin

negativ. Mjetet e informacionit publik kanë hyrë në garë për t'i paraqitur sa më të zeza rrethanat në kolektivin tonë. Gazetarët nuk ngurrojnë aspak që qendrës sonë shkollore t'i vënë epitete të tilla si epiqendër, çerdhe, fidanishte ose strehë e nacionalizmit dhe e separatizmit shqiptar. Për fat të keq, edhe në gazetën «Borba» të 3 prillit të këtij viti, në artikullin me titull «Epiqendra në shkollën «Skënderbeg»», me autor V. Velkoviç, vazhdohet me këtë stil.

Qysh në fillim po bëjmë pyetjen se si është e mundur që i njëjti kolektiv, kryesisht të njëjtët njerëz, tani me një kualifikim më të mirë (90 për qind e arsimtarëve janë specialistë dhe jo 75 për qind, sikurse shkruan gazetari i huaj), të shndërrohet menjëherë nga kolektiv i bashkim-vëllazërimit, sikurse ka qenë deri tani kjo qendër arsimore, në fidanishte të nacionalizmit, sikurse thuhet në artikull. Nuk është për t'u habitur që ju, ashtu si edhe funksionarët e Komunës, të akuzoni qendrën arsimore për të gjitha problemet e grumbulluara dhe fatkeqësitë e kësaj komune në ekstrem të pazhvilluar. Në të vërtetë, në një pjesë të artikullit të lartpërmendur ju thoni se nuk jemi fajtorë vetëm ne, por, megjithëkëtë, pohoni se jemi epiqendër e nacionalizmit dhe e separatizmit.

Le të fillojmë nga argumenti juaj kryesor, i cili s'është gjë tjetër veç një aktakuzë për veprimtari armiqësore, e cila nuk provohet me asgjë. Pikë së pari, ai ka natyrë joprofesionale, sepse pranon në mënyrë jokritike dhe transmeton informata të gabuara. Në të vërtetë, në materialet e Komitetit të LK të Preshevës, nga mbledhja e së cilës informon gazetari i huaj, për 9 profesorë thuhet se kanë vepruar në mënyrë destruktive dhe kjo provohet me atë se 50 kolegë të tyre të tjerë kanë qenë pjesëmarrës më aktivë në mbledhjet e kolektivit dhe të organizatës bazë të LK.

Lufta kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar, në kuadrin e luftës kundër të gjithë nacionalizmave, duhet të jetë një proces i përhershëm dhe jo spontan. Po kështu edhe diferencimi në punë dhe ideopolitik duhet të jetë i pranueshëm nga të gjithë dhe jo vetëm çështje e të plotfuqishmëve lokalë dhe e gazetarëve. Ai duhet të zhvillohet me argumentet përkatëse, sepse në rast të kundërt

shndërrohet në fushatë, dhe çdo fushatë kërkon listën e fajtorëve e në këtë rast argumentet dhe provat për një konkluzion logjik janë të tepërta. Përsa i përket bojkotimit të mësimit nga nxënësit e kombësisë shqiptare, jemi dakord se ai kontribuoi në ftohjen e mëtejshme të marrëdhënieve ndërnacionale. Mirëpo, megjithëse i informuar plotësisht, autori i artikullit në fjalë nuk përmend aspak se përpara këtij bojkotimi ka pasur disa bojkotime mësimesh nga nxënësit e kombësisë serbe.

Është e vërtetë që marrëdhëniet ndërnacionale janë ftohur gjatë këtij viti shkollor dhe se për çështje të veçanta kemi pasur edhe ndarje nacionale. Por, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, është e nevojshme një analizë e gjërë dhe e thellë, e cila nuk mund të bëhet në këtë reagimin tonë të shkurtër. Ndërkohë, ashtu sikurse theksoni edhe ju, deri kohët e fundit këto marrëdhënie ishin të mira dhe, meqë është fjala kryesisht për të njëjtët njerëz, ne nuk shohim asnjë arsye që këto marrëdhënie të mos jenë të mira edhe në të ardhmen. Mendojmë se mundësitë më të mëdha qëndrojnë në anën e marrëdhënieve të mira ndërnacionale. Këto marrëdhënie, sikurse edhe më parë, duhet t'i ndërtojnë ata, të cilët punojnë çdo ditë bashkë dhe në të njëjtat kushte. Çdo njeri e ka të qartë se jeta pa tensione dhe pa ndarje nacionale nuk mund të ndërtohet me anën e vendimeve të njëanshme dhe të shpejta, me anën e shpërndarjes së organizatës së LK dhe as me reduktimin e vetadministrimit.

Riza Haljimi
Ali Ahmedi
Sami Hasani
Rexhep Rushiti
Nazmi Jashari
Hali Jusufi
Avni Shaqiri
Hejljulj Nasufi

Qendra arsimore «Skënderbeg»,
Preshevë

«Kad se dobri pokvare», «Borba»,
Beograd, 5 qershor 1989

Dr. Hajrullah Koliqi

ARSIMIN KOSOVAR?

Për botën e civilizuar nuk ka dilemë se pa arsim nuk mund të ketë përparim. Pikërisht kjo është njëra nga arsyet që UNESKO-ja të drejtën për të mësuar (nxënë) e ka ngritur në nivelin e së drejtës elementare të njeriut bashkëkohor.

Kjo nevojë e domosdoshme dhe e drejtë elementare e njeriut është sanksionuar edhe me aktet tona përkatëse normative. Në këtë fushë të veprimtarisë shoqërore te ne janë arritur rezultate të konsiderueshme. Mirëpo, vështirësitë tona ekonomike, shoqërore, politike, kulturore etj. ndikuan e ndikojnë vazhdimisht edhe në keqësimin e gjendjes së arsimit tonë përgjithësisht. Gjendja tejet shqetësuese është veçanërisht në veprimtarinë arsimore në KSA të Kosovës.

Për këtë dëshmon, në radhë të parë, gjendja alarmante e arsimit fillor (baza tejet e dobët materiale-financiare, kuadri arsimor i destimuluar për punë, mospërfshirja e shkapërderdhja e nxënësve përkatës, cilësia e ulët e mësimit e rezultatet e dobëta të tij etj.). Se si është gjendja në arsimin fillor kosovar dëshmon qartë e bindshëm përqindja aq e madhe (17,6%) e popullsisë analfabete. Ky është një anakronizëm i çuditshëm. Edhe pse arsimi fillor është i obligueshëm me ligj për të gjithë fëmijët prej moshës 7-15 vjeçare, ne edhe aktualisht «pro-

dhojmë» analfabetë të rinj, madje edhe analfabetë të shkolluar.

Këtë gjendje e vëren jo vetëm intelektual, por edhe punëtori e fshatari ynë. Për këtë flet edhe vetiniciativa e vetorganizimi i punonjësve e i fshatarëve tanë që me vetëkontributin dhe mjetet e djersën e tyre të ndërtojnë godina shkollore për shkollimin e edukimin e fëmijëve të vet. Rastet e tilla janë të shumta në këto treva. Nga njëra anë, kjo është një dëshmi e gjallë se edhe fshatari ynë është dashamirës i arsimit dhe i shkollës dhe është kënaqësi që ai angazhohet për vepra të tilla fisnike, por, nga ana tjetër, shqetëson fakti që shoqëria jonë socialiste nuk është në gjendje të sigurojë madje as lokal të mjaftueshëm për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në shkollimin e plotë fillor (tetëvjeçar). Ky problem është shumë i rëndë jo vetëm në fshat, por edhe në qytet. E, përsa i përket modernizimit të mësim, nuk mund të bëhet fjalë.

Lenini, me të drejtë, ka pasë thënë se socializmi nuk mund të ndërtohet me njerëz analfabetë. Gjithashtu, është iluzion të mendohet se me njerëz analfabetë e gjysmëanalfabetë (me këtë shkollë fillore, siç e kemi sot), do të mundemi të përgatitemi me sukses për ndryshimet e vullshme të shekullit XXI.

Gjendja nuk është e mirë as në arsimin e mesëm kosovar. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me vështirësi të natyrës materiale e të kadrove, por edhe me një varg çështjesh të tjera. Kështu, bie fjala, nga njëra anë, numri i semimaturantëve (me mësim në gjuhën shqipe) shkon vazhdimisht duke u rritur, nga ana tjetër, mundësitë për regjistrimin e tyre në shkollimin e mesëm jo vetëm që nuk u zgjeruan, por madje edhe u ngushtuan. Nga mjetet e informimit publik mësojmë se sivjet në shumë komuna të Krahinës, në shkolla të mesme nuk kanë pasur mundësi të regjistrohen (për shkak të mungesës e «ngushtimit» të lokalit shkollor) rreth 50% e semimaturantëve në fjalë. Vite më parë, siç dihet, shoqëria bënte përpjekje të mëdha për regjistrimin e tyre nëpër shkolla të mesme (ku edhe u arritën rezultate të konsiderueshme), ndërsa sot rreth gjysma e tyre nuk kanë mundësi të regjistrohen, përkatësisht të vazhdojnë shkollimin e mesëm, sepse shoqëria nuk ka krijuar kushte të nevojshme për një gjë të tillë.

Është habi e madhe se si lihet në heshtje e vërteta rrënoqethëse që vajzat e motrat tona (veçanërisht ato të fshatit) në masë aq të madhe të heqin dorë nga shkolla (fillore dhe e mesme). Këtë, siç dihet, në radhë të parë e bëjnë për shkaqe të përmendura më lart, pastaj sepse nuk kanë mundësi materiale për shkollim, nuk shohin perspektivë për të gjetur punë etj. Në dëm të shkollimit të mesëm ndikoi edhe shuarja e një vargu kursesh dyvjeçare, ku kish-te mundësi të përfshiheshin një numër më i madh nxënësish të të dy gjinive, sidomos të vajzave. Kur është fjala për këtë, le të kujtojmë një mendim të artë të Sharl Furiesë: «Shkalla e emancipimit të gruas është masë e natyrshme e emancipimit të përgjithshëm».

Po përkujtojmë se ka vende ku arsimit i mesëm është i obligueshëm, ka vende të tjera që e synojnë një gjë të tillë në një afat sa më të shkurtër. Këtë e bëjnë me bindje të plotë se arsimit i mesëm do të jetë arsim elementar për shekullin XXI.

Themelimi i Universitetit të Prishtinës ishte një ngjarje me peshë të madhe jo vetëm për arsimin, shkencën e kulturën kosovare, por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Shkollat e larta dhe fakultetet e tij ishin ato që formuan një inteligjencie të re e vitale, ishin ato që formuan kuadro me kualifikime të larta të nevojshme për ekonominë, shkencën, kulturën e arsimin e kësaj treve e jashtë saj.

Kriza ekonomike, shoqërore e politike u shpreh gjerësisht edhe në këtë institucion. Lindën probleme të llojllojshme, u dhanë vlerësime e propozime për veprimtarinë e tij etj. Unë do të përqendrohem në dy-tri çështje të kësaj natyre.

Së pari, konsiderohej se nuk është mirë që edhe këtu të synohet pakësimi i numrit të studentëve, por të punohet për transformimin dhe ngritjen e nivelit arsimor e shkencor brenda e jashtë tij. Ishte alarmues për të gjithë kompetentët e arsimit e dashamirët e përparimit vendimi i organeve të Akademisë së Arteve që ta ndërpresë punën për shkak të mungesës së kushteve elementare për një veprimtari normale akademike. Edhe më shqetësues ishte lajmi për vendimin e ndërprerjes së veprimtarisë së Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës me qëllim që në lokalet e saj të vendoset Akademia e Arteve. S'ka

dyshim se një vendim i tillë jo vetëm që është i pamatur e i shpejtuar, por ka edhe pasoja tejet të rënda si për arsimin e lartë, ashtu edhe për arsimin fillor kosovar e më gjerë. Ky vlerësim mbështetet në faktin se në shkollat tona fillore ende punon një numër i konsiderueshëm punonjësish të arsimit, të cilët nuk kanë kualifikime të nevojshme profesionale. Përveç kësaj, me Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës lidhen edhe fijet e arsimit të lartë e universitar në KSA të Kosovës etj. Dashamirët e arsimit e të përparimit do të dëshironin të dëgjonin për hapjen e ndonjë shkolle apo dege të re, e jo për mbylljen eventuale të ndonjërës prej tyre.

Ndërsa, sa i përket arsimit të të rriturve në Krahinën tonë, mund të thuhet se ai i është lënë stihisë e spontanitetit, kurse përfshirja e fëmijëve të moshës parashkollore në institucione përkatëse edukativo-arsimore është tejet simbolike.

I vumë në pah vetëm disa probleme të njohura të arsimit kosovar, ngase jemi të bindur se ato janë në shpërpjesëtim të plotë me idealet e proklamuar të shoqërisë sonë. Tragjike është për një shoqëri, kur midis idealit e realitetit ekziston një shpërpjesëtim kaq i theksuar. Gjithashtu, kombësia shqiptare jeton në përbashkësi me popujt e tjerë të vendit tonë e krahasimi midis tyre nxjerr qartë në pah prapambeturinë e kësaj kombësie edhe në fushën e arsimit. Prandaj, çdo ndër marrje e papeshuar mirë, përkatësisht keqësimi i mëtejshëm i gjendjes së arsimit e të kulturës në fjalë, do të kishte pasoja katastrofale e të pakompensueshme për popullin e shoqërinë tonë. Jeta ka sprovuar e mendimtarët largpamës kanë dëshmuar se arsimit është mjeti më i fuqishëm i njeriut, i popullit, i shoqërisë. Ai është tabani i emancipimit e i progresit. Prandaj, edhe në arsimin kosovar — jo restriksione, por angazhim të gjithanshëm për përmirësimin rrënjësor e të shumanshëm të tij.

«Rilindja», Prishtinë, 17.10.1989

IV
GJENDJA EKONOMIKE E
SHOQËRORE E KOSOVËS



PROBLEMET DEMOGRAFIKE TË KOSOVËS DHE INTERPRETIMI I TYRE

Kosova dhe shqiptarët u gjendën për herë të parë në qendër të vëmendjes të të gjithë opinionit publik jugosllav, por edhe atij evropian e botëror në fillim të viteve 80-të të shekullit tonë, vëmendje që po rritet gjithnjë e më shumë. Në kuadrin e diskursit serb dhe mbarëjugosllav për Kosovën dhe shqiptarët nuk kanë shpëtuar pa u prekur as problemet demografike, sidomos lindshmëria, migracionet dhe rritja demografike. Lidhur me këtë, në mungesë pothuaj të plotë të aftësisë për një gjykim racional shtrohet një numër i pafund çështjesh, propozohen zgjidhje të ndryshme, theksohen qëllime e motive të dyshimta dhe nënvizohen kërkesa të qarta neomaltuziane. Interesi i shoqërisë për problemet demografike të Kosovës shtohet dhe shkak për këtë janë përqindja aktuale e lindshmërisë të shqiptarët dhe migrimet nga Kosova dhe në drejtim të Kosovës vetëm të një pjese të popullsisë (serbëve dhe malazezëve), kurse roli i pazëvendësueshëm i shkencës në ndriçimin, sqarimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe në interpretimin e të dhënave të tjera të lëvizjeve demografike ose është spostuar ose përfundimet e saj janë mohuar me forcë.

Në shqyrtimin e mëposhtëm, në kuadrin e marrëdhë-

nive Kosovë—Serbi—Jugosllavi dhe anasjelltas, vëmendjen do ta përqendrojmë në dy sektorë kyç të zhvillimit demografik: lindshmëria e migracionet e popullsisë dhe interpretimi i tyre.

I

1 — Një vështrim mbi karakteristikat kryesore të popullsisë, të ekonomisë dhe zhvillimit shoqëror të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore tregon se deri nga mesi i viteve 60-të në Serbi dhe Jugosllavi nuk është shprehur ndonjë interesim i sigurtë që kjo krahinë dhe shqiptarët të zhvillohen ekonomikisht dhe të përfshihen në zhvillimet e përgjithshme të jetës shoqërore dhe të emancipimit kulturor. Shqetësimi kryesor i konceptit burokratiko-unitarist të shoqërisë deri në ato vite ka qenë që çështja e shqiptarëve të zgjidhet një herë e mirë kryesisht me shpërnguljen e tyre në krahinat feudale të Turqisë e sidomos në zonat e shkreta të Anadollit. Për këtë flet më së miri politika e investimeve në Kosovë. Nuk u bënë investime në kapacitetet përpunuese dhe degët e prodhimit intensiv, që nxisin rritjen e masës së zënies me punë edhe të meshkujve, edhe të femrave, por investimet u orientuan kryesisht në zhvillimin e energjetikës dhe të lëndëve të para, në degët me aftësi të ulëta akumuluese dhe riprodhuese, ku përfaqësoheshin interesat jo vetëm të Serbisë, por edhe të gjithë Jugosllavisë. Në planin e parë 5-vjeçar të zhvillimit, 1947-1951, në Kosovë ishin përcaktuar kufij shumë të ngushtë të veprimtarive ekonomike (industria e tjegullave, e tullave dhe e gëlqerës, industria e drurit dhe furrat e pjekjes, prodhimi i qilimave dhe punimi i teneqesë), ndërsa «Trepça» dhe miniera të tjera vareshin nga plani republikan dhe federativ. Tendenca e lënies pas dore të zhvillimit ekonomik të Kosovës vazhdoi deri nga fundi i viteve 50-të, kur ajo trajtohej vetëm si një problem i brendshëm serb, ndërsa pasojat ishin mbetja vazhdimisht prapa e saj në krahasim me zonat e tjera të vendit dhe prapambetja thellohej gjithnjë e më shumë. Vetëm pas vitit 1956 kjo krahinë trajtohet si një zo-

në e pazhvilluar e vendit, ndërsa Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi, që në fillim morën investime të garantuara nga shteti, domethënë pa detyrim kthimi (M. Limani, 1980). Viti 1965 e gjeti Kosovën me mbi 1.000 fshatra të paelektrifikuara, që do të thotë më shumë se 70 për qind e fshatrave. Në Kosovë socializmi filloi të ndërtohej pa bazat materiale të shoqërisë.

2 — Zhvillimi i industrisë nxjerrëse dhe i energjetikës kërkonte investime të mëdha dhe nuk mund të ndikonte fuqishëm për zhvillimin e shpejtë të industrisë dhe të urbanistikës, rritjen e masës së zënies me punë, veçanërisht të grave, dhe ndryshimin e strukturës socialekonomike të popullsisë. Përveç kësaj, këto degë janë faktor i madh i ndotjes së mjedisit. Në këtë mënyrë bujqësia ekstensive nuk mundi të shkarkohet nga tepricat agrare. Rritja e vazhdueshme e numrit absolut të popullsisë që merret me bujqësi deri në fillim të viteve 70-të përbënte dukurinë më të pafavorshme në strukturën dominuese fshatare dhe agrare. kështu që «uria» për tokë rritej vazhdimisht, sikurse edhe çmimet shumë të larta të tokave të punueshme. Për këtë arsye ndryshimet social-demografike ishin më të ngadalta, dhe këto para së gjithash në sferën e lindshmërisë dhe të vdekshmërisë ndër fëmijët, por dhe në fushën e mobilitetit social, profesional dhe në hapësirë të popullsisë, si dhe në mënyrën urbane të jetesës. Ndërkohë, pas viteve 60-të dhe sidomos pas viteve 70-të, industrializimi fillestar dhe procese të tjera të zhvillimit shoqëror patën një rëndësi të madhe në prishjen graduale të strukturës relativisht homogjene, demografike e social-ekonomike të Krahinës. Krahas ndryshimeve filloi të bjerë përqindja e lindshmërisë (sot është rreth 29 për mijë). Në këtë periudhë kemi diferencimin rajonal dhe socialklasor të popullsisë, si dhe shtresëzimin e saj sipas prizmit shoqëror. Edhe përvoja e popullive që e kishin kapërcyer periudhën kalimtare demografike (rënia e vdekshmërisë, e lindshmërisë dhe zgjatja e jetës së njeriut) ka treguar se fillimi i rënies së lindshmërisë nuk shfaqet në tërë popullsinë, por në ato pjesë të saj ku janë krijuar kushtet për ndryshimin e riprodhimit. Barra e riprodhimit nuk është e shpërndarë barabar kudo midis

tipeve të vendbanimeve, të shtresave sociale të shoqërisë dhe të jetëgjatësisë së popullsisë, ndërsa në zonat e pazhvilluara si rregull popullsia fshatare e agrare mban barrën më të madhe. Popullsia fshataro-agrare e Kosovës deri kohët e fundit ka qenë në kufijtë, ku ekuilibri demografik midis lindjeve dhe vdekjeve është arritur me humbje shumë të mëdha njerëzore, njëlloj si te të gjitha popullsitë paraindustriale me të ashtuquajtur shtim natyror. (P. Festy, 1979).

3 — Studimet edhe në rastin e popullatës kosovare tregojnë se gratë që marrin pjesë aktive në ekonomi Tindin më pak fëmijë se gratë shtëpiake (sipas regjistrimit të vitit 1981 një grua aktive lindi 3.07 fëmijë, ndërsa shtëpiaket 5.49 fëmijë), se gratë që punojnë në bujqësi kanë mesatarisht një pjellori më të lartë sesa gratë me punë jo në bujqësi (më 1981 gratë shtëpiake në fshat lindnin 6.74 fëmijë, ndërsa gratë aktive në punë jo në bujqësi lindnin 2.74 fëmijë, jetëgjatësia 45-49 vjeç) dhe se gratë analfabete apo pa arsimin përkatës shkollor lindnin më shumë fëmijë, kurse më pak gratë me një shkallë më të lartë arsimimi (një grua e paarsimuar lindi 7.04 fëmijë, ajo me arsim të mesëm 2.24, ndërsa gruaja me arsim të lartë 2.18 fëmijë). Është fakt se gratë shqiptare në Kosovë dhe në zona të tjera më pak të zhvilluara të vendit lindin më shumë fëmijë, ndërsa pozita e tyre materiale, social-kulturore dhe e punësimit, si dhe komponenti se kush vendos në familje dhe në shoqëri është shumë i disfavourshëm për to. Zënia e saj me punë në sektorin shoqëror është jo vetëm e ulët (15 për qind e numrit të përgjithshëm të shqiptarëve të zëna me punë në Kosovë në vitin 1986), por edhe një kategori krejt e re. Ajo është ende e varur ekonomikisht (më 1981 vetëm 7.4 për qind e grave ishin ekonomikisht aktive; në fshat 3.9 për qind) dhe me arsim të pamjaftueshëm (më 1981 26.3 për qind e grave ishin analfabete: në fshat kjo shifër arrin në 29.2 për qind, ndërsa te brezat mbi 35 vjeç analfabetizmi kap rreth 60 për qind të tyre), ndërsa para 10 vjetësh gjendja ishte edhe më e disfavourshme (H. Islami, 1985). Më se 1/3 e lindjeve në Kosovë edhe sot e kësaj ditë bëhet jashtë institucioneve shëndetësore dhe pa ndihmën e specialistëve. Përqindja e grave të kuruara para vdekjes është rreth 65

për qind, ndërsa shkalla e vdekshmërisë të foshnjët është mjaft e lartë (rreth 55 për mijë), ku mbisundojnë shkaqet e jashtme të vdekjes. Vetëm pas vitit 1980 popullsia fshatare e Krahinës gëzon mbrojtjen e plotë shëndetësore, por vazhdon të mbetet e pazgjidhur çështja e pensioneve dhe e sigurimit për invaliditet. Tuberkulozi si sëmundje tipike sociale shënon rritje vetëm në Kosovë. Sipas vlerësimeve të sindikatave kosovare, mbi 60.000 familje nuk kanë asnjë anëtar në marrëdhënie pune.

4 — Lindshmëria është një çështje socialklasore. Ajo nuk përcaktohet nga aspekti etnik apo fetar, nuk lidhet me dukuri ataviste dhe as me ideologjinë dhe ndërgjegjën specifike për despansionizëm, gjë që u atribohet shqiptarëve. Përkatësia nacionale shfaqet vetëm si një nga tiparet sociale. Dallimet në përqindjen e lindjeve midis kombësive të ndryshme janë rrjedhim i shkallës jo të barabartë të zhvillimit dhe të jetës socialekonomike, arsimore, kulturore e shëndetësore dhe të qëndrimeve e normave të ripërtëritjes, që krijohen mbi këtë bazë. Dallimet janë evidente edhe midis përfaqësuesve të së njëjtës kombësi apo fe në zona me nivel të ndryshëm zhvillimi. Gjatë gjithë periudhës së pasluftës lindshmëria është më e lartë te serbët në Kosovë dhe në Bosnjë-Hercegovinë, te malazezët në Mal të Zi (deri dje edhe në Kosovë), te myslimanët në zonën e Sanxhakut, te kroatët në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë (në vitin 1981 27.5 për mijë kundrejt 15.3 për mijë në Kroaci) dhe te shqiptarët në Kosovë, Maqedoni e Serbi. Gratë shqiptare (më 1981) në fund të periudhës së pjellorisë kishin në Kosovë 6.66 fëmijë, në Maqedoni — 5.60 dhe në Serbi — 5.75 fëmijë, kurse në Slloveni — 3.07, në Kroaci — 3.56 dhe në Bosnjë-Hercegovinë — 4.29 fëmijë.

Gratë serbe në fund të kësaj periudhe kishin në Kosovë 3.42, në Bosnjë-Hercegovinë — 2.81, në Kroaci — 2.02, në Vojvodinë — 1.87, Serbi — 1.85 dhe Slloveni — 1.65 fëmijë. Ato malazeze në fund të periudhës së lindjes kanë pasur në Kosovë — 3.16, në Mal të Zi — 2.95 dhe Maqedoni — 2.59, ndërsa në Kroaci — 1.84 dhe Slloveni — 1.98 fëmijë. Sipas regjistrimit të vitit 1981, për shembull, në Kosovë 15.101 serbë kishin lindur 5 e më shumë fëmijë (prej tyre 10.038 gra edhe mbi 6 fëmijë) dhe po aq

1.400 gra malazeze. Në zonat e pazhvilluara fshatare të Krahinës, deri në vitet e vonshme të pasluftës, te serbët ruheshin edhe familjet e mëdha.

5 — Duke u nisur nga një sërë faktorësh biologjikë, ekonomikë, socialë etj, që lidhen e kushtëzohen reciprokisht nga vdekshmëria, veprimtaria ekonomike, zënia me punë në sektorin ekonomik dhe arsimimi hyjnë midis faktorëve kyç që përcaktojnë jo vetëm ndryshimet në riprodhim, por edhe në pozitën e përgjithshme të gruas e rolin e saj në marrëdhëniet familjare e në shoqëri. Nëpërmjet angazhimit të saj në procesin e punës së bashkuar, i cili, nga ana e tij, kërkon objektivisht një shkallë të caktuar arsimi të përgjithshëm e profesional, gruaja ka mundësi të shprehë aspiratat, dëshirat, nevojat dhe interesat e tjerë jetësorë jashtë familjes si një kuadër bazë ku realizohet lindja dhe veprimtaria si nënë, si edhe jashtë bashkësisë lokale: ajo bëhet më aktive në hapësirë dhe në shoqëri dhe krijon qëndrime krejt të ndryshme ndaj martesës e kohës së fillimit të saj, pastaj ndaj shtatzanisë, lindjes, familjes, jetës dhe vdekjes. Mbi këtë bazë krijohen premisa objektive për një ndërgjegje të re dhe motive të reja për planifikimin e familjes, për pranimin e kontrollit të lindjeve si «stil» i jetës bashkëshortore dhe, në analizë të fundit, për një lindshmëri më të ulët, për një familje më të vogël dhe për pakësimin e rritjes së përgjithshme të popullsisë.

6 — Në përgjithësi nuk diskutohet që shoqëria në bazë të njohurive shkencore dhe përparimit të përgjithshëm, si dhe në mënyrë njerëzore e marksiste, shqyrton funksionimin dhe gjithë sistemin e qëndrimeve dhe të koncepteve që kanë të bëjnë me lindjen, jetën e vdekjen dhe sqaron rëndësinë e madhe të martesës dhe familjes, si qelizat bazë të lindjes dhe të ripërtëritjes së popullsisë, si dhe vlerat e drejta të jetës në përgjithësi. Por në këto përpjekje të shoqërisë duhet të respektohen edhe drejtimit kryesorë të lindjeve dhe të riprodhimit, si parime të përbashkëta, pavarësisht nga përkatësia rajonale, sociale, nacionale e fetare. Lindja, si moment kyç jo vetëm i zhvillimit demografik, por edhe i zhvillimit të përgjithshëm social-ekonomik, është një aspekt sa i rëndësishëm, aq edhe i ndjeshëm i jetës së njeriut, një aspekt që nuk du-

ron politizim, manipulim burokratik e detyrim. Në sulmet kundër çdo gjëje ekzistuese në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve nuk ka shpëtuar pa u prekur edhe kjo sferë kyç e jetës së njeriut. Ajo madje sot është bërë fusha kryesore e sulmit si nga organet lokale, mitingjet e rrugëve e deri në Federatë. Gruaja shqiptare quhet me përbuzje «makinë për lindje». Ky etiketim dëgjohej si në mitingjet e rrugëve, ashtu edhe në forumet politike, tribunat shkencore e organet e shtypit; në demonstratat e rrugëve të grave serbo-malazeze në vitin 1987 u dëgjua edhe parulla «shqiptarët shtohen gjithnjë e më shumë, por pjella e tyre është e prishur». Në shumë diskutime shihet qartë se problemi i lindshmërisë së popullsisë shqiptare nuk shtrohet thjesht për humanizimin e marrëdhënieve midis burrit e gruas, për ruajtjen e shëndetit të gruas dhe përmirësimin e cilësisë së riprodhimit e të jetës, por ajo që sundon në të gjitha këto është frika nga një bashkësi etnike, e cila nga rrethana jo rastësisht historike nuk është me origjinë jugosllave e sllave.

7 — Shqiptarofobia rritet në mënyrë ekspansive. Shqiptarët i numërojnë e i rinumërojnë çdo ditë në shtyp e publicistikë, në diskutimet e individëve, në forumet shtetërore e politike dhe në mbledhje të ndryshme bëhen hipoteza se sa do të jetë numri i shqiptarëve pas 20, 50 e 100 vjetëve, se si ata do të pushtojnë hapësirat serbe e jugosllave, se si numri i tyre dhe shtimi në të ardhmen do të kërcënojnë prosperitetin demografik, politik e nacional të serbëve, maqedonasve, malazezëve e të Jugosllavisë, por edhe të Ballkanit, pasi «shqiptarët në vitin 2030 do të përbëjnë popullin më të madh në Ballkan, prandaj ky është edhe problemi ynë strategjik» (S. Dolanc, 1988). Fli-tet për «bombën në pelena», për «ekspansionin biologjik» e për «shpërthimin demografik» të shqiptarëve. Ky është fjalor i qarqeve konservatore dhe me ideologji neokolonialiste, që është përdorur pas Luftës së Dytë Botërore për vendet dhe popujt në zhvillim. Me këtë fjalor kanë folur dhe flasin për shqiptarët Cvijiç, Çubrilloviç, Çosiç, Iviç, Macura e emra të tjerë të njohur në shkencën dhe kulturën serbe. Sot është e qartë se kjo është gjuha dhe qëndrimi i strukturave politike të vendit. Fëmijët e lindur e të palindur të kombësisë shqiptare shpallen armiq, dhe

për këtë komentet janë të tepërta. Gjithçka tjetër që lidhet me jetën dhe zhvillimin e shqiptarëve dhe me aspiratën për emancipim kombëtar e kulturor shihet si rrezik për popujt e kulturat e tjera. Me përpjekje të tilla nuk bëhet tjetër veçse rritet te shqiptarët ndjenja e të qenit i huaj në shoqërinë jugosllave dhe presioni për largimin sa më shumë të tyre nga kategoria e qytetarëve të barabartë të RSFJ-së.

8 — Meqenëse koha, me sa duket, e ndërpreu përfundimisht mundësinë për shpërngulje masive të shqiptarëve në Turqi, gjë që zgjati gjatë gjithë dekadave të para të shekullit të 20-të, si kërkesë kryesore sot shtrohet pakësimi radikal i lindshmërisë dhe i rritjes demografike të tyre. Për këtë pakësim propozohen masa shtetëro-administrative e antisociale, si ato në Maqedoni, e cila është bërë poligon prove për kufizimin e perspektivës së përgjithshme të zhvillimit dhe të civilizimit të shqiptarëve. Mbështetet politika njënacionale e popullimit: për shqiptarët kundër lindjeve, për serbët e maqedonasit shtimi i lindjeve në të njëjtin territor dhe nën të njëjtën kushtetutë, kurse në Kosovë politika e imigrimit të serbëve dhe malazezëve dhe ajo e emigrimit për shqiptarët. Një politikë e tillë përpíqet edhe të mbyhtë dëshirën e prindërve për një numër të caktuar trashëgimtarësh dhe në këtë mënyrë të realizohet ai presion mbi natyrën dhe ndjenjat e njeriut dhe mbi arsyetimin e tij, ashtu siç veprohet sot në Kinë apo më parë në Indi etj. Manipulimi me popullsinë femër dhe llogaritë prapa shpinës së tyre janë të qarta: shqiptarëve u rekomandohet dhe u jepet «urdhër» të mos lindin më shumë se dy a tri fëmijë, pasi prishen përpjesëtimet nacionale dhe vjen varfëria, kurse nga serbet, maqedonaset etj. kërkohet që të lindin shumë fëmijë, pasi kjo është në interes të çështjes kombëtare e politike. Është interesante se për hungarezët, vllahët etj., te të cilët vihet re një regres i madh demografik, nuk thuhet asnjë fjalë!

9 — Përsëritet vazhdimisht teza se nëpërmjet lindjeve të fëmijëve shqiptarët shfrytëzojnë zonat e kombësive e tjera të vendit. Bëhen përpjekje që opinionit publik t'i imponohet bindja se përparimi i Kosovës nuk është i mundur pa pakësimin e lindshmërisë së shqiptarëve, duke mohuar në këtë mënyrë qëllimet e vërteta të pakë-

simit të tij dhe se shoqëria, si kusht për investimet në zhvillimin e kësaj krahine, duhet të shtrojë problemin e pakësimit të normës së lindjeve. Disa autorë nga radhët e shkruesve të «memorandumeve» madje kanë llogaritur se rreth 90 për qind të prapambetjes së vet Kosova e pas-ka gjoja nga shtimi natyror i popullsisë (K. Mihajloviç, 1987).

10 — Sot, në vargun e shpifjeve dhe të gënjeshtreve të këtyre 150-200 vjetëve të fundit, dëgjohej teza se shqiptarët lindin për qëllime nacionaliste, vetëm e vetëm që të dëbojnë serbët nga vatrat e tyre dhe të krijojnë një «Kosovë etnikisht të pastër» dhe «Shqipërinë e Madhe», parulla këto që nuk u dëgjuan nëpër demonstrata dhe për të cilat asnjë nga qindra e qindra mijë të burgosur nuk është dënuar. Një nga këto konstruksionet është edhe vlerësimi: «Ne e njohim shumë mirë një nga parullat kryesore të irredentizmit: bli tokë dhe lind fëmijë» (S. Dolanc, 1988). Nuk është e mundur që ky politikan i Federatës nuk ka dijeni për raportin e organeve të Punëve të Brendshme të Krahinës, të cilin e ka miratuar edhe Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, ku thuhet se «të gjitha të dhënat e deritanishme operative nuk vërtetojnë që mjetet materiale për blerjen e pronave të serbëve dhe të malazezëve të jenë siguruar nga irredentizmi, organizatat e emigrantëve apo nga ndonjë tjetër në botën e jashtme» (Prishtinë, 1987). Sllogani i viteve 80-të është ky: armiq të serbëve dhe të Jugosllavisë janë shtresat më të arsimuara të shqiptarëve, ndërsa të ndershëm janë vetëm fshatarët dhe analfabetët e kësaj kombësie. Si është e mundur atëherë që norma e lindjeve është disa herë më e ulët se shtresat e intelektualëve dhe të shqiptarëve të tjerë në gjendje të mirë materiale, në krahasim me shtresat e fshatarësisë e të të paarsimuarve dhe në gjendje të keqe sociale të kësaj kombësie? Nga ana tjetër, të kërkosh ideologjinë të fshatarët e paarsimuar dhe të gratë analfabete e të varura ekonomikisht është vërtet një gjë absurde. Lindja si akt dhe lindja në tërësi si proces nuk është quajtur si nacionaliste, nga *homo sapiens* e deri më sot.

11 — Iniciatorët e këtij diskutimi politikën populluese në kuptimin e mësipërm dhe planifikimin e familjes e

kuptojnë si reduktim të lindshmërisë, por, me aq sa dimë ne, duket se edhe aktorët e riprodhimit si të tilla i marrin. Por, në fakt, qëllimi i planifikimit të familjes nuk nënkupton sasinë apo përpjekjen për një numër më të vogël apo më të madh fëmijësh, por cilësinë e riprodhimit biosocial dhe përpjekjen që individët, çiftet, familjet e popullsisë të kontrollojnë edhe riprodhimin e tyre (D. Breznik 1976; V. Tomshić, 1975). Një trajtim i tillë i planifikimit të familjes në aspektin shkencor dhe humanitar, por, nisur edhe nga interesi më i gjerë shoqëror, konsiderohet si qëllim i pranueshëm e i dëshirueshëm. Pra, thelbi i konceptit shkencor dhe i konceptit tonë shoqëror (Rezoluta për planifikimin e familjes e vitit 1969, Kushtetuta e vitit 1974) është familja e lirë, e ndërgjegjshme dhe e përgjegjshme.

12 — Këmbëngulja për kufizimin e lindjeve me ilaçe, aborte dhe sterilizime, me qëllim që të pakësohet shtimi i popullsisë e në këtë mënyrë të zgjidhen problemet ekonomike e sociale, është një pikëpamje neomaltuziane, kundër së cilës shoqëria jugosllave ka luftuar me këmbëngulje gjatë 30 vjetëve të fundit edhe në arenën ndërkombëtare. Por kjo pikëpamje sundon sot, për fat të keq, kur është fjala për Kosovën dhe shqiptarët. Po ç'mund të thuhet për pretendimet e tepruara të sllavëve të jugut se lindshmëria e shqiptarëve duhet të ulet për t'u rregulluar struktura nacionale e popullsisë në favor të serbëve, maqedonasve, malazezëve, apo thënia se në Kosovë nuk ia vlen të investohet pa praninë e serbëve etj.?

13 — Riprodhimi dhe zhvillimi i popullsisë janë procese shoqëro-historike dhe «mënyrave të ndryshme të prodhimit shoqëror u përgjigjen mënyra të ndryshme të riprodhimit të popullsisë» (A. Wertemer, 1986). Kosova është në Evropë, kurse shqiptarët e Jugosllavisë janë pjesa më e pazhvilluar e popullsisë evropiane, prandaj problemi i pakësimit të lindshmërisë së tyre mund të zgjidhet vetëm në rrugët, në të cilat ka ecur Evropa dhe zonat e zhvilluara të Jugosllavisë në këta 100 vjetët e fundit. Kërkesat për zbatimin e masave të tipit indian e kinéz me elementet e dhunës për uljen e lindshmërisë janë të pazbatueshme në një shoqëri evropiane, socialiste. Të gjitha vendet e popujt e kontinentit tonë e kanë pranuar kontrollin e lindjeve në martesë dhe e kanë pakësuar

normën e lindshmërisë si dhe madhësinë e familjeve jo me masat e presionit social e politik ndaj individëve dhe çifteve, por me zhvillim e, në radhë të parë, me emancipimin social e kulturor të gruas. Serbia e Jugosllavia, në vend që t'i shohin me sy kritik lëshimet e gabimet për zhvillimin e vonuar e të tërthortë të shqiptarëve (numri i të cilëve sot arrin në rreth 2.050.000), sidomos në dy dhjetëvjeçarët e parë pas Luftës, sot bëjnë fajtorë këtë kombësi për lindshmërinë e lartë.

14 — Vetëdijen riprodhuese në kuptimin e ripërtëritjes racionale të popullsisë e përcakton baza materiale, si dhe standarti i përmirësuar social, urban, arsimor, shëndetësor dhe i infrastrukturës. Është e sigurtë se autorët e riprodhimit do të pranonin menjëherë idetë dhe mjetet që do të ofrojë shoqëria krahas ndryshimeve të tilla. Pa kushte dhe premisa të tilla, siç tregon përvoja e popullsisë që e ka kapërcyer momentin kalimtar demografik, nuk mund të pranohet, të zbatohet dhe të përhapet i ashtuquajtimi kontroll i lindjeve në martesë. Përsa i përket efektit në disa pjesë dhe në tërësinë e popullsisë, gjithnjë duhet pasur parasysh karakteri i ndërlikuar dhe afatgjatë i proceseve demografike, sidomos i lindshmërisë dhe i strukturës së moshave të popullsisë.

15 — Në historinë e demografisë deri më sot nuk është parë ndonjëherë që ndërhyrja e shtetit në procesin e lindjeve të japë rezultat pa sjellë pasoja në vullnetin dhe arsyen njerëzore. Manipulimi i detyruar dhe burokratik i shoqërisë nëpërmjet motivimit të dyshimtë, presioneve, theksimit vetëm të efekteve negative të lindshmërisë së lartë dhe politizimit të tij, si dhe nëpërmjet mohimit të së drejtës për të vendosur lirisht lidhur me numrin e trashëgimtarëve dhe kohës midis lindjeve si një e drejtë themelore njerëzore që e garanton edhe kushtetuta jonë, mund të shkaktojë tek autorët e riprodhimit jo vetëm qëndrim të kundërt, por edhe konflikte afatgjata ndërnacionale në zonat me popullsi të përzier dhe me implikime të pallogaritshme shoqëroro-politike. Ato subjekte të shoqërisë që shprehen për zgjidhjen e problemeve sociale e nacionale në Kosovë, Maqedoni etj., nëpërmjet së ashtuquajturës rrugë demografike, me sa duket, nuk janë fare të ndërgjegjshme për këtë fakt.

II

1 — Migracionet e popullsisë në botën moderne praktikisht janë bërë një proces i pandalshëm i një evolucioni sasior e cilësor të popullsisë në kushtet e dallimeve të theksuara ekonomike, social-profesionale dhe demografike, si midis rajoneve dhe shteteve, ashtu edhe brenda vetë këtyre vendeve. Migracionet sot përbëjnë një problem të shumanshëm: hapësinor, demografik, ekonomik, social, politik etj. dhe nxiten nga faktorë të ndërlikuar që shpesh janë të lidhur midis tyre. Migrimet janë bërë një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm i metamorfozës së lëvizjeve, të përbërjes dhe mënyrës së jetesës së popullsisë.

2 — Në periudhën e pasluftës migracionet e popullsisë janë shumë intensive dhe masive në të gjitha republikat, krahinat, rajonet, komunat dhe fshatrat e Jugosllavisë, duke përfshirë të gjitha shtresat e shoqërisë dhe pjesëtarët e të gjitha kombësive. Një nga format masive të lëvizjes së popullsisë brendapërbrenda territorit të një republike apo krahine në këtë periudhë janë migrimet nga të gjitha tipet e vendbanimeve, sidomos nga fshatrat në drejtim të qendrave të republikave dhe krahinave dhe në qytete të tjera të mëdha apo të mesme. Këtë e kanë nxitur, nga njëra anë, kushtet e kufizuara jetësore dhe të infrastrukturës, dhe, para së gjithash, mbipopullimi agrar i zonave bujqësoro-blegtorale, si rrethanë që nxit largimin, ndërsa, nga ana tjetër, procesi i industrializimit të fuqishëm të disa zonave, zhvillimi i qyteteve, i arsimit, komunikacionit etj. si faktor tërheqës. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 numri i atyre që kanë ndërruar vendlindjen arrin në 9.184.451 banorë, që do të thotë 41 për qind e popullsisë së përgjithshme të vendit. Zonat e pazhvilluara janë pothuaj gjithnjë të parat që braktisen, ndërsa ato të zhvilluara shtohen vazhdimisht me të ardhur. Disa drejtime të lëvizjes tashmë janë bërë tradicionale.

3 — Edhe shpërnguljet midis republikave, republikë-krahinë dhe midis krahinave janë gjithnjë intensive dhe kapin 1.760.333 banorë (1981), kryesisht të atyre bashkësive që janë larg «territoreve mëmë», (Tabela 1).

Popullsia e çdo kombësie, duke kapërcyer kuadrin republikan e krahinor, është e orientuar pothuaj gjithnjë drejt zonave që janë më afër nga ana hapësinore, megjithëse më larg popullsisë mëmë dhe ku gjuha, feja, zakonet, kultura dhe tipare të tjera etnike janë të njëjta ose të ngjashme, sidomos në qoftë se zona e imigracionit ofron më shumë nga pikëpamja materiale, sociale e kulturore. Studimet e deritanishme kanë vërtetuar edhe faktin se popullsia e së njëjtës kombësi nga pikëpamja hapësinore dhe sociale është më e lëvizshme, në qoftë se është vendosur në një zonë të zhvilluar, dhe më pak e lëvizshme, në qoftë se jeton në një zonë të pazhvilluar.

4 — Rajonet e zhvilluara dhe qendrat e mëdha urbane janë bërë shumë tërheqëse dhe rrezja tërheqëse e tyre arrin deri në 400 km, siç është rasti me Beogradin, Zagrebin, Sarajevën, Novi-Sadin, Prishtinën etj. Në largësi më të mëdha, në shumicën e rasteve lëvizin si rregull ato kombësi që kanë edhe një traditë më të gjatë urbane. Kështu krijohen bërthamat dhe zonat e përqendrimeve nacionale. Serbët nga të gjitha zonat e, para së gjithash, nga Bosnja-Hercegovina, Kroacia e Kosova, shkojnë drejt Serbisë e Beogradit, Vojvodinës e Novi-Sadit; kroatët e Bosnjë-Hercegovinës e të Serbisë drejt Kroacisë e Zagrebit; myslimanët e Serbisë, të Malit të Zi, Kosovës e Maqedonisë drejt Bosnjë-Hercegovinës e Sarajevës; ndërsa shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi dhe Jugut të Serbisë drejt Kosovës e Prishtinës. Për pjesëtarët e pakicës nacionale të vendosur në zonën e kombësisë që përbën shumicën, si p.sh. shqiptarët në Beograd, Lubjanë, Sarajevë, Zagreb etj, myslimanët etj, në qytetet sllovene, në mënyrë që të mos asimilohen e të zhduken nga mjediset me gjuhë, kulturë dhe zhvillim social të ndryshëm, duhet menduar hapja e shkollave në gjuhën amtare, si dhe duhen bërë përpjekje për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar etj.

5 — Bosnjë-Hercegovina është zona më e madhe emigruese në Jugosllavi, bilanci negativ i së cilës në migracion, në krahasim me republikat dhe krahinat e tjera, sipas regjistrimit të vitit 1981, ishte 397.272 banorë. Saldo negative migruese e ka me zonat e zhvilluara: me Kroacinë (182.346 veta), Vojvodinën (125.910), me Serbi-

në pa krahinat (72.971) dhe Slloveninë (28.200), (Tabela Nr. 2). Ndërsa zona më e madhe imigruese në vend është Serbia pa krahinat. Për këtë arsye, si dhe për temën që po flasim, kjo pjesë e vendit meriton më shumë vëmendje. Sipas regjistrimit të vitit 1981 në këtë zonë u vendosën 637.399 banorë të ardhur nga republikat e krahinat e tjera, si dhe nga bota e jashtme, kuptohet, në të gjitha periudhat. Më tepër kanë ardhur nga Vojvodina — 144.075 ose 22.6 për qind e numrit të përgjithshëm të të ardhurve, pastaj nga Bosnjë-Hercegovina — 111.828 ose 17.5 për qind, Kroacia — 110.704 ose 17.3 për qind, Kosova — 110.675 ose 17.3 për qind, Maqedonia — 50.011 ose 7.8 për qind, Mali i Zi — 42.755 ose 6.7 për qind, nga bota e jashtme — 24.299 ose 3,8 për qind dhe që nuk dihen — 30.066 ose 4,7 për qind. Përsa i përket kohës së ardhjeve, imigracionet më të mëdha në Serbi janë shënuar pas viteve 60-të. Në periudhën 1961-1981 aty janë vendosur 363.239 banorë ose 56.8 për qind e numrit të përgjithshëm të të ardhurve; vetëm në periudhën 1976-1981 kanë imigruar 101.502 veta ose 15.9 për qind e numrit të përgjithshëm të të ardhurve. Nga Kosova në Serbi kanë ardhur më shumë gjithashtu prej vitit 1961: në periudhën 1961-1970 — 34.227 veta, 1971-1975 — 22.792 dhe 1976-1981 — 28.617 banorë, ndërsa për migracionet pas vitit 1981 do të flasim më vonë.

6 — Më tërheqës ka qenë dhe mbetet rajoni i Beogradit, i cili nga numri i përgjithshëm i të ardhurve në Serbi, pa krahinat, ka thithur 404.394 banorë nga republikat e tjera e krahinat, që do të thotë 63,4 për qind të numrit të përgjithshëm të të ardhurve në këtë republikë. Më tepër kanë ardhur nga Vojvodina (104.046 veta), Kroacia, (90.517), Bosnjë-Hercegovina (75.191), pastaj Kosova (41.955), Maqedonia (27.260), Mali i Zi (23.965), Sllovenia (8.502), nga bota e jashtme (16.620) dhe që nuk dihet nga kanë ardhur (16.298 veta). Në këtë rajon nga Kroacia janë vendosur — 81,7% e kroatëve të ardhur në Serbi, nga Vojvodina — 72,2%, Bosnjë-Hercegovina — 67,2 për qind, Sllovenia — 65,9 për qind, Mali i Zi — 56,0 për qind, Maqedonia 54,5 për qind, Kosova 37,9 për qind (si dhe 16,3 në rajonin e Shumadisë dhe Pomoravljes, 15,3 për qind në rajonin e Kraljevost, 9,8 për qind në rajonin

e Podunaves, 9.5 për qind në rajonin e Nishit etj.), nga jashtë 68,3 për qind dhe që nuk dihet — 54,2 për qind.

7 — Edhe më intensive janë migracionet brendapërbrenda vetë Serbisë, ku numri i popullsisë që ka ndërruar vendbanimin, sipas regjistrimit të vitit 1981, arrin në 1.753.116 ose pothuaj 1/3 e popullsisë së Serbisë (nga një vend i komunës në tjetrin 819.335 dhe nga njëra komunë e Serbisë në tjetrën 1.943.781). Lindi problemi dramatik i braktisjes së fshatit (nga viti 1953-1981 bilanci demografik është — 578.200 fshatarë) dhe i ekonomive agrare (nga viti 1953-1981 popullsia që merrej me bujqësinë është pakësuar me 687.000 banorë), dhe i ashtuquajtur i rrënim demografik i fshatit serb-çpopullimi, mplakja, prishja e strukturave kryesore demografike dhe në një të ardhme jo të largët edhe vdekja e jetës në një numër të rëndësishëm vendbanimesh rurale. Degrarizimi shpërngulli riprodhimin biologjik, por edhe social-ekonomik nga fshati në qytet. Në fshatrat e zonave kodrinore-malore po ndodh një numër i madh ndryshimesh sociale, ndryshime brenda familjes me pasoja negative shumë të mëdha. Në popullsinë fshatare të Serbisë ka rënë forca vitale: lindshmëria është ulur nga 27.2 për mijë në vitin 1953 në 5,8 për mijë në vitin 1981, vdekshmëria e përgjithshme është rritur nga 12.3 në 16.2 për mijë, ndërsa shtimi natyror ka rënë nga 14.4 në vitin 1953 në 10.4 për mijë në vitin 1981 (S. Livada, 1988). Një tendencë e tillë negative e riprodhimit të popullsisë, që është e pamundur të rehabilitohet, është karakteristike jo vetëm për Serbinë, por edhe për Kroacinë, Slloveninë, Vojvodinën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Nga ana tjetër, kemi edhe përqendrimin e tepërt dhe të pakontrolluar të popullsisë nëpër qytetet, ku lindin probleme të mëdha në të gjithë sektorët e urbanizimit, ato funksionale, demografike dhe hapësinore. Urbanizimi si mënyrë jetese nuk ka përfshirë njëlloj të gjitha pjesët e qyteteve të vendit tonë, gjë që do të thotë se në anën cilësore të këtij procesi nuk bëjnë pjesë njëlloj të gjitha strukturat sociale, ndërsa në qytetet me kombësi të përziera edhe të gjitha nacionalitetet. E gjithë kjo tregon se si në Serbi, por jo vetëm aty, për një kohë të gjatë është ndjekur një politikë e gabuar në planifikimin rajonal, territorial dhe urbanistik.

8 — Nga fillimi i viteve 80-të problemet demokratike të kombeve dhe të kombësive, sidomos problemi i shpërnguljeve, janë bërë shumë të ndieshme në aspektin shoqëror e politik. Migracionet janë bërë një fushë delikate dhe fakt politik pikërisht për shkak se ekziston frika se me kalimin e kufijve republikanë e krahinorë do të ndryshojnë marrëdhëniet në strukturën e popullsisë. Nga një anë, në disa zona kemi homogjenizimin e përbërjes nacionale nëpërmjet komponentit migrues, ndërsa, nga ana tjetër, kemi heterogjenizimin e disa zonave gjithashtu si pasojë e shpërnguljeve, që bëhet për shkak të zënies me punë, shkollimit, lidhjeve martesore etj. Serbisë i intereson më tepër aspekti territorial politik i kësaj çështjeje. Ajo shikon rrezikun nga homogjenizimi nacional i Kosovës (77.4 për qind shqiptarë në vitin 1981), me rritjen e popullsisë shqiptare dhe largimin e serbëve nga kjo krahinë, por ka frikë edhe nga rënia e numrit të serbëve në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, krahinën e Sanxhakut, në Serbinë e Jugut etj. Mbi këtë bazë arriti t'i imponojë Jugosllavisë tezat për krijimin e «Kosovës etnikisht të pastër», «të shqiptarizimit të Kosovës», «të një Shqipërie të dytë në Serbi», «të Shqipërisë së Madhe» etj., gjoja si ide të hershme që nga Lidhja e Prizrenit (1878) dhe Konferenca e Bujanit (1944).

9 — Maqedonia duket sikur sheh një rrezik edhe më të madh nga numri i shqiptarëve (377.726 ose 19.8 për qind të popullsisë së përgjithshme të republikës në vitin 1981, ndërsa në pjesëmarrjen në ekonomi shqiptarët zënë vetëm 6,7 për qind), dhe në 8 vitet e fundit, gjoja për shkak të nacionalizmit agresiv shqiptar, e vë theksin në problemin e lindshmërisë së shqiptarëve dhe shpërnguljen e tyre «të madhe» nga Kosova për në territorin e saj, kështu që ka ndaluar rreptësisht ardhjen e shqiptarëve, ndërsa kundër popullsisë së atjeshme shqiptare merr një sërë masash kufizuese në fushën e arsimit, të përdorimit publik të gjuhës amtare, të zënies me punë, të lindjes së fëmijëve etj. Çdo kërkesë elementare njerëzore e kush-tetuese e shqiptarëve cilësohet si kundërrevolucion. «Dyndja» e shqiptarëve nga Kosova në Maqedoni është trilluar me shkathtësi si sulm i Kosovës dhe i shqiptarëve ndaj kësaj republike. Politika zyrtare e Maqedonisë këtë

«valë migrimi» dhe lindshmërinë e lartë të shqiptarëve e interpreton si qëllim gjoja të kësaj kombësie të sintetizuar në idenë për krijimin e «një Kosove të dytë në Maqedoni», «të një Shqipërie të dytë në Maqedoni» dhe «të Shqipërisë së Madhe». Pas vitit 1981 është përsëritur vazhdimisht teza se vetëm në komunën e Tetovës nga Kosova vitet e fundit kanë ardhur mbi 15.000 shqiptarë. Por, sipas regjistrimit të vitit 1981, në gjithë territorin e kësaj republike nga Kosova janë vendosur 21.245 vetë gjatë të gjitha periudhave. Shpërngulja më e madhe është vënë re në periudhën 1946-1970, ndërsa nga 1.6.1983 deri më 31.12.1987, sipas të dhënave zyrtare, nga Kosova kanë shkuar në Maqedoni gjithsej 1.043 veta. Maqedonia ka qenë tërheqëse për shqiptarët në vitet 50-të e 60-të, kur vazhdonte shpërngulja intensive për në Turqi, ndërsa kjo republikë, përkatësisht kryeqyteti i saj, Shkupi, ishte stacion kalimtar. Aty bëhej ndërrimi i kombësisë në turq, merreshin pasaportat dhe vizat, e, për këtë qëllim organet kompetente punonin edhe natën. Në një kohë kur përpjekjet për reduktimin e të drejtave elementare të njeriut e ato kushtetuese të shqiptarëve në Maqedoni rriten në mënyrë ekspansive, kjo republikë nuk mund të presë, por vetëm përcjell. Dhe shpërnguljet kryhen në mënyrë intensive për në SHBA, Turqi, Australi e Kosovë. Qëllimi i këtij presioni është pikërisht që të largojë popullsinë shqiptare nga kjo republikë.

10 — Çdo shtrirje demografike e shqiptarëve drejt Serbisë jugore, Maqedonisë së mesme dhe drejt Titogradit shpjegohet si «shtrirje e hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe» (S. Shuvar, 1981). Nga ana tjetër, shqiptarët akuzohen vazhdimisht se po futen vetë në geto etnike, kulturore e sociale. Pas viteve 80-të shqiptarëve u është ndaluar rreptësisht vendosja në fshatra serbe apo të përziera serbo-shqiptare në Kosovë. Me këmbënguljen e kryetarit të shtetit serb I. Stamboliçit në fshatin Batusim pranë Prishtinës, pas rrënimit të shtëpisë përpara kamerave televizive, një familje shqiptare prej 10 anëtarësh u dëbua, ndërsa me këmbënguljen e kryetarit të organizatës së partisë të Beogradit, D. Pavloviçit, në fabrikën e re të sapondërtuar në këtë fshat nuk u pranua asnjë shqiptar. Këto janë monumente të përhershme segregacioni që

kanë ngritur përfaqësuesit e qeverisë dhe të partisë serbe.

11 — Edhe Kosova është një zonë me imigracion dhe emigracion të theksuar. Për interpretimin dhe kuptimin e strukturës së popullimit të kësaj krahine e, sidomos, të disa pjesëve të saj, si dhe të disa formave të zhvillimeve të tanishme të migracionit të popullsisë, analiza duhet shtrirë doemos në një periudhë të gjatë kohore, të paktën për një periudhë prej 100 vjetësh, që nga luftërat serboturke 1876-1878 deri më sot. Kjo është periudha e ngulimeve të mëdha në Kosovë dhe e shpërnguljeve të mëdha nga territori i saj sipas përkatësisë nacionale e fetare, me shkaqe e pasoja specifike nacional-politike. Pas vitit 1878 me qëllim që të krijonte një shtet të pastër etnikisht qeveria serbe i dëboi të gjithë shqiptarët nga 504 fshatra dhe disa qytete të qarqeve Nish, Prokuplje dhe Vranjë, por emigroi edhe një numër serbësh nga Kosova për në Serbi. Këta migrantë, të njohur si muhaxhirë, vendoseshin në periferitë e fshatrave kosovare ose krijuan fshatra të reja.

12 — Periudha midis dy luftërave botërore shquhet për shtrirjen e kolonistëve nga radhët e popullsisë serbe të Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës, Likës, Dalmacisë etj. në kuadrin e reformës së njohur agrare, e cila nuk kishte për qëllim likuidimin e mbeturinave të marrëdhënieve feudale dhe zgjidhjen e problemeve sociale e ekonomike, por shpërnguljen masive të shqiptarëve në Turqi e Shqipëri, me qëllim që të krijonte një territor të pastër etnikisht, apo «serbizimin e Kosovës» (M. Obradović, 1981). Toka u merrej kryesisht shqiptarëve të varfër dhe mbi 200.000 ha u janë ndarë jo vetëm kolonëve, por edhe ekonomive të mëdha, shkollave bujqësore, kishave e manastireve, ushtrisë, xhandarëve, nëpunësve të komunave, çetnikëve, banditëve etj. U arrit kështu që nga gjithë Jugosllavia të shpërngulen rreth 240.000 shqiptarë (H. Bajrami, 1981) dhe të vendosen në Kosovë rreth 65.000 kolonë serbë. Por, qarqet sunduese nuk ishin të kënaqura me rezultatet e nguljes së serbëve dhe shpërnguljet e shqiptarëve, kështu që kërkuan që të dëbohen të gjithë shqiptarët me mjetet më brutale duke përfshirë edhe djegiet e fshatrave edhe të lagjeve të tyre në qytete, ashtu siç ve-proi Serbia me ta pas vitit 1878. Për këtë qëllim u an-

gazhuan një sërë institucionesh e individësh, por më tepër u shqua Klubi kulturor serb (1937) dhe Vasa Çubrilloviçi, i cili në vitin 1937 doli me elaboratin e njohur me titull «Shpërngulja e shqiptarëve», që shërbeu si bazë për përgatitjen e marrëveshjes për konventën midis qeverisë jugosllave e asaj turke, për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve nga Jugosllavia e vjetër. Por meqenëse rrethanat nuk ndihmuan që të ratifikohesh kjo konventë dhe të realizohesh shpërngulja e plotë e shqiptarëve, Çubrilloviçi, menjëherë pas çlirimit të Beogradit, më saktë më 3.11.1944, del me elaboratin tjetër, ku në një mënyrë edhe më fashistoide kërkon spastrimin e Jugosllavisë jo vetëm nga shqiptarët, por tani edhe nga të gjitha pakicat e tjera kombëtare jugosllave: gjermanët, hungarezët, italianët e rumunët, ideja për territore të pastra etnike, pra, është shumë e vjetër dhe buron nga qarqet kulturore politike të Serbisë. Por, Çubrilloviçi në Jugosllavinë e re do të emërohet ministër i shumë dikastereve, ndërsa më 1987, me rastin e 90-vjetorit të ditëlindjes, Kryesia e RSFJ-së (kryetar Sinan Hasani) e dekoron me Urdhrin e Yllit Jugosllav!

13 — Periudha pas Luftës së Dytë Botërore është karakteristike për migrimin e popullsisë brenda Kosovës, në drejtim të Kosovës e nga Kosova. Popullsia e krahinës, e mbërthyer për një kohë të gjatë pas shtëpisë, familjes dhe vendlindjes, pas viteve 60-të e 70-të, me shfaqjen e dallimeve rajonale në shkallën e zhvillimit, gjithnjë e më shumë u përfshi në lëvizjet hapësinore e sociale brenda-përbrenda territorit të saj. Sipas regjistrimit të vitit 1981, nga vendlindja ishin larguar 474.213 banorë ose 29.9 për qind e popullsisë së përgjithshme (Jugosllavia 41.0%, ndërsa Sllovenia 47.2 për qind), gjysmën e tyre e përbëjnë migracionet lokale (brenda komunës), 37.5 për qind migracioni kosovar midis komunave, 10.6 për qind nga republikat e tjera e Vojvodina dhe 0.7 për qind nga bota e jashtme (3.331 veta). Nga Shqipëria kanë ardhur 1.543 veta, prej të cilëve, sipas të dhënave të Sekretariatit të Punëve të Brendshme, sot ka 704 vetë. E dhëna se në krahinë ka 300.000 emigrantë shqiptarë, e cila ka dalë nga mitingjet e serbëve e të malazezëve dhe në forumet politike, është gënjeshtër 426 fish!

14 — Në procesin e lëvizjes së popullsisë brenda Kosovës mbizotëron migrimi fshat-qytet, gjë që shihet nga fakti se në një numër të madh fshatrash është pakësuar popullsia (410 fshatra në periudhën 1971-1981). ndërsa qytetet dhe qendrat e komunave shënojnë një rritje gjithnjë e më të madhe demografike (Përqindja e popullsisë në qendra me mbi 15.000 banorë u rrit nga 11.8 për qind në vitin 1948 në 24.7 për qind më 1981). Shkaqet e shpërnguljeve të brendshme qëndrojnë para së gjithash në mbi-popullimin agrar dhe në mungesën e sistemeve infrastrukturore e urbane të objekteve arsimoro-shoqërore. Intensive janë edhe migrimet fshat-fshat, ku popullsia braktis zonat kodrinore-malore dhe vendoset në fshatrat e zonave fushore dhe përreth qyteteve, me mundësi më të mira jetese. Në kuadrin e këtyre migrimeve më të rëndësishme janë migrimet martesore. Krahas shpërnguljeve masive rurale, intensive janë edhe shpërnguljet agrare me kalimin e popullsisë që merret me bujqësi në sektorë jobujqësorë, nëpërmjet ndërrimit të profesioneve, shkollimit të brezave të rinj, por edhe drejtpërdrejt, pa ndryshim të pozitës profesionale apo të arsimimit.

15 — Në vitet e para të pasluftës në Kosovë vijnë një numër i madh serbësh e malazezësh, si nga krahinat përreth, ashtu edhe nga ato të largëta të Serbisë e të Malit të Zi, si quadro, por edhe me familje. Kryesisht këta futen në punë në institucione shoqërore, administrative, kulturore, si në banka, administrata, tregti, shërbimet, ndërmarrje të ndryshme, organet e komunave, shtëpitë e kulturës, mjekësi etj. Përsa i përket nivelit arsimor ata kryesisht kishin mbaruar filloren ose të mesmen, ndërsa shumica e tyre fitoi kualifikimin e nevojshëm gjatë punës, nëpërmjet të ashtuquajturave skolla të natës e kurse të ndryshme. Imigrimi i popullsisë së këtyre kombësive është i njohur kryesisht si «kolonizimi» i dytë i Kosovës.

16 — Deri në plenumin e 4-t të Brionit në vitin 1966 të paktë ishin ata jashtë Kosovës, Serbisë e Maqedonisë që dinin për shpërnguljet masive të shqiptarëve e të tjerëve për në Turqi si vazhdim i emigrimeve të paraluftës. Vlerësohet se nga gjithë Jugosllavia pas luftës në Turqi janë shpërngulur 246.108 vetë (P. Nushi, 1978). Kjo gjë

kryhej pa dijeninë e pjesëve të tjera të vendit e me gjerë, ndërsa motivet e shpërnguljeve ishin po ato të paraluftës, vetëm se ishin modifikuar dhe u ishin përshtatur kushteve të reja të rendit socialist. Kjo ishte pikërisht mishërimi i elaboratit të V. Çubrilloviçit të vitit 1944 me titull «Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re» dhe i planeve serbomëdha të përgatitura me kujdes. Si mjete të drejtpërdrejta presioni për dëbimin dhe shpërnguljen e shqiptarëve, krahas keqtrajttimeve të fshatarëve të pafajshëm dhe sidomos të inteligjencies së vogël në numër dhe të arsimitarëve (deri edhe në vdekje në shumë raste) ishin detyrimi për t'u deklaruar me kombësi turke, aksioni për grumbullimin e armëve me arsyetimin se shqiptarët gjoja po përgatiten për kryengritje të armatosur dhe për t'u bashkuar me Shqipërinë. Procesi i Prizrenit, inskenimi i organizatave të fshehta politike «irredentiste», reduktimi i së drejtës së përdorimit të gjuhës dhe simboleve kombëtare, mbyllja e Institutit Albanologjik dhe e shkollave në gjuhën shqipe, ngritja e flamurit shqiptar në ditën e festës kombëtare nga ana e organeve të sigurimit bëheshin me qëllim që të arrestonin njerëz të pafajshëm etj. Valët e shpërnguljeve në Turqi sikur u shuan para Plenumit të 4-t në vitin 1966 me «ndërhyrjen» e rrethanave ndërkombëtare dhe para së gjithash me protestat e emigracionit shqiptar në OKB. Programi i partisë që ishte përcaktuar në fund të viteve 50-të gjithashtu pati ndikimin e vet në përmirësimin e pozitës së kombësive, pra edhe në ndalimin e emigrimit të shqiptarëve e të tjerëve për në Turqi. «Në sy të botës, Jugosllavia socialiste nuk mund të luftonte më për një çështje tepër serbe, siç ishte ringjallja e Kosovës serbe» (Sh. Maliqi, 1986).

17 — Pas plenumit të 4-t të Brionit në vitin 1966 Kosovën filluan ta lënë serbët, malazezët, por edhe shqiptarët, myslimanët, etj. Njëkohësisht, sidomos pas viteve 70-të në këtë krahinë filluan të imigrojnë shqiptarë, myslimanë e të tjerë nga krahina të vendit, para së gjithash shqiptarët nga Maqedonia, jugu i Serbisë dhe Mali i Zi, pas hapjes së Universitetit në Prishtinë etj. Nuk është e vërtetë se serbët e malazezët filluan të lënë Kosovën pas amendamenteve kushtetuese të vitit 1968 dhe sidomos pas Kushtetutës së vitit 1974. Procesi i emigrimit filloi me-

njëherë pas plenumit të 4-t të Brionit. Pas këtij plenumi gjallërohet procesi i emancipimit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve dhe trajtimi i tyre i barabartë me serbët e malazezët në të gjitha fushat e jetës e të punës, kështu që jehona e këtij plenumi më tepër se kudo u ndie pozitivisht në Kosovë dhe te shqiptarët. Një pjesë e serbëve dhe e malazezëve, punonjës të aparatit shtetëror e politik dhe kuadro drejtues në ekonomi dhe sektorët shoqërorë, pjesërisht për shkak të pasigurisë si rezultat i deformimeve dhe padrejtësive që kishin bërë kundër qytetarëve dhe punonjësve shqiptarë, pjesërisht sepse nuk mund të duronin barazinë me shqiptarët, si dhe për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri para vitit 1966, filluan ta lënë Kosovën. Vlen të theksohet se një numër jo i vogël i popullsisë së ngulur të këtyre kombësive është me origjinë kolonizuese, të periudhave të kolonizimeve të paraluftës e të pasluftës. Nga ana tjetër, dallimet në shkallën e zhvillimit midis Kosovës dhe Serbisë e të zonave të tjera të vendit thellohen gjithnjë e më shumë, kështu që, duke mos pasur mundësi të gjejnë punë në Kosovë, njerëzit shkojnë në rajonet e zhvilluara të Serbisë, të Sllovenisë etj. Por, edhe migrimet për arsye familjare, individuale etj. janë një dukuri e zakonshme të të gjithë, pavarësisht nga kombësia e feja. Së treti, përveç Beogradit e qyteteve të tjera të mëdha Serbia ka edhe disa qendra të tjera të rëndësishme ekonomike, urbane e kulturore në jug të republikës (Titovo Uzhice, Çaçak, Kraljevo, Krushevac, Aleksinac, Prokuplje, Kurshumlija, Leskovac, Vranje etj.) Duke pasur parasysh afërsinë e tyre, por edhe në kuadrin e migrimeve intensive fshat-qytet, popullsia serbe e Kosovës, kur vendos të lëjë fshatin, vendoset drejtpërdrejt në këto qytete të Serbisë, ndërsa vetëm një pjesë e papërfillshme vendoset në qytetet kosovare. Diçka e ngjashme ngjet edhe me shqiptarët, të cilët duke braktisur fshatrat e Serbisë jugore, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi ngulen drejtpërsëdrejti në qytetet e mëdha kosovare, sidomos në Prishtinë. Fshatari-bujk serb që shpërngulet, duke shitur pronën me çmime shumë të larta në Kosovë, blen shtëpinë dhe mjediset e tjera përreth saj, mjetet e punës dhe tokën në zonat bujqësore (si rregull në rrethinat e qyteteve të Serbisë)

me çmime shumë të ulëta, në krahasim me ato të shitjes, kështu që kursejnë mjete të konsiderueshme. Serbët, që kanë një mënyrë më të gjatë të jetës urbane në Kosovë, si rregull ngulen në qendrat e mëdha urbane thellë në Serbi, para së gjithash në Beograd ose rrethinat e tij, pasi u ofrohen kushte shumë më të favorshme dhe më të mira jetese e pune.

18 — Shpërnguljen e serbëve dhe të malazezëve nga Kosova, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite, strukturat politike të Serbisë dhe të Jugosllavisë e shpjegojnë me «presionin» e shqiptarëve kundër tyre gjoja për të krijuar «Kosovën etnikisht të pastër» dhe për «shqiptarizimin e Kosovës». Dhe kjo nuk është e re. Kjo është thjesht llomotitje politike. Duke mos njohur prapaskenën politike të kësaj teze dhe karakterin e procesit të migrimit, udhëheqja e ngathët dhe e paarsimuar pranoi me lehtësi vlerësimin e Serbisë se deri sa të shpërngulet edhe një serb apo malez i vetëm, situata nuk duhet konsideruar stabël. Serbët largohen jo vetëm nga Kosova, por, siç e theksuam edhe më lart, largohen edhe nga të gjitha zonat e tjera të vendit drejt Serbisë e Vojvodinës dhe qendrave të tyre, prandaj shtrohet pyetja: ç'është ky irredentizëm që i detyron ata për një gjë të tillë?! «Mosbesimin ndaj shqiptarëve dhe deformimet në qëndrimet ndaj tyre, nacionalistët serbë i kanë shpjeguar përpara masave serbe e malazeze si mbrojtje të popullit serb e malazez në Kosovë e Metohi duke këmbëngulur për shtetësinë e tyre e detyrat për të ruajtur Kosovën nga shqiptarët. Në këtë linjë organet e sigurimit të shtetit migrimin ekonomik të serbëve nga Kosova e kanë shpjeguar si pasojë të presionit të shqiptarëve, të cilët në atë kohë faktikisht i ishin nënshtruar një presioni të fortë të këtyre organeve» (H. Hoxha, 1982). Gjendja faktike nuk përputhet me vlerësimin se serbët e malazezët largohen nga Kosova për shkak të presioneve të shqiptarëve. Fjalët «presion» dhe «diskriminim» sikur janë bërë tepër të buta, pasi kohët e fundit janë zëvendësuar me fjalët «terror», «genocid», «fashizëm», «shfarosje» etj. Këto fjalë të fjalorit të përditshëm politik janë me të vërtetë shumë të rënda. Ato fyejnë popullin shqiptar pasi përpiqen ta paraqesin atë si gjenetikiisht të prirur për vepra antisociale e krime, por,

për fat, ato thuhën pa pasur asnjë argument. Shqiptarët: tashmë janë shpallur fajtorë të përhershëm për gjithçka, një komb i dyshimtë në Jugosllavi, duke u shpikur edhe kategoria e «shqiptarëve të ndershëm».

19. — Nuk mund të qëndrojë kurrsesi pretendimi se serbët janë të diskriminuar në zënien me punë në sektorin shoqëror pas viteve 70-të, dhe sidomos duke filluar që nga futja në përdorim e dy gjuhëve për ato vende pune që e kërkojnë patjetër një gjë të tillë. Përkundrazi, në këtë periudhë e deri në ditët e sotme numri absolut i serbëve të zënë në punë në sektorin shoqëror është rritur vazhdimisht: në vitin 1970 — 32.739; 1980 — 45.183 dhe në vitin 1986 — 48.429, (1970-1986 shihet një rritje prej 47.9%). Shkalla e zënies me punë në vitin 1971 për serbët ka qënë 14.3%, për malazezët 22.7%, ndërsa për shqiptarët 5.8% dhe për turqit 5.0% (përqindja si krahinë 7.8%), ndërsa në vitin 1981 kjo përqindje është rritur për të gjithë, por shumë më tepër për malazezët (27.5) dhe për serbët (21.5), sesa për shqiptarët (9.3) dhe turqit (17.9), kundrejt mesatares së krahinës prej 11.1%. Gjendja dhe raporti i të zënëve me punë në sektorin shoqëror në vitin 1971 është si më poshtë: 1 në 4.3 malazezë, në 6.9 serbë, në 9.4 turq dhe në 16.7 shqiptarë (mesatarja e krahinës 1 në 12.6), ndërsa në vitin 1981 në këtë sektor në Kosovë raporti ka qënë 1 në 3.6 malazezë, në 4.5 serbë, në 5.5 turq, në 10.7 shqiptarë dhe 11.5 myslimanë (mesatarja për Kosovën — 8.9). Serbët dhe malazezët punojnë kryesisht në veprimtaritë shoqërore, në administrata, banka dhe llogari, në sigurimet shoqërore e shëndetësi, zyrat e punës, në personalet drejtuese, në tregti, shërbimet, transport, hotelet e në sektorë të tjerë dytësorë. Përqindja e tyre në këto fusha, kryesisht sektorë të tretë e të katërt, është shumë më e lartë se mesatarja e krahinës, ndërsa në sektorët parësorë (si bujqësi) dhe në punësimin jashtë shtetit kjo përqindje është më e ulët se mesatarja. Shqiptarët punojnë më tepër në sektorët parësorë me produktivitet të ulët e jashtë krahinës (në shtete të tjera e nëpër Jugosllavi), ndërsa në sektorët dytësorë e sidomos të tretë e të katërt përqindja e tyre është shumë më e ulët se mesatarja për Kosovën, megjithëse përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë.

20 — Serbët dhe malazezët bëjnë pjesë midis kombësive më të urbanizuara në Kosovë. Në vitin 1961 në qytete banonin 36.3% e malazezëve dhe 20.3% e serbëve, ndërsa në vitin 1981 këto përqindje rriten në 70.0% të malazezët dhe 38.1% të serbët. Shqiptarët kanë përqindjen më të ulët të urbanizimit në Krahinë: në vitin 1961 — 16.7% dhe më 1981 — 28.9% e tyre banonte në vendbanimet qytetare (mesatarja e krahinës 19.7% dhe 32.4%). Në dallim nga serbët dhe malazezët që jetojnë në qendrat e qyteteve dhe kryesisht në apartamente shtetërore, pra bëjnë një jetë urbane, shqiptarët janë të përqëndruar në periferitë e këtyre vendbanimeve dhe kryesisht në shtëpi private, shpesh pa elementet kryesore të sistemit urban, sipas mënyrës «fshatare» të jetës. Në kuadrin e urbanizimit të Prishtinës, për shembull, nga 8.075 apartamente gjithsej pronë shtetërore (1/3 e fondit të Krahinës), sipas regjistrimit të vitit 1981-3.334 ose 41% u përkisnin shqiptarëve (kundrejt 70.1% të tyre në popullsinë e qytetit), 3.055 ose 38% serbëve (15.6% të popullsisë së qytetit), 903 ose 11% malazezëve (3.8% të popullsisë), 271 ose 3% myslimanëve (2.3% të popullsisë), 129 ose 2% turqve (1.7% të popullsisë), 54 ose 1% ciganëve (4.7% të popullsisë), 89 ose 1% jugosllavëve (0.4% të popullsisë) dhe 237 ose 3% të ndryshmëve (kundrejt 1.4% të popullsisë së qytetit). Më tepër apartamente shtetërore kanë malazezët (84.7%), jugosllavët (82.7%), serbët (70.3%), myslimanët (60.5%), ndërsa më pak shqiptarët (26.9%) dhe turqit (35.9%) (Studimi sociologjik i qytetit të Prishtinës, Instituti Ekonomik, Prishtinë, 1986).

21 — Pas vitit 1981 në bazë të vendimit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Sekretariati Krahinor për Punët e Brendshme dhe enti krahinor i statistikave, nga 1 qershori i vitit 1983 ndjekin në mënyrë të organizuar të gjitha largimet e njerëzve nga Kosova në republikat e tjera dhe në Vojvodinë dhe të gjitha ardhjet nga republikat e tjera e Vojvodina. Evidenca është autentike. Të dhënat grumbullohen sipas shumë karakteristikave: përkatësia kombëtare, gjinia, moshja, veprimtaria, profesioni dhe marrëdhëniet në punë, arsimit dhe shkalla e arsimit profesional, arsyet e njoftimit dhe të lajmërimit për largim, komuna dhe

rajoni ku do të ngulen migrantët etj. Këto të dhëna është vështirë t'i mbledhësh edhe me të ashtuquajturat studime të thella anketore; vlera e tyre e madhe është në faktin se çdo individ pyetet pse migron. Duke qenë se i mbledh shteti, të dhënat janë për përdorim të brendshëm. Sipas këtyre të dhënave, nga gjysma e qershorit e vitit 1983 deri më 31 dhjetor 1987 nga Kosova janë larguar 34.251 veta dhe aty kanë ardhur 11.942 veta, që do të thotë se bilanci migrues është negativ me 23.309 banorë (Pasqyra sipas kombësive dhe vitet e largimit dhe të ardhjeve shihet në tabelat 3 e 4). Gjatë paraqitjes së këtyre të dhënave, sidomos për personat që janë shpërngulur nga Kosova, ka edhe shumë manipulime madje që nga forumet më të larta shtetërore e partiake. Në mbledhjen e kryesive të KQ të LKJ-së dhe të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës mbajtur më 12.10.1988 në Prishtinë, për shembull, kryetarja Kaqusha Jashari dha të dhënën e saktë se, që nga viti 1981 e deri më sot janë shpërngulur 25.661 serbë e malazezë, ndërsa po në këtë mbledhje sekretari i KQ të LK të Serbisë. Sokolloviç tha se gjatë së njëjtës periudhë nga Kosova janë larguar 31.000 serbë e malazezë. Mospërputhja arrin në 5.339 vetë!

22 — Evidenca autentike e të shpërngulurve dhe e të ardhurve zbulon motive krejt të tjera nga ato që japin politika e përditshme dhe mjetet e informacionit masiv. Në të vërtetë qytetarët e të gjitha kombësive deklarojnë se largohen në radhë të parë për arsye ekonomike, ku mbizotërojnë zënia me punë, ndërsa përqindja e këtij motivi në periudhën nga viti 1983 deri në vitin 1987 lëkundet nga 47.0% te serbët deri në 73.6% te shqiptarët; për arsye familjare përqindja e këtij motivi lëviz nga 23.5% te shqiptarët deri në 47.7% te serbët; ndërsa përqindja e shkollimit si arsye e largimit është shumë e ulët dhe lëkundet nga 0.6 % te ciganët e deri në 6.7 % te myslimanët. Për arsye të tjera, ku janë evidentuar presionet si motiv largimi nga Kosova, nga viti 1983 deri në vitin 1987 janë larguar gjithsejt 14 veta (11 serbë, 2 malazezë dhe një nga radhët e «të tjerëve»). Pasqyra e largimit të popullsisë nga Kosova në zona të tjera të vendit sipas motiveve të largimit shihet mjaft mirë nga tabela 5.

23 — Është interesante se edhe te të ardhurit në

Kosovë sundon motivi ekonomik dhe përçindja e tij lëkundet nga 57.2% te myslimanët e deri në 37.5% te ciganët, pastaj vijnë arsytet familjare, përçindja e të cilave lëviz nga 33.3% te «të tjerët» deri në 60.9% te ciganët, ndërsa arsyeja e shkollimit është më e lartë te shqiptarët (11.1 %) dhe më e ulëta te ciganët (1.3%). Është interesante të përmendet se në fletët e evidencave autentike të organeve që merren me njoftimin për largim të Sekretariatit të Punëve të Brendshme për personat që vijnë në Kosovë nga zona të tjera të vendit në përgjithësi nuk figuron fare kolona «arsye të tjera», domethënë, presioni, prandaj edhe nuk ka të dhëna dhe persona të evidentuar. Pasqyra e të ardhurave nga zonat e tjera në Kosovë, sipas arsyeve të ardhjes, shihet nga tabela Nr. 6.

24 — Nga një vështrim i motiveve të të shpërngulurve dhe të të ardhurve shihet se është fjala po për të njëjtat arsye të popullsisë e të gjitha kombësive. Fjala është për lëvizje lirisht të njerëzve për motive ekonomike, familjare, arsimore e personale, ndërsa grumbullimet për arsye nacionale në drejtim të territoreve mëmë, si një karakteristikë e përgjithshme në të gjithë vendin, duhet të studiohen. Për largimet, për shkak të psikozës së frikës dhe të ashtuquajturave motive të padukshme, të cilat, sigurisht, nuk mund të mohohen, gjithashtu duhen bërë studime më të thella sociologjike dhe të tjera. Përgjegjësisë për këtë, në kuadrin e zhvillimeve politike e shoqërore në Jugosllavi, nuk mund t'i shpëtojnë as burokracitë politike dhe liderët nacionalë.

25 — Është interesant fakti se të gjitha subjektet shoqërore e politike të Kosovës, Serbisë dhe Jugosllavisë janë të shqetësuar për shpërnguljet e serbëve dhe malazezëve nga Kosova, ndërsa largimi i të tjerëve, në radhë të parë i shqiptarëve, nuk i intereson kurkujt. Përsa i përket ardhjes në Kosovë, gjithë shoqëria është e shqetësuar gjithashtu vetëm për ardhjen e serbëve e malazezëve, duke miratuar edhe objektiva që dihen që më parë se janë të perealizueshme, ndërsa për motivet e ardhjeve të shqiptarëve nga zonat jashtë Kosovës asnjë nuk e vrät mendjen, ashtu sikurse nuk është dënuar me asnjë ditë burg qoftë edhe vetëm një në Serbi për keqtrajtim të shqiptarëve, të cilëve u shkatërrohen dyqanet (267 raste

gjatë periudhës 1984-1987) dhe u bojkotohen shërbimet. Asnjë nuk e shqetëson fakti se shqiptarët largohen nga Maqedonia përgjithnjë për në Turqi, nga Maqedonia e Mali i Zi për në SHBA dhe nga Kosova dhe pjesë të tjera të Jugosllavisë drejt vendeve më të zhvilluara të Evropës. Sipas të dhënave të Shoqatës për popujt e rrezikuar (Gesellschaft für bedrohte Völker) në Gëtingen gjatë këtyre 15 vjetëve të fundit, për arsye ekonomike e politike, kanë emigruar 250.000 shqiptarë duke lënë vatrat e tyre (100.000 në RFGJ, 60.000 në Zvicër, 40.000 në vende të tjera të Perëndimit dhe 50.000 në pjesët veriore të Jugosllavisë).

26 — Ardhja e serbëve dhe malazezëve në Kosovë stimulohet në shumë mënyra: që nga vendosja në vende pune të mira dhe me paga të larta deri në sigurimin e apartamenteve, të shesheve për ndërtim falas, të kredive afatgjata pa kamatë etj. Në kuadrin e të ashtuquajturit program jugosllav si ndihmë për Kosovën rekomandohet politika e ardhjes së «truve», ndërsa këto deri më sot janë policia dhe gjykatësit. Nga ana tjetër, përkrahet dhe zbatohet politika e futjes në punë e shqiptarëve si «skllëvër» në zonat e tjera të Jugosllavisë, në vende të tilla që i refuzojnë vendasit (njëlloj si jashtë shtetit) dhe ku paga është ulët, kërkojnë forcë më të madhe fizike dhe lënë gjurmë negative për një kohë të gjatë në kondicionin fizik dhe në jetën e tyre. Këto vende pune janë kryesisht në industrinë e rëndë, metalurgji, ndërtim, miniera, komunale (fshesaxhinj) etj. Në kuadrin e programit jugosllav hartohen programe konkrete zhvillimi për komunitat me popullsi të përzier, që do të thotë vetëm për serbët e malazezët. Për ta nga viti 1987 janë formuar edhe disa komuna (Zubin Potoku, Shtërpe dhe Shtimlje e po vazhdon ngritja e të tjerave), në të cilat janë ngritur menjëherë disa objekte industriale, ndërsa në komunën Malishevo, si e vetmja komunë e re ku zotërojnë shqiptarët, nga themelimi në vitin 1985 nuk është ngritur asnjë objekt industrial. Dhe kështu shtrihen monumentet e segregacionit me pasoja shumë të dëmshme ekonomike e politike.

27 — Për nxënësit serbë e malazezë, por dhe të kombësive turke formohen klasa edhe me 2-10 nxënës dhe numri i këtyre të ashtuquajturave mikroklasa arrin në rreth 500 gjithsejt, kurse në fakultetin e mjeksisë dhe de-

gë të tjera të parapëlqyera regjistrimi bëhet edhe mbi numrin e parashikuar dhe këta të «tepërt» pranohen edhe pa provim — konkurs. Nga viti 1988 ka filluar që fëmijët e kombësisë serbe e malazeze në shkollat fillore e të mesme të bëjnë mësim vetëm në turnin e parë (para dite), ndërsa fëmijët shqiptarë pas dite. Fëmijët dhe prindërit serbë vënë kushte ultimative se në qoftë se nxënësit shqiptarë nuk largohen nga shkollat e përbashkëta, do të largohen vetë nga Kosova dhe këto kërkesa u plotësohen: filloristët shqiptarë zhvillojnë mësimin në shtëpi private (rasti në Prilluzhja, komuna Vuçitern). Kërkojnë edhe ndryshimin e emrave të shkollave të përziera, të cilat mbajnë emra të luftëtarëve të njohur të Krahinës, të iluministëve dhe humanistëve shqiptarë. Gjithçka bëhet me këmbënguljen e udhëheqësve serbo-malazezë në Kosovë e jashtë saj, ndërsa burokracia karrieriste e komunës këtë e pranon menjëherë. Për të gjitha këto ndasi në opinionin jugosllav fajtorë bëhen shqiptarët.

28 — Në Kosovë dhe kundër shqiptarëve përdoren gjerësisht metodat e linçimit, për pasojat e të cilave askush nuk mendon, ashtu sikurse nuk ka as ndonjë politikë të urtë që të mendojë për pasojat që sjell fakti se më se 584.000 shqiptarë, nga viti 1981 e deri më sot kanë kaluar nëpër represionin policor (për ndjekje penale, kundërvajtje, arrestime etj.), domethënë mesatarisht çdo ditë janë arrestuar 200 shqiptarë, kryesisht të rinj deri në 25 vjeç. Këto shifra vlejnë vetëm për shqiptarët kosovarë, por sa janë arrestuar në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbinë e jugut, ende nuk dihet. Zbatimi i ligjeve është i ndryshëm për të njëjtat vepra penale: për shqiptarët sanksionet janë 10 herë më të rrepta (një shqiptar i mitur nga fshati Plementi për tentativë dhunimi të një serbeje të mitur u dënua me 10 vjet burg, ndërsa i rrituri serb nga Staro Selo për dhunimin e një të miturë shqiptare u dënua vetëm me 1 vit burg).

29 — Nëpërmjet parullës së pengimit të shpërnguljeve të serbëve dhe malazezëve, Serbia, por edhe shumë forume federative, duke e trajtuar Kosovën si zonë speciale, dëshirojnë të zgjidhin çdo gjë në dëm të interesave jetësore të shqiptarëve me nxjerrjen e ligjeve speciale (për gjuhën, flamurin, shitblerjen etj.), gjithnjë pa respektuar

TABELA — 1

Migrationet (të ardhur, të ikur) midis republikave dhe krahinave socialiste autonome sipas regjis-trimit të vitit 1981

Të ardhur: Të ikur:	RSFJ (gjithsejt)	B-H	Mali i Zi	Kroacia	Maqedonia	Slllovenia	Serbia e ngushtë	Kosova	Vojvodina
B-Hercegovina	538.602	—	9.480	228.843	4.896	33.530	111.828	5.015	145.010
Mali i Zi	105.490	19.822	—	9.416	3.678	2.211	42.755	13.021	14.587
Kroacia	291.809	46.497	5.477	—	4.513	48.745	110.704	2.094	73.779
Maqedonia	88.405	6.034	1.441	8.886	—	3.118	50.011	5.600	13.315
Slllovenia	57.570	5.330	728	33.176	1.314	—	12.988	474	3.560
Serbia pa krahinat —	291.070	38.857	14.021	40.675	36.681	16.236	—	22.668	121.932
Kosova	166.972	5.690	8.261	8.256	21.245	2.577	110.675	—	10.268
Vojvodina	220.415	19.100	5.703	39.483	4.921	5.488	144.075	1.645	—
RSFJ	1.760.333	141.330	45.111	368.735	77.248	111.905	583.036	50.517	382.451

(Burimi: Komunikata nr. 26, Zyra federative për statistikat, Beograd, 3.2.1984)

TABELA — 2

Bilanci i migracionit (+ ose -) të popullsisë midis republikave e krahinave socialiste autonome sipas regjistrimit të vitit 1981

Territori, për të cilin bën fjalë bilanci i migrimit	Diferenca							Vojvodina
	B-H	Mali i Zi	Kroacia	Maqedonia	Slllovenia	Serbia e ngushtë	Kosova	
B-Hercegovina	-397.272	+ 10.342	-182.346	+ 1.138	- 28.200	- 72.971	+ 675	-125.910
Mali i Zi	- 60.379	-	-	2.237	1.483	- 28.734	-	8.884
Kroacia	+ 76.926	+ 3.939	-	+ 4.373	- 15.569	- 70.029	+ 6.162	- 34.296
Maqedonia	- 11.157	+ 2.237	+ 3.939	-	- 1.804	- 13.330	+ 15.645	- 8.394
Slllovenia	+ 54.335	+ 1.483	+ 15.569	+ 1.804	-	-	- 2.103	+ 1.928
Serbia e ngushtë	+ 291.966	+ 28.200	- 70.029	+ 13.330	- 3.248	-	+ 88.007	+ 22.143
Kosova	-116.455	+ 4.760	+ 6.162	- 15.645	- 2.103	- 38.007	-	8.623
Vojvodina	-162.036	+ 8.884	+ 34.296	+ 8.394	- 1.928	- 22.143	+ 8.623	-

(Burimi: ai më sipër)

TABELA — 3

Numri i të shpërngulurve nga KSA e Kosovës në republikat e tjera dhe në Vojvodinë nga 1.6.1983 — 31.12.87, sipas kombësisë dhe viteve të shpërnguljeve.

Kombësia	1983		1984		1985		1986		1987		1983-1987	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
shqiptarë	1.313	24,6	2.145	26,1	1.870	25,6	1.983	26,6	1.852	30,9	9.163	26,7
serbë	2.453	45,9	3.873	44,7	3.386	45,7	3.187	42,7	2.272	38,0	14.921	43,5
malazezë	469	8,7	572	6,9	425	5,8	434	5,8	399	6,6	2.299	6,7
turq	57	1,0	44	0,5	14	0,1	16	0,2	16	0,2	147	0,4
myslimanë	313	5,8	641	7,8	701	9,6	724	9,7	632	10,5	3.011	8,7
ciganë	355	6,6	605	7,3	569	7,8	643	8,6	492	8,2	2.664	7,7
të tjerë	375	7,0	520	6,3	376	5,1	461	6,2	314	5,2	2.046	5,9
Gjithsej	5.335	100,0	8.200	100,0	7.291	100,0	7.448	100,0	5.977	100,0	34.251	100,0

(Burimi: Të ikurit dhe të ardhurit në Kosovë, Buletini 25, 50, 72 dhe 109, Zyra federative për statistikat, Prishtinë 1984-1988 (Për përdorim të brendshëm)).

TABELA — 4

Numri i të ardhurve në KSA të Kosovës nga republika të tjera dhe Vojvodina nga 1.6.1983 deri 31.12.1987, sipas kombësisë dhe viteve të vendosjes.

Kombësia	1983		1984		1985		1986		1987		1983-1987	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
shqiptarë	668	46,1	1.425	49,8	1.375	47,7	1.301	49,0	1.013	48,1	5.782	32,6
serbë	386	26,6	741	25,9	737	25,5	644	24,2	500	23,7	3.008	25,1
malazezë	120	8,2	135	4,7	112	3,8	83	3,1	74	3,5	524	4,3
turq	55	3,7	52	1,8	14	0,4	11	0,4	7	0,3	139	1,1
myslimanë	80	5,5	256	8,9	302	10,4	287	10,8	238	11,3	1.163	9,7
ciganë	53	3,6	117	4,0	141	4,8	143	5,3	144	6,8	598	5,0
të tjerë	86	5,9	132	4,6	198	6,8	185	6,9	127	6,0	728	7,9
Gjithsejt	1.448	100,0	2.858	100,0	2.879	100,0	2.654	100,0	2.103	100,0	11.942	100,0

(Burimi: ai më sipër)

TABELA — 5

Të shpërngulurit nga KSA e Kosovës për në republikat e tjera socialiste dhe në KSA të Vojvodinës nga 1.6.1983 deri më 31.12.1987, sipas kombësisë dhe motiveve të largimit.

Kombësia	Numri	Gjithsejt	Arsye ekonomike			Sh.kollimi			Familjare			Te tjera	Te tjera Presione
			Punësimi	Kushte me të mira materiale	Te tjera	Vete	Fëmijët	Vajtje te fëmijët	Martesa				
shqiptarë	numri	9.163	6.181	272	311	219	8	1.042	958	172	—	—	
	%	100,0	67,4	2,9	3,3	2,3	0,0	11,3	10,4	1,8	—	—	
serbë	numri	14.921	4.906	1.370	770	762	109	3.947	2.602	584	11	—	
	%	100,0	32,8	9,1	5,1	4,5	0,7	26,4	17,4	3,9	0,0	—	
malazezë	numri	2.299	803	210	173	131	15	584	260	221	2	—	
	%	100,0	34,9	9,1	7,5	5,6	0,6	25,4	11,3	9,6	0,0	—	
turq	numri	147	73	7	5	5	—	33	18	6	—	—	
	%	100,0	49,6	4,7	3,4	3,4	—	22,4	12,2	4,0	—	—	
myslimanë	numri	3.011	1.503	159	143	185	4	605	243	164	—	—	
	%	100,0	49,9	5,2	4,7	6,1	0,1	20,0	8,2	5,4	—	—	
ciganë	numri	2.664	1.497	100	80	16	2	576	344	46	—	—	
	%	100,0	56,1	3,7	3,0	0,6	0,0	21,6	12,9	1,7	—	—	
të tjere	numri	2.046	664	212	140	89	23	597	182	138	1	—	
	%	100,0	32,4	10,3	6,8	4,3	1,1	29,1	8,8	6,7	0,0	—	
Gjithsej	numri	34.251	15.627	2.330	1.625	1.317	161	7.384	4.612	1.181	14	—	
	%	100,0	45,6	6,8	4,7	3,8	0,4	21,5	13,4	3,4	0,0	—	

(Burimi: Të shpërngulurit nga Kosova dhe të ardhurit në Kosovë, Buletini nr. 25, 50, 72, 89 e 109, Zyra krahnore për statistikat, Prishtinë, 1984-1988).

TABELA — 6

Të ardhurit në KSA të Kosovës nga republikat socialiste dhe nga KSA e Vojvodinës nga 1.6.1983 — 31.12.87, sipas kombësive dhe motiveve të ardhjes.

Kombësia	Numri	Gjithsejt	Punësimi	Bëkonomieke		Te tjera	Shkollimi Vetë ose i të mijëve	Familjare	
				Kushte, më të mira materiale	Te tjera			Vendosja tek fëmijët	Martesa
shqiptarët	numri %	5.782 100,0	2.038 36,0	511 8,8	557 9,6	644 11,1	1.472 25,4	448 7,7	112 1,9
serbët	numri %	3.008 100,0	1.142 37,9	189 6,2	264 8,7	109 3,6	885 29,4	313 10,4	106 3,5
malazezët	numri %	524 100,0	201 38,3	14 2,6	65 12,4	42 8,0	116 22,1	72 13,7	14 2,6
turq	numri %	139 100,0	51 36,6	13 9,3	15 10,7	6 4,3	26 18,7	26 18,7	2 1,4
myslimanë	numri %	1.163 100,0	389 33,4	80 6,8	198 17,0	43 3,6	195 16,7	183 15,7	49 4,2
ciganë	numri %	598 100,0	150 25,0	27 4,5	48 8,0	8 1,8	276 46,1	74 12,3	15 2,5
të tjerë	numri %	728 100,0	262 35,9	33 4,5	91 12,5	26 3,5	163 22,3	127 17,4	26 3,5
Gjithsejt	numri %	11.942 100,0	4.233 35,4	927 7,7	1.238 10,3	904 7,5	3.133 26,2	1.243 10,4	324 2,7

(Burimi: Të shpërngulurit dhe të ardhurit në Kosovë. Buletini 25, 50, 72, 89 e 109, Zyra krahnore për statistikat, Prishtinë 1984-1988
Vërejtje: Për të ardhurit nga republikat e tjera dhe Vojvodina për «arsye të tjera» ku përfshihen pre-
sionet, nuk janë grumbulluar të dhëna (!)

mendimin e shqiptarëve, duke zbatuar ndaj tyre diferen-
cimin me karakter inkuizicioni. Mitingjet e protestës të
pothuaj gjysmë milioni shqiptarësh të Kosovës në nëntor
të vitit 1988 ishin paralajmërimi i fundit se nuk mund të
vazhdohet më kështu.

*Referat i mbajtur në simpoziumin
shkencor «Kosova-Serbia-Jugoslla-
via», në Lubjanë, «Zbornik: Koso-
vo-Srbija-Jugoslavijsa», Lubjanë
1989, faqe 39-66.*

Zenun Çelaj

SIKUR JANË ZGJATUR MUAJIT

Punëtori kosovar, me të ardhurat personale të tashme, gjithnjë e më vështirë mund ta përthekojë muajin. Më së keqi janë, ata të cilët nuk krahasohen me as-kënd.

Paga mesatare e punëtorit kosovar gjatë vitit të kaluar ishte 45.6 për qind më e ulët se ajo që morën punëtorët në nivel të vendit. Ky nuk është fakt që ilustron nivelin e angazhimit aktual të tij në punë, aq më pak për kundërvlerën e punës. Por, gjithsesi flet për dallimet, të cilat sa vijnë e bëhen më të theksuara jo vetëm në zhvillim, por edhe nga aspekti social. E nëse «baza materiale përcakton vetëdijen», siç kemi mësuar nga lënda e marksizmit, atëherë nuk mund të lihet anash as aspekti politik i problemit, i cili në rrethanat kosovare ka peshë tjetër në krahasim me viset e vendit.

Ditë më parë Enti Federativ i Statistikës kumtoi se vjet paga mesatare e të punësuarve në Jugosllavi

ishte 173.965 dinarë. Kjo shumë me siguri do të ishte shumë më e lartë, sikur në këtë mesatare të mos hynin edhe të ardhurat personale të punëtorëve nga Maqedonia dhe Kosova, të cilat janë gati përgjysmë më të ulëta ose 119.347 — në Maqedoni dhe 119.456 — në Kosovë, kur në Slloveni ato kapin 271.063 dinarë. Të ardhurat mesatare mujore të dhjetorit të vjemë japin pasqyrë edhe më të çoroditur, meqë dallimet janë njëmend të mëdha. Kështu, ndërsa mesatarja e së ardhurës personale të punëtorit në Slloveni në dhjetor ishte 429.345 dinarë, në Kosovë ishte 184.415 dinarë, madje në Maqedoni mbi një mijë dinarë më pak.

Vetëm për bukë goje

Këto raporte nuk do të ishin shqetësuese, sikur këtë mesatare ta gëzonte një numër më i madh punëtorësh. Mirëpo, fatkeqësisht, këtë privilegj e kishte diku çdo i teti banor i Kosovës, në rrethana kur në nivel të vendit me punë ishte i zënë më shumë se çdo i katërti, e të mos zihet në gojë Sllovenia, ku ky tregues flet për standard të pjesës më të zhvilluar të Evropës, që është dëshmi e polarizimit të vendit jo vetëm simbolikisht: në veri e jug. Të mos i zëmë në gojë as të 130 mijë të papunët dhe mijëra familje pa asnjë të punësuar.

Keqësimi i pozitës materiale jo vetëm të punonjësve e të qytetarëve, por edhe të punës së bashkuar në tërësi, tani nuk paraqet kurrfarë fshehtësie. Shefi i shërbimit për të ardhurat i Entit Krahinor të Statistikës, Nazmi Pllana, na shfaq keqardhjen që Enti s'ka mjete të mjaftueshme materiale për të kryer si duhet funksionin e vet, prandaj kumtesat e informacionet e tjera shfrytëzuesve detyrohet t'ua japë gojarisht, duke shprehur edhe kështu situatën aktuale në këtë fushë. Të dhënat nuk janë fare trimëruese, por te vëzhguesi shkaktojnë respekt ndaj durimit që manifestuan punonjësit, të cilët me të ardhurat nga puna e tyre mund të blejnë vetëm bukën e gojës, sidomos nëse

në treg nuk gjejnë bukën e zezë, tani gjithnjë e më popullore. Bile, po u zbatuan kriteret për shportën e shpenzimeve të familjes katëranëtarëshe, që është modeli i familjes mesatare jugosllave, por jo edhe kosovare (familja mesatare në Kosovë është diku 6-8-anëtarëshe), njeriu njëmend habitet si po ia dalin në krye kosovarët dhe ata që kanë nivelin e jetesës të njëjtë me këta. Ndoshta shpjegimi mund të jepet me faktin se punëtori në Kosovë mbeti vazhdimisht me njërën këmbë në fshat, që merrej rrethanë e pafavorshme për ekonominë, porse në kushtet aktuale reflektohet pozitivisht.

Veprimtaritë me të ardhura më të larta e më të ulëta personale

Veprimtaria	dhjetor 1987	Veprimtaria	janar- dhjetor 1987
Arsimi tjetër	499.850	Arsimi i lartë	197.588
Shoqata e OPB-ve	349.388	Organ. shoqërore- -politike	188.054
Arsimi i lartë	312.550	Shoqata e OPB-ve	181.980
Arsimi superior	292.964	Elektroekonomia	179.851
Sigurimi i pasurisë dhe pers.	276.216	Kuvendet dhe org. ekzekutive	177.283
Organ. shoqëroro- -politike	273.125	Prodhimi i thëngjillit	176.593
Veprimt. shkencore- kërkimore	271.704	Arsimi superior	175.311
Elektroekonomia	271.106	Sig. i pasurisë dhe person.	173.370
Kuvendet dhe org. ekzekutive	267.880	Bankat	160.469
Prodhimi i thëngjillit	259.748	BVI-të	159.481

Punëtorët e punësuar në sektorin shoqëror në KSA të Kosovës — gjithsej sipas lartësisë së të ardhurave në %o mars dhe shtator 1987

	mars	1987	shtator	1987
Lartësia e TAP në 0.000 din.	Numri i punëtorëve	struktura në %o	Numri i punëtorëve	struktura në %o
deri —3	1421	0,67	97	0,05
3— 4	4580	2,16	485	0,23
4— 5	13234	6,22	1238	0,58
5— 6	22475	10,57	3499	1,64
6— 7	30308	14,25	9929	4,67
7— 8	31194	14,67	13981	6,57
8— 9	27649	13,00	19537	9,18
9—10	23845	11,21	24189	11,37
10—12	23805	11,19	37796	17,76
12—14	13892	6,53	31554	14,83
14—16	8339	3,91	22304	10,48
16—18	5331	2,50	15460	7,26
18—20	3341	1,57	11159	5,24
20—25	2584	1,21	12909	6,07
25—30	625	0,29	5558	2,61
30—35	89	0,04	1977	0,93
35—40	24	0,01	073	0,32
40—50	21	0,00	392	0,18
50—60	2	0,00	46	0,02
60— e më tepër	1	0,00	13	0,00
Gjithsej	212760	100,00%	212796	100,00%

Ç'thonë të dhënat statistikore?

Në Kosovë vjet ishin në marrëdhënie pune 233.133 veta, nga të cilët vetëm 6002 në sektorin individual. Secili nga këta punoi për të mbajtur së paku edhe nga shtatë të tjerë. E sa e si mund të mbahen tetë veta me 119.456 dinarë, sa ishte mesatarja e të ardhurave personale në vitin e kaluar, nuk do shumë shpjegim, aq më parë kur dihet se ku kanë hipur shpenzimet.

Mesatarja mashtruese

U muar vesh se mesataret gjithmonë fshehin edhe pa-barazitë. Derisa në veprimtaritë ekonomike të sektorit shoqëror ku janë të zënë me punë 169.626 veta, mesatarja e të ardhurave personale vjet ishte 118.171 dinarë, në ato jashtë ekonomisë, secili nga 57.505 të zënë me punë në to vjet mori mesatarisht nga 124.348 dinarë në muaj. Por as këto nuk japin pasqyrën reale të dallimeve dhe të shtresimeve sociale gjithnjë e më të theksuara, qoftë si rezultat i punës dhe i angazhimit në punë, qoftë për shkak të vendit të punës ose të veprimtarisë. Më së keqi, natyrisht, janë ata që s'kanë me kë të krahasohen dhe që nuk hyjnë në asnjë mesatare. Kështu, në dhjetor të vitit që lamë, mesatarja e atyre që punonin në të ashtuquajturin «Arsimi tjetër», ishte 499.850 dinarë, që është mesatarja më e lartë e këtij muaji, ndërkaq mesataren më të ulët e kishin të punësuarit në veprimtarinë që merret me rregullimin e vendbanimeve dhe të hapësirës — vetëm 108.689 dinarë, pra një raport i patolerueshëm; një me pesë, që po të zbërthehej më shumë, do të shpaloste dallime edhe më të mëdha. Të dhënat statistikore për shtatorin e vitit të kaluar rrëfejnë se në atë muaj 97 veta kishin të ardhura personale më pak se 30 mijë dinarë, kurse 13 — më shumë se 600 mijë dinarë, pra raport një me njëzet. Të përkujtojmë se specialistët për matjen e nivelit të jetesës kanë gjetur se një familjeje katëranëtarëshe për të përmbushur kërkesat themelore vetëm me ushqim, brenda muajit i duhen rreth 270 mijë dinarë. Po ashtu pjesa e ushqimit në shpenzimet e jetesës tani është mbi 80 për qind. Prandaj nuk është për t'u habitur pse saraçët janë gjithnjë e më të zënë me punë dhe këtij profesioni po u kthehen edhe ata që e kishin braktisur jo kaheër, të bindur se kish «kaluar koha e tyre». Edhe rreshtat para dyqaneve ku shitet mall me çmime të ulura janë gjithnjë e më të kuptueshëm, kurse ndër njerëz tani më shpesh e dëgjon lavdimet: «E gjeta me çmim të ulët». Ditë më parë, një koleg rrëfente në redaksi se si njëri e kishte lutur punëtorin e sportelit të «Elektrokosovës» që t'i lejonte të paguajë faturën mujore të shpenzimit të

rrymës në dy këste, ndryshe do t'i mbeteshin fëmijët edhe pa bukë. Zaten, ka raste që për shkak të borxheve njerëzve t'u ndërpritet rryma dhe tani të futen në përdorim përsëri llambat e vajgurit. Nëpër rrugë nuk janë më lypës vetëm ata që këtë gjë e bënin pse e kishin bërë shprehë ose zeje, sheh gjithnjë e më shpesh edhe asish që skuqen kur e shtrijnë dorën. Duket se as ndihmat sociale nuk po kanë forcë blerëse për t'i ndalë nga kjo mënyrë e zgjidhjes së problemit, ndonëse edhe ato janë ngritur.

Optimistët janë të prirur të shohin anën pozitive të kësaj krize. Zaten, në fillim të kësaj dekade, kur shenjat e krizës dolën përfushë, një ekonomist në zë pati thënë: «Krizë do të thellohet deri sa secili, në punë e në shtëpi, të mos fillojë të bëjë hesap se si t'ia dalë në krye muajit, duke punuar më shumë edhe duke kursyer maksimalisht». Nëse mund t'i besohet këtij, tani mund të thuhet se ka ardhur ajo ditë dhe kurba e krizës mund të fillojë rënien. U provuan edhe grevat në socializëm, si kulm i krizës, kurse grevistët askush nuk i quan më «armiç klasorë», madje as në Kosovë, ku ky interpretim bëhej më lehtë.

Pavarësisht nga këto, bindja se vetëm me punë më të angazhuar mund të prosperohet më shpejt është gjithnjë e më e pranishme jo vetëm si parullë, por edhe si vetëdije. Dëshmi e kësaj është edhe produktiviteti më i lartë në punë, shfrytëzimi më racional i kohës së punës, punimi më i madh i tokës...

Krizë nuk ka ardhur sa hap e mbyll shtëpitë, prandaj as dalja prej saj nuk mund të jetë e shpejtë siç nguten për të futur mjegullën ata që duan të përfitojnë për qëllimet e veta, duke gjetur fajtorë për këtë pikërisht vlerat më pozitive të shoqërisë: barazinë, vëllazërimin dhe bashkëjetesën, të sanksionuara në Kushtetutën e 1974-shit. Edhe për shkak të këtyre, pra për t'i demantuar këta, do të duhej të shtoheshin përpjekjet në të gjitha nivelet, qoftë edhe me sakrificë.

«Rilindja», Prishtinë, 6.3.1988

Ramush Tahiri

PIKËPAMJE SHKENCORE E JO POLITIZIM

Demografët mendojnë se po të kenë parametrat zhvillimore si janë, bie fjala, të ardhurat kombëtare për kokë të banorit, niveli i arsimimit të popullsisë, sidomos i femrave, shkalla e punësisë, shërbimet shëndetësore, atëherë me përpikëri të pagabueshme mund të llogarisin shkallën e lindshmërisë, përkatësisht të shtimit natyror të popullsisë në një mjedis. Prapa politizimeve shpesh fshihen edhe paragjykimet nacionaliste.

Çështja e planifikimit të popullsisë në Kosovë viteve të fundit ka dalë në opinionin jugosllav si një ndër çështjet më të rëndësishme në stabilizimin e gjendjes ekonomike dhe politike në këtë pjesë të vendit. Mjetet e informimit kësaj çështjeje i kanë dhënë një publicitet të jashtëzakonshëm, që nuk ishte karakteristike edhe në periudhat e mëhershme kur problemet demografike në vend dhe në Kosovë ishin shumë të theksuara sesa janë tash. Në shkrimet e shumta, të cilat vërshuan shtypin ditor dhe periodik, dominuan ato mendime të thëna në të shumtën e rasteve nga persona joprofesionalë, të cilat çështjes së shtimit natyror në Kosovë filluan t'i japin asi lloj karakteristikash, të cilat për shkencën demografike janë një absurditet i vërtetë, dhe nuk mund t'i qëndrojnë

asnjë kritike të mirëfilltë shkencore. Në opinion filluan të lansohen teza për shtimin enorm të shqiptarëve, shtim, i cili kinse po i rrezikuaka popujt e tjerë fqinjë — serbët, malazezët dhe maqedonasit, se po zgjeruaka territorin etnik të shqiptarëve dhe se ky qenka në shërbim të qëllimeve të errëta të irredentës për krijimin e së ashtuquajturës «Shqipëri të Madhe», se ky shtim pamundëson zhvillimin më të shpejtë ekonomik të Kosovës, se shtimit të tillë të popullsisë nuk mund t'i bëjnë ballë edhe ekonomitë më të zhvilluara e të ngjashme.

«Teoritë» për shtimin natyror të popullsisë

Tezat dhe teoritë e tilla për shtimin e popullsisë në Kosovë më së paku kanë mbështetje shkencore dhe janë refleks i politikës negative të ditës, dhe për këtë më së paku janë të lansuara nga shkencëtarët e cilësdo lëmi.

Shkenca e demografisë që moti i ka shpjeguar të gjithë faktorët, që ndikojnë në shtimin e popullsisë të një mjedisi dhe për të gjithë ata, që dëshirojnë të merren me këto çështje, nuk mund të mos jenë të njohur, sepse janë botuar edhe në të gjithë doracakët e kësaj lëmie e të mos flasim për studimet më të thella demografike. Teza që një kohë të gjatë po lansohet për kinse rrezikimin nga shqiptarët si pasojë e shtimit të tyre jashtëzakonisht të madh është thjesht pikëpamje nacionaliste, së cilës asesi nuk mund t'i mveshet petku kinse marksist dhe kinse i nxjerrë si konkludim pas analizave të gjendjes konkrete dhe reale në Kosovë dhe në viset e tjera të vendit ku jetojnë shqiptarët. Është e njohur e pakontestueshme se zhvillimi i përgjithshëm shoqëroro-ekonomik pashmangësisht reflektohet edhe në shtimin natyror të popullsisë, saqë demografët thonë se po i patën të njohur treguesit e zhvillimit të gjithmbarshëm të një mjedisi, si janë të ardhurat kombëtare për kokë të banorit, shkalla e arsimimit të popullsisë sidomos shkalla e arsimimit të femrave, e në këtë vazhdë shkalla e analfabetizmit, pastaj shkalla e punësisë, përkatësisht të papunësisë së popullsisë, e sidomos të femrave, shkalla e kujdesit shëndetësor,

struktura e popullsisë, pjesëmarrja e popullsisë fshatare në popullsinë e përgjithshme etj, atëherë, në mënyrë të pagabueshme mund të llogaritet shkalla e natalitetit, mortalitetit, fertilitetit dhe shtimit natyror të popullsisë së atij mjedisi. Gjithherë, sa më e ulët të jetë shkalla e zhvillimit shoqëroro-ekonomik të një mjedisi, aq më i lartë është shtimi natyror i popullsisë dhe anasjelltas: sa më i lartë të jetë zhvillimi i përgjithshëm shoqëroro-ekonomik, aq më i vogël është shtimi natyror i popullsisë. Shembujt e panumërt anembanë rruzullit tokësor, por edhe në mbarë vendin tonë e vërtetojnë këtë. Gjithashtu, dihet se në shtimin natyror ndikojnë edhe një varg faktorësh socialë, porse sociologët e dinë mirë se marrëdhëniet në shoqëri, pra edhe kushtet sociale dhe vetëdija e ngritur mbi këtë, burimin e kanë në zhvillimin e përgjithshëm material dhe si ndryshon ky, ashtu ndryshojnë edhe faktorët e përmendur.

Teza se shqiptarët me shtimin e tyre rrezikojnë popujt fqinjë, thënë më së lehti, ka paragjykime nacionaliste, sepse bën projektimin konfrontues mes popujve në të ardhmen, se shqiptarët nuk i pranon si të barabartë me kombet dhe kombësitë e vendit, por i konsideron si element të huaj në trupin jugosllav. Deri më tash asnjëherë në vendin tonë nuk u vu në pikëpyetje shtimi natyror i popullsisë nga këndvështrimi i shtrimit të këtij apo atij kombi a kombësie, dhe të zgjerimit të «territorit etnik» të këtij apo atij kombi a kombësie në dëm të kombeve dhe kombësive të tjera të vendit. Ndërsa dihet se në të kaluarën, sikurse është rasti edhe tash, asnjëherë të gjitha kombet dhe kombësitë në RSFJ nuk patën shtim të njëjtë natyror, sikur nuk patën dhe nuk kanë edhe zhvillim të njëjtë ekonomik dhe të përgjithshëm. Kombet dhe kombësitë e Jugosllavisë përherë RSFJ-në e konsideruan dhe e konsiderojnë si shtet të njëmendët dhe të vetëm të tyre, dhe të gjitha fitoret, por edhe dështimet i ndërlihdin me të, se edhe perspektivën e vet e shohin vetëm këtu. Prandaj askujt nuk mund t'i mveshen atributet e shtetësisë ekskluzive, sepse të gjithë së bashku gjatë LNÇ u deklaruan të jetojnë këtu me të drejta të plota e të barabarta. Pra, edhe shqiptari, njësoj si dhe serbi, malazezi, maqedoni apo dikush tjetër, ka përgjegjësi të njëjtë për

fatin e vendit, dhe kjo asesi nuk guxon t'i mohohet, ashtu si nuk guxon t'i caktohet territori, në të cilin duhet të jetojë, të krijohen rezervate territoriale për ta, sepse tërë territori i RSFJ-së është atdheu i tyre i përbashkët, në të cilin i realizojnë, ashtu si edhe kombet dhe kombësitë e tjera të gjitha të drejtat nacionale dhe kushtetuese. Numërimi nacional me projeksion negativ të shtimit do të kishte reperkusione të paparashikueshme për mbarë vendin, sepse ashtu si tregohet kujdesi për shtimin e lartë natyror të shqiptarëve, (i cili me të vërtetë është i lartë, krahasuar me viset e tjera, por i përgjigjet zhvillimit të përgjithshëm shoqëroro-ekonomik të mjedisit në të cilin jetojnë) kujdes i njëjtë duhet të tregohet edhe për shtimin jashtëzakonisht të vogël të hungarezëve për zvogëlimin e numrit të tyre, apo bie fjala të bullgarëve apo të ndonjë kombi a kombësie tjetër. Pra, ndërtimi i një politike të caktuar nacionale populative, si po tentohet ndaj shqiptarëve kohëve të fundit, nënkupton edhe politikë nacionale populative ndaj të gjitha kombeve dhe kombësive të tjera, sepse ekskluzivitet nuk ka dhe nuk mund të ketë. Mirëpo, politikat e ashtuquajtura nacionale populative aspak nuk përkojnë me qëndrimet shkencore në përgjithësi dhe në veçanti me pikëpamjet marksiste ndaj shtimit të popullsisë.

A ka gisht irredenta?

Tezat se në shtimin natyror të popullsisë ka gisht irredenta, se kjo shkon në dobi të krijimit të «Kosovës së pastër etnike», në fazën e parë, dhe të krijimit të së ashtuquajturës «Shqipëri të Madhe», në fazën e dytë, përveç që nuk janë fare shkencore, janë të mbështetura në paragjykimet nacionaliste dhe politikisht shumë të dëmshme. Teza e tillë, nëse pranon irredentizmin, do ta ngrinte në një lëvizje gjithpopullore të shqiptarëve, e cila ka aq ndikim të madh në popull sa njerëzit, edhe përkundër gjendjes së vështirë ekonomike dhe perspektivës jo të sigurtë të pasardhësve, janë të gatshëm të lindin më shumë fëmijë, mu për shkak që kjo qenka kinse në përputhje

edhe me programin strategjik të irredentës. Kjo tezë në thelb bazohet në thënien «Sa më shumë shqiptarë, aq më shumë armiq të Jugosllavisë». Pra, nga vetë qenia e deklarimit nacional, nxirren edhe konkluzionet e caktuara politike, në përputhje me paragjykimin nacionalist se shqiptarët janë element i huaj në Jugosllavi dhe nuk janë element konstituiv i Federatës jugosllave. Kjo tezë edhe nuk lejon diferencimin klasor dhe idepolitik në kuadrin e vetë kombësisë shqiptare dhe nuk e pranon atë, për të mohohet ndikimi i LKJ në kombësinë shqiptare, mohohet përcaktimi i kombësisë shqiptare i verifikuar edhe gjatë LNC, por edhe gjatë ndërtimit socialist të vendit për të jetuar të barabartë në kuadër të RSFJ-së. Kjo tezë gjen mbështetje në pikëpamje reaksionare për Jugosllavinë si shtet të sllavëve të jugut, që është në kundërshtim të thellë me qëndrimet kushtetuese, sipas të cilave RSFJ është shtet i të gjitha kombeve dhe kombësive të barabarta.

Prandaj duket se ka ardhur koha që për çështjen e planifikimit të familjes fjalën e vet ta thonë ekspertët, shkencëtarët e lëmenjve përkatës, që të flaken politizimet negative politike, që në mjetet e informimit masiv kjo çështje të marrë vendin e merituar, që këtu të dominojnë pikëpamjet shkencore e jo ato të lansuara nga pseudo-shkencëtarët, nga njerëzit me njohuri të pamjaftueshme, nga ata që nisen jo nga pikëpamjet e barazisë së plotë të kombeve dhe kombësive, por nga ata që me shkrimet e tyre dëshirojnë të fuqin përçarje dhe të krijojnë huti.

Karakteristikat e Kosovës

Kosova karakterizohet me shkallën më të ulët të zhvillimit shoqëror e ekonomik dhe me shkallën më të lartë të shtimit natyror të popullsisë, derisa në vitin 1921 kishte 439.010 banorë, në vitin 1948 kishte 733.064 banorë, për të arritur në vitin 1981 në 1.594.440 banorë, që shënon një shtim për më shumë se tri herë. Edhe numri i banorëve në një kilometër katror u shtua prej 40.2 në vitin 1921 në 145.3 në vitin 1981, që është dendësia më e madhe e

vendit. Sipas shënimeve të Entit Krahinor të Statistikës në vitin 1967, shkalla e natalitetit në Kosovë ishte 41.7 për mijë, shkalla e mortalitetit 12.1 për mijë, ndërsa shkalla e shtimit natyror të popullsisë 29.6 për mijë. Në vitin 1981 shkalla e natalitetit në Kosovë ishte 30.2 për mijë, e mortalitetit 6.1 për mijë, ndërsa shtimi natyror i popullsisë 24.1 për mijë. Pra, vërehet tendenca e vazhdueshme e rënies së shkallës së natalitetit, e cila në vitin 1983 zbriti në 29.6 për mijë, por gjithashtu bie edhe shkalla e mortalitetit, gjë që ndikon që shtimi natyror i popullsisë të mbetet disi konstant, por me tendencë të vazhdueshme të zvogëlimit, kështu që në vitin 1983 shkalla e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë ishte 23 për mijë.

Sic shihet edhe nga këto të dhëna, me vetë zhvillimin ekonomik e të përgjithshëm shoqëror ndikohet edhe në planifikimin e familjes, sepse bashkëshortët e arsimuar, të punësuar dhe ata që jetojnë në qytet, rëndom mu për shkak të kushteve të jetesës përcaktohen për numër më të vogël të fëmijëve. Të dhënat e shumta e dokumentojnë një gjë të tillë. Popullsia e Kosovës, vlerësuar sipas parametrave të caktuar, në të ardhmen do të ketë shtim më të vogël të popullsisë me tendencë të vazhdueshme të rënies. Në këtë do të ndikojë edhe struktura e popullsisë. Deri tash Kosova karakterizohet nga një popullsi shumë e re, që përkundër vdekshmërisë jashtëzakonisht të madhe të foshnjave (në vitin 1971 vdiqën 89.6 foshnje në 1000 të lindura gjallë) siguronte një shtim më të madh të popullsisë, sepse struktura moshore ndikonte që mortaliteti i përgjithshëm të ishte më i vogël se në të gjitha viset e tjera të vendit. Mirëpo tash popullsia ka arritur në fazën kur nuk mund të rinohet më shumë dhe vërehen tendencat e ngadalshme të mplakjes së popullsisë, që karakterizohet me rritje të ngadalshme të vdekshmërisë së popullsisë, e cila në vitin 1983 arriti në 6.6 për mijë, përkundër zvogëlimit të vdekshmërisë së foshnjave, e cila në vitin 1983 ishte 69.2 për mijë.

Projeksionet e popullsisë që bëhen në stilin se në vitin 2000 apo 2020 Kosova do të kishte kaq ose aq banorë, se kaq do të jetë numri i shqiptarëve në Jugosllavi, nuk mund t'i qëndrojnë kritikës shkencore dhe për këtë nuk mund të merren si të vërteta të pagabueshme. Edhe pa-

rashikimet e tilla që u bënë para 20 vjetësh nuk dolën si të sakta. Nëse marrim për masë të llogaritjes shtimin e popullsisë që Kosova e kishte në vitin 1971, 29.3 për mijë dhe në bazë të saj llogarisim se sa banorë do të ketë në vitin 2000, atëherë gjithsesi do të gabojmë, sepse viteve të ardhshme Kosova pati shtim më të vogël.

Edhe po të merrnim shkallën e shtimit të popullsisë për 24.1 për mijë, që ishte në vitin 1981 për të llogaritur numrin e popullsisë në të ardhmen, prapë do të gabonim, sepse që në vitin 1983 ky shtim ishte 23 për mijë. Pra nuk mund të themi se Kosova në bazë të këtyre të dhënave do të dyfishohej apo trefishohej për kaq vjet duke u nisur nga këto të dhëna, sepse, po të llogaritej sipas rënies së shkallës vjetore të shtimit të popullsisë prej një për mijë, atëherë pas 20 vjetësh shtimi në Kosovë do të ishte vetëm një për mijë. Demografët në llogaritjen e projeksioneve të popullsisë rëndom nisen nga vlerat mesatare të shtimit të popullsisë, por theksojnë se edhe këto nuk janë të sigurta, sepse shprehur më thjesht, bie fjala, ndërtimi i një fabrike në një fshat dhe punësimi i femrave të fshatit menjëherë do të përgjysmonte shtimin e popullsisë në atë mjedis.

Si përfundim disa masa që tash po ndërmerren aty-këtu për kufizimin administrativ të lindjeve në dy apo në tre fëmijë, në ndaljen e shtesave fëmijërore pas fëmijës së tretë e të ngjashme, janë masa shkurtpamëse e të gabueshme e në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese, me të cilat u garantohet bashkëshortëve që lirisht të vendosin për numrin e fëmijëve dhe intervalin e lindjeve. Gjithashtu, këto as nuk përkojnë me qëndrimet humane, sepse i vënë në pozitë të padrejtë fëmijët që lindin pas fëmijës së tretë, duke i dënuar ato me masa ekonomike pa fajin e tyre.

Çështjet populatave, pra edhe të planifikimit të familjeve duhet t'u lihen shkencës dhe shkencëtarëve, që ata ta thonë fjalën e tyre dhe që ata të propozojnë masat. Të hiqet politizimi negativ që po vërehet viteve të fundit në mjetet e informimit rreth kësaj çështjeje, pasi si i tillë ka pasoja të dëmshme.

«Bota e re», Prishtinë, 15.1.1988

Ymer Bajra

LIMITI I QUAJTUR STRUKTURË

Sforcimi i industrisë bazë në aspektin e investimeve ishte dhe ngeli orientim kryesor i zhvillimit të gjithmbarshëm (të deritashëm) të Krahinës, sikundër që, në të njëjtën kohë, ishte dhe ngeli bastion i pakalueshëm në rrugën e zhvillimit të saj më intensiv si rajon.

KSA e Kosovës ishte dhe ngeli rajoni më pak i zhvilluar i vendit. Të dhënat që pasqyrojnë dinamikën e zhvillimit relativ të kësaj krahine gjatë tërë periudhës së pasluftës, jo vetëm që nuk janë inkurajuese, por ende më shumë paradoksale. Në vitin 1947, pjesëmarrja e industrisë në produktin shoqëror të Krahinës ishte 16.1 për qind (në nivel të vendit 18.2%), e bujqësisë 58.3 për qind (në nivel të vendit 39.7%), e tregtisë 10.7 për qind, (në nivel të vendit 12.8 për qind) e kështu me radhë.

Monostruktura e tipit agrar të ekonomisë së Krahinës është shumë më e theksuar sesa në nivel të vendit, gjë që shihet nga struktura socialekonomike e popullsisë. Në vitin 1948, 80.9 për qind të të gjithë banorëve të Kosovës i përbënte popullata bujqësore (në nivel të vendit 67.2 për qind).

Niveli i ulët i zhvillimit të ekonomisë së Krahinës, ndërkaq, shpjegohet edhe nëpërmjet të dy indikatorëve

të tjerë sintetikë: të produktit shoqëror për një banor dhe shkallës së punësimit. Produkti shoqëror për një banor në Kosovë, në vitin 1947 arrinte në 49 për qind të mesatares së vendit, kurse në vitin 1952 në 100 banorë të aftë për punë binin 4.8 të punësuar (në nivel të vendit ishin të punësuar 10.3 për qind).

Me kalimin e kohës, përkundër përcaktimeve dhe qëndrimeve të marra partiake e qeveritare për intensifikimin e zhvillimit të Krahinës në krahasim me viset e tjera të vendit, mandej, me gjithë masat konkrete që janë ndërmarrë, praktikisht nuk u arrit qëllimi. Përkundrazi, shpërpjesëtimet në shkallën e zhvillimit relativ të Kosovës vetëm sa u shtuan. Kështu, niveli i tashëm i zhvillueshmërisë së Krahinës (matur me përqindje), në krahasim me mesataren e vendit, është afërsisht për gjysmë më i ulët sesa para dyzet vjetësh (!).

«Humbja e rrugës» — që në start

Mirëfilli dihet se në periudhën 1947-1957 Krahina nuk ka qenë drejtpërsëdrejti e përfshirë në sistemin e stimulimit rajonal në nivel të vendit, prandaj as që ka mundur të priten fare rezultate në kuptimin e intensifikimit të zhvillimit apo edhe të ndryshimeve pozitive të strukturës së ekonomisë së saj. Produkti shoqëror në Kosovë gjatë kësaj periudhe shënon një shtim mesatar prej 4.4 për qind, ndërsa në nivel të vendit ishte 5.5 për qind.

Udhërrëfyes i zhvillimit ekonomik (industrial) në Kosovë ishin resurset natyrore, me një bazë mjaft të mirë e të begatë. Kjo mundësonte vetëm zhvillimin e industrisë bazë. Për këtë arsye pason edhe «sulmi» në këtë degë të industrisë me investime, sadoqë ato ishin mjaft modeste. Diversifikimi i degëve të industrisë ishte mjaft i pazhvilluar. Ndërsa në nomenklaturën e industrisë (në vitin 1957) në nivel të vendit figuronin 39 degë, në Kosovë ishin vetëm 11 sosh. Vendin e nderit atëbotë e mbante industria e metaleve me ngjyra, e cila, njëherit, realizonte 55.8 për qind të produktit shoqëror të industrisë së Krahinës.

Në fushën e investimeve aktualisht dominon industria bazë. Në vitin e përmendur (1957), 79.8 për qind të investimeve të gjithmbarshme që u depozituan në industri, i përkitnin industrisë bazë, pjesa tjetër (20.2 për qind) u depozitua në kapacitetet përpunuese. Në nivel të vendit, ky proporcion ishte shumë më i volitshëm dhe arrinte në 60:40. Investimet në metalurgjinë me ngjyra përbënin 46.1 për qind të investimeve të gjithmbarshme në industrinë e Krahinës. Kjo flet për faktin se «rruga pati humbur» që në fillim të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Në periudhën 1958-1965 pasojnë ndryshime bukur të mëdha në politikën zhvillimore të vendit, prandaj edhe të Krahinës. Gjatë kësaj kohe edhe Kosova përfshihet në sistemin e stimulimit të drejtpërdrejtë të zhvillimit në nivel të vendit. Investimet tash bëhen nga Fondi i përgjithshëm investiv. Për këtë arsye, norma e shtimit mesatar të produktit shoqëror ishte 7.4 për qind, aq sa ishte edhe në nivel të vendit.

Si rezultat pozitiv i zhvillimit ekonomik-shoqëror të Krahinës gjatë kësaj kohe, mund të konsiderohet niveli i pjesëmarrjes së industrisë dhe bujqësisë në produktin shoqëror: e para merrte pjesë me 30,9, kurse e dyta me 31,7 për qind. Në të njëjtën kohë, realizohen ndryshime shumë më cilësore në nivel të vendit, ku pjesëmarrja e industrisë në produktin shoqëror e tejkalon dukshëm pjesëmarrjen e bujqësisë në këtë aspekt.

«Përbindëshat» e investimeve

Para pak më shumë se dy dekada, xehetarisë dhe metalurgjisë me ngjyra në Kosovë i shtohet edhe një degë tjetër. Sërish, duke u bazuar në rezervat e mëdha natyrore, në sasi të mëdha të thëngjillit, filloi zhvillimi i energjetikës. Me kalimin e kohës, edhe në këtë degë të industrisë u shënuan rezultate mjaft të larta. Mirëpo, këtu duhet nënvizuar posaçërisht se në Kosovë u ndërtuan kapacitete të energjisë elektrike që japin sasi shumë më të mëdha të rrymës sesa i nevojiten Krahinës. Dhe, jo vetëm kaq: energjetika nuk iu bë vetëm kundërpeshë metalur-

gjisë me ngjyra, por në të njëjtën kohë u shndërrua në «përbindësh» të dytë të investimeve në Kosovë. Ato vazhdimisht, madje, edhe sot e kësaj dite, gëlltisnin shumicën e investimeve që depozitohen në ekonominë e Krahinës.

Nga viti 1966 fillon periudha e zhvillimit edhe nëpërmjet mjeteve intervenuese të Fondit të Federatës për nxitjen e zhvillimit të republikave jo mjaft të zhvilluara dhe të KSA të Kosovës. Deri në vitin 1976, këtë Fond e përbënin vetëm mjetet e obligueshme, kurse me transformimin e tij si instrument, gjysma e mjeteve realizohet nëpërmjet bashkimit të punës dhe të mjeteve. Mirëpo, zhvillimi ekonomik i Krahinës sikundër edhe i mbarë vendit, pas viteve shtatëdhjetë, vështirësohet dukshëm për shkak të paraqitjes së recesionit në nivel të Jugosllavisë, si edhe në përmasa botërore.

Në anën tjetër, efektet e Fondit të Federatës nuk ishin gjithaq të mëdha në Kosovë dhe kjo jo vetëm pse u zvogëlua përqindja e ndarjes së mjeteve për alimentimin e tij, por edhe për atë se këtu filloi ndërtimi i objekteve të reja, sërish kapitale, për realizimin e të cilave nevojiteshin sasi të mëdha të mjeteve investive, ndërsa edhe ndërtimi i tyre zgjaste shumë. Më vonë, me shpejtësi marramendëse ngrihet inflacioni, që si pasojë ka edhe tejkallimet enorme të investimeve në krahasim me preventivin. Në këtë mënyrë vetëm sa keqësohej struktura edhe ashtu e pavolitshme e ekonomisë së Krahinës, ndërsa, në të njëjtën kohë nuk ishte e lehtë të vlerësohet saktësisht funksioni real i Fondit të Federatës. Dhe, pasojë e të gjitha këtyre, ishte stagnimi i mëtutjeshëm i zhvillimit të Krahinës në tërësi.

Pësimet e mësimet

Me planin e fundit afatmesëm (në periudhën 1981—1985), përmirësimi i strukturës së ekonomisë së Krahinës u vijëzua me veçanti si qëllim strategjik. Synimet e tilla fituan ende në peshë, kur dihet se në këtë periudhë Kosova «fitoi» trajtimin e rajonit më pak të zhvilluar të

vendit, përçka në mënyrë më të theksuar u shtrua nevoja e zhvillimit të saj me të shpejtë jo vetëm në krahasim me viset e zhvilluara të vendit, por edhe kundruall republikave jo mjaft të zhvilluara. Mirëpo, edhe gjatë kësaj periudhe sikur vazhdoi «kënga e vjetër»: mbi 60 për qind e investimeve të gjithmbarshme u depozituan në industri. Ajo që është edhe më brengosëse ka të bëjë me faktin se gati gjatë tërë periudhës së pasluftës nuk ndryshoi rënditja në fushat e tjera ekonomike përsa u përket investimeve, përkundër qëndrimeve që përparësi t'u jepet atyre degëve që do të iniconin zgjidhjen e problemeve të ndryshme të grumbulluara me dekada të tëra. E, këtu është fjala për zbutjen e problemit të papunësisë, për shtimin e normës së akumulimit të ekonomisë dhe zhvillimin më harmonik rajonal të Krahinës.

Për arsye të ndryshme, këto synime nuk u realizuan, sikundër që nuk u përmbushën qëndrimet që investimet në ekonominë kosovare më shumë të orientohen në degët propulsive, më atraktive, prodhimet e të cilave shumë lehtë do të merrnin notë kaluese në tregun e vendit, por edhe në atë të jashtëm.

Duke mos i respektuar me përpikëri parimet e potenciale në dokumentet zhvillimore kur kemi të bëjmë me politikën e investimeve, pasuan edhe shpërpjesëtime të theksuara në mes të kapaciteteve të prodhimit primar dhe kapaciteteve përpunuese. Shembull mund të na shërbejë kombinati «Trepça», i cili një kohë të gjatë nuk i kushtoi kujdesin e duhur zhvillimit të xehetarisë, derisa u realizuan investime të shumta në modernizimin e zgjerimin e kapaciteteve përpunuese, siç është metalurgjia e zinkut dhe ajo e plumbit. Kapacitetet e këtyre subjekteve ekonomike tani nuk mund t'i «ushqejnë» as për së afërmi fazat paraprake të riprodhimit në këta viganë të ekonomisë sonë. Një pjesë e madhe e lëndës së parë, para së gjithash, e koncentratit, duhet siguruar nga viset e tjera të vendit dhe të importohet nga jashtë. Në këtë mënyrë eliminimi i «fyteve të ngushta» nuk është lehtë të arrihet.

Pos kësaj, gjatë dy dekadave të fundit, në Kosovë u ndërtnuan, u modernizuan e u zgjeruan kapacitetet e disa degëve të industrisë që, ose qind për qind, ose një sasi të madhe të lëndës së parë duhet ta sigurojnë nga importi.

Nuk është i vogël numri i atyre subjekteve ekonomike që lëndën e parë e sigurojnë nga tregjet e huaja (kryesisht në tregun konvertibil), ndërsa produktet e tyre finale tërësisht apo pjesërisht realizohen në tregun e vendit, pra — me dinarë.

Në fillim të realizimit të planit vijues afatmesëm që besuar se ndikim të madh në përmirësimin e strukturës së ekonomisë sonë do të ketë bashkimi vetëqeverisës i punës dhe mjeteve të organizatave ekonomike të Krahinës, dhe të subjekteve të ndryshme anembanë vendit. Efekti i realizuar në këtë mënyrë dhe mbi këtë bazë nuk dha rezultatet e dëshiruara, kur dihet se për bashkim të punës dhe të mjeteve nuk u inkuadruan edhe sistemet e mëdha ekonomike të vendit. Falë kësaj, edhe hapja e shumë kapaciteteve të reja me akumulim të ulët dhe që nuk absorbojnë fuqi të madhe punëtore (siç janë kapacitetet e industrisë së tekstilit), nuk i dhanë kurrëfarë «gjaku të ri» ekonomisë së Krahinës.

Ka edhe shumë mësimet e përvoja të vlefshme që puna jonë e bashkuar të nxjerrë nga zhvillimi i vet i deritashëm. Të gjitha degët e industrisë, që ndërkohë hapën kapacitete të reja, në të cilat realizohet shkalla më e lartë e finalizimit, njëherit shënuan edhe rezultate për lakmi. Kështu mund të thuhet për disa kapacitete të kombinatit «Trepça», siç është fabrika e nikel-kadmiumit në Gjilan, «Famipa» në Prizren, fabrika e llamarinës së zinktuar në Vuçiternë, industria e akumulatorëve starterë në Mitrovicën e Titos etj.

«Rilindja», Prishtinë, 21.2.1988

Zenun Çelaj

ME MESATARE - AS EKZISTENCA

Familjes katëranëtarëshe për t'i përmbushur kërkesat elementare të jetesës i duhen rreth 800 mijë dinarë, kurse në Kosovë të ardhurat personale neto për gjashtë muajt e parë ishin vetëm 218.684 dinarë. — Familjet pa asnjë të punësuar (rreth 18 mijë sosh) — në pozitën më të keqe. — A po zbatohen masat për mbrojtjen e standardit?

Të dhënat më të reja arsyetojnë drojen që manifestuan njohësit e rrethanave ekonomike, sipas të cilëve ky vit do të jetë rekord sa i përket ngritjes së inflacionit dhe rënies së nivelit të jetesës së punonjësve. Caku i planifikuar vjetor i shkallës së inflacionit 95% u kapërcye që në gusht dhe arriti në 98,8 për qind, pra iu afrua numrit në tri shifra, pas të cilit kontrolli dhe frenimi i tij është shumë më i zorshëm. Këtë e kanë kuptuar të gjithë dhe sikur kanë nisur të mësohen me të, ndoshta pse tash disa vjet po jetojnë me të dhe me pasojat e tij gjithnjë e më të rënda dhe më të padurueshme. Si po e përballojnë kosovarët këtë gjendje, të cilën e ngarkon edhe më shumë situata politike dhe e sigurisë?

Qetësi shqetësuese

Ndonëse sipas kalendarit vera vazhdon deri më 21 shtator, njerëzve sikur po u pëlqen të bëjnë bilancin e saj dhe sa më parë ta harrojnë, sepse ajo qe jo vetëm me vapë, por edhe e nxehtë politikisht, një verë shumë e gjatë. Në Kosovë kësaj iu gëzuan vetëm ata që kishin mbjellë grurë, sepse të korrat qenë të pasura, më të pasurat në historinë e bujqësisë së kësaj Krahinë; iu gëzuan edhe ata që kishin ujë për arat, të cilat nuk i ka lagur shiu tash disa muaj. Në Kosovë edhe prodhimi industrial ishte mbi nivelin e mesatares së vendit 11 për qind, por këtë të dhënë thujse askujt nuk iu kujtua ta trajtojë në favor të futjes së një optimizmi mobilizues ndër punonjësit, sikundër as shtimin e eksportit që ishte 27⁰/₀ më i lartë se vjet (periudha janar-korrik) as rënia e importit për 20⁰/₀, e cila në rrethanat kosovare mund të ketë pasoja negative.

Këto rezultate sikur kanë mbetur në hijen e tendencave negative të stabilizimit të gjendjes politike dhe të rritjes së inflacionit e të çmimeve, si dhe të rënies drastike të nivelit të jetesës së punonjësve, i cili pasqyrohet jo vetëm në nivelin e ulët të të ardhurave personale, por edhe me rreshtat e zgjatur para dyqaneve për blerjen e bukës së vrugët, me fuqinë e kufizuar blerëse të tyre dhe me rënie drastike të qarkullimit (rreth 13⁰/₀). Nëpër dyqanet tregtarët tani duken më mikpritës, por kanë gjithnjë e më pak punë.

«Qetësia» relative, kundruall pjesëve të tjera të vendit, nuk reflekton disponimin faktik të punonjësve kosovarë me pozitën e tyre materiale. Ç'është e vërteta, as Krahinës sonë nuk i ranë për qark grevat e punëtorëve të pakënaqur me të ardhurat e tyre personale. Ato këtu qenë më të rralla, më pak masive dhe më pak agresive, me siguri nga droja se mos atyre u jepet karakter politik, sepse edhe sanksionet janë më të ashpra, por edhe për shkak të vetëdijes se ato do të mund t'i keqpërdorte armiku. Njëmend në disa shkolla të Komunës së Prishtinës nuk ra zilja më 1 shtator për shkak të grevës së arsimitarëve të pakënaqur nga të ardhurat personale, të cilët sikur para-

lajmërojnë se edhe në Krahinën tonë mund të priten çrregullime me përmasa më të mëdha, për ç'arsye faktorët përgjegjës do të duhej të tregonin vigjilencë, jo duke i hetuar dhe duke i ndaluar me masa represive, por duke zbatuar masat tashmë të njohura për mbrojtjen e standardit të punonjësve dhe të qytetarëve me të ardhura të ulëta. Sepse, nëse analitikët kanë bërë llogari të saktë se për përmbushjen e kërkesave elementare të jetës një familje mesatare kateranëtarëshe në Jugosllavi i duhen rreth 800 mijë dinarë në muaj, familjes mesatare kosovare, që është dy herë më e madhe se ajo e vendit, i duhen dyfish më shumë mjete, që nuk i ka. Madje, niveli i të ardhurave mesatare të punonjësve në ekonominë e Kosovës në gjysmën e parë të vitit ishte vetëm 218.684 dinarë, e dihet se niveli i punësisë në Kosovë është gati tri herë më i ulët se ai i vendit.

As për bukë

Llogaria e thjeshtë tregon se punëtorit kosovar të ardhurat personale nuk i mjaftojnë as për të siguruar bukën thatë të familjes. Shumë sish nuk do të kenë të holla as për t'u blerë tekstet fëmijëve të tyre (për ta pajisur një fëmijë për shkollë me tekste, fletore e mjete të tjera mësimore mesatarisht duhen 40 deri 50 mijë dinarë), e për blerjen e zahireve as që mbetet gjë, kurse për shkak të thatësisë së madhe prodhimet bujqësore janë shtrenjtuar shumë. Njëmend disa institucione hulumtuese konsiderojnë se në Kosovë familjes katëranëtarëshe për të siguruar minimumin e ekzistencës në muaj i duhen rreth 560 mijë dinarë, porse analizat e tyre sikur nuk përfillin kriteret dhe ligjet e tregut unik të vendit dhe veprimin e pamëshirshëm të inflacionit kudo njësoj.

Të përkujtojmë se gjatë gushtit çmimet me pakicë u ngritën 14.7 për qind në krahasim me korrikun, kurse kundruall gushtit të vjetëm ato ishin 198.4% më të larta. Si pasojë e kësaj, edhe shpenzimet e jetesës shënuan rritje në krahasim me korrikun 13.7%, kurse në krahasim me gushtin e vitit të kaluar 189% (të dhënat i referohen

vendit në tërësi), kurse të ardhurat personale, siç dihet, për periudhën janar-shtator mund të rriten vetëm 132%.

Se a do të mbetet në fuqi Ligji mbi kufizimin e të ardhurave personale edhe pas shpërthimit të nivelit të papraparë të inflacionit për tërë vitin, është çështje për të cilën po diskutohet, kurse Sindikata e Jugosllavisë tanimë ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e tij, meqë me kufizimin e të ardhurave personale nuk mposhtet inflacioni, por me masa të tjera sistemore që stimulojnë prodhimin dhe eksportin, kurse motivi i punëtorëve për më shumë prodhim mungon. Në anën tjetër, janë rritur edhe problemet sociale (vetëm në Kosovë rreth tridhjetë mijë veta janë shfrytëzues të ndihmave sociale). Tanimë në këtë kategori mund të hyjë një numër i mirë punëtorësh (më shumë se gjysma marrin më pak se mesatarja e të ardhurave personale), ndërkaq mundësitë ligjore (por edhe materiale) për të rritur të ardhurat janë shumë të kufizuara. Deri në fund të vitit, realisht ato do të bien edhe më shumë (tash për tash të ardhurat personale kanë rënë realisht më shumë se dhjetë për qind). Me gjasë rripi s'ka ku të shtrëngohet më. Mirëpo, nëse çlirohet pa u mbështetur në rezultatet e punës, hyhet në rrugën që çrregullon edhe më keq procesin ekonomik. Prandaj Sindikata po kërkon shtegdalje pikërisht në punën më produktive.

«Rilindja», Prishtinë, 7.9.1988

Xhemail Rexhepi

SA PESHONJË SHPËRPPJESËTIMET?

Për shkak të strukturës së pavolitshme të ekonomisë, efektet e investimeve në Kosovë vazhdimisht qenë të ulëta dhe në shpërpjesëtim me nevojat reale zhvillimore. — Vitin e kaluar në Elektroekonominë e Kosovës, ku edhe pse dukshëm u shtua prodhimi dhe produktiviteti i punës, megjithatë, për një dinar të investuar, u realizuan vetëm 0.9 dinarë të hyra të përgjithshme. — Edhe investimet e këtij pesëvjeçari — në shpërputhje me kërkesat dhe synimet e përcaktuara për përmirësimin e strukturës së ekonomisë.

Sa herë që është vlerësuar shkalla e zhvillimit ekonomik të Krahinës, në periudha të caktuara, vazhdimisht është përmendur se struktura e saj e pavolitshme la dhe po lë pasoja të mëdha në politikën e përcaktuar të zhvillimit të shpejtuar të saj, politikë kjo që është përcaktuar gjithnjë jo vetëm në Planin Shoqëror të Krahinës, por edhe në atë të vendit. Kjo tashmë është e qartë dhe pikërisht për këtë në dy dekadat e fundit janë bërë përpjekje të shumta që të ndërrohet kjo gjendje, në mënyrë që nga investimet e realizuara të arrihen efekte më të mëdha zhvillimore.

Mirëpo, përkundër orientimeve të tilla, rezultatet e

arritura në këtë drejtim janë minimale, së paku nëse ato shikohen karshi nevojave reale. Investimet edhe më tutje kryesisht u realizuan në degët bazike — në energjetikë, në metalurgjinë me ngjyra dhe në jometale. E tërë kjo ndodhi në pesëvjeçarin e kaluar, si edhe në pesëvjeçarët e mëhershëm, e kjo rrugë nuk u ndërpre as në këtë pesëvjeçar.

Dëme të shumëfishta

Për këtë arsye, edhe efektet nga investimet e realizuara vazhdimisht qenë më të ulëta seç do të duhej të ishin, e lëre më në krahasim me synimet e planifikuara. Sepse, siç është e ditur, degët bazike vazhdimisht gëlltisin mjete të mëdha investive, aktivizimi i tyre është i gjatë, e në anën tjetër, krijojnë hapësirë të vogël për të futur në punë më shumë punëtorë. Kosova kishte dhe ka nevojë që nga çdo investim të nxjerrë efekte maksimale, si në ngritjen e bazës materiale, ashtu edhe në shtimin e numrit të punëtorëve, nevoja këto që vazhdimisht janë aktuale edhe në viset e tjera jo mjaft të zhvilluara — në Maqedoni, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Mal të Zi, të cilat po ashtu po ballafaqohen me probleme për shkak të strukturës së pavolitshme të ekonomisë.

Për fat të keq të këtyre viseve që përbëjnë familjen e jo mjaft të zhvilluarve në vend, që nga Çlirimi e këndeje çmimet e prodhimeve të industrisë bazike, pra lëndët e para, po mbahen nën kontrollin administrativ të shtetit, të cilat përherë qenë dhe janë më të ulëta se çmimet e produkteve finale, të cilat formoheshin dhe formohen lirish. Kështu, me vite të tëra në ekonominë e vendit tonë ekzistojnë shpërpjesëtime të mëdha të çmimeve, që, thënë me gjuhën popullore, do të thotë derdhje e mjeteve (të ardhurave) nga një degë në degën tjetër të ekonomisë, por edhe nga një rajon në rajonin tjetër. Pikërisht për këtë shkak, me masat e reja që u miratuan në maj të këtij viti në Kuvendin e RSFJ-së, u bënë disa përpjekje që të krijohen kushte e mundësi për eliminimin e këtyre devijimeve, duke liberalizuar më se 60 për qind të çmimeve, e

me orientim që në pesëvjeçarin e ri të hyjnë pa kontroll administrativ të çmimeve.

Çfarë do të ndodhë deri atëherë, në këtë drejtim pri-tet se do të jepen përgjigje të qarta edhe me reformën ekonomike, e në këtë drejtim po punohet shumë. Megji-thatë, një e dhënë, që këto ditë e dëgjuam nga biseda e disa funksionarëve krahinorë me një numër të madh ga-zetarësh e punëtorësh publikë të Sllovenisë, më së miri tregoi për peshën e rëndë të shpërpjesëtimeve në ekono-minë e vendit e jo vetëm në atë të Kosovës.

Çfarë është pozita e Elektroenergjisë?

Në të vërtetë, në bisedën e përmendur, kryetari i Kë-shillit Punëdrejtues të Elektroekonomisë së Kosovës, Sa-dik Vllasaliu në mes tjerash, tha se sikur të mos ek-zistonin shpërpjesëtimet në çmimet e prodhimeve koso-vare, atëbotë nuk do të ekzistonte nevoja për mjetet e Fondit Federativ. Deklarata të ngjashme më parë janë dë-gjuar edhe nga zyrtarët e Bosnjë-Hercegovinës e të viseve të tjera jo mjaft të zhvilluara, e kjo tregon për barrën vërtet të rëndë të shpërpjesëtimeve, para së gjithash, në viset ku dominon struktura e pavolitshme e ekonomisë dhe pjesëmarrja e lartë e industrisë bazike në krijimin e produktit shoqëror.

Struktura e tillë e ekonomisë në këto vise u reflek-tua në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në efektet e ulëta të investimeve të realizuara. Kështu, në bazë të një ana-lize të investimeve që u bë për periudhën e viteve 1976-1983, shihet se efikasiteti i tyre në Bosnjë-Hercegovinë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Kosovë, në periudhën e përmendur ishte 85.4 për qind e mesatares së vendit, ndaj 105.3 për qind të koeficientit të efikasitetit të investimeve në viset e zhvilluara karshi mesatares së vendit.

Mirëpo, sikur efikasiteti i investimeve të matej në kushte të strukturës së njëjtë të ekonomisë, atëbotë rezul-tatet do të ishin krejt të tjera. Në të vërtetë, karshi me-satares së vendit, efikasiteti i investimeve në viset jo mjaft të zhvilluara do të ishte 94 për qind, kurse në ato të zhvi-lluara 103.9 për qind.

Se çfarë efektesh dhanë investimet në degët bazike, po përmendim disa të dhëna lidhur me zhvillimin e elektroenergjisë së Krahinës, si degë kryesore industriale në Kosovë. Në bazë të një analize që në fillim të këtij viti u përgatit në Entin Krahinor të Planifikimit Shoqëror, del se në këtë degë të industrisë në pesëvjeçarin e kaluar u investuan gati një e treta e të gjitha investimeve të Krahinës në industri. Ndërkaq, në vitin 1985 energjetika në krijimin e produktit shoqëror të Krahinës mori pjesë me 27 për qind, ndaj 10.9 për qind, sa ishte pjesëmarrja e energjetikës së tërë vendit në produktin shoqëror jugosllav. Duke analizuar më tej faktorët e ekonomizimit në Elektroekonominë e Krahinës, analiza e përmendur tregon se vitin e kaluar, bie fjala, përkundër shtimit të rezultateve në prodhim, por edhe në shtimin e produktivitetit të punës, elektroekonomia kosovare arriti që nga një dinar i investuar të realizojë 0.99 dinar të hyra të përgjithshme.

Akumulimi i zvogëluar

Politika e shpërpjesëtimeve të çmimeve u reflektua edhe në aftësinë akumuluese e riprodhuese të kësaj dege të ekonomisë kosovare. Kështu, në vitin 1986 aftësia akumuluese e riprodhuese e energjisë elektrike ra në 0.3 për qind, nga 0.9 për qind që ishte në vitin 1985, që do të thotë se u zvogëluar plot tri herë. Në të njëjtën kohë, u shënuar rritje e madhe e borxheve. Edhe pse, siç dihet, viteve të fundit çmimi i energjisë elektrike dhe i thëngjillit u ngrit vazhdimisht, andaj edhe është bërë barrë e rëndë për shumë konsumatorë.

Mirëpo, ky çmim në raport me ekuivalentin e çmimit të mazutit ende po ngec shumë. Kështu, çmimi i një ton thëngjilli në vitin 1972 ishte afër 66 për qind të çmimit të një tonelate të mazutit, për të rënë në 54 për qind në vitin 1975, në 48 për qind në vitin 1978 dhe në 35 për qind në vitin 1986. Në këtë drejtim, siç pohojnë në elektroekonominë e vendit, as tash, pas shtrenjtimeve mjaft të mëdha, gjendja nuk është e volitshme.

Nga këto pak të dhëna del se shpërpjesëtimet e çmi-

meve po reflektohen mjaft negativisht në ekonominë e viseve me strukturë të pavolitshme të ekonomisë. Por, përkundër këtyre të dhënave të pamohueshme, për fat të keq, edhe në këtë pesëvjeçar në Kosovë nuk u shënuan kthesat e pritura, por edhe të synuara me dokumente zhvillimore, që të ndërrohet dhe të përmirësohet struktura e ekonomisë. Prandaj, mbetet që në këtë drejtim të bëhet diç më shumë se në dy vjetët e ardhshëm të këtij pesëvjeçari, veçmas në pesëvjeçarin e ardhshëm.

«Rilindja», Prishtinë, 17.9.1988

V
FATI I NJË POPULLI
JASHTËKUSHTETUES



Shkëlzen Maliqi¹

MASAKRIMI I ELITËS KULTURORE

(Intervistë dhënë revistës «Danas»)

Pyetje: Ç'përbën inteligjencia shqiptare në Kosovë? Si mund të shpjegohet dhe të përcaktohet nëse ka specifikë në zhvillimin e saj?

Përgjigje: Ashtu sikurse edhe gjetkë, në Kosovë inteligjencia është një nga shtresat shoqërore që merret me të ashtuquajturën punë intelektuale, që e nxjerr bukën e vet, si të themi, me anën e «shitjes» së trurit, të aftësisë dhe të talentit artistik. Këtë shtresë disa e konsiderojnë shumë të gjerë, duke futur në të edhe të gjithë ata që kanë arsimit të lartë. Ka gjithashtu pikëpamje që statusin e intelektualit ia njohin vetëm nënshtresës së inteligjencies, që ndodhet në kulmin e kësaj shtrese dhe që ka një pozitë të pavarur (ose lufton për ta pasur atë), të cilin Sartri e ka quajtur «rojtëse të qëllimeve themelore të shoqë-

1) Shkëlzen Maliqi (1947) u kthye në Prishtinë si intelektual i formuar pas vitit 1981 (ka studiuar në Fakultetin e Filozofisë në Beograd dhe pas vitit 1968 punoi në një nga katedrat e tij)... Sot punon në bashkësinë kulturoro-arsimore të Kosovës dhe është një nga intelektualët e rrallë kosovarë të kombësisë shqiptare, i cili nuk ngurron të thotë atë që mendon. (Shënim i redaksisë së revistës DANAS).

risë» dhe që qëndron përmbi interesat e shtresave të tjera. Në të vërtetë, në qoftë se nisemi nga ky përcaktim i ngushtë, atëherë mund të arrihet në tezën që mbrojtj kohët e fundit në një tribunë miku im Isuf Berisha se në Kosovë nuk ka intelektualë. Kjo tezë, kuptohet vetvetiu, u hodh vetëm për nxitjen e diskutimit, në të cilin duhej të tregohej pozita e varur e inteligjencies kosovare. Në qoftë se nocioni inteligjencie merret në kuptimin më të gjerë (ose të paktën më gjerë), atëherë si karakteristikë kryesore e inteligjencies kosovare mund të veçohet kjo: ajo është e re dhe prandaj tregon shenja papjekurie dhe pasigurie. Është fjala për një shtresë të vogël, por prapa saj qëndron një baticë në ardhje e brezit të ri, që ka fituar arsimin e lartë ose po e fiton atë dhe që po formon ndërgjegjen lidhur me pozitën e vet të veçantë dhe funksionin e veçantë shoqëror. Karakteristika e dytë, që do të desha të veçoja, qëndron në moshegjemonizimin potencial të kësaj shtrese, e cila nuk ka arritur ende në artikulum të plotë, sepse batica që po vjen, nuk ka hapësirë për një promovim normal në mjedisin kosovar të monopolizuar të institucioneve dhe mjeteve të informacionit. Si karakteristikë e tretë është fakti se inteligjencia kosovare pushton hapësirën në kushtet e traumave gjithnjë e më të thella politike dhe kombëtare. Ndarja nacionale vitet e fundit ka marrë përpjesëtime tragjike.

Pyetje: Është e qartë se në Kosovë ka vite që gjendja nuk është aspak e «rregullt». Në rrethana të tilla të jashtëzakonshme ç'mundësi realizimi ka intelektualit kosovar i etnitetit shqiptar?

Përgjigje: Nga pikëpamja e individit janë të mundura «përgjigje» të ndryshme ndaj sfidave të rrethanave të jashtëzakonshme. Për disa, ato mund të jenë nxitëse dhe frymëzuese, sepse gjendja e krizës e çliron imagjinatën krijuese dhe jep tema të reja punimesh, krijon mundësi që realiteti të shihet në të gjitha kontradiktat e tij, të cilat nuk shihen në kushte normale. Por, në qoftë se inteligjencia shqiptare në Kosovë konsiderohet si shtresë, atëherë kjo periudhë krize ka sjellë më shumë kufizime dhe frustracione të dhimbshme sesa nxitje dhe frymëzim.

Intelektuali shqiptar në Kosovë gjatë periudhës së pasluftës, për të mos u futur më thellë në histori, kur

edhe ajrin e ka pasur me pakicë, asnjëherë nuk e ka ndër veten të qetë. Nuk ka qenë i lumtur as në vitet 50-të, kur kishte për mision arsimimin e popullit dhe ishte nën mbikqyrjen e policisë dhe të politikës, e cila e shihte me më shumë mosbesim këtë mision. Nuk ka qenë i lumtur as në periudhën pas plenumit të Brionit dhe as në vitet 70-të, kur gjoja fitoi lirinë dhe u zhgënjye në përpjekjet e tij për afirmimin origjinal kombëtar të shqiptarëve. Më pak i lumtur ai ka qenë pas viteve 1981, kur e akuzuan se ka qenë «truri» dhe «promotori» i «kundërrevolucionit». Gjatë këtyre 40 e ca vjetëve, intelektual i shqiptar asnjëherë nuk ka qëndruar mbi këmbët e veta. Atij nuk i është lejuar të pyesë apo të dojë ndonjë gjë tjetër, veç asaj që lejohej nga komitetet e partisë. Edhe në vitet 70-të, kur partia lejoi mundësinë e afirmimit të plotë kombëtar të shqiptarëve dhe fuqizimin nga ana institucionale të kulturës së tyre, intelektualët kanë qenë nën mbikqyrjen e politikës. Pikërisht në këtë kohë, nën parullën e luftës kundër liberalizmit, nën ombrellën e «Rilindjes» u krijua sistemi i fuqishëm për kontrollin e informacionit masiv dhe monopoli i të gjitha botimeve në gjuhën shqipe.

Duke qenë se nuk guxonin të shpjegonin të tashmen, iu futën së kaluarës si e vetmja koniunkturë e mundshme që u kishte mbetur, në të cilën gjendeshin gjithashtu shumë vende dhe emra të ndaluar. Në vitin 1981 hapësira u ngushtua më tej, sepse kontrolli ndaj veprave të intelektualëve u bë i dyfishtë. U errësua plotësisht kufiri midis asaj që quhet afirmim kombëtar dhe asaj që quhet shmangie nacionaliste. Lindi situata e një zhgënjimi të plotë, kur inteligjencia shqiptare nuk mund të hulumtonte e lirë të kaluarën, të tashmen dhe as të jepte vizionet e së ardhmes.

Pyetje: Kur është fjala për intelektualët e kombësisë shqiptare në Kosovë, duhet të flasim detyrimisht edhe për pozitën dhe trajtimin e kësaj popullsie në Jugosllavi nga mbarimi i Luftës dhe triumfi i Revolucionit e këtej. Ekzistojnë disa nocione, me të cilat operohet: periudha «para Brionit» dhe «pas Brionit», evolucioni nga «antikombëtarja» te «kombëtarja» dhe deri te «nacionalistja», ashtu sikurse e ka përkthyer këtë në mënyrë figurative Veton Suroi, por edhe ju keni përmendur diçka të tillë.

Përgjigje: Periodizimi është i saktë dhe shënon tri faza, në të cilat shikohet në mënyrë të ndryshme statusi i shqiptarëve në Jugosllavi. Dilema kyç e politikës jugosllave dhe, sidomos, serbe, qëndron në atë se në ç'mënyrë duhet të shprehet subjektiviteti politik dhe kulturor i shqiptarëve në shtetin që në emrin e vet përmban idenë e shtetit të sllavëve të jugut. Sipas një pale, shqiptarët duhet të kenë statusin e pakicës nacionale në shtetin e kombeve: serb, maqedonas dhe malazez, me të drejta të kufizuara dhe të kontrolluara në fushën e autonomisë kulturore dhe arsimore. Një palë tjetër mendojnë se shqiptarët, për shkak të numrit të tyre të madh dhe të kompaktësisë në trojet, në të cilat jetojnë, duhet të kenë një autonomi të gjerë politike dhe kulturore. Në periudhën para Brionit mbizotëronte teza e parë, në periudhën pas Brionit teza e dytë, kurse viti 1981 solli një kthesë të re duke gjallëruar përkrahësit e tezës së parë. Nga viti 1981 e këtej shfaqet një cilësi e re. Më parë për fatin e shqiptarëve vendosej kryesisht nga oligarkia partiake e shtetërore, kurse sot u përfshinë në kontradikta edhe popujt. Nga njëra anë, gjenden popujt serb, malazez e maqedon, të cilët mendojnë se territoret ku jetojnë shqiptarët, janë territore të tyre kombëtare. Nga ana tjetër, gjendet populli shqiptar, i cili lufton me mundim që të ruajë dhe të çojë përpara të drejtat e fituara dhe nuk pranon statusin e pakicës në shtëpi të huaj dhe atë të qytetarit të dorës së dytë.

Pyetje: Margjinalizimi i inteligjencies kosovare në kreu të periudhës, për të cilën flasim, me sa duket, është rezultat i pragmatizmit politik. Kjo të imponon pyetjen lidhur me marrëdhëniet midis inteligjencies dhe politikës së përditshme në Kosovë. Ç'mendonit për këtë?

Përgjigje: Po i referohem përsëri Sarrit, i cili ka thënë se intelektualët ndodhen gjithmonë midis dëshmisë së të vërtetës dhe torturës dhe se pushteti, sido qoftë ai, dëshiron t'i shfrytëzojë intelektualët për propagandën e tij, por edhe ruhet prej tyre dhe gjithmonë ka një purgativ kundër tyre. Thirrja që i bëhet inteligjencies shqiptare jo për të dëshmuar të vërtetën, po për propagandë, pra, që të vihet në funksion të politikës së përditshme, kohët e fundit po krijon një numër gjithnjë e më të madh

martirësh dhe ndjenjën e përgjithshme të persekutimit. Kur përmenden marrëdhëniet midis politikës së përditshme dhe intelektualëve, më kujtohen gjithmonë episodet e viteve 1982 dhe 1983, kur sundimtarët kosovarë grumbullonin në shumë raste rreth 100 intelektualë dhe secilit prej tyre i jepnin detyrë «partie» për të shkruar tekste propagandistike me tema të caktuara, duke i kërcënuar se «do të diferencoheshin», në qoftë se nuk e plotësonin këtë detyrë. Në këto grumbullime atëherë u ndodh gati krejt ajka intelektuale e shqiptarëve të Kosovës, por vetëm pak pranuan t'i nënshtroheshin një shantazhi të tillë poshtërues. Pavarësisht nga motivet, nga të cilat u udhëhoqën, rebelimi i tanishëm i intelektualëve tregon distancimin e parë të inteligjencies nga politika aktuale. Mund të thuhet se kjo është një shenjë dhe tregues që tani ajo është pjekur si e tillë. Revoltimi i saj nuk mbeti pa u ndëshkuar. Ata që kanë pushtetin sot në Kosovë, këtë vit morën masa ndëshkimi kundër tyre. Të gjithë emrat e rëndësishëm të listës së vjetër «u diferencuan» gjatë verës që kaloi dhe në këtë mënyrë atyre iu preçdo mundësi për të folur.

Këtej e tutje ata nuk i lidh gjë me politikën aktuale. Për më tepër, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe që pasojë e këtij diferencimi do të jetë edhe kufizimi për shtypjen e veprave të tyre. Ata në mënyrë kolektive do të shtrojnë problemin për të pasur të drejtën elementare, për të pasur një mendim ndryshe nga tjetri.

Pyetje: Qëndrimi i inteligjencies shqiptare në Kosovë, në dritën e ngjarjeve tashmë të njohura, mos lë hapësirë për një vlerësim kritik dhe për disa veprime «kundërproduktive»? Krijohet përshtypja, të paktën te vëzhguesit e paanshëm, se në sjelljen e kësaj inteligjencie ka pasur shumë ngathtësi dhe mosorientim. Me se e shpjegoni këtë?

Përgjigje: Në radhë të parë, me faktin se inteligjencia shqiptare nuk ishte bërë aspak e aftë për një vetëhulumtim dhe se nuk kishte organe të shtypit kritik për të shtruar çështjen e statutit të saj. Ngathtësia, që përmendet, është pasojë e kurthit, në të cilin u ndodhën intelektualët shqiptarë si njerëz politikisht të dyshimtë. U bë një zhurmë e madhe se pse heshtin ata, kurse as në krahinën

e tyre dhe as në mjedise të tjera nuk iu krijuan mundësi që të flasin dhe të shprehin lirisht mendimet e tyre. Dhe kur më në fund, folën, këtë u detyruan ta bëjnë me frustracione. Në mënyrë të veçantë kjo u pa në rastin e bisedimeve midis shkrimtarëve shqiptarë dhe serbë vitin e kaluar në Beograd. Atëherë nuk pati aspak dialog, por një luftë të hapur verbale. (Milan Komeniçi e filloi fjalimin e tij me thirrjen e «njohur»: «Zotërinj, jemi në luftë!»). Por «ngathtësia» e diskutimeve të shkrimtarëve shqiptarë në këtë rast nuk ishte aspak më problematike nga kulmi i histerisë së shkrimtarëve serbë, të cilët dëshironin të hynin në «dialog» me mitin kosovar dhe me «prova» emocionale të zjarrta, por jo të argumentuara, për terrorin shqiptar në Kosovë.

Pyetje: Për Kosovën ekzistojnë sot, do t'i quaja stereotipe, nga të dyja anët. Njëra prej tyre është edhe teza për monolitetin, mendimin unanimitet të inteligjencies shqiptare në këtë zonë. Sa e vërtetë është kjo?

Përgjigje: Teza për monolitetin dhe unanimitetin e inteligjencies shqiptare mund të jetë e saktë vetëm po të mbajmë parasysh se asaj i është mbyllur goja dhe, pra, mund t'i atribuohet gjithçka. Me fjalë të tjera, në Kosovë për një kohë të gjatë është penguar paraqitja e mendimeve të ndryshme dhe këtu futet edhe dialogu me orientime të ndryshme politike e kulturore. Por ky prodhim artificial i «monolitetit» dhe «unitetit» nuk do të thotë se në Kosovë mbizotëron një monolitet dhe unitet i vërtetë. Në fakt, ekziston një përputhje e madhe mendimesh rreth disa çështjeve politike, para së gjithash, rreth ruajtjes së autonomisë së Kosovës dhe identitetit kulturor të kësaj hapësire, por rreth karakterit të kësaj autonomie dhe sidomos, karakterit të identitetit kulturor ekzistojnë mospërputhje të pashprehura.

Pyetje: Shumë shqiptarë të Kosovës mbajnë një qëndrim shumë më kritik ndaj mjediseve «jashtë» sesa «brenda» Krahinës. Shumë nga ajo që mund të quhej emancipim i plotë kombëtar, nuk i reziston dot një pikë-pamjeje pak kritike, në qoftë se kemi parasysh disa sisteme të vendosura të vlerësimit të ligjshmërisë. Si mund të nivelizohen të gjitha këto, si mund të bëhesh objektiv në këto kushte?

Përgjigje: Po, kjo më duket se është një dukuri e përgjithshme në Jugosllavi. Të gjithë janë më kritikë ndaj të tjerëve dhe shumë më pak ose aspak ndaj vetes. Me këtë nuk dua të justifikoj shqiptarët, por vetëm konstatoj një sindromë të përgjithshme jugosllave, e cila na ka sjellë në krizën e tanishme. Nuk u përkas atyre që nuk janë kritikë ndaj asaj nga brenda, megjithëse edhe vetë e ndiej se kjo nuk është e mjaftueshme, duke pasur parasysh faktin që kohët e fundit jam shumë i angazhuar ndaj asaj të jashtmes. Por është vështirë që në ndarjet dhe orientimet e tanishme të gjendet masa dhe të balancohen gjërat. Pra, ajo që unë shkruaj dhe si shkruaj, nuk botohet në Kosovë, prandaj kryesisht botoj në Slloveni dhe, kohët e fundit edhe në të përmuajshmen «Alternativa» që boton shoqëria kulturore shqiptare «Migjeni» në Lubjanë. Rreth numrit të dytë të «Alternativës» është bërë zhurmë e madhe, para së gjithash, për shkak të tekstit për Adem Demaçin, që paraqitet si një Nelson Mandela evropian, si dhe për shkak të botimit të disa fragmenteve nga vepra e tij letrare. Lidhur me këto do të desha të ndihmoj kritikën «e brendshme», dhe kjo sepse jam edhe anëtar i redaksisë së kësaj reviste, (megjithëse nuk marr pjesë në redaktimet e saj). Nuk kam asgjë kundër botimit të prozës së Adem Demaçit e as do të më pengonin shënimet informuese për burgosjen e tij të gjatë. Por shndërrimi i Demaçit në një shenjtor shqiptar më duket pa baza dhe kundërproduktiv.

Pyetje: Duke pasur parasysh gjithçka që ka ndodhur në Kosovë, nuk mund të lëmë mënjanë edhe implikimet aktuale të politikës së përditshme si pasojë e disa përpjekjeve të ngritjes së zërit të inteligjencies së kombësisë shqiptare në Kosovë, e cila, siç përmendët ju, është akuzuar rregullisht për heshtjen e saj. Marrim si shembull Apelin e 215 intelektualëve, që tani është bërë baza e diferencimit e që këtu është kuptuar si mundësi për të bërë një larje përfundimtare hesapesh me «armiqtë». Mos po futen të gjithë intelektualët shqiptarë në një thes?

Përgjigje: Apeli vetëm konfirmoi listat e hartuara më parë të të dyshimtëve. Qëllimi ishte që të dënohej dhe të eliminohej ajka e inteligjencies shqiptare. Por qëllimi i mëtejshëm i masakrimit të elitës kulturore, ashtu si-

kurse edhe në rastin e masakrimit të udhëheqësve politikë edhe në fushën e ekonomisë, është eliminimi i të gjithë atyre, që konsiderohen bartës kryesorë dhe për-krahës të autonomisë politike, ekonomike dhe kulturore të Kosovës. Në këtë mënyrë krijohet hapësirë për ndër-hyrje radikale sipas diktatit të Serbisë dhe për kthim në gjendjen që ishte para vitit 1966, dhe, mbase, për një kufizim më radikal të autonomisë së Kosovës, madje edhe të asaj kulturore. Këtu kemi të bëjmë me llogari të gabuara, sepse nuk është fjala vetëm për krerët, po për kërkesa të të gjithë shqiptarëve.

Ekziston mendimi se në Kosovë mund të kthehet gjendja ashtu siç ishte në vitet 50-të. Për sa i përket Apelit të 215-tëve, i cili nuk ka asgjë kriminale në përmbajtjen e tij, atë do ta nënshkruante shumica e shqiptarëve, dhe ky është një fakt me rëndësi të dorës së parë. Në qoftë se dikush nuk e beson këtë, le të bëhet një referendum në Kosovë.

Pyetje: Imponohet pyetja, ç'do të thotë të jesh shqiptar në Jugosllavi ose shqiptar jugosllav? A është ai në «truallin e vet» apo është rastësisht këtu? A është ai «i huaj» apo «vendas»?

Përgjigje: Shqiptari në Jugosllavi dëshiron të jetë në shtëpinë e vet dhe kjo si shqiptar dhe jo si një lloj bastardi kulturor dhe politik. Por ka nga ata që duan ta shndërrojnë atë në «të huaj» dhe në «mysafir» të padëshiruar, sepse gjoja të parët e tij para disa qindra vjetësh paskan pushtuar tokat e huaja serbe.

Pyetje: Ekziston teza se gjithçka që kohët e fundit zbatohet këtu, bëhet sipas parimit «shqiptari më i mirë është shqiptari analfabet». Shembulli më i freskët për këtë është regjistrimi në vitin e parë të shkollave të mesme dhe konkursi për fondin unik të teksteve shkollore për RS të Serbisë. Si e komentoni këtë?

Përgjigje: Po, në Serbi ekzistojnë forca që dëshirojnë kthimin e atyre kohërave, kur shqiptari i pashkolluar ka qenë shqiptari më i mirë. Por nuk shikoj se si mund të kthehet sot ajo kohë. Edhe fshatari më i varfër shqiptar është i gatshëm të bëjë sakrificat më të mëdha për t'i siguruar fëmijës së tij arsim të lartë. Ekziston kulti i arsimimit. Kam dëgjuar njerëz që thonë: «Në qoftë se

këtu vendosen kufizime, fëmijën do ta çojmë në rajone të tjera të vendit, madje edhe jashtë shtetit. Ai nuk do të mbetet pa shkollë. Mungesën e arsimimit në të kaluarën e kemi paguar shtrenjtë. Ajo na ka bërë të varur dhe të pafuqishëm. Gjithashtu, nuk shikoj të ardhme as edhe për prirjen që kultura shqiptare në Kosovë të modelohet nga Beogradi. Një kopjimi të tillë kolonial të modeleve kulturore i ka kaluar koha në botë.

Pyetje: Ç'mund të bëhet në këtë situatë në planin kulturor?

Përgjigje: Kultura, sidomos kjo bashkëkohore, në goftë se shmangen mistifikimet rreth identitetit të saj kombëtar, është aspiratë për një përcaktim autokton, i cili te ne është në të gjitha mjediset gjithnjë e më i ndjeshëm dhe fusha më e mirë për lulëzimin e një mijë luleve dhe bashkëjetesën e orientimeve, drejtimeve dhe stileve të ndryshme në nivel planetar. Në vend të politizimit dhe ideologjizimit të kulturës. do të duhej që politikën ta bënim më të kulturuar, ta mësojmë të jetë më toleruese, të pranojë dialogun e bashkëjetesës, të drejtën për veçori, për larmi, për pluralizëm. Te ne tani mbisundon zhargoni i autenticitetit, himnizohet në mënyrë prej maniaku e kaluara nacionale, njerëzit e kulturës gati në mënyrë masive janë radhitur nën flamujt nacionalë dhe portretet e udhëheqësit, megjithëse një gjë e tillë është përjetuar në të kaluarën, megjithëse nga përvoja e kombeve të tjera, sot të kulturuar, e dimë se ç'pasoja kanë pasur homogjenizime të tilla dhe thirrjet për troje dhe gjak. Kam shpresë se vendi ynë nuk do të jetë i detyruar të kalojë nëpërmjet çmendurisë së revanshizmave nacionalë dhe rivendikimeve të të drejtave historike dhe etnike, megjithëse pranvera e përgjakshme kosovare dhe shtyrja nga ana e oligarkive tona politike e përgjigjes për rrugët e daljes reale nga kriza nuk ndjellin kohë të mirë. Me sa më duket mua, kultura e ka humbur shansin e vet, megjithëse jo edhe perspektivën, për të qenë në lartësinë e misionit të saj të vërtetë.

Pyetje: Ju pothuaj me të njëjtin intesitet ju kanë lavdëruar dhe kritikuar të dy palët, duke filluar nga qëndrimi dashamirës i Beogradit, ku keni jetuar deri në

fillim të viteve 80-të e deri tek intervistat në «Politika», «Start», nga kthimi juaj në Prishtinë, marrja përsipër e «Fjalës» deri te komenti i sotëm i «Jedinstvos» me rastin e shkrimit tuaj në «Dello» të Lubjanës. Në mendimet për ju ka me të vërtetë ndryshime radikale. Cilat janë këto ndryshime në mendime dhe qëndrime?

Përgjigje: Kam qenë dhe kam mbetur anësor dhe naiv në politikë, një njeri, i cili është sorollatur në të jo nga dëshira, por sepse rreth nesh është rritur një pyll, një xhungël, në të cilën dëgjohet vazhdimisht thirrja për bashkime dhe orientime fisnoro-politike. Nuk kam mundur të mbyll sytë para këtyre që po ndodhin, meqenëse vazhdimisht kam pasur një opozitë të fortë të brendshme të një pjese racionale dhe të frikësuar të ndërgjegjes sime, e cila më tërheq vëmendjen për absurditetin e angazhimit politik në momentin e tanishëm. Çdo shkrim, përfshirë edhe këtë që po them tani, fsheh në vetvete edhe dëshirën që të jetë aventura ime e fundit politike, por përsëri futem në lojë dhe tradhtoj veten, sepse kam një frikë të tmerrshme nga pasojat e asaj që po ndodh. nga politika që po ndiqet. Shkruaj që të largoj frikën, shkruaj për atë që ndiej, që dëgjoj, ashtu si i shikoj gjërat, pa zbukurime, pavarësisht nëse kjo dikujt i pëlqen apo jo.

Iso Rusi. «Sjeba kulturnih kneževa», «Danas», 19.9.1989.

Ibrahim Rugova

NUK JEMI OPOZITË, NE JEMI ARMIQ!

— *Intervistë në «Slobodna Dalmacija»* —

Me Ibrahim Rugovën, deri kohët e fundit kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, u takuam vetëm 10 orë para nisjes së tij për në SHBA, ku gjatë dy javëve duhet të marrë pjesë në disa mbledhje shkencore, në qoftë se autoritetet «nuk e prishin në momentin e fundit» nisjen e tij. Në bisedë, midis të tjerave, ai tha:

— Ky proces kundër Vllasit është tragjik, pasi përbën një uverturë në proceset e mëtejshme, megjithëse ne asnjëherë nuk kemi qenë shtet juridik, po shtet politik. Duhet dënuar liderët, e kjo pastaj të «mbulojë» gjithçka tjetër. Kjo është një lojë, që krijohet nga politika zyrtare, e më pas përpunohet nga shtypi zyrtar. Në qoftë se autoritetet kanë vendosur të dënojnë Vllasin, e duket qartë se e kanë vendosur një gjë të tillë, atëherë, pavarësisht nga opinioni eventual, ky është me siguri edhe një gjykim i letrës së Dërnovshekut. Dyshoj plotësisht që në këtë moment do të mbisundojë ndonjë forcë demokratike. Vetë Vllasi ka kaluar dy faza përsa u përket qëndrimeve të popullsisë shqiptare dhe të asaj serbe. Në vitin 1981 ai mbajti një qëndrim shumë të ashpër dhe te shqiptarët pati pakënaqësi, por më pas e kuptoi se nuk

mund të vazhdojë kështu, prandaj, për të ekzistuar, ndoqi një politikë më të qetë. Për këtë arsye në fazën e dytë fitoi simpatinë dhe miratimin e shqiptarëve. Te serbët, natyrisht, të kundërtën. Në periudhën kur na godiste ne, për ata ishte super i mirë, ndërsa më vonë, kur e panë se donte të ishte një politikan normal, nëpër mitingje filluan të kërkonin kokën e tij.

Është për të qeshur kur bëhen përpjekje që të zbatohet «njëfarë programi jugosllav për Kosovën». Kjo më kujton disa mendime të mëparshme të Vasa Çubrilloviçit, vetëm se tani në një kuptim modern, në kuadër të partisë, gjë që është edhe më shumë për të ardhur keq. Politika ndaj shqiptarëve në Kosovë zbatohet në mënyrë të ndër-gjegjshme, kështu që neve praktikisht na është imponuar getoizimi. Sot, në qoftë se ne përpiqemi të grumbullohemi në çfarëdolloj mënyre, dikush këtë do ta interpretojë si grumbullim proteste, autoritetet nuk lejojnë asgjë, madje as format më të thjeshta të shoqërimit, për të mos folur për ndonjë lloj opozite. Ne për ta nuk mund të jemi opozitë, ne jemi automatikisht armiq. Unë e kam thënë në Lidhjen Socialiste, kur na ftuan në një mbledhje të të gjitha shoqatave — të shkrimtarëve dhe të gjuetarëve, — se autoritetet kosovare duhet të tregohen pak elastike, të lejojnë, të paktën, ekologjistët apo diçka tjetër. Por as për këtë nuk janë të gatshëm. Megjithatë, ato lejuan krijimin e shoqatës për kthimin e serbëve dhe të malazezëve në Kosovë. Kur është fjala për shqiptarët, atëherë çështja bëhet problem dhe thuhet se bëhet fjalë për diçka etnikisht të pastër. . .

Unë u dëbova nga LK nga fundi i korrikut. Kjo këtu te ne është e mundshme pa ndonjë bisedë apo pëlqim nga organizata bazë. Në fakt, unë kam dashur edhe vetë ta braktis LK, pasi nuk jam dakord me politikën e tanishme, e pasi kemi vetëm këtë parti, e cila është në pushtet, atëherë nuk kemi alternativë tjetër. Megjithatë, te ne është mjaft e rrezikshme të dalësh apo të dëbohesh nga LK, pasi kjo ka konsekuenca të mëtejshme. Unë punoj në Institutin Albanologjik, i cili deri tani nuk ka qenë aq shumë nën goditje si arsimi apo Universiteti. Mbase do të qëndroj këtu, por edhe mund të më heqin.

Në gazetatat e këtushme artikujt e mi nuk botohen

më. Vepron një censurë e fshehtë. E di se më ndjekin, më përgjojnë telefonin dhe bëjnë çdo gjë. E kam të vështirë të lëviz nëpër Prishtinë. Disa shqiptarë çuditën sesi jam ende këtu. Te ne ka ardhur një kohë saqë nuk mund të bësh madje asnjë bisedë të zakonshme për jetën, sepse njerëzit ngurrojnë. Tashmë është gjallëruar plotësisht psikoza e logjikës policore. Kjo më hidhëron, pasi të gjithë këtë, si i ri, e kam provuar para plenumit të Brionit.

«Nismo opozicija, mi smo neprijatelji!», «Slobodna Dalmacija», Split, 8.10.1989

GENOCID KULTUROR

— Intervistë në «Slobodna Dalmacija» —

Pyetje: Si e komentoni gjykimin e Azem Vllasit dhe të drejtuesve të tjerë politikë e ekonomikë shqiptarë, i cili fillon së shpejti?

Përgjigje: Ky është një gjyq politik i urdhëruar nga udhëheqësit politikë të Serbisë. Azem Vllasi dhe të tjerët akuzohen se kanë marrë pjesë në organizimin e grumbullimeve të nëntorit dhe të grevave të shkurtit të shqiptarëve, dmth, se kanë manipuluar masat shqiptare për qëllime politike. Kjo sikur populli shqiptar të ishte i papjekur historikisht e politikisht, të mund të manipulohet dhe sikur vullneti politik të mund të reduktohet në vullnetin e individit! Natyrisht, në Kosovë askush nuk e beson këtë gjë, por që e gjithë kjo është një konstruksion, mund të shihet edhe nga aktakuza kundër Vllasit dhe të tjerëve. Gjykimi i Azem Vllasit tregon se si është sot fati politik dhe juridik i popullit shqiptar. Në Mal të Zi dhe Vojvodinë janë shpërblyer me poste të larta politike dhe shtetërore ata, që bënë «të zgjohej» populli malazez dhe ai serb e që përmbysen organet legale të pushtetit në Mal të Zi dhe Vojvodinë, ndërsa Azem Vllasi ndiqet penalisht nën akuzën se deshë «të zgjonte» popullin shqiptar. Në Mal të Zi dhe Vojvodinë u shkel kushtetuta që ishte në fuqi, por thuhet: ky ishte vullneti i popullit! Në Ko-

sovë u mbrojt kushtetuta që ishte në fuqi e për këtë thuhet: kjo ishte kryengritje! Kështu, populli shqiptar u shpall jashtëkushtetues, kështu edhe Azem Vllasi u bë viktimë e politikës represive, që zbatohet ndaj popullit shqiptar. Për këtë arsye gjykimi i Azem Vllasit dhe të tjerëve është dënim i politikës së barazisë nacionale, e cila me masa të shumta kundër shqiptarëve, në fakt, është dënuar që më parë. Gjykimi i Azem Vllasit dhe të tjerëve është gjykim i shtetit juridik nga ana e shtetit partiak, gjykim i demokracisë nga ana e autoritarizmit, gjykim i të pafuqishmëve nga ana e hegjemonëve. Historia, pa dyshim, do ta mbajë mend se Azem Vllasi ka bërë mjaft gabime në dëm të popullit shqiptar, por është e vërtetë se Azem Vllasi ishte tepër i mençur dhe tepër dinjitoz që politika e sotme serbe ta lejonte të qëndronte në Kosovë mbas plenumit të 8-të të KQ të LK të Serbisë, kur u mitraluan politikisht të gjithë ata që shprehën edhe dyshimin më të vogël për vijën e saj.

Pyetje: Ç'rezultat parashikoni nga gjykimi dhe cilat do të jenë, sipas mendimit tuaj, pasojat e tij për zhvillimet e ardhshme politike në Kosovë?

Përgjigje: Çdo njeri, që e di se parimet bazë të demokracisë janë liria e barazia e popujve dhe e qytetarëve, e ka plotësisht të qartë se Azem Vllasi dënohet, në radhë të parë, që të dënohet vullneti politik i popullit shqiptar, i shprehur me rastin e ndryshimeve kushtetuese, nga njëra anë, dhe që nëpërmjet shembullit të fatit të tij politik, të paralajmërohen njëherë e përgjithmonë kuadrot politike shqiptarë, nga ana tjetër. Kështu ai do të bëhet simbol i fatit politik të një populli që është në pakicë e që nuk është i mbrojtur. Azem Vllasi dhe të tjerët, të paktën, do të gjykohen në dritën e diellit, por çfarë të thuhet për shumë të tjerë, emrat e të cilëve askush nuk i përmend e që janë dënuar apo dënohen në një errësirë të thellë?

Pyetje: Vallë tronditjet aktuale në skenën politike jugosllave, sidomos pas miratimit të amendamenteve kushtetuese të RS të Sllovenisë, do të mund të pasqyrohen në gjykimin e Vllasit?

Përgjigje: Tronditjet politike në mjedise të tjera të Jugosllavisë gjithmonë ndihen shumë në Kosovë, ndërsa ashpërsimi i marrëdhënieve midis republikave të tjera

forcon presionin politik në krahinë. Është plotësisht e besueshme që acarimi i tanishëm midis Serbisë dhe Sllovenisë do ta keqësojë pozitën e Azem Vllasit dhe të të tjerëve. Do të ndodhte e kundërta sikur Serbia të donte demokratizimin e Federatës. Por ajo nuk e dëshiron, pasi në Serbi mendojnë, të paktën kështu tregojnë praktika politike, se demokratizimi është shkak i patologjisë politike ndërnacionale.

Sllovenët e pranojnë tani se u patën thënë më parë udhëheqësve serbë që ta rregullojnë gjendjen kushtetuese në republikën e tyre ashtu si të duan, me shpresë se edhe ata do t'u thoshin të njëjtën gjë kur të ndryshonin kushtetutën e Sllovenisë. Kryetari i mëparshëm i Kryesisë së KQ të LKJ, Stipe Shuvar, u tha të njëjtën gjë më parë udhëheqësve serbë me shpresë se kështu do të shmangeshin problemet që filluan këtë verë në Knin. Kështu, u bë e mundur që Kosova dhe Vojvodina të humbisnin atë që e kishin fituar një herë. Rezultoni, pra, që llogaritë kushtetuese në Jugosllavi u rregullovan në radhë të parë prapa shpinës së Kosovës dhe të shqiptarëve. Por që një politikë e tillë prej Çembërleni e Kroacisë dhe e Sllovenisë — të cilën, për shkak të qëndrimit të tyre ndaj shqiptarëve, e pranuan me lehtësi edhe Maqedonia dhe Mali i Zi — është dritëshkurtër, këtë e treguan në fillim ngjarjet në Knin, ndërsa tani edhe qëndrimi ndaj ndryshimeve në kushtetutën e RS të Sllovenisë. Ujku nuk akuzon vetëm një qengj se i turbullon ujin nga poshtë, por edhe qengjat e tjerë.

Pyetje: Cila është sot pozita e inteligjencies shqiptare në Kosovë?

Përgjigje: Nga viti 1981 kjo pozitë po bëhet gjithnjë e më e rëndë edhe nga pikëpamja politike, edhe nga ajo shoqërore e morale. Procesi i të ashtuquajturit diferencim më shumë godet inteligjencien. Meqenëse ky diferencim zhvillohet valë-valë e me presion, nuk është e çuditshme që shumica e valëve të shndërrohen në spastrime të vërteta. E një nga këto spastrime u bë gjatë verës. Mendoni se ç'fenomen politik është ky, kur njerëzit detyrohen që të deklarojnë se çfarë kanë menduar, çfarë mendojnë, çfarë orientimi kanë dhe për ç'arsye, për cilin janë e për cilin nuk janë. Mendoni ç'kohë e keqe politike është kjo, në të cilën

njerëzit detyrohen të pendohen si para tribunalit të Fronit të Shenjtë! Kështu, intelektualët shqiptarë janë vënë në një situatë që të lajnë hesapet me vetveten, me bindjet dhe ndërgjegjen e vet, por edhe midis tyre! Sidoqoftë, ky është bërë një proces, në të cilin njerëzit poshtërohen. Për këtë arsye mimikria është bërë fati i tyre moral, për të mos folur për ata intelektualë, të cilët janë në poste drejtorësh, kryeredaktorësh, kryetarësh dhe nënkryetarësh, dekanësh, rektorësh, zëvendësrektorësh, redaktorësh e të tjerë, të cilët gjenden në një situatë, kur detyrohen të pranojnë forma të tilla qëndrimi, për të cilat shpesh, në qoftë se u ka mbetur ndopak ndërgjegje, vuajnë shumë.

Por, megjithëkëtë, nuk është inteligjencia ajo shtresë shoqërore, pozita e së cilës është më e rëndë. Pasojat e dramës kosovare në mënyrë më tragjike pasqyrohen në jetën e më të pafuqishmëve, në jetën e masave të gjera shqiptare — te punëtorët, fshatarët, mësuesit, nëpunësit, të rinjtë. Ata, ndaj të cilëve historia gjithmonë ka qenë e pamëshirshme, e kalojnë më keq edhe në kushtet e jash-tëzakonshme në Kosovë.

Pyetje: Cili është qëllimi i diferencimit, sipas mendimit tuaj?

Përgjigje: Që të kuptohen qëllimet e masave politike, gjithmonë duhen parë rezultatet e tyre. Një numër të madh shqiptarësh diferencimi i ka flakur nga jeta publike dhe i ka izoluar plotësisht. Shumë mësues, pedagogë, profesorë, nëpunës, punëtorë i ka lënë pa punë. Shumë të rinjve u ka bërë të pamundur shkollimin e mëtejshëm. Shumë vepra letrare dhe shkencore kanë mbetur të pashkruara. Shumë vepra në pikturë, muzikë, film, teatër kanë mbetur pa u realizuar. Ky diferencim, që vazhdon pa ndërprerje prej më se tetë vjetësh, ka bërë që inteligjencia krijuese shqiptare të përqendrohet për të siguruar ekzistencën, të mendojë se si të përballojë jetën. Prandaj, për këtë diferencim do të flitet një ditë si për një luftë të shpallur kundër letërsisë, arteve, shkencës, kulturës shqiptare.

Kështu, qëllimi i diferencimit realizohet objektivisht, si një rraskapitje shpirtërore, kulturore, sociale dhe morale e shqiptarëve. Në qoftë se këtij diferencimi i shtojmë edhe izolimin, trajtimin policor të qindra mijëra njerëz-

ve, ndjekjet penale, si dhe të gjitha masat e tjera të precisionit politik e shtetëror, vetëm atëherë mund ta kuptojmë dramën e madhe që ai përbën: kemi një numër gjithnjë e më të madh emigrantësh shqiptarë në disa vende të Evropës Perëndimore, një numër gjithnjë e më të madh të rinjsh shqiptarë, që flenë nëpër stacionet e trenave të qyteteve evropiane, një numër gjithnjë e më të madh intelektualësh shqiptarë, që kërkojnë mundësinë për të shkuar jashtë shtetit. Autoritetet mund të krijojnë të gjitha parullat e mundshme. me të cilat pushteti përpiqet të fshehtë të vërtetën për Kosovën sot, por një fakt nuk mund të fshihet: populli shqiptar u është ekspozuar vuajtjeve të mëdha. Por, megjithatë, shpresojmë se nga këto vuajtje do të dalë më i pjekur dhe më i qëndrueshëm nga ana shpirtërore dhe morale.

Pyetje: Sa është midis shqiptarëve shkalla momentale e homogjenizimit të atyre, që kanë mendime të njëjta?

Përgjigje: Ndarja e shpejtë dhe e gjithanshme në shtresa objektivisht bën të pamundur çfarëdolloj homogjenizimi të shqiptarëve. Diferencimi gjithashtu shkatërron mundësinë e ekzistencës së atyre që kanë të njëjtat mendime. Udhëheqjet politike, që kanë për qëllim të grumbullojnë popullin — për shembull, në Serbi, me mitet nacionale dhe me ortodoksinë e vet, ndërsa në Slloveni me idealet demokratike — në Kosovë sikur kanë për detyrë që popullin ta tjetërsojnë, përndryshe nuk do t'u drejtoheshin vazhdimisht shqiptarëve me nocione negative, me shpata, kërcënime dhe frikësime. Duhet të lexohet diskutimi i kryetarit të Komitetit të LK të Prishtinës, Gani Jashari, në plenumin e fundit të KQ të LK të Serbisë, për të parë se njeriu shpëtimin e gjen vetëm në pyll! Megjithëkëtë, sot ka diçka që shqiptarët, pavarësisht nga çdo gjë, i afrojnë më tepër sesa më parë me njëri-tjetrin: e kjo është ndjenja se atyre po u bëhen padrejtësi të mëdha.

Pyetje: Tani, kur i është hequr izolimi një numri intelektualësh shqiptarë, ç'mendonit për qëllimin e tij të vërtetë?

Përgjigje: Një i izoluar më ka thënë: vuajtjet e të izoluarve janë një e keqe më e vogël nga qëllimet që duhej të arrinte izolimi. Me sa duket, një nga qëllimet e izolimit

ka qenë që, në bazë të deklaratave të të izoluarve, të nxirreshin para gjyqit një numër i madh intelektualësh shqiptarë.

Pyetje: Çfarë qëndrimi keni ndaj atyre intelektualëve shqiptarë, që kooperojnë me politikën e ditës?

Përgjigje: Kooperim! Intelektuali, që pranon t'i shërbejë politikës së ditës ose, siç thoni ju, të kooperojë me të, nuk e meriton të quhet me emër tjetër veçse kooperues politik. Ai nuk është më intelektual, që ka kokë për të menduar në mënyrë të pavarur dhe kritike për gjithçka, e, në radhë të parë, për politikën. Midis intelektualëve kosovarë, edhe midis shqiptarëve, edhe midis serbëve, gjithmonë ka pasur më tepër kooperues të tillë politikë sesa në mjediset e tjera të vendit. Sot, megjithatë, ka gjithnjë e më shumë intelektualë shqiptarë, që qëndrojnë larg politikës, jo sepse të gjithë ata i përkasin së ashtuquajturës inteligjencie kritike, pasi intelektualë kritikë në Kosovë ka pak, por sepse praktikisht urat midis inteligjencies dhe politikës së ditës janë shkatërruar dhe sepse politika në Kosovë është shndërruar në një pushtet autoritar, i cili i ka privuar shqiptarët nga çfarëdo lloj sovraniteti.

Pyetje: Çfarë ndikon më tepër sot në përçarjet midis kombësive në Kosovë?

Përgjigje: Nuk mendoj se ekziston ndonjë përçarje midis kombësive në Kosovë. Mendoj se ekziston përçarja midis popullit dhe pushtetit. Shqiptarët dhe serbët në Kosovë prej shekujsh jetojnë së bashku, askush nuk i ka mësuar ata e as i ka detyruar të jetojnë së bashku, por vetë jeta u tregoi se bashkërisht, duke u mbështetur te njëri-tjetri, në mirëkuptim dhe me respekt reciprok, do të jetë më lehtë dhe më mirë për të gjithë ata. Përçarjet e ndarjet janë një gjendje e panatyrshme në marrëdhëniet ndërnjerezore. Vetëm paqja dhe solidariteti janë gjë e natyrshme e njerëzimit, gjendje e natyrshme në jetën midis popujve. Megjithatë, në qoftë se ndonjëherë gjatë historisë ka pasur ndarje midis serbëve dhe shqiptarëve, ato kanë ndodhur pasi ata i kanë ndarë kryesisht ose të tjerët ose pushtetmbajtësit e vet. Pushtetmbajtësit dinë të shkatërrojnë barazinë midis popujve vetëm e vetëm që t'i zgjasin jetën sundimit të tyre.

Pyetje: Cilat janë shanset dhe mundësitë e ndonjë demokratizimi të marrëdhënieve në Kosovë?

Përgjigje: Për çfarë demokratizimi mund të flitet në Kosovë, ku vetëm gjatë 8 vjetëve 584373 njerëz janë arrestuar, marrë në pyetje, paraburgosur, u është tërhequr vërejtje dhe janë ndjekur penalisht ose për shkelje! Për ç'demokraci mund të flitet në një mjedis, në të cilin gjatë 8 vjetëve është shpallur dy herë gjendja e jashtëzakonshme! Për ç'demokraci mund të flitet në një mjedis, në të cilin diferencimi politik dhe policor janë një proces i vazhdueshëm! Mundësitë për demokratizim janë minimale sot në Kosovë, pasi kështu do Serbia. Udhëheqja serbe shfrytëzoi tensionin kosovar si mjet për t'u bërë presion organeve federative dhe republikave të tjera për të zbatuar më lehtë strategjinë e vet në të gjithë Jugosllavinë. Ajo, me ruajtjen e tensioneve kosovare, arriti të realizojë atë që nuk mund të mendohej dhe që nuk është në përputhje me prirjen e realitetit dhe me arsyen historike: që Kosovës t'i merret autonomia bazë, që kishte fituar e që është bërë pjesë e ndërgjegjes sonë dhe e vlerave të jetës sonë. Kosova, në versionet e mjeteve informative të Beogradit, është bërë kështu një kapital politik, të cilin udhëheqja serbe e ka shfrytëzuar në mënyrë të shumëfishtë për qëllimet e veta politike, me të cilat, siç shihet, shumë pak veta janë dakord në Jugosllavi dhe në botë.

Pyetje: Cili është fati juaj personal në kuadrin e këtij kompleksi të përgjithshëm?

Përgjigje: Nuk është fjala për fatin tim personal. Unë jam një intelektual me qëndrim kritik ndaj realitetit shoqëror dhe politikës. Unë jam shkrimtar dhe, si i tillë, e kam detyrë morale të them të vërtetën për njerëzit e jetën dhe jo të jem pjesë e ndonjë rezolute. Për këtë arsye, këta tetë vjet, në njëfarë mënyre, unë jam njeri i ndaluar në Kosovë. Andrallat e shumta apo të pakta, vuajtjet e shumta apo të pakta, të cilat tani po shtohen gjithnjë e më shumë, janë për mua një shfaqje gati e përditshme.

Pyetje: TANJUG-u dha një lajm, sipas të cilit në Tiranë u bë prezantimi i librit tuaj. Në Prishtinë flitet se ju u ftuat, por nuk ju dha mundësia të shkoni.

Përgjigje: Shtëpia botuese «Naim Frashëri» në Tiranë ka botuar monografinë time shkencore për poetin dhe mendimtarin e madh shqiptar, Naim Frashërin, dhe me këtë rast më ftoi që të marr pjesë në prezantimin e këtij libri. Ftesën dhe kërkesën për të shkuar në Tiranë ia dërgova Komitetit Krahinor për Marrëdhëniet me Jashtë. Megjithatë, shkuarja nuk u bë e mundur. S'ke ç'bën. Dobrica Qosiçi mund të shkojë në Suedi dhe atje të mbajë leksione për çfarë të dojë duke mos kursyer as politikanët e gjallë dhe as ata të vdekur; Milan Komneniçi dhe Vuk Drashkoviçi mund të japin të tilla deklarata në televizionin suedez, prej të cilave shumë njerëzve në Jugosllavi u rrënqethet mishi, pas pjesëmarrjes së tij në një mbledhje të gjerë në kishën ortodokse në kryeqytetin suedez; Voislav Shesheli mund të shkojë në SHBA dhe atje të bëjë parashikime se, brenda 10 vjetëve, në mes të Beogradit do të ngrihet monumenti i Drazha Mihajloviçit. Dhe të gjithë ata munden përsëri dhe përsëri të shkojnë ku të duan jashtë shtetit. Shkrimtarët serbë, maqedonë, kroatë, sllovenë, malazezë, myslimanë mund të shkojnë në prezantimet e librave të tyre në Varshavë, Moskë, Pragë, Paris, Melburn apo në Tokio, por unë nuk mund të shkoj në Tiranë në prezantimin e librit tim për personalitetin më të madh krijues në historinë e kulturës shqiptare. Ata mund të shkojnë kur të duan dhe ku të duan në botë, por Rexhep Qosja nuk mund të shkojë deri në Tiranë që atje, me rastin e një ceremonie kulturore, të shihet me miqtë e vet të dashur, me të cilët i përket së njëjtës kulturë kombëtare. Intelektualët dhe shkrimtarët hungarezë nga Vojvodina mund të shkojnë për dreka ose darka në Budapest, por Rexhep Qosja nuk mund të shkojë në prezantimin e librit të vet në Tiranë, që atje të bisedojë me kolegët e vet që merren me të njëjtën periudhë historike letrare, me të njëjtët shkrimtarë dhe fenomene të letërsisë shqiptare si dhe ai. Punonjësit shkencorë serbë, kroatë, sllovenë mund të shkojnë të shfrytëzojnë arkivat dhe bibliotekat në të gjithë botën, por shkencëtari shqiptar nga Kosova nuk mund të shkojë, tashmë prej më tepër se tetë vjetësh, të shfrytëzojë arkivat dhe bibliotekat në Shqipëri! Ndërkohë Beogradi është qyteti, në të cilin ministrat e punëve të jashtme të ven-

deve ballkanike u takuan për të çuar përpara bashkëpunimin midis popujve dhe shteteve të Ballkanit. Në dokumentet e Kombeve të Bashkuara pamundësia e komunikimeve kulturore midis pjesëtarëve të të njëjtit komb quhet genocid kulturor. Po, genocid kulturor.

*«Sudbina izvanustavnog naroda»,
«Slobodna Dalmacija», Split,
8.10.1989*

PËRMBAJTJA

Paraqitja	3
-----------------	---

I. NDRYSHIMET NË KUSHTETUTËN E RS TË SERBISË DHE PASOJAT PËR STATUSIN JURIDIK TË KO- SOVËS.

Apel i punëtorëve shkencorë dhe kulturorë për mbrojtjen institucionale dhe afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ-së, drejtuar Kuvendit të RS të Serbisë dhe opinionit të Jugosllavisë	7
RRUSTEM RUGOVA — Autonomia e krahinave në thumb	15
ALI ALAJ — Kërkesa e artikulime absurde	20
IBRAHIM RUGOVA — Serbët vijnë përsëri si hakmarrës	23
RRUSTEM RUGOVA — Shkelje e marrëveshjeve	28
Prof. Dr. ZEKERIA CANA — Larja e hesapeve në Kosovë	33
SHKËLZEN MALIQI — Gjithçka mund të parashikohej.	39
JUSUF FERIZI — Letër e hapur drejtuar Aleksandër Perljas	43
ALI ALIU — MILAZIM KRASNIQI — Komisari i ndër- lidhjes	45

II. KRIZA E KOSOVËS DHE GJENDJA E JASHTËZA- KONSHME

MUHAMEDIN KULLASHI — Kriza kosovare dhe kriza e Jugosllavisë	53
---	----

REXHEP QOSJA — Letër e hapur shkrimtarëve serbë, pjesëmarrës në takimin «Mbi Kosovën dhe për Kosovën»	64
FEHMI AGANI — Vështrim kritik lidhur me diskursin politik për Kosovën dhe shqiptarët ...	76
REXHEP QOSJA — Një gram pushtet rëndon më shumë se një tonelatë mend	100
XHEMAIL MUSTAFA — Kosova si Atlantidë	109
Peticion i 184 shqiptarëve të Fushë-Kosovës: Të gatshëm për luftim vetëm të nacionalizmit të vërtetë	113
REXHEP QOSJA — Autonomia e pezulluar	116
ALI ALIU — Fshehja e së vërtetës	121
IBRAHIM RUGOVA — Strategji antishqiptare	125
Dr. AGIM VINCA — Edhe incesti mungonte	128
REXHEP QOSJA — Rojat e mjegullës	131
AGIM HYSENI — Me mohime e dyshime nuk ngrihen ura «N.N. —shqiptar i izoluar» — Intervistë në «Mlladina» ...	151
REXHEP QOSJA — Evropa në mënyrën ballkanike	157
JUSUF BUXHOVI — Letër e hapur drejtuar Kryetarit të Kryesisë së RSFJ Janez Dërnovshek ...	168
Prof. Dr. ZEKERIA CANA — Fshesa e çeliktë nuk kursen askënd.	172
RAMIZ KELMENDI — Situata kafkiane	182
IBRAHIM RUGOVA — Intervistë botuar në revistën «Start»	187

III. HISTORIA DHE TRADITAT E SHQIPTARËVE

Reagim i Shoqatës së pedagogëve universitarë dhe të pu- nonjësve shkencorë të Kosovës — «Ç'nuk qenka shqip- tarizim»!	207
RABIT REXHEPI — Zenel Hajdini e jo Zejnel Ajdinoviç	222
Dr. KAJTAS RREÇAJ — Planprogrami i papranueshëm ...	225
Dr. AGIM VINCA — Mitizim i realitetit	228
BESIM BOKSHI — Do të frenoj të qeshurit	235
REXHEP OSMANI — Nuk u pranuan as «të paobligueshmet»	238
REXHEP QOSJA — Margjinalizimi i çështjeve të rëndësishme	244
ASTRIT SHEZIMANI — Pa kritere	260
BAJRAM KABASHI — Kërkesa që provokojnë	263

Reagim i punonjësve shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës — Kërkesa e qëndrime që zhvlerësojnë historinë e traditën	267
Letër e tetë arsimtarëve dhe nxënësve të shkollës «Skënderbeg» të Preshevës — Kur të mirët prishen	274
Dr. HAJRULLA KOLIÇI — Arsimin kosovar?	277

IV. GJENDJA EKONOMIKE E SHOQËRORE E KOSOVËS

HIVZI ISLAMI — Problemet demografike të Kosovës dhe interpretimi i tyre	283
ZENUN ÇELAJ — Sikur janë zgjatur muajt	319
RAMUSH TAHIRI — Pikëpamje shkencore e jo politizim	326
YMER BAJRA — Limiti i quajtur strukturë	332
ZENUN ÇELAJ — Me mesatare — as ekzistenca	338
XHEMAIL REXHEPI — Sa peshojnë shpërpjesëtimet? ...	342

V. FATI I NJË POPULLI JASHTËKUSHTETUES

SHKËLZEN MALIÇI — Masakrimi i elitës kulturore	349
IBRAHIM RUGOVA — Nuk jemi opozitë, ne jemi armiq ...	359
REXHEP QOSJA — Genocid kulturor	362

Rofë

KOSOVA

VIVE de La Cosov-

Tirazhi 12000 kopje

Format 60x90/16

Stazh 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja e Re, Tiranë 1989

